cimi i mëtejshëm i ekonomive të kooperativave bujqësore e të rritet niveli i jetesës së fshatarësisë,

Vendosën:

Kooperativave bujqësore t'u falen kreditë e dhëna nga shteti për elektrifikimin e fshatit të pashlyera deri më 31 tetor 1971 për një shumë prej rreth 130 milion lekë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Komiteti Qendror i PPSH dhe Këshilli i Ministrave i RPSH shprehin besimin se fshatarësia kooperativiste, në përgjigje të këtij vendimi do t'i shumëfishojë përpjekjet e veta dhe do të mobilizojë të gjitha forcat për të plotësuar me nder detyrat e mëdha të zhvillimit të shpejtë dhe intensiv të bujqësisë sonë socialiste.

KOMITETI QENDROR I PPSH

KËSHILLI I MINISTRAVE I RPSH

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 251 (7228), 21 tetor 1971

KONGRESI I 6-TË I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Tiranë, 1-7 nëntor 1971

Kongresi i 6-të zhvilloi punimet e veta në Tiranë prej 1 deri më 7 nëntor 1971. Në Kongres merrnin pjesë 676 delegatë me votë deliberative dhe 174 me votë konsultative, që përfaqësonin 68 858 anëtarë dhe 18 127 kandidatë për anëtarë partie.

Kongresi punoi me këtë rend dite:

1. — Raport «Mbi veprimtarinë e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë», mbajtur nga Sekretari i Parë i Komitetit Qendror, shoku Enver Hoxha.

2. — Raport «Mbi aktivitetin e Komisionit Qendror të Kontrollit e të Revizionimit të Partisë», mbajtur nga kryetari i komisionit shoku Ibrahim Sina.

3. — Raport «Mbi direktivat e Kongresit të 6-të të PPSH për planin e pestë pesëvjeçar (1971-1975) të zhvillimit ekonomik e kulturor të Republikës Popullore të Shqipërisë», mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike dhe Kryetar i Këshillit të Ministrave, shoku Mehmet Shehu.

4. — Zgjedhja e organeve qendrore të Partisë.

Kongresi i bëri një analizë të thellë e shkencore marksiste-leniniste veprimtarisë së Partisë që nga Kongresi i 5-të dhe përgjithësoi në një shkallë më të lartë përvojën revolucionare të Partisë dhe të masave punonjëse, sidomos në vitet e fundit. Ai bëri bilancin e rezultateve të arritura në fushën politike, ideologjike, ekonomike e kulturore, përcaktoi detyrat për zhvillimin e për thellimin e pandërprerë të revolucionit socialist në të gjitha fushat si dhe për luftën kundër frontit të bashkuar imperialisto-revizionist.

Kongresi mori vendime të rëndësishme me të cilat iu hapën vendit tonë perspektiva të shkëlqyera për të ardhmen.

Kongresi miratoi direktivat e planit të pestë pesëvjeçar, bëri dhe disa ndryshime të pjesshme në Statutin e Partisë.

Kongresi zgjodhi organet udhëheqëse të Partisë: Komitetin Qendror të PPSH prej 71 anëtarësh dhe 39 kandidatësh si dhe Komisionin Qendror të Kontrollit e të Revizionimit.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, i zgjedhur nga Kongresi i 6-të, në mbledhjen e tij më 7 nëntor 1971, zgjodhi Byronë Politike të përbërë prej 13 anëtarësh e 4 kandidatësh dhe Sekretariatin e Komitetit Qendror të përbërë nga 4 sekretarë. Sekretar i Parë i Komitetit Qendror u zgjodh përsëri shoku Enver Hoxha.

RAPORT

I MBAJTUR NË KONGRESIN E 6-TË TË PPSH NGA SEKRETARI I PARË I KQ TË PPSH SHOKU ENVER HOXHA «MBI VEPRIMTARINË E KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË»

1 nëntor 1971

Të dashur shokë e shoqe delegatë,

Kongresi i 6-të i Partisë është thirrur të bëjë bilancin e punës vetëmohuese e heroike, që komunistët dhe gjithë populli ynë kanë kryer në këto pesë vjet për zhvillimin e pandalshëm të revolucionit dhe për ndërtimin me sukses të socializmit në Shqipëri. Duke qenë forumi më i lartë i Partisë, atij i takon nderi dhe përgjegjësia e madhe të caktojë objektivat themelorë për periudhën e ardhme, detyrat e Partisë dhe rrugët për realizimin e tyre.

Kongresi i 6-të, ashtu si edhe kongreset e tjera të Partisë, do të shënojë një etapë të re në marshimin tonë fitimtar, një shkallë tjetër më të lartë ngjitjeje e përparimi të gjithanshëm të shoqërisë sonë socialiste.

Sytë dhe zemrat e gjithë popullit punonjës të Shqipërisë janë drejtuar tani te kongresi ynë, sepse jeta, aspiratat dhe e ardhmja e popullit janë të lidhura ngushtë me Partinë e Punës, me vijën dhe veprimtarinë e saj, sepse interesat e Partisë, të popullit dhe të atdheut tonë socialist janë një e të pandara.

Me punën e tij kongresi ynë do ta justifikojë plotësisht besimin dhe dashurinë e patundur që kanë klasa punëtore dhe gjithë punonjësit te Partia e tyre, tek e cila ata shohin udhëheqësen e sprovuar, garancinë e fitoreve të arritura dhe të së ardhmes komuniste.

Kongresi i 6-të mblidhet në pragun e një feste të madhe,

tridhjetëvjetorit të themelimit të Partisë heroike të Punës. Tridhjetë vjet jetë të Partisë janë 30 vjet beteja e fitore të lavdishme, 30 vjet luftë e punë titanike për krijimin e ndërtimin e Shqipërisë së re. Kjo është periudha më e ndritur dhe më e madhërishme në historinë shumëshekullore të popullit tonë, kur ai, i udhëhequr nga Partia, kaloi nga errësira në dritë, tregoi me një forcë të paparë vitalitetin, trimërinë dhe shpirtin e tij të pamposhtur liridashës, kur, si asnjëherë tjetër, shpërthyen talenti, aftësitë dhe energjitë e tij krijuese, kur Shqipëria i doli zot vetes në arenën ndërkombëtare dhe me dinjitet e meritë qëndron në radhët e popujve dhe të kombeve të përparuar të botës.

Lavdia e të gjitha këtyre fitoreve u takon bijve dhe bijave heroike që bënë fli jetën e tyre për idealet fisnike të Partisë e të popullit, u takon atyre që kanë shkrirë të gjitha forcat fizike e mendore për fuqizimin e lulëzimin e atdheut socialist, klasës punëtore, fshatarësisë punonjëse, inteligjencies popullore, gjithë popullit tonë, që me guxim e frymë të lartë revolucionare çojnë përpara çështjen e socializmit në Shqipëri.

Në të gjitha fitoret e arritura në këta 30 vjet është mishëruar vija konsekuente e parimore e Partisë. Në themel të saj kanë qëndruar e qëndrojnë mësimet jetëdhënëse të marksizëm-leninizmit, të cilat Partia jonë i ka zbatuar në mënyrë krijuese dhe i ka mbrojtur me vendosmëri. Këto mësime kanë qenë busulla që na ka udhëhequr në të gjitha betejat, janë ato që kanë ndriçuar dhe ndriçojnë rrugën tonë revolucionare.

Partia e Punës e Shqipërisë u krijua për të çliruar Shqipërinë, për të bërë revolucionin, për të vendosur diktaturën e proletariatit dhe për të ndërtuar socializmin në Shqipëri. Sot, në tridhjetëvjetorin e Partisë, ne jemi krenarë që këtë mision historik, të cilin komunistët shqiptarë e morën përsipër qysh në ato ditë të vështira të Nëntorit 1941, e shohim të realizuar me sukses. Shqipëria është e lirë dhe e pavarur, klasa punëtore mban fort në duart e saj pushtetin e diktaturës së proletariatit, socializmi ka triumfuar në të gjitha fushat.

Filli i kuq që përshkon tërë jetën e veprimtarinë e Partisë është lufta e saj e ashpër dhe e vendosur kundër të gjithë armiqve të klasës, është besimi i pakufishëm në popull dhe mbështetja e patundur në forcat e tij të pashtershme, është besnikëria ndaj idealeve të internacionalizmit proletar.

Dallgë të egra janë vërsulur në këto vite kundër Partisë dhe Shqipërisë socialiste. Imperialistët, revizionistët dhe gjithë armiqtë e tjerë të brendshëm e të jashtëm, me një mijë mënyra janë

përpjekur të na largojnë nga rruga e drejtë, të ndalin marshimin tonë fitimtar. Por Partia dhe populli ynë kanë qëndruar si shkëmb graniti dhe i kanë shpartalluar orvatjet e tyre për të na mposhtur e gjunjëzuar.

Populli ynë ka dalë gjithnjë fitimtar, sepse ka pasur dhe ka një Parti të fortë e revolucionare, e cila e ka mbajtur gjithnjë të mprehtë vigjilencën dhe tehun e luftës klasore, sepse te ne është farkëtuar një unitet i çeliktë dhe i palëkundshëm i Partisë me popullin. Në luftën tonë nuk kemi qenë kurrë të izoluar dhe të vetëm. Populli dhe Partia kanë pasur dhe kanë ndierë kurdoherë nga afër ndihmën e përkrahjen e fuqishme dhe solidaritetin e partive marksiste-leniniste, të popujve të vendeve socialiste, të të gjithë revolucionarëve e njerëzve përparimtarë të botës.

Si në ditët e para të jetës së saj, Partia jonë është gjithnjë e re e dinamike. Tridhjetë vjetët që kaluan i dhanë asaj pjekurinë e luftëtarit të sprovuar në beteja, e kalitën politikisht e ideologjikisht, e formuan si një parti të vërtetë revolucionare me rrënjë të thella në klasën punëtore e në popullin shqiptar, e bënë atë një brigadë sulmuese të komunizmit ndërkombëtar.

Procesi i madh i revolucionarizimit të gjithanshëm, që u zhvillua me vrull veçanërisht pas Kongresit të 5-të, forcoi edhe më tej pozitat e socializmit në Shqipëri, rriti shpirtin luftarak dhe gjallëroi tërë jetën e veprimtarinë e Partisë, i dha një nxitje të paparë iniciativës e krijimtarisë së masave, zhvillimit të hovshëm të ekonomisë e kulturës popullore.

Kjo ka qenë një luftë e madhe klasore për t'i prerë rrugën çdo mundësie të lindjes së revizionizmit dhe të kthimit prapa të shoqërisë, një luftë për të çuar përpara dhe në mënyrë të pandërprerë revolucionin dhe ndërtimin e socializmit.

Në këtë kongres Partia jonë vjen me një përvojë të pasur e me rezultate të mëdha, me një unitet të pathyeshëm të radhëve të saj, e gatshme të marrë përsipër barrë të reja edhe më të rënda për të mirën e lumturinë e popullit, e vendosur për të çuar deri në fund çështjen e socializmit e të revolucionit.

Punimet dhe vendimet e Kongresit të 6-të me siguri do t'i japin një shtytje të re e të fuqishme gjithë punës dhe luftës sonë revolucionare, zhvillimit të gjithanshëm të ekonomisë, kulturës dhe ngritjes së mirëqenies së popullit, që atdheu ynë të qëndrojë gjithnjë kështjellë e pamposhtur e socializmit, që Partia jonë të mbajë si kurdoherë lart e të pastër flamurin ngadhënjimtar të marksizëm-leninizmit.

I

GJENDJA NDËRKOMBËTARE DHE POLITIKA E JASHTME E REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

Kongresi ynë i 6-të mblidhet në një kohë kur ekzistojnë kontradikta dhe ballafaqime të mëdha në shkallë botërore, kur, si asnjë herë tjetër, janë grumbulluar e janë vënë kundrejt njëra-tjetrës forca të mëdha klasore, politike, ekonomike e ushtarake që përfshijnë tërë globin.

Nga njëra anë e barrikadës qëndrojnë forcat e imperializmit, revizionizmit e reaksionit dhe nga ana tjetër forcat e socializmit, fronti i popujve, me klasën punëtore ndërkombëtare në krye. Vija e demarkacionit midis tyre po bëhet gjithnjë e më e qartë në të gjitha fushat.

Kuptimi i drejtë i këtyre kontradiktave, shqyrtimi realist e objektiv i raportit të forcave që veprojnë në arenën ndërkombëtare, njohja e tendencave themelore të zhvillimit të sotëm botëror përbëjnë një moment me rëndësi vendimtare në luftën kundër imperializmit e revizionizmit, në luftën për fitoren e revolucionit.

Tendenca e zhvillimit të sotëm botëror është revolucioni dhe fitorja e socializmit

Ngjarjet që kanë ndodhur në botë gjatë këtyre pesë vjetëve të fundit vërtetojnë vlerësimin e drejtë që i bëri Partia jonë në Kongresin e saj të 5-të gjendjes dhe prirjeve të zhvillimit të marrëdhënieve ndërkombëtare. Duke analizuar tani situatën në botë, ne mund të theksojmë se jo vetëm ajo është në favor të revolucionit, por edhe se revolucioni po bëhet aspiratë e përgjithshme e popujve.

Ky vlerësim i situatës nuk është një deklaratë e thjeshtë optimiste, por shpreh realitetin objektiv, procesin historik të zhvillimit të sotëm botëror, ku duken qartë acarimi i antagonizmave socialë dhe rritja e forcimi i pandërprerë i luftës revolucionare të popujve, të cilat po tronditin nga themelet botën imperialiste e revizioniste dhe po thellojnë më tej krizën e gjithanshme të saj.

Ne sot jemi dëshmitarë të përleshjeve të mëdha klasore midis punonjësve dhe kapitalit e pushtetit të tij. Lufta klasore e proletariatit dhe e shtresave të tjera shoqërore të shfrytëzuara ka

marrë të tilla përpjesëtime, si për sa i përket numrit të pjesëmarrësve, ashtu edhe mprehtësisë së saj, saqë periudha e sotme mund të krahasohet me periudhat më kritike që ka kaluar borgjezia e vendeve kapitaliste. Betejat e shkëlqyera të punonjësve francezë, italianë, spanjollë, anglezë, belgjianë etj., përvoja pozitive e negative e fituar, do të lënë gjurmë të pashlyeshme në ndërgjegjen e tyre. Edhe në ato vende që propaganda borgjeze i paraqiste si zona të «paqes klasore» të përjetshme po zhvillohen beteja të fuqishme midis punonjësve e kapitalit. U thye edhe këtu miti i përrallave socialdemokrate të «evolucionit shoqëror» për krijimin e mirëqenies së përgjithshme nën sistemin kapitalist.

Shumë janë acaruar kontradiktat sociale në vetë Shtetet e Bashkuara. Si rezultat i dështimeve në politikën e jashtme e të brendshme është thelluar edhe më tepër kriza politike, ekonomike e shoqërore e imperializmit janki, është zgjeruar edhe më shumë lufta revolucionare e popullit amerikan. Kështjella e imperializmit po tronditet nga revolta e gjerë e zezakëve amerikanë për barazi e të drejta civile dhe e gjithë popullit kundër luftës në Vietnam.

E rëndësishme në këto beteja të reja klasore që zhvillohen në vendet kapitaliste është dalja në plan të parë e kërkesave politike, rritja e ndërgjegjes revolucionare të punonjësve, shkëputja gjithnjë e më e madhe nga ndikimi i oportunizmit socialdemokrat e revizionist.

Një tjetër veçori e luftës klasore kundër sistemit shfrytëzues kapitalist dhe politikës imperialiste është shpërthimi kudo i lëvizjes së rinisë e të studentëve, e cila po shndërrohet në një forcë të fuqishme revolucionare të kohës sonë. Rinia e botës kapitaliste nuk është e kënaqur as me gjendjen e saj sociale, as me sistemin që i ka mbyllur të gjitha shtigjet e perspektivës. Ajo tani është në kërkim të së vërtetës dhe e vërteta po e çon dhe do ta çojë me siguri drejt bashkimit me klasën punëtore, drejt revolucionit.

Imperializmi botëror po merr goditje gjithnjë e më të rënda nga lufta çlirimtare e popujve të Azisë, Afrikës e Amerikës Latine, e cila po zhvillohet kudo me vrull. Një shembull i shkëlqyer i hovit të madh të saj dhe një nxitje e fuqishme për të është lufta e vendosur antiimperialiste e popullit të Vietnamit dhe e popujve të tjerë të Indokinës, të cilët e rrëzuan një herë e përgjithmonë mitin e pathyeshmërisë së superfuqisë amerikane, të makinës së saj ushtarake dhe të armëve moderne.

Përpjesëtime të reja edhe më të mëdha ka marrë lufta e armatosur antiimperialiste e popujve të Tajlandës, të Birmanisë,

të Malezisë e të Indonezisë në Azi. Zhvillim të gjerë ka marrë lufta revolucionare e popujve të Brazilit e të Kolumbisë, të Kilit e të Perusë, të Bolivisë, të Argjentinës e të vendeve të tjera në Amerikën Latine kundër imperializmit amerikan dhe oligarkive vendëse për mbrojtjen e sovranitetit e të pavarësisë kombëtare, për zhvillimin demokratik e të pavarur, për përparimin shoqëror. Një situatë e re revolucionare ka filluar të krijohet edhe në Afrikë. Popujt janë përfshirë kudo nga vala e luftës kundër kolonializmit të vjetër e të ri, kundër forcave shtypëse e reaksionare për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë së tyre. As politika e diktatit, as mashtrimet, as dhuna e armatosur e imperializmit nuk mund të mposhtin vullnetin e popujve për të luftuar dhe për të marrë në duart e veta fatin e tyre.

Imperializmi dhe revizionizmi po tërheqin mbi vete urrejtjen e popujve, të cilët te politika amerikane dhe ajo e revizionistëve sovjetikë shohin rrezikun e lirisë e të pavarësisë së tyre. Popujt duan lirinë, janë kundër ndërhyrjes brutale të imperialistëve e të revizionistëve, dënojnë politikën e tyre të hegjemonisë e të shantazhit. Kudo rritet e forcohet ndjenja e antiamerikanizmit, ashtu siç po rritet e forcohet kundërshtimi ndaj socialimperializmit sovjetik.

Ngjarje e rëndësishme në lëvizjen revolucionare të viteve të fundit është rritja e partive të reja marksiste-leniniste. Sot thuajse në të gjitha vendet e botës janë krijuar parti ose organizata marksiste-leniniste, të cilat gjithnjë e më me sukses po vihen në radhët e para të luftës revolucionare e çlirimtare. Kjo është një ngjarje e madhe historike që dëshmon për vitalitetin e ideve të marksizëm-leninizmit, që provon se perspektiva e revolucionit dhe e fitores së socializmit po bëhen gjithnjë e më të qarta.

Rritja e forcave revolucionare dhe e hovit revolucionar në botë tregon se, me gjithë përpjekjet e mëdha e të ethshme për të kthyer prapa rrotën e historisë, imperializmi dhe revizionizmi nuk kanë mundur dhe nuk do të mundin kurrë të ndryshojnë raportin e përgjithshëm të forcave që anon gjithnjë e më shumë nga revolucioni. Iniciativa historike ka kaluar përfundimisht në duart e klasës punëtore e të popujve. Rrugën e zhvillimit të shoqërisë së sotme njerëzore e hap dhe e përcakton revolucioni.

Zhvillimi e zgjerimi plot sukses i lëvizjes revolucionare botërore dhe i luftës së popujve është prova më e qartë e thellimit të krizës së rëndë, në të cilën gjenden armiqtë më të urryer të popujve, imperializmi e revizionizmi.

Tradhtia e revizionistëve modernë hrushovianë, që i solli një dëm të madh lëvizjes revolucionare, qe një avantazh i përkohshëm për sistemin kapitalist në përgjithësi. Por ajo nuk e shpëtoi

dot kapitalizmin nga kriza e përgjithshme, ashtu si nuk ndryshoi dot kursin e historisë, tendencën e zhvillimit të saj drejt revolucionit e fitores së socializmit.

Në planin e vetë sistemit të tij shfrytëzues, imperializmi synonte të zhdukte krizat ekonomike dhe të mënjanonte kontradiktat e thella midis vendeve kapitaliste. Edhe këtu ai ka pësuar disfatë. Vendet e mëdha kapitaliste, pa përmendur të voglat, tani ndodhen në një fazë kur fenomenet e krizës janë bërë kronike dhe kanë krijuar vështirësi të reja për tërë ekonominë e tyre. Kriza e sistemit financiar-valutor është bërë këto vitet e fundit një sëmundje e pashërueshme. Rriten me hapa të shpejtë inflacioni e shtrenjtësia e jetesës, me miliona numërohen të papunët. Tronditjet e thella të pozitave sunduese të dollarit amerikan dhe masat shtrënguese të Niksonit kanë shkaktuar një çoroditje e rrëmujë të madhe në tërë botën kapitaliste. Kriza e dollarit nuk është vetëm krizë e monedhës amerikane dhe as e monedhave të shteteve të tjera kapitaliste. Kjo është një shprehje e dukshme e krizës së përgjithshme ekonomike, politike, ushtarake e ideologjike e të gjithë sistemit kapitalist, e strukturave dhe e superstrukturave të tij, e regjimeve dhe e aleancave kapitaliste e imperialiste.

Të gjitha këto fenomene i kanë shtuar e acaruar edhe më shumë kontradiktat midis vendeve të ndryshme borgjeze e sidomos kontradiktat me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Lufta ekonomike e politike midis vendeve kapitaliste po merr proporcione gjithnjë e më të mëdha. Integrimet ekonomike dhe formimi i blloqeve ushtarake e kanë shtuar edhe më tepër konkurrencën e pamëshirshme midis tyre. «Tregu i përbashkët» evropian kërkon tani të sfidojë supremacinë amerikane në tregun botëror, ndërsa fuqia e re ekonomike e Japonisë me ndërhyrjen e saj po e shtrëngon mjaft ekspansionin e monopoleve amerikane në Azi. Grindje të mëdha kanë shpërthyer në gjirin e NATO-s dhe të aleancave të tjera të imperializmit. Tendenca e këtyre rivaliteteve dhe e kontradiktave midis vendeve imperialiste shkon drejt thellimit të mëtejshëm.

Për të konsoliduar pozitat e tij, për të shmangur vështirësitë ekonomike, kontradiktat politike dhe konfliktet sociale, imperializmi është përpjekur dhe përpiqet t'u përshtatet kushteve të reja të luftës klasore si brenda, ashtu dhe jashtë vendit. Por as zhvillimi i kapitalizmit monopolist shtetëror, as koncentrimi në shkallë kombëtare e ndërkombëtare i prodhimit dhe i kapitaleve, as militarizimi i ekonomisë dhe as revolucioni tekniko-shkencor nuk e kanë shpëtuar dhe nuk mund ta shpëtojnë kurrë atë nga disfatat dhe shembja e tij e pashmangshme. Zgjidhjet e pjesshme e të përkohshme që ato mund të japin, janë të mbarsura me kontradikta e konflikte të reja akoma më të ashpra, me një krizë

akoma më të thellë e më tronditëse të tërë sistemit kapitalist botëror.

Një situatë po kaq e rëndë sundon tani edhe në kampin revizionist. Partia jonë, e ndriçuar nga teoria marksiste-leniniste, parashikoi drejt se ku do t'i çonte revizionistët rruga e tyre e tradhtisë, parashikoi rënien dhe degjenerimin e tyre të gjithanshëm. Kriza që po kalon revizionizmi është edhe ideologjike, edhe politike, edhe ekonomike. Krerët e Moskës jo vetëm që dështuan në përpjekjet për të vendosur sundimin e tyre mbi lëvizjen komuniste dhe për të kontrolluar atë nacionalçlirimtare, por ata tani nuk janë në gjendje të bëjnë zap as edhe aleatët më të afërt, klikat revizioniste në vendet satelite.

Midis reparteve të ndryshme të revizionizmit nuk ka as unitet ideologjik, as unitet veprimi. Konfliktet dhe grindjet midis klikave revizioniste në fuqi përbëjnë një fenomen të zakonshëm dhe kanë arritur në pika të larta tensioni, që mund të shpërthejnë në çdo moment. Në radhët e partive revizioniste janë krijuar fraksione e rryma nga më të ndryshmet. Tradhtia ndaj marksizëm-leninizmit futi në radhët e këtyre partive konfuzionin dhe shthurjen.

Vendet revizioniste dhe vetë kreu i tyre Bashkimi Sovjetik kanë filluar të vuajnë nga plagët kronike të shoqërisë borgjeze. Pakënaqësia që ka shkaktuar në masat vija revizioniste po shndërrohet në një revoltë të hapët. Ngjarjet e vitit të kaluar në Poloni treguan se klasa punëtore iu kundërvu ballë për ballë pushtetit revizionist. Shembulli i punëtorëve polakë që zbritën në fushën e betejës është frymëzues për gjithë punonjësit e popujt e vendeve ku sundojnë revizionistët. Ai është një kushtrim lufte për përmbysjen e tradhtisë revizioniste.

Imperializmi dhe revizionizmi në stadin e tyre të tanishëm, me gjithë pamjen e jashtme të fuqishme, janë të dobët, kalbëzohen dhe degjenerohen përditë e më shumë. Ata sot nuk janë në gjendje të zgjidhin asnjë problem themelor të brendshëm dhe të realizojnë asnjë qëllim kryesor të tyre të jashtëm.

Imperializmit, revizionizmit dhe gjithë reaksionarëve të tjerë po u dridhet toka nën këmbë. Në epokën tonë s'ka asnjë forcë në botë që mund të ndalë marshimin fitimtar të revolucionit dhe të socializmit.

Ne, komunistët shqiptarë, ashtu si edhe gjithë marksistë-leninistët kudo që ndodhen, e shikojmë të ardhmen e botës me optimizëm, të bindur se ajo i takon lirisë e pavarësisë së popujve, i takon socializmit. Por optimizmi ynë revolucionar nuk na ndalon të shohim në të njëjtën kohë edhe kërcënimet e rreziqet për vendin tonë dhe për të gjithë popujt, që vijnë nga imperializmi amerikan e politika e tij agresive dhe nga imperializmi i ri revizionist sovjetik, të cilët së bashku pretendojnë për hegjemoninë dhe sundimin botëror.

Me gjithë ndryshimet që janë bërë e po bëhen në botë, imperializmi amerikan ka qenë dhe mbetet armiku kryesor i të gjithë popujve, shtypësi dhe shfrytëzuesi më i madh i vendeve të tjera, bastioni i reaksionit ndërkombëtar. Përderisa ai qëndron në këmbë, mbetet e pandryshuar edhe natyra e tij reaksionare, mbetet politika e strategjia e tij agresive e luftënxitëse, që buron nga vetë thelbi i sistemit të tij shfrytëzues. Imperializmi amerikan nuk mund të jetojë pa ekspansion ekonomik, pa ndërhyrje politike e agresione ushtarake, pa shtypur e shfrytëzuar popujt e tjerë. Ndryshe ai vdes, hapet rruga për revolta e revolucione.

Ngjarjet e viteve të fundit vërtetojnë më së miri se imperializmi i SHBA-së jo vetëm nuk ka hequr dorë, por bën çmos për ta minuar lirinë e pavarësinë e shteteve të tjera dhe për të vendosur sundimin e tij botëror. Kudo ai vringëllon armët, kudo ai kërcënon me luftë.

Imperialistët amerikanë po vazhdojnë luftën e tyre barbare në Vietnam. Ata e shtrinë agresionin e tyre edhe në Kamboxhia e Laos, duke u shkaktuar kështu gjithë popujve heroikë të Indokinës shkatërrim, vrasje e plagë të rënda. Me nxitjen dhe me ndihmën aktive të drejtpërdrejtë të SHBA-së, Izraeli shpërtheu agresionin kundër vendeve arabe dhe mban të pushtuara tokat e tyre. Komplotet, aktet e subversionit, ndërhyrjet e dhuna e armatosur në Libi, në RP të Kongos ose në Somali, në Guine ose në shumë vende të Azisë e të Amerikës Latine kanë qenë dhe janë vepër e imperialistëve amerikanë. Shtetet e Bashkuara janë aleatët dhe garantët e të gjitha regjimeve reaksionare e fashiste, janë mbrojtësit kryesorë të sistemit ndërkombëtar të shfrytëzimit kapitalist.

Agresioni i hapët gjithnjë e më tepër po del si mjet kryesor për sigurimin e pozitave të sundimit ekonomik, politik e ushtarak të SHBA-së në vendet e tjera. Realizimin e kësaj strategjie imperialistët amerikanë përpiqen ta arrijnë edhe me anë të politikës së neokolonializmit e të përpjekjeve për ruajtjen e monopolit teknik e shkencor si mjet ndërhyrjeje, shtypjeje e shfrytëzimi.

Mund të thuhet se praktikisht sot nuk ka vend të lirë e të pavarur, që në këtë ose atë formë të mos jetë i kërcënuar nga imperializmi amerikan, të mos ndiejë presionet e shantazhet e tij, të mos preket nga ndërhyrjet e tij brutale.

Përballë popujve qëndron një armik i madh, i pangopur e barbar. Për këtë arsye edhe lufta kundër imperializmit amerikan është bërë një detyrë supreme për të gjitha forcat revolucionare të kohës sonë, për të gjithë popujt. Kontradikta e thellë që ekziston midis imperializmit amerikan e politikës së tij agresive nga njëra anë dhe popujve e luftës së tyre antiimperialiste, nga ana tjetër, do të vijë gjithnjë duke u ashpërsuar dhe duke u bërë më

e mprehtë. Në përleshjen midis tyre nuk mund të ketë as periudha qetësie, as lëshime dhe as tërheqje, siç predikojnë revizionistët. Çdo lëkundje në luftën kundër imperializmit është e mbarsur me pasoja shumë të rrezikshme.

Por imperializmi amerikan nuk është i vetmi armik i popujve; as duhen konsideruar si aleatë të tij vetëm kukullat reaksionare të lidhura drejtpërdrejt politikisht, ushtarakisht e financiarisht me Uashingtonin. Anglia, Gjermania Perëndimore, Japonia e vendet e tjera imperialiste, me gjithë kontradiktat që kanë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, mbeten partnerët kryesorë të tyre, ndjekin gjithashtu politikën e ekspansionit ekonomik e të neokolonializmit ndaj vendeve të tjera, kërkojnë të krijojnë sfera influence dhe kurdoherë dalin në përkrahje të reaksionit botëror. Evropa e bashkuar, që po kurdis kapitali i Evropës Perëndimore, synon të bëhet një superfuqi e re imperialiste me pretendime hegjemoniste e sunduese të njëllojta me ato të Shteteve të Bashkuara të Amerikës e të Bashkimit Sovjetik. Lufta kundër imperializmit amerikan do të ishte joefikase, në qoftë se nuk luftohet edhe kundër miqve e aleatëve të tij, gjithë fuqive imperialiste.

Qëndrimi ndaj imperializmit, e në radhë të parë ndaj atij amerikan, përbën «gurin e provës» për të gjitha forcat politike të botës. Kjo nuk është një çështje e thjeshtë taktike, as edhe një zgjidhje e përkohshme koniunkturale. Qëndrimi ndaj imperializmit është çështje përmbajtjeje e vijës politike, ai është masë vlerësimi e veprimeve praktike, është më në fund një vijë demarkacioni që ndan dy kampet në luftë, që ndan ata të cilët mbrojnë interesat jetike të popujve dhe të së ardhmes së njerëzimit, nga ata që i marrin këto nëpër këmbë, që ndan revolucionarët nga reaksionarët e tradhtarët.

Lufta antiimperialiste nuk ka kudo dhe nuk mund të ketë të njëjtën shtrirje dhe të njëjtin intensitet. Por e rëndësishme është që popujt të ngrihen në luftë çlirimtare kundër imperializmit, jo vetëm për t'ia bërë jetën të pamundur, por edhe për t'ia shkurtuar. Vetëm rezistenca e vendosur, lufta e hapët e dhëmb për dhëmb, mostërheqja përpara vështirësive e sakrificave mund ta detyrojnë atë të zmbrapset e të mposhtet. Detyra e revolucionarëve është që t'i sqarojnë politikisht e ideologjikisht masat e popujve, të rritin vigjilencën, t'u tregojnë atyre ku është armiku e si vepron ai, si duhet të organizohen dhe si të luftojnë kundër tij.

Për popujt e revolucionin një armik po aq i rrezikshëm, po aq dinak e agresiv si imperializmi amerikan është edhe imperializmi i ri revizionist sovjetik.

Partia jonë, që kur revizionizmi modern rrëmbeu pushtetin

në Bashkimin Sovjetik dhe në vende të tjera socialiste, e vlerësoi drejt situatën dhe theksoi se në botë po hapej një «front i dytë» kundër socializmit dhe komunizmit.

Sot të gjithë jemi dëshmitarë se Bashkimi Sovjetik revizionist është shndërruar në një shtet shovinist e neokolonialist. Politika e jashtme e revizionistëve sovjetikë është politika rusomadhe e carëve të vjetër, janë po ato synime ekspansioniste, janë po ata objektiva nënshtrimi e skllavërimi të popujve. Oreksi i imperializmit të ri revizionist sovjetik është i madh. Ashtu si Shtetet e Bashkuara, krerët e Kremlinit i kanë mbushur qiejt me aeroplanë dhe oqeanet me nëndetëse, krijojnë ku mundin baza ushtarake, tregje ekonomike për të thithur pasuritë e popujve dhe rekrutojnë agjentë në të katër anët. Rublat e tanket, korrupsioni e shantazhet ecin paralel. S'ka zonë të botës ku revizionistët sovjetikë të mos kërkojnë të shtrijnë influencën e tyre imperialiste, s'ka çështje ndërkombëtare ku ata të mos përzihen për të nxjerrë përfitime në dobi të vet. Në gjurmët e imperialistëve amerikanë, ata janë bërë nga tregtarët më të mëdhenj të armëve, fajdexhinj të pangopur, frymëzues të komploteve kundërrevolucionare dhe nxitës të konflikteve midis kombeve.

Kronologjia e veprimeve të revizionistëve sovjetikë gjatë këtyre viteve të fundit tregon se ky kurs agresiv vjen gjithnjë e duke u thelluar. Sa më shumë shtohen kontradiktat brenda Bashkimit Sovjetik, sa më shumë rriten grindjet e kundërshtimet brenda kampit revizionist dhe, më në fund, sa më tepër rritet konkurrenca me rivalin dhe aleatin e tij, imperializmin amerikan, aq më tepër në plan të parë të aksionit të revizionistëve sovjetikë del aventura ushtarake.

Agresioni barbar kundër Çekosllovakisë nuk ishte një gjë e rastit, një situatë e jashtëzakonshme dhe e papërsëritshme, por kulmi i një politike agresive e shoviniste të ngritur në vijë zyrtare, fillimi i një sulmi të madh të drejtuar kundër lirisë e pavarësisë së shumë vendeve e popujve. Fakt është se në një kohë me pushtimin e hapur të Çekosllovakisë u forcua edhe pushtimi i heshtur ushtarak i Polonisë, Gjermanisë Demokratike, Hungarisë, Bullgarisë e i Mongolisë. Këto vende praktikisht janë kthyer në guberna ushtarake të perandorisë së Moskës, ku gjeneralët sovjetikë mbajnë aty jo vetëm «qetësinë», por bëjnë edhe politikën, edhe ligjin.

Ironia e tërë kësaj politike shoviniste, e tërë përpjekjeve për të sunduar popujt është se revizionistët sovjetikë këtë politikë mundohen ta përligjin edhe «teorikisht», ta quajnë «proletare», bile edhe «leniniste». Brezhnjevi nxori teorinë famëkeqe të «sovranitetit të kufizuar» dhe propagandistët e tij të zellshëm po përpiqen ta bindin botën se Bashkimi Sovjetik nuk dërgoi në Pragë tanket, por «ndihmën e tij internacionaliste», se ai nuk po i

shtyp vendet satelite, por «forcon bashkësinë socialiste», se nuk po i shfrytëzon ata, por shpejton «integrimin socialist» të tyre etj.

Teoria e «sovranitetit të kufizuar» është teoria e shovinizmit dhe e ekspansionit të fuqisë së madhe, teoria me anën e së cilës imperialistët e rinj sovjetikë kërkojnë të shuajnë çdo sovranitet të popujve të tjerë dhe t'i krijojnë vetes të «drejtën sovrane» për të ndërhyrë ku të duan e kur të duan. Duke u mohuar të tjerëve sovranitetin, ata kërkojnë t'u mohojnë kombeve e shteteve atë çfarë kanë më të shtrenjtë — lirinë e pavarësinë, t'u mohojnë individualitetin e tyre kombëtar, të drejtën e pamohueshme të vetëvendosjes e të zhvillimit të pavarur, të drejtën e barazisë në jetën ndërkombëtare dhe të pjesëmarrjes aktive në marrëdhëniet botërore. Me «sovranitetin e kufizuar», ata kërkojnë të ligjërojnë të drejtën e më të fortit për të mbytur të dobëtin, të më të madhit për të gllabëruar të voglin. Ajo është teoria e justifikimit të agresionit imperialist.

Një përmbajtje të tillë reaksionare ka edhe «internacionalizmi proletar» i revizionistëve sovjetikë. Sundimtarët e Kremlinit kërkojnë të spekulojnë dhe t'u imponojnë forcave revolucionare e antiimperialiste konceptin e shtrembër se gjoja kriter bazë i internacionalizmit proletar, «gur i provës» është qëndrimi ndaj Bashkimit Sovjetik, se e gjithë lufta dhe veprimet revolucionare u duhen nënshtruar interesave të Bashkimit Sovjetik dhe politikës së tij.

Spekulimet me të kaluarën dhe përdorimi i tezave që dikur kanë qenë të drejta, sot, kur revizionistët sovjetikë e tradhtuan marksizëm-leninizmin dhe e shndërruan Bashkimin Sovjetik në një vend imperialist, nuk bindin njeri. Sot qëndron përsëri si një kriter i internacionalizmit proletar qëndrimi ndaj Bashkimit Sovjetik, por në kuptimin e kundërt nga ai që kishte në kohën e Leninit e Stalinit, kur ai ishte qendër e revolucionit botëror dhe bazë e tij. Revolucionar e internacionalist sot është ai që luftón revizionistët sovjetikë, që demaskon tradhtinë e tyre, që kundërshton me të gjitha forcat politikën dhe vijën e tyre antimarksiste e imperialiste.

Kalimi i revizionizmit sovjetik në socialimperializëm, intensifikimi i politikës dhe i veprimtarisë së tij ekspansioniste kanë shtruar edhe detyra të reja përpara forcave revolucionare e antiimperialiste. Lufta ideologjike kundër revizionizmit mbetet gjithnjë aktuale dhe një detyrë e dorës së parë që duhet çuar deri në fund, deri në shkatërrimin e tij të plotë. Por sot kjo do të ishte e pamjaftueshme dhe nuk do të përfundonte me sukses, në qoftë se Bashkimi i sotëm Sovjetik nuk konsiderohet e trajtohet edhe si një fuqi shtetërore imperialiste.

Forca më e madhe kundërrevolucionare që i kundërvihet luftës së popujve për liri e socializëm është aleanca sovjeto-amerikane. Në të gjitha fushat — ekonomike, politike e ushtarake

— kurset imperialiste të SHBA-së dhe të Bashkimit Sovjetik po afrohen e po puqen pa ndërprerje. Për të realizuar qëllimet e tyre hegjemoniste e sunduese të dy superfuqitë ia kanë nevojën njëra-tjetrës, prandaj edhe rregullojnë së bashku orët, koordinojnë vazhdimisht planet dhe bashkërendojnë veprimtarinë konkrete.

Pesha e kësaj aleance reaksionare është e pranishme në të gjitha konfliktet e problemet ndërkombëtare. Që kur ka mbaruar Lufta e Dytë Botërore kanë kaluar më se 26 vjet, megjithatë Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Sovjetik mbajnë akoma të dislokuara në vende të tjera ushtri të tyre. Të dy superfuqitë kanë njohur dhe pranuar si fakt të kryer zonat përkatëse të influencës dhe përpiqen të mos e pengojnë njëra-tjetrën në sundimin dhe shfrytëzimin e tyre.

Nëpërmjet diplomacisë së fshehtë dhe në përputhje të plotë me praktikën imperialiste, amerikanët dhe revizionistët sovjetikë po bëjnë tani pazarllëqe në prapaskenë për të ndarë midis tyre ish-zonat e influencës, nga të cilat u shporrën fuqitë e vjetra imperialiste, për të mbushur, siç thonë ata, «boshllëqet». Këto «fryte» të aleancës sovjeto-amerikane duken mjaft qartë në Lindjen e Mesme, në bregun verior të Afrikës, në detin Mesdhe, në Oqeanin Indian etj.

Të dyja superfuqitë përpiqen që për çështjet e mëdha ndërkombëtare të dalin me një politikë të koordinuar dhe me një qëndrim të përbashkët ndaj të tretëve, siç po ndodh në bisedimet për çarmatimin në Gjenevë, në ato për Lindjen e Mesme në Nju-Jork etj. Akoma më qartë duket ky koordinim e ky qëndrim në veprimtarinë e OKB-së, e cila është shndërruar në një instrument të politikës së tyre hegjemoniste. Në praktikë, në OKB asnjë vendim nuk merret, asnjë sugjerim nuk pranohet, po nuk u pëlqeu të dy fuqive të mëdha. Ajo që kërkojnë e synojnë Shtetet e Bashkuara e Bashkimi Sovjetik është t'i detyrojnë shtetet e tjera t'ua besojnë fatet e tyre të dy superfuqive, që këto të bëhen arbitra jo vetëm për punët e jashtme të vendeve të tjera, por edhe për punët e brendshme. Të dy superfuqitë kërkojnë që pranimi i vullnetit dhe i diktatit të tyre të ngrihet në ligj e normë të jetës ndërkombëtare.

Përpjekje të mëdha bëjnë imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë për ruajtjen e ekuilibrit të fuqisë midis tyre dhe për mbajtjen e një distance të caktuar ndaj të tjerëve. Të gjitha marrëveshjet që ata kanë përfunduar në fushën e armëve atomike, të hapësirës kozmike, të fundit të detrave etj., synojnë të ruajnë të paprekura këto raporte të reja strategjike, të cilat përcaktojnë edhe politikën e përbashkët të superfuqive. Ata duan sidomos të ruajnë të paprekur monopolin e armëve të reja dhe epërsinë tekniko-shkencore në degët kryesore të zhvillimit, me qëllim që t'i mbajnë vendet e tjera të varura dhe të ushtrojnë

mbi to një presion të vazhdueshëm politik, ekonomik e ushtarak. Asnjë nuk dyshon se takimet tepër të fshehta të SALT-it, nga të cilat janë përjashtuar edhe aleatët më të ngushtë, janë shndërruar në një institucion ku jo vetëm bashkërendohen çështjet ushtarake, por përcaktohen edhe qëndrimet konkrete politike, edhe strategjia e përbashkët me afat të gjatë.

Sigurisht, do të ishte e pakuptueshme dhe joreale sikur në aleancën sovjeto-amerikane të shihnim vetëm afrimin e bashkëpunimin e dy superfuqive, interesat dhe veprimet e përbashkëta. Si fuqi imperialiste që janë, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Sovjetik revizionist kanë edhe grindje, rivalitete e kontradikta të thella midis tyre, të cilat i pengojnë të veprojnë kurdoherë e kudo në harmoni e unitet të plotë. Ekzistenca dhe ashpërsimi i kontradiktave qëndrojnë në vetë bazën e kësaj aleance, në sistemin shoqëror kapitalist të të dy vendeve, në synimet imperialiste të tyre. Të dyja palët, duke u përgatitur për luftë, planifikojnë t'i hanë kokën edhe njëra-tjetrës.

Duke spekuluar me kontradiktat që kanë me SHBA-në dhe me qëllim që të fshehin tradhtinë e tyre, revizionistët sovjetikë kërkojnë të hiqen si antiimperialistë, sikur edhe ata e kundërshtojnë politikën e agresionit e të luftës të imperializmit amerikan. Por «antiimperializmi» i revizionistëve është një parullë false, një taktikë për të mashtruar popujt, për të përçarë unitetin e tyre antiimperialist, për të sabotuar revolucionin. Çdo iluzion mbi «antiimperializmin» e revizionistëve sovjetikë do të ishte shumë i rrezikshëm dhe me pasoja të rënda për luftën revolucionare të popujve.

Përderisa imperializmi amerikan dhe ai revizionist janë dy superfuqi imperialiste dhe kanë dalë me një strategji të përbashkët kundërrevolucionare, atëherë nuk është e mundur që edhe lufta e popujve kundër tyre të mos shkrihet në një rrymë të vetme. Nuk mund të mbështetesh te njëri imperializëm për të kundërshtuar tjetrin.

Imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë përpiqen të ruajnë qetësinë, statukuonë dhe aleancat. Ata kërkojnë nga popujt të rrinë urtë, të aprovojnë politikën dhe veprimet e tyre. Por popujt, revolucionarët dhe gjithë njerëzit përparimtarë të botës e urrejnë me gjithë shpirt shtypjen e shfrytëzimin, që janë njëlloj të padurueshëm qoftë kur ushtrohen nga imperialistët amerikanë, qoftë kur ushtrohen nga revizionistët sovjetikë.

Ata nuk e duan «qetësinë» e «paqen» imperialiste, nuk duan as statukuonë e tanishme reaksionare, që predikojnë imperialistët e revizionistët. Revolucioni, lufta për çlirimin kombëtar e shoqëror nuk është «shkatërrimi i njerëzimit», siç predikojnë imperialistët e revizionistët, por shkatërrimi i shtypjes e i shfrytëzimit, ai është shpëtimi i njerëzimit.

Revolucioni patjetër nuk do të shpërthejë në të njëjtën kohë në të gjitha vendet dhe nuk do të fitojë në të njëjtën ditë. Ai do të ketë zigzaget e tij, ngritjet e uljet e veta. Por kudo ku ka shtypje e shfrytëzim, ka edhe do të ketë luftë klasore, ka edhe do të ketë revolucion. Marksizëm-leninizmi frymëzon tani çdo ditë e më shumë proletariatin botëror, u ndriçon gjithë masave të shtypura rrugën drejt fitores.

Paqja e vërtetë dhe sigurimi i popujve arrihen me luftë kundër imperializmit amerikan e socialimperializmit sovjetik

Një vëmendje të posaçme Partia dhe Qeveria jonë u kanë kushtuar disa problemeve të veçanta, të rëndësishme e të mprehta të jetës ndërkombëtare, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti mbi fatet dhe të ardhmen e popujve në një plan të gjerë.

Po bëhen tani 12 vjet që populli heroik vietnamez zhvillon një luftë për jetë a vdekje kundër agresionit imperialist të Shteteve të Bashkuara dhe kukullave të tij të Sajgonit. Edhe pse imperialistët amerikanë e kanë humbur luftën në fushën e betejës, edhe pse asnjë shpresë nuk kanë që situata të ndryshojë në dobi të tyre, ata vazhdojnë me kokëfortësi të dëshpëruar agresionin dhe përpjekjet për të përkulur dhe për të shtypur popullin vietnamez. Për më tepër, kohët e fundit imperialistët amerikanë e shtrinë agresionin e tyre edhe në Kamboxhia e Laos. Por edhe zgjerimi i agresionit tregoi se, ashtu si dje, edhe sot dhuna e armatosur, terrori e barbarizmat nuk mund t'u ofrojnë imperialistëve amerikanë një rrugëdalje nga qorrsokaku ku janë futur. Në saje të luftës së bashkuar të popujve të Indokinës, të unitetit dhe të vendosmërisë së tyre, dështuan plotësisht planet strategjike e taktike të qeverisë së Niksonit.

Indokina është bërë tani fusha kryesore e luftës çlirimtare të popujve kundër imperializmit amerikan, prandaj edhe fitoret e popullit të Vietnamit, Laosit e Kamboxhias kanë qenë një frymëzim i madh revolucionar për të gjithë ata që kundërshtojnë imperializmin, që luftojnë për lirinë e pavarësinë kombëtare, për demokraci e drejtësi shoqërore. Sidomos ato kanë ngritur lart moralin, frymën luftarake të popujve të vegjël, kanë rritur besimin në forcat e veta dhe në të ardhmen e tyre.

Mësimi historik që vjen nga Vietnami është se agresionit të fuqisë së madhe imperialiste mund t'i kundërvihet me shumë sukses lufta popullore, se në kushtet e sotme edhe një vend i vogël mund të mposhtë një superfuqi, kur ai është i vendosur të bëjë çdo sakrificë dhe të ecë me guxim në rrugën e lirisë e të revolucionit.

Doktrina e re e Niksonit e ashtuquajtur «vietnamizim i luftës» dhe manovrat e tij për «bisedime paqësore» etj. nuk mund të kenë asnjë sukses. «Vietnamizim» do të thotë zgjerim dhe vazhdim i agresionit imperialist, që vietnamezët të vihen kundër vietnamezëve, aziatikët kundër aziatikëve dhe imperialistët amerikanë t'i sundojnë, t'i shtypin, t'i shfrytëzojnë e t'i përdorin si mish për top në politikën e tyre agresive e hegjemoniste. Por plani i Niksonit për «vietnamizimin» e luftës në Vietnam dështoi përballë qëndresës heroike të popujve të Indokinës dhe nuk mund t'i çojë autorët e tij asgjëkundi tjetër përveçse në disfata të reja edhe më të mëdha. Nga katastrofa në Vietnam imperialistët amerikanë nuk mund t'i shpëtojnë as miqtë e tyre, revizionistët sovjetikë, të cilët për vite me radhë kanë sabotuar përpjekjet e popullit vietnamez dhe kanë bërë presione që ai ta shuajë luftën antiamerikane.

Në Vietnam dhe në gjithë Indokinën nuk mund të ketë paqe të vërtetë, gjersa të mos tërhiqen përfundimisht të gjitha forcat amerikane nga ky rajon dhe gjersa të mos prishen atje të gjitha bazat e instalimet ushtarake amerikane. Populli vietnamez do të fitojë me siguri dhe kjo fitore do të arrihet në fushën e betejës nga populli vietnamez që lufton e derdh gjak. Atij dhe vetëm atij i takon e drejta të vendosë vetë dhe në mënyrë të pavarur për fatet e veta.

Populli shqiptar ka qenë e do të jetë kurdoherë me mish e me shpirt me popullin vëlla vietnamez dhe me popujt e tjerë të Indokinës, ai është plotësisht solidar me luftën e tyre të drejtë e heroike kundër imperializmit amerikan e aleatëve të tij. Ne u japim gjithë përkrahjen tonë qëndrimeve të drejta të qeverisë së Republikës Demokratike të Vietnamit dhe të qeverisë së përkohshme revolucionare të Republikës së Vietnamit të Jugut për largimin e trupave amerikanë dhe zgjidhjen e konfliktit vietnamez.

Në vatër tensioni është shndërruar edhe Lindja e Mesme. Prej kohe vazhdon agresioni imperialisto-izraelit që synon të nënshtrojë dhe të skllavërojë të gjithë popujt arabë. Gjendjen e ka rënduar edhe përzierja në këtë zonë e revizionistëve sovjetikë, të cilët, duke u hequr si miq të shteteve arabe, kërkojnë të zënë pozita strategjike dhe të shtrijnë atje hegjemoninë e tyre.

Sionistët, imperialistët dhe revizionistët sovjetikë përpiqen tani t'i përçajnë arabët dhe t'i vënë në grindje njëri me tjetrin, me qëllim që të dobësojnë frontin e tyre të përbashkët çlirimtar antiimperialist dhe t'u imponojnë një paqe në kundërshtim me interesat e tyre jetike. Synimi i dy superfuqive, të cilat kërkojnë të marrin fatet e Lindjes së Mesme në duart e veta dhe të luajnë rolin e arbitrit, është ta ndajnë atë në zona të influencës dhe mbi jetën e kokallat e popujve arabë të ndërtojnë plasdarme të

reja, nga ku të nisen për pushtime imperialiste në kontinentet e Azisë dhe të Afrikës.

Por popujt arabë nuk kanë luftuar me shekuj për lirinë e pavarësinë, për mbrojtjen e nderit dhe të pasurive të tyre që tani t'i bëjnë fli për interesat imperialiste të fuqive të mëdha. Çmimi i «paqes» që u ofrojnë imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë është shumë i madh. Për më tepër ai është ofendues dhe prek thellë traditat e lavdishme, dinjitetin dhe krenarinë e gjithë popujve arabë. Popujt arabë e kanë bërë të qartë se nuk do të heqin dorë as nga një pëllëmbë tokë arabe dhe nuk do të bëjnë asnjë pazarllëk me çështjen palestineze. Ata janë ngritur kundër dhunës së reaksionarëve jordanezë për shtypjen e forcave partizane të Palestinës, që qëndrojnë në pararojë të luftës çlirimtare të popujve arabë dhe kanë hedhur poshtë komplotin imperialist, i cili ka për qëllim të likuidojë tërësisht e përfundimisht revolucionin palestinez.

Populli ynë i ka miq tradicionalë e vëllezër popujt arabë dhe është plotësisht solidar me çështjen e tyre të drejtë, ai ka qenë dhe do të jetë kurdoherë përkrah tyre. Ne jemi të bindur se popujt arabë do ta ngrenë lart flamurin e luftës çlirimtare kundër imperialistëve e sionistëve, kundër ndërhyrjeve të revizionistëve sovjetikë dhe mashtrimeve të gjithë atyre që u hiqen si miq, por që kërkojnë t'u futin thikën pas shpine. Tokat arabe u takojnë arabëve, çështja për të cilën lufton populli palestinez është e pamposhtshme.

Republika Popullore e Shqipërisë është e interesuar për një paqe dhe sigurim të vërtetë në Evropë, për një zgjidhje reale e të drejtë të problemeve të mbetura pezull që nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore, e, në radhë të parë, të problemit gjerman.

Por situata në Evropë nuk është ashtu, siç kërkojnë ta paraqesin revizionistët sovjetikë, sikur tensioni ka rënë dhe gjendja është qetësuar, sepse u nënshkrua traktati Moskë-Bon, sepse Bashkimi Sovjetik dhe Gjermania Federale paskan garantuar paprekshmërinë e kufijve të shteteve evropiane.

Përkundrazi, përfundimi i traktatit sovjeto-gjerman krijoi një tension të ri në Evropë, që vjen nga kërcënimet reale të revizionizmit sovjetik dhe të revanshizmit gjerman kundër interesave, sovranitetit dhe të drejtave të vendeve evropiane, nga synimi i tyre për hegjemoni e sundim në kontinentin tonë. Që tani Republika Federale Gjermane është bërë shteti më i fuqishëm kapitalist në Evropën Perëndimore, që sfidon ndikimin amerikan dhe përpiqet të errësojë fuqinë e Francës e të Anglisë, pa mos përmendur partnerët e tjerë të NATO-s. Në vend që të ndihmojë për ndonjë zgjidhje, traktati sovjeto-gjerman krijon kontradikta, rivalitete e ndërlikime të reja imperialiste me pasoja të rrezikshme për të gjitha vendet e Evropës.

Me anë të kësaj marrëveshjeje kërkohet të lihet mënjanë traktati i paqes me Gjermaninë dhe të shkelen e të mohohen të drejtat e ligjshme të popujve që luftuan kundër Gjermanisë hitleriane dhe fituan. Por ata që derdhën gjak në luftën kundër nazizmit nuk mund të pranojnë kurrë që militarizmit dhe revanshizmit gjerman t'u lihen duart të lira dhe t'u krijohen premisat që ta hedhin përsëri Evropën e botën në një kasaphanë të re. Përfundimi i traktatit të paqes me Gjermaninë është një e drejtë që u takon të gjitha vendeve të koalicionit antifashist dhe këtë nuk mund t'ua rrëmbejë e mohojë njeri. Marrëveshja sovjeto-gjermane, duke e lënë mënjanë këtë çështje, shkeli interesat e larta të Republikës Demokratike Gjermane, të cilat janë vënë tani në tryezën e pazarllëqeve që bëhen prapa shpinës së saj nga diplomacitë e katër fuqive të mëdha e të Bonit. Këtë e vërtetoi fare qartë edhe marrëveshja për Berlinin, ku lëshimet e kompromiset e krerëve të Kremlinit e vunë Republikën Demokratike Gjermane në një pozitë shumë mospërfillëse e poshtëruese.

Është e vërtetë se popujt e Evropës aspirojnë dhe kanë nevojë për sigurimin e lirisë, të pavarësisë dhe të zhvillimit normal të tyre. Por sigurimi, për të cilin kohët e fundit revizionistët sovjetikë po bëjnë një zhurmë të madhe, është një sigurim i rremë. Popujt e Evropës nuk mund të pranojnë të bëhen bashkëfajtorë të dy fuqive të mëdha imperialiste kundër vetë interesave të tyre supreme, nuk mund të pranojnë të bëjnë lojën e dy superfuqive, që mendojnë vetëm për sigurimin e sferave të tyre të influencës dhe nënshtrimin e sundimin e vendeve evropiane. Sigurimin e vërtetë popujt nuk e presin nga dy fuqitë e mëdha imperialiste që janë autorët e agresioneve në Vietnam, në Lindjen e Mesme, në Çekosllovaki e gjetkë, që mbajnë bazat dhe ushtritë e tyre pushtuese në shumë vende të Evropës dhe që marrin nëpër këmbë lirinë e pavarësinë e popujve e të vendeve sovrane.

Në Evropë ekziston blloku i NATO-s që është një aleancë agresive e sunduar nga imperialistët amerikanë dhe ku revanshistët e Gjermanisë Perëndimore luajnë një rol kryesor. Qëllimi i tij ka qenë dhe mbetet lufta kundër komunizmit, shtypja e revolucionit në Evropë dhe sigurimi i interesave imperialiste amerikane. Ekziston, gjithashtu, Traktati i Varshavës, i cili është shndërruar në një makinë për mbajtjen e sundimit të revizionistëve sovjetikë në vendet që bëjnë pjesë në të dhe në një forcë agresive e kërcënuese kundër pavarësisë së vendeve të tjera. Për çfarë sigurimi evropian mund të bëhet fjalë, kur këto dy blloqe mbajnë nën thundrën e tyre popujt e kësaj e të asaj ane të Evropës, kur ato janë shtyllat themelore të sundimit të dy superfuqive e të diktatit të tyre? Është e qartë se, përderisa të ek-

zistojnë në Evropë këto dy blloqe, bazat e ushtrisë amerikane e sovjetike në vendet evropiane, nuk mund të ketë kurrë sigurim të vërtetë evropian.

Vendi ynë doli nga Traktati i Varshavës dhe e denoncoi botërisht politikën e veprimtarinë e tij agresive. Me këtë akt të drejtë ne mbrojtëm jo vetëm lirinë e pavarësinë e atdheut tonë, por edhe treguam se rruga për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë, rruga e paqes dhe e sigurimit ndërkombëtar është kundërshtimi i vendosur ndaj politikës hegjemoniste e skllavëruese të imperializmit e të revizionizmit.

Ne mendojmë se sigurimin e tyre popujt e Evropës mund ta arrijnë dhe do ta arrijnë vetëm duke forcuar pavarësinë e sovranitetin e tyre kombëtar, në luftë të vendosur kundër politikës hegjemoniste të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik, kundër përpjekjeve të tyre për konservimin e bazave ushtarake e të zonave të influencës në Evropë, kundër përpjekjeve për ruajtjen e kësaj statukuoje dhe drejtimin e tehut të luftës në Azi.

Republika Popullore e Shqipërisë, si vend mesdhetar, është e interesuar dhe lufton që pellgu i Mesdheut të jetë një zonë paqeje e bashkëpunimi të frytshëm. Ajo dënon me vendosmëri politikën agresive të fuqive imperialiste, e në radhë të parë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës e të Bashkimit Sovjetik, të cilat me flotat e tyre të luftës kërcënojnë seriozisht lirinë e pavarësinë e vendeve mesdhetare. Është detyrë e vendeve liridashëse dhe e gjithë forcave përparimtare të Mesdheut të kërkojnë largimin e këtyre flotave dhe të luftojnë për këtë, të kundërshtojnë çdo politikë hegjemoniste në këtë pjesë të botës. Mesdheu u përket vetëm popujve dhe vendeve mesdhetare.

Një zhurmë e madhe po bëhet prej kohe në të gjithë botën rreth problemit të çarmatimit. Kjo është ngritur me qëllim nga imperialistët amerikanë dhe socialimperialistët sovjetikë për të vënë në gjumë popujt dhe për të intensifikuar planet e tyre agresive. Faktet tregojnë se ndërsa të dy superfuqitë flasin shumë për çarmatimin, ndërsa kanë bërë me qindra e mijëra mbledhje, kanë krijuar komitete e komisione që nuk numërohen, ato vazhdojnë garën e shfrenuar të armatimeve. Si kurrë ndonjëherë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik kanë rritur buxhetet ushtarake, kanë zgjeruar në të gjitha kontinentet e detet bazat ushtarake dhe dislokimin e trupave sulmues, kanë përqendruar forcat e tyre më të mëdha e më të mira teknike e shkencore për përsosjen e armëve të shfarosjes në masë etj.

Armatimi i vazhdueshëm është kusht i ekzistencës së imperializmit, që buron nga vetë karakteri i rendit ekonomik dhe nga politika e tij agresive. Prandaj, përderisa ekzistojnë shtete im-

perialiste, e socialimperialiste, nuk do të ketë kurrë çarmatim në botë. Imperialistët e revizionistët armatosen dhe rritin forcat sulmuese për të pushtuar dhe rindarë botën midis tyre, për t'i shtypur revolucionet, për të shkatërruar shtetet socialiste dhe për të robëruar popujt. «Përpjekjet për çarmatim» të tyre synojnë të çarmatosin popujt dhe t'u imponojnë atyre më lehtë sundimin e vet. Nga ana tjetër, kjo propagandë është një ushqim për teoricienët pacifistë dhe gjithë naivët që rrojnë me shpresa dhe jashtë realitetit objektiv.

Gara e armatimeve, të cilën të dy superfuqitë përpiqen ta zhvillojnë në mënyrë të ekuilibruar midis tyre, është e mbarsur me pasoja mjaft të rrezikshme. Ato përgatiten për luftëra agresive, të cilat mund t'i shpërthejnë veç e veç ose së bashku kundër vendeve të tjera, ose edhe kundër njëri-tjetrit. Në këto kushte nuk përjashtohen jo vetëm luftërat lokale, që imperialistët e revizionistët i shpërthejnë vazhdimisht, por as edhe luftërat në shkallë botërore. Bile, luftërat lokale i përgatitin terrenin cilitdo agresor për luftëra në një shkallë më të gjerë, janë avancime taktike të agresivitetit të imperialistëve në strategjinë e tyre të një lufte imperialiste globale. Këtij synimi i shërbejnë edhe komplotet e puçet e kurdisura nga agjenturat e fuqive imperialiste e revizioniste në shtetet e ndryshme pa ndërhyrje ushtarake të jashtme.

Përderisa imperialistët dhe socialimperialistët armatosen e përgatiten për luftëra agresive, shtetet socialiste nuk mund të rrinë duarlidhur. Armatimi i tyre ka për qëllim mbrojtjen e atdheut socialist, kundërshtimin e politikës së ndërhyrjeve, presioneve e shantazheve të imperializmit e socialimperializmit. Ai drejtohet kundër orvatjeve të tyre për të cenuar të drejtat e lirinë e popujve dhe ndihmon popujt e tjerë që të ruajnë ose të fitojnë lirinë e pavarësinë e tyre kombëtare.

Popujt nuk mund të mos shohin se grupimet ushtarake agresive të NATO-s, ku sundojnë imperialistët amerikanë dhe ato të Traktatit të Varshavës, ku sundojnë socialimperialistët sovjetikë, përbëjnë sot kërcënimin kryesor për paqen dhe sigurimin ndërkombëtar. Nën pretekstin se mbrohen nga njëri-tjetri dy superfuqitë janë ato që bëjnë ligjin në këto pakte, që ndajnë zonat e influencës, që bëjnë agresione të veçuara ose ndihmojnë agresorë të tjerë në shërbim të tyre. Duke përfituar nga fuqia e grupimit, ato edhe më tepër rrezikojnë lirinë, jetën e njerëzve e të shteteve. Popujt në të katër anët e botës duhet ta shikojnë drejt në sy situatën, ta demaskojnë këtë gjendje alarmante dhe të vënë përpara përgjegjësisë të gjitha ato qeveri që bëjnë lodrën e dy superfuqive.

Për veprimet agresive të dy superfuqive mbajnë përgjegjësi jo vetëm qeveritë, por edhe popujt e tyre, ashtu siç mbajnë përgjegjësi edhe qeveritë e popujt e partnerëve në aleancat ushtarake përkatëse. Lidhur me agresionin kundër Çekosllovakisë, për shembull, nuk mbajnë përgjegjësi vetëm socialimperialistët sovjetikë që e organizuan, por edhe qeveritë e shteteve anëtare të Traktatit të Varshavës, pjesëmarrëse në këtë agresion, mbajnë edhe popujt e Bashkimit Sovjetik, Polonisë, Gjermanisë Demokratike, Bullgarisë e të Hungarisë, që qëndruan pasivë dhe e lejuan këtë akt barbar. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për ndihmën e drejtpërdrejtë e të tërthortë që partnerët e Shteteve të Bashkuara u japin agresorëve amerikanë në Vietnam. Pjesëmarrjen në NATO ose në Traktatin e Varshavës, aleancën e miqësinë me Shtetet e Bashkuara ose me Bashkimin Sovjetik partnerët e tyre e justifikojnë me nevojën e mbrojtjes. Por me këtë ata forcojnë superfuqitë, i ndihmojnë këto të ruajnë dhe të ndajnë zonat e influencës, të zbatojnë politikën e hegjemonisë, të diktatit e të agresionit.

Sa më e organizuar, e gjerë dhe e fuqishme të jetë rezistenca e lufta e popujve të vendeve të NATO-s dhe të Traktatit të Varshavës ndaj veprimeve agresive të dy superfuqive dhe të qeverive të tyre që i përkrahin ato, aq më vështirë do ta kenë agresorët për të kryer aventurat e tyre ushtarake kundër popujve.

Manovra të panumërta ushtarake bëhen në kufijtë e Jugosllavisë e të Rumanisë nga Bashkimi Sovjetik, Hungaria, Bullgaria e Çekosllovakia. Është e qartë se këtu kemi të bëjmë me presione, shantazhe e kërcënime, që në mos sot nesër mund të shndërrohen në agresione të hapura. A nuk e shohin e nuk e ndiejnë popujt e vendeve pjesëmarrëse në këto manovra se ç'plane e komplote të rrezikshme po kurdisen? Historia do t'i dënojë rëndë, në qoftë se ata rrinë të qetë dhe ua lënë duart të lira agresorëve.

Politika e jashtme e Republikës Popullore të Shqipërisë është një politikë konsekuente e parimore në të gjitha drejtimet e saj

Shokë e shoqe,

Republika Popullore e Shqipërisë zë sot një vend të nderuar në arenën ndërkombëtare, ajo gëzon respektin e admirimin e popujve liridashës dhe të të gjitha forcave përparimtare. Shqipëria socialiste nuk u izolua, siç predikonin e dëshironin armiqtë e saj, por i forcoi edhe më shumë lidhjet ndërkombëtare, autoritetin dhe pozitën e saj në botë.

Simpatia e respekti që gëzon te të gjitha vendet përparimtare e popujt e botës, pesha dhe influenca e vendit tonë nuk janë pasojë as e madhësisë së popullsisë, as e fuqisë ekonomike ose ush-

tarake të tij. Forca dhe influenca e Shqipërisë socialiste qëndrojnë në idetë marksiste-leniniste që e frymëzojnë, që i mbron të pastra dhe i përhap në të gjithë botën. Ato qëndrojnë në shoqërinë e vërtetë socialiste që ndërtohet në Shqipëri, në luftën e guximshme, parimore e konsekuente kundër imperializmit, revizionizmit dhe gjithë reaksionarëve.

Vendi ynë ka me qindra e qindra milionë shokë e miq në gjithë botën, pse ai është një shtet që respekton vetveten dhe gjithë popujt, pse ashtu si ruan me vendosmëri lirinë e pavarësinë e tij, u do të mirën e të ardhmen e lumtur dhe gjithë vendeve të tjera.

Pikërisht sepse ndjekim këtë politikë dhe gëzojmë këtë respekt, armiqtë na urrejnë, na shajnë dhe na luftojnë. Por kjo nuk na bën të ndryshojmë rrugë, as t'i fshehim pikëpamjet e veprimet tona. Kurajua civile në arenën ndërkombëtare nuk i ka munguar kurrë Partisë sonë dhe nuk do t'i mungojë në asnjë kohë dhe në asnjë rrethanë.

Partia e Punës dhe Republika Popullore e Shqipërisë janë dhe do të jenë armiq të betuar të imperializmit dhe të revizionizmit. Duke e quajtur luftën e tyre si pjesë të pandarë të luftës së përgjithshme revolucionare të popujve, ato kanë zhvilluar një luftë aktive kundër imperializmit, me atë amerikan në krye dhe kundër revizionizmit, me udhëheqjen sovjetike në krye, kanë dënuar dhe demaskuar me vendosmëri politikën dhe veprimtarinë e tyre agresive, qëllimet për të shtypur popujt, për të mbytur revolucionin dhe për të sunduar botën. Eksperienca e gjertanishme e vendit tonë na ka bindur edhe më shumë se liria e pavarësia e fituar, si dje ashtu edhe sot, mbrohen e garantohen vetëm me një luftë të vazhdueshme kundër imperializmit e revizionizmit, pa kompromis, kudo dhe në të gjitha aspektet.

Drejtësinë e vijës së Partisë sonë në luftën kundër imperializmit e revizionizmit e vërtetoi plotësisht jeta, e vërtetojnë fitoret e arritura.

E ndërgjegjshme për përgjegjësinë e lartë përpara popullit të vet e socializmit, Partia jonë nuk do të ndalet kurrë në mes të rrugës, ajo do të luftojë me vendosmëri e me të gjitha forcat kundër imperializmit dhe socialimperializmit, deri në shkatërrimin e tyre të plotë dhe triumfin e revolucionit botëror. Këtë luftë populli dhe Partia jonë e shikojnë si një e të pandarë, sepse nuk mund të kundërshtohet me sukses imperializmi pa luftuar njëkohësisht edhe socialimperializmin sovjetik ose anasjelltas.

Politika e jashtme e Partisë dhe e Qeverisë sonë ka qenë dhe është parimore e konsekuente në të gjitha drejtimet dhe komponentet e saj. Bazë themelore dhe e patundur e politikës sonë të jashtme ka qenë dhe do të jetë forcimi i miqësisë, i ndihmës reciproke, bashkëpunimi vëllazëror dhe uniteti luftarak me vendet socialiste, me të cilat na bashkojnë idealet e socializmit e të komunizmit, lufta e përbashkët kundër imperializmit, revizionizmit dhe reaksionit.

Partia dhe populli ynë janë të lidhur me një miqësi dhe një solidaritet të fuqishëm socialist me popullin vietnamez, Republikën Demokratike të Vietnamit. Ashtu si përkrahim përpjekjet e saj për ndërtimin e socializmit, ne i japim të gjithë përkrahjen e mbështetjen tonë kundërshtimit të vendosur që ajo i bën agresionit imperialist. Ne përkrahim, gjithashtu, Republikën e Vietnamit të Jugut dhe qeverinë e përkohshme revolucionare të Vietnamit të Jugut, të cilat janë përfaqësueset e vetme dhe të pakundërshtueshme të të gjithë vietnamezëve që banojnë në Jug të paralelit 17.

Republika Popullore e Shqipërisë, ashtu si edhe në të kaluarën, është për zhvillimin e forcimin e mëtejshëm të marrëdhënive miqësore me Republikën Demokratike Popullore të Koresë në bazë të parimeve të marksizëm-leninizmit e të internacionalizmit proletar, në interes të ndërtimit të socializmit në dy vendet tona. Populli shqiptar përkrah me vendosmëri luftën e drejtë që zhvillon populli korean kundër imperializmit amerikan dhe shërbëtorëve të tij për mbrojtjen e Republikës Demokratike Popullore të Koresë dhe ribashkimin e atdheut. Ne dënojmë politikën agresive të imperialistëve japonezë kundër Republikës Demokratike Popullore të Koresë, si dhe manovrat e revizionistëve sovjetikë që inkurajojnë politikën e tyre ekspansioniste.

Partia dhe Qeveria jonë kanë përkrahur dhe do të përkrahin kurdoherë pa rezerva luftën e popujve të Azisë, Afrikës dhe të Amerikës Latine për çlirimin kombëtar e shoqëror, kundër imperializmit, dallimit racial, shtypjes e shfrytëzimit kolonial.

Marrëdhënie miqësore ekzistojnë midis Shqipërisë dhe Republikës Arabe të Egjiptit, të Algjerisë, të Sirisë, të Libisë e vendeve të tjera arabe. Edhe në të ardhmen ne do të përpiqemi që marrëdhëniet e mira dhe bashkëpunimi reciprok të zhvillohen e të forcohen më tej në të mirë të popujve tanë.

Vendi ynë ka treguar gjithnjë vullnet të mirë dhe ka ndërmarrë hapa konstruktivë për të mbajtur e zhvilluar marrëdhënie normale me të gjitha vendet me sisteme të ndryshme shoqërore në bazë të parimeve të bashkekzistencës paqësore, të barazisë, të respektimit të sovranitetit shtetëror e të integritetit territorial, të mosndërhyrjes në punët e brendshme të njëri-tjetrit e të leverdisë reciproke.

Duke luftuar kundër imperializmit e revizionizmit, ne i përmbahemi me rreptësi parimit se çështjet e brendshme të çdo vendi janë çështje që duhet të zgjidhen nga ai vetë pa asnjë imponim ose ndërhyrje nga jashtë. Ne mbrojmë, gjithashtu, pikëpamjen se të gjitha marrëdhëniet midis vendeve, qofshin këto të

vogla ose të mëdha, mund dhe duhet të ndërtohen vetëm mbi bazën e barazisë e të mosndërhyrjes në punët e brendshme. Mbi këto baza i kemi vendosur dhe i zhvillojmë ne marrëdhëniet me të gjitha shtetet. Lidhjet e marrëdhënieve diplomatike të Shqipërisë me një numër vendesh, që u përfunduan gjatë këtij viti të fundit, janë një sukses i dukshëm i politikës sonë të jashtme dhe dëshmojnë për forcimin e pozitës ndërkombëtare të Republikës Popullore të Shqipërisë. Ato përputhen me interesat e përbashkëta dhe i shërbejnë forcimit të mirëkuptimit e të bashkëpunimit midis popujve.

Marrëdhënieve të vendit tonë me shtetet fqinj Partia dhe Qeveria u kanë kushtuar një kujdes të veçantë. Po zhvillohen normalisht marrëdhëniet miqësore midis Shqipërisë e Rumanisë, që janë në dobinë reciproke të të dy vendeve dhe u përgjigjen interesave të popujve tanë. Populli shqiptar do të përkrahë gjithnjë luftën e drejtë të popullit rumun për të mbrojtur pavarësinë e sovranitetin e atdheut të tij nga çdo kërcënim i jashtëm.

Në frymën e fqinjësisë së mirë po zhvillohen marrëdhëniet edhe me Jugosllavinë. Me gjithë divergjencat e njohura ideologjike, ne jemi për përmirësimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve shtetërore në të gjitha ato fusha ku ekzistojnë interesa reciproke. Me popujt e Jugosllavisë jemi miq e vëllezër. Ne dëshirojmë që ndjenjat e miqësisë, të kalitura në luftën antifashiste, të zhvillohen në rrugë të drejtë në të mirën e përbashkët të popujve tanë. Në popullin shqiptar popujt e Jugosllavisë do të kenë kurdoherë një mik që dëshiron t'i shikojë të lirë, të pavarur e sovranë, që kundërshton me vendosmëri të gjitha manovrat, shantazhet e kërcënimet e fuqive imperialiste ndaj Jugosllavisë fqinje.

Marrëdhënie të mira ekzistojnë midis vendit tonë dhe Italisë e Turqisë. Ruajtja dhe zhvillimi i tyre u përgjigjet interesave të përbashkëta. Këtë vit u vendosën edhe marrëdhënie diplomatike midis Shqipërisë e Greqisë. Kjo është një ngjarje e rëndësishme që i dha fund një gjendjeje anormale dhe që i shërben forcimit të paqes e sigurisë në Ballkan.

Republika Popullore e Shqipërisë është për atë që edhe në të ardhmen marrëdhëniet midis vendit tonë dhe atyre fqinj të zhvillohen në drejtim pozitiv dhe në ato fusha që paraqesin interes reciprok në luftën kundër ndërhyrjeve e intrigave të fuqive të mëdha imperialiste.

Miqësia dhe mirëkuptimi midis vendeve ballkanike duhet t'i ketë bazat në popull. Ne nuk kemi ndërmend as të parashtrojmë, as të pranojmë propozime për të formuar blloqe e aleanca ballkanike. Republika Popullore e Shqipërisë dëshiron e do të luftojë të kalitë miqësinë me popujt e Ballkanit në bazë të parimeve të bashkekzistencës paqësore. Regjimi i çdo vendi është çështje e popullit të vet. Ne nuk përzihemi në punët e brend-

shme të askujt, por as edhe të tjerët nuk duhet të përzihen në tonat. Kjo nuk përjashton kritikat e polemikat reciproke. Shqipëria socialiste nuk do t'i lejojë kurrë vetes të cenojë lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e vendeve të tjera. Këtë nuk e ka bërë asnjëherë populli shqiptar gjatë historisë së vet, por ai nuk do të lejojë as të tjerët t'i prekin lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e tij.

Kohërat për ne shqiptarët kanë ndryshuar. Në rast se carët e rinj të Kremlinit, si carët e vjetër, imperialistët e ndryshëm ose klikat shoviniste të Ballkanit do të orvaten të prekin kufijtë e Republikës Popullore të Shqipërisë, shqiptarët si një bllok i tërë, nuk do t'i gjejnë më as si më 1878, as si më 1914 dhe as si në kohën e Musolinit e të Hitlerit. Llogaritë e qarta bëjnë miq të mirë.

Populli shqiptar që ka vuajtur në shekuj nga pushtues barbarë, që e fitoi lirinë duke derdhur shumë gjak, u thotë popujve vëllezër të Ballkanit të ruhen nga intrigat e imperialistëve të çdo ngjyre, së bashku t'u themi larg duart nga vendet tona, të mos lejojmë kërkënd të shpërdorojë miqësinë tonë.

Popujt e Ballkanit janë plotësisht në gjendje të vendosin vetë e në mënyrë sovrane për marrëdhëniet midis tyre. «Fuçi baruti» Ballkani nuk ka qenë nga vetja e tij. Të tillë në të kaluarën atë e kanë bërë të huajt, imperialistët, që mbanin në duart e tyre të gjithë detonatorët. Kështu e duan ata të jetë edhe sot. Detyra e popujve të Ballkanit është t'ua presin me shpatë të gjitha fitilat, që paqja dhe siguria të vendosen me të vërtetë në Ballkan.

Është e natyrshme se popujt tanë kanë nevojë për miq. Por asnjëherë ata nuk duhet të bëhen vegla të të huajve në dëm të interesave të çdo populli në veçanti dhe të gjithë popujve tanë së bashku. Kjo është aleanca më e sinqertë dhe më e çeliktë që mund t'u propozohet popujve të Ballkanit.

Në rast se ndonjë shtet ballkanik, i shtyrë nga fuqitë imperialiste, ndërmerr një agresion kundër një shteti tjetër ballkanik, duhet të jetë e qartë se nuk do të mund të evitohet ndërhyrja e shteteve të tjera të Ballkanit. Kjo nuk do të mbetet një luftë lokale, por do të bëhet shkak për një konflikt botëror.

Të gjitha shtetet që respektojnë të drejtat e larta të Shqipërisë socialiste, që zbatojnë parimet e njohura, mbi të cilat mbështeten marrëdhëniet midis shteteve sovrane dhe që duan të mbajnë me ne marrëdhënie normale, do të gjejnë në Republikën Popullore të Shqipërisë mirëkuptim e reciprocitet.

Marrëdhëniet e vendit tonë me vendet e Evropës Lindore, pjesëtare të Traktatit të Varshavës, janë të një niveli të ulët. Kjo nuk është për fajin tonë. Udhëheqjet e tyre, duke qenë të nënshtruara plotësisht ndaj Moskës dhe duke iu bindur verbërisht politikës së saj të jashtme, kanë ndjekur ndaj vendit tonë një politikë armiqësore, e cila, siç dihet, i ka shkaktuar dëme të më-

dha Shqipërisë. Edhe pse kanë dështuar në përpjekjet e tyre për të na frikësuar e përkulur, ata vazhdojnë të jenë kokëfortë në qëndrimin e tyre antishqiptar. Aq më keq për ta.

Për sa u përket popujve të këtyre vendeve, të cilët nuk janë fajtorë për situatën e krijuar, ne kemi qenë, jemi dhe do të jemi miq me ta, u kemi dashur dhe do t'u duam të mirën kurdoherë. Partia dhe populli shqiptar, ashtu siç dënuan agresionin e gushtit 1968, me të njëjtën vendosmëri përkrahin rezistencën e popullit çekosllovak kundër pushtuesve revizionistë sovjetikë e tradhtarëve vendës për liri e pavarësi kombëtare, luftën e popullit polak e të popujve të vendeve të tjera ku janë në fuqi klikat revizioniste kundër sundimit revizionist dhe politikës së diktatit e të shovinizmit të shtetit të madh të socialimperialistëve sovjetikë.

Mjaft herë Partia jonë u është drejtuar popullit dhe komunistëve të Bashkimit Sovjetik, duke u shpjeguar hollësisht dhe në mënyrë të dokumentuar shkaqet e vërteta të prishjes së marrëdhënieve sovjeto-shqiptare. Populli e Partia jonë janë në dijeni për gjithë zhvillimin e ngjarjeve dhe do të ishte e tepërt t'i përsëritnim.

Kohët e fundit udhëheqësit sovjetikë hiqen sikur dëshirojnë «normalizimin» e marrëdhënieve me vendin tonë. Kjo është fund e krye demagogji dhe një përpjekje për ta pasur si një çertifikatë shfajësimi. Por ne nuk biem në kurthet e tyre. Ashtu siç nuk u jemi trembur kërcënimeve me armë, nuk gënjehemi as nga tundja e degës së ullirit. Ata i kanë borxhe të mëdha politike, ideologjike dhe ekonomike Shqipërisë. Normalizim mund të ketë dhe do të ketë me siguri, kur popujt sovjetikë dhe bolshevikët e vërtetë do të ndërhyjnë për të vendosur drejtësinë revolucionare marksiste-leniniste për këto çështje.

Populli ynë e kupton, e mbron dhe e zbaton me konsekuencë e deri në fund politikën e jashtme të Partisë e të Qeverisë sonë, sepse ajo është një politikë e qartë e drejtë dhe parimore. Shqipëria e re socialiste ka mundur të përballojë furtunat e tërbuara imperialiste e revizioniste, të rritë autoritetin e prestigjin e saj ndërkombëtar, të sigurojë miq të fuqishëm dhe përkrahës në gjithë botën, sepse Partia, Qeveria dhe populli kanë vepruar në unitet të plotë, si në analizën e situatave, ashtu edhe në konkluzionet e nxjerra e në qëndrimet e mbajtura.

Ky unitet i pathyeshëm, vigjilenca e pashuar revolucionare, qëndrimet e shëndosha marksiste-leniniste ndaj ngjarjeve ndërkombëtare dhe përgjithësisht ndaj zhvillimit të sotëm botëror janë një garanci e madhe se Republika Popullore e Shqipërisë do të ecë në rrugë të sigurta dhe do të qëndrojë kurdoherë ballëlart në radhët e para të frontit antiimperialist e antirevizionist, luftëtare e paepur për çështjen e shenjtë të revolucionit dhe të çlirimit të popujve.

II

ZHVILLIMI I EKONOMISË DHE DETYRAT E PARTISË

Shokë dhe shoqe,

Kongresi i 5-të shtroi detyra të rëndësishme për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës dhe për rritjen e mirëqenies së popullit. Klasa punëtore, fshatarësia kooperativiste dhe inteligjencia popullore, nën udhëheqjen e Partisë e me një ndërgjegje të lartë revolucionare, i plotësuan me nder ato detyra kolosale. U krye kështu një hap tjetër i rëndësishëm drejt ndërtimit të plotë të socializmit në vendin tonë.

Plani i katërt pesëvjeçar për prodhimin e përgjithshëm industrial dhe për investimet u plotësua në 4 vjet e 7 muaj, ndërsa punonjësit e qytetit të Tiranës e realizuan atë në 4 vjet e 4 muaj. Niveli i prodhimit industrial, i parashikuar për vitin 1970, u arrit që në vitin 1968. Ekonomisë sonë iu shtuan vepra të tilla madhështore si Hidrocentrali «Mao Ce Dun» mbi lumin Drin, vendburimet e reja naftëmbajtëse, uzinat e plehrave kimike, hekurudha Rrogozhinë-Fier etj. Gjithsej u ndërtuan dhe u vunë në shfrytëzim mbi 200 vepra të mëdha për industrinë, bujqësinë, transportin dhe degët e tjera të ekonomisë. Të gjitha këto e rritën potencialin e ekonomisë sonë, forcuan edhe më tej bazën materialo-teknike të socializmit.

Të rëndësishme janë edhe sukseset e arritura në zhvillimin socialist të fshatit dhe të bujqësisë. Duke ecur në rrugën e intensifikimit, bujqësia jonë shtoi nga njëri vit në tjetrin prodhimin dhe sidomos rendimentet e drithërave të bukës. Më 1970 rendimenti mesatar i drithërave ishte 17.3 kv për hektar. Një rendiment i tillë nuk ishte arritur kurrë ndonjëherë më parë edhe në vitet me kushte më të mira atmosferike. Një hop i madh përpara u bë për zgjerimin e sipërfaqes së ujitshme, për rritjen e shkallës së mekanizimit, si edhe të përdorimit të plehrave kimike e të farërave të zgjedhura.

Kongresi i 5-të bëri thirrjen «T'u qepemi kodrave e maleve, t'i zbukurojmë e t'i bëjmë ato pjellore si edhe fushat». Kjo direktivë çeli horizonte të reja për zhvillimin e bujqësisë dhe lulëzimin e jetës edhe në zonat e thella malore. Brenda një kohe të shkurtër përfundoi me sukses edhe këtu kolektivizimi. Plani i hapjes së tokave të reja nga fshatarësia kooperativiste në pesë-

vjeçarin që kaloi u plotësua para afatit dhe u tejkalua. Vënia në shfrytëzim e këtyre tokave u lejoi shumë fshatrave malore që të shtojnë prodhimin e drithërave, të sigurojnë bukën me forcat e tyre dhe t'i shesin teprica shtetit. Kjo ishte fitorja e parë në rrugën për ta kthyer në realitet perspektivën e re që hapi Partia për këto zona.

Gjatë pesëvjeçarit të katërt u morën shumë masa për të forcuar natyrën socialiste të marrëdhënieve ekonomiko-shoqërore. U përmirësua i gjithë sistemi i drejtimit dhe i planifikimit të ekonomisë. Në fshat, me anën e bashkimit vullnetar të kooperativave të vogla në kooperativa të zmadhuara, u ngrit në një nivel më të lartë shoqërizimi i pronës dhe i punës. Oborri kooperativist u zvogëlua, duke harmonizuar më drejt interesin e përgjithshëm me interesin personal të kooperativistëve. Pagat e larta të kuadrove të Partisë e të shtetit u ulën dhe diferencat e tyre me pagat e punonjësve të tjerë dhe të punëtorëve u ngushtuan në përputhje me parimet e socializmit. Interesi material u vu në raport më të drejtë me stimujt moralë, ndërsa shumë stimuj materialë, që u kishte kaluar koha ose ishin të tepëruar, u hoqën fare.

Lufta dhe puna vetmohuese e masave punonjëse për zhvillimin e ekonomisë siguruan atë bazë të domosdoshme, që lejoi të plotësohen me sukses edhe detyrat e caktuara në pesëvjeçarin e katërt për ngritjen e mirëqenies dhe të nivelit kulturor të popullit. Në vitin 1970 të ardhurat kombëtare ishin 55 për qind më të mëdha se në vitin 1965, ndërsa të ardhurat reale për frymë të popullsisë u shtuan 17 për qind. Popullsia u furnizua më mirë dhe pa ndërprerje me mallrat e nevojshme. Pothuajse në çdo kooperativë u ngrit një rrjet i gjerë i shërbimeve socialkulturore. U përmirësua jetesa e përditshme e çdo familjeje qytetare e fshatare.

Në të gjithë vendin përfundoi shtrirja e arsimit të detyrueshëm tetëvjeçar, duke krijuar kështu mundësinë për të ngritur në një shkallë më të lartë përgatitjen e përgjithshme arsimore e kulturore të rinisë. Por fitorja më e shquar që u shënua në lëmin e arsimit ishte programi që shtroi Partia për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës. Zbatimi i këtij programi ka një rëndësi të jashtëzakonshme për edukimin e shëndoshë revolucionar të brezit të ri dhe për fatet e socializmit në Shqipëri.

Realizimi një vit para afatit i aksionit të madh, elektrifikimit të të gjitha fshatrave, është një fitore e shkëlqyer e me të vërtetë historike e rendit tonë socialist, një dëshmi tjetër e kujdesit të vazhdueshëm të Partisë e të pushtetit popullor për ngritjen dhe emancipimin e gjithanshëm të fshatit tonë kooperativist.

Mjete të shumta u investuan nga shteti gjatë pesëvjeçarit të katërt për ndërtimin e shtëpive të banimit. Por një faktor shumë i rëndësishëm që çeli perspektiva të reja për të bërë një kthesë në plotësimin e nevojave për strehim të punonjësve të qytetit dhe të qendrave punëtore ishte shpërthimi i iniciativës revolucionare të masave për ndërtim banesash me kontribut vullnetar të vetë punonjësve. Gjatë pesë vjetëve u ndërtuan, në qytet dhe në fshat, rreth 73 mijë apartamente. Një punë e madhe ndërtuese, ku u shpreh uniteti i shkëlqyer dhe solidariteti socialist i popullit tonë, u krye për përballimin e pasojave të rënda, të shkaktuara nga tërmeti në rrethet e Dibrës dhe të Tepelenës. Me ndihmën e pushtetit dhe kontributin e gjithë popullit u ndërtuan brenda një afati rekord 1 600 shtëpi të reja dhe u meremetuan rreth 11 000 të tjera.

Vendi ynë është vendi i vetëm në botë ku popullsia nuk paguan asnjë lloj tatimi e takse të drejtpërdrejtë. Heqja e plotë e taksave nga popullsia është një epërsi që duket sheshit e rendit tonë socialist mbi atë kapitalist.

Rezultatet e arritura në zhvillimin e ekonomisë e të kulturës, në ngritjen e mirëqenies së popullit dhe forcimin e rendit tonë shoqëror janë fitore të shquara të ndërtimit tonë socialist, që gëzojnë me të drejtë Partinë e popullin, që u japin atyre energji e guxim të ri revolucionar për të ecur kurdoherë përpara. Ato flasin qartë për drejtësinë e vijës dhe të politikës konsekuente marksiste-leniniste që ka zbatuar Partia, për atë entuziazëm, mobilizim në punë dhe frymë të lartë revolucionare, që karakterizojnë masat tona punonjëse.

Pesëvjeçari që u mbyll do të hyjë në histori si periudha e iniciativave të mëdha popullore dhe e heroizmit masiv, kur forca e bashkuar e popullit, nën udhëheqjen e Partisë, bëri të tunden malet e fushat. Kjo është koha kur i madh e i vogël u ngritën në këmbë, kur entuziazmi dhe hovi revolucionar pushtoi fabrikat e fshatrat, shkollat e minierat. Është koha e heronjve të vetëdijshëm që asnjë pengesë, asnjë vështirësi, asnjë furtunë nuk i kthen prapa, për të cilët zbatimi i detyrës, përmbushja e porosisë së popullit është ligj suprem e i shenjtë. Kjo periudhë e lavdishme lindi heronj të tillë si cucën malësore Shkurte Pal Vata, punëtorin Adem Reka, inxhinierin Muhamet Shehu, mësuesin Ismet Sali Bruçaj, ushtarin Agron Elezi e shumë të tjerë, që dhanë jetën në krye të detyrës për idealet e Partisë dhe interesat e popullit. Shembulli e figura e tyre u bënë pishtarë të qëndrimit burrëror dhe të devocionit të pakufishëm, që ngritën peshë mbarë popullin.

Në këto valë të papërmbajtura revolucionare shpërthyen

iniciativat e mrekullueshme të masave dhe fryma e aksionit, që i dhanë një përmbajtje e shtytje të re punës në të tërë sektorët, që treguan se ç'forca kolosale akoma të panjohura e të pashfrytëzuara ruajnë në gjirin e tyre Partia, klasa punëtore e fshatarësia, rinia e gruaja, ç'forca të pashtershme ka rendi socialist.

Populli ynë është modest, por ai ka të drejtë të krenohet për bijtë e bijat e tij që ngrenë e montojnë vetë fabrikat e fjalës së fundit të teknikës botërore, që drejtojnë anijet moderne nëpër oqeane, që aq shpejt e aq mirë ndërtojnë vepra të tilla të komplikuara teknike si hidrocentralin e Vaut të Dejës. Ai ka të drejtë të krenohet për njerëzit e tij të rinj, që me guxim të pashembullt sulmojnë shkencën e teknikën, përmbysin normat akademike e lënë prapa edhe parashikimet më optimiste.

Ky entuziazëm i paparë revolucionar, ky heroizëm masiv dhe kjo frymë e lartë iniciative nuk ranë nga qielli. Ato e kanë burimin në atë luftë heroike e të pashembullt që Partia e populli kanë bërë për shpartallimin e bllokadave imperialiste e revizioniste, në patriotizmin e pashuar dhe besimin e patundur që populli ynë ka në forcat e veta, në sigurinë e së ardhmes që far-këton socializmi, në nxitjen jetëdhënëse që frymëzojnë mësimet e Partisë. Vetëm një perspektivë e madhe lind guximin e madh, vetëm bindjet e rrënjosura ideologjike mund të bëjnë çudira. T'i ruajmë e t'i zhvillojmë më tej këto cilësi të mëdha morale të fituara, të vëmë të gjitha forcat për t'i mbajtur kurdoherë të gjalla e të pastra, t'i bëjmë ato një forcë lëvizëse për të zgjidhur me sukses detyrat madhështore që kemi përpara.

Fitoret e mëdha të arritura në të gjitha fushat e ndërtimit socialist, përvoja e grumbulluar dhe entuziazmi e fryma e lartë revolucionare e masave punonjëse përbëjnë atë bazë të fuqishme, mbi të cilën do të mbështetet i gjithë zhvillimi ekonomik e shoqëror i vendit në pesëvjeçarin e pestë. Detyrat kryesore të planit që do të aprovojë ky Kongres rrjedhin nga vazhdimi i ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste, nga stadi i arritur dhe perspektivat e zhvillimit të ekonomisë.

Ekonomia jonë ka arritur një nivel të ri më të lartë sasior e cilësor. Zhvillimi i mëtejshëm i industrisë karakterizohet nga një vëllim i madh prodhimi dhe sidomos nga krijimi i degëve të reja të industrisë së rëndë përpunuese. Janë ngritur ndërmarrje të mëdha e komplekse, me teknikë e teknologji të përparuar. Kudo ku akoma prodhohet me metoda artizanale është shtruar detyra që të kalohet në metodat industriale të prodhimit. Shkenca dhe teknika e re po futen gradualisht në të gjitha degët e ekonomisë. Bujqësia po ecën gjithnjë e më shumë në rrugën e intensifikimit.

Të gjitha këto tregojnë se ekonomia jonë po hyn në një

etapë të re, se zhvillimi i saj i mëtejshëm kërkon një harmonizim më të mirë të rrugës ekstensive me atë intensive, si dhe zgjidhjen e problemeve që lindin nga ky harmonizim. Në këto kushte del e domosdoshme që i gjithë zhvillimi i ekonomisë, drejtimi dhe organizimi i saj të vihen mbi baza më të shëndosha shkencore.

Në përputhje me orientimet themelore të politikës së Partisë për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste, si detyrë kryesore e zhvillimit të ekonomisë në pesëvjeçarin e pestë do të jetë:

Të sigurohet fuqizimi i përgjithshëm i ekonomisë popullore në rrugën e kthimit të Shqipërisë nga një vend bujqësor-industrial në një vend industrial-bujqësor, me qëllim që të rritet shkalla e vetëveprimit të ekonomisë, të forcohet më tej rendi socialist, të ngrihet mirëqenia materiale e kulturore e popullit, duke ngushtuar sidomos dallimet esenciale midis fshatit e qytetit dhe të rritet aftësia mbrojtëse e vendit.

Për këtë:

Të luftohet për një zhvillim të mëtejshëm të industrisë, duke përmirësuar strukturën e saj me degë e prodhime të reja, sidomos të industrisë së rëndë përpunuese, për të zgjeruar bazën energjetike dhe të lëndëve të para dhe për të shfrytëzuar më racionalisht burimet dhe pasuritë e vendit;

Të arrihet një rritje më e madhe e prodhimit bujqësor nëpërmjet intensifikimit të mëtejshëm të tij, duke u mbështetur në forcimin e organizimit e të drejtimit shkencor të prodhimit dhe në fuqizimin e bazës materiale-teknike të bujqësisë;

Të zhvillohet me vrull përparimi tekniko-shkencor në të gjitha degët e ekonomisë popullore, të përsosen pa ndërprerje marrëdhëniet socialiste në prodhim, të thellohet revolucioni socialist në fushën e ideologjisë e të kulturës, të zbatohet me vendosmëri parimi i mbështetjes në forcat e veta.

Planin e ri pesëvjeçar e hartuan vetë masat punonjëse, duke u mbështetur në direktivat e orientimet e Partisë e të Qeverisë. Klasa punëtore, fshatarësia kooperativiste, specialistët e teknikët, kuadrot e bazës e të qendrës, të gjithë së bashku diskutuan gjallërisht si asnjëherë tjetër dhe caktuan detyrat e pesëvjeçarit të pestë. Fryma e lartë revolucionare, mendimi krijues, përvoja e tyre e pasur, mbështetja në forcat e veta, ndjenja e thellë e përgjegjësisë për fatet e atdheut e të socializmit qëndrojnë në themel të projektdirektivave që i paraqiten këtij Kongresi mbi zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës për vitet 1971-1975.

Edhe në pesëvjeçarin e pestë industria do të luajë si gjithnjë rolin pararojë për zhvillimin e forcave prodhuese. Prodhimi i përgjithshëm industrial parashikohet që më 1975 të rritet 61-66 për qind në krahasim me vitin 1970. Kjo do të thotë se vetëm

në vitin 1975 prodhimi industrial do të jetë 12 për qind më i madh sesa ai i realizuar gjatë gjithë pesëvjeçarit të dytë, 1956--1960. Vetëm ky fakt mjafton për të hedhur poshtë shpifjet banale të revizionistëve sovjetikë, se ekonomia jonë ka ngecur gjoja në vend që kur u prenë ndihmat e tyre.

Gjatë këtij pesëvjeçari do të synohet që industria, sidomos ajo nxjerrëse dhe e rëndë përpunuese, të forcohet, të modernizohet më tej dhe të ngrihet në një shkallë më të lartë. Për këtë arsye do të ndërtohen një varg veprash të reja me procese teknologjike e përpjesëtime prodhimi të papara për ekonominë tonë. Të tilla do të jenë: kombinati i metalurgjisë së zezë me cikël të mbyllur, uzina për përpunimin e thellë të naftës, minierat e mëdha për nxjerrjen e hekurnikelit, kromit, qymyrgurit, hidrocentrali i Fierzës, fabrikat për pasurimin e mineraleve etj. Do të prodhohen për herë të parë çeliqe dhe gizë, nikel, kobalt, llamarinë, tubo, karburante të cilësive të larta, gaz i lëngët, uré, acid klorhidrik etj. Si rrjedhim i këtij zhvillimi do të shtohet klasa punëtore, do të rritet niveli tekniko-profesional dhe roli i saj udhëheqës në të gjithë jetën e vendit.

Perspektiva të mëdha hapen në planin e ri pesëvjeçar edhe për zhvillimin e bujqësisë sonë socialiste. Në vitin 1975 prodhimi i përgjithshëm bujqësor do të jetë 65-69 për qind më i madh se ai i vitit 1970 ose rreth 3 herë më i lartë se ai i vitit 1960. Do të shtohet shumë prodhimi i drithërave, i qumshtit, i mishit, i vezëve, i perimeve dhe i bimëve industriale. Numri i pemëve frutore do të rritet rreth 28 për qind. Duke ndërtuar vepra të rëndësishme bonifikimi e ujitjeje, sidomos në zonat malore, aftësia ujitëse do të përfshijë rreth 58 për qind të sipërfaqes së tokës arë të vendit. Numri i traktorëve në shfrytëzim, të kthyer në 15 kuaj fuqi më 1975, në krahasim me vitin 1970, do të rritet rreth 40 për qind, ose 3,5 herë më shumë nga sa kishte në vitin 1960. Është parashikuar që nevojat e bujqësisë për plehra kimike e mekanizma, për farëra e kafshë race të llojeve me prodhimtari të lartë të plotësohen si asnjëherë më parë. Gjatë këtij pesëvjeçari do të përgatiten me mijëra specialistë të mesëm e të lartë për këtë sektor kaq të rëndësishëm të ekonomisë sonë.

Një program madhështor ndërtimesh kapitale do të përfshijë të gjitha fushat e veprimtarisë shoqërore. Investimet e caktuara për pesëvjeçarin e pestë janë të barabarta me të gjitha investimet që janë bërë gjatë 11 vjetëve të fundit të marrë së bashku (1960-1970). Vetëm vlefta e ndërtim-montimit për dy objektet e mëdha, për kombinatin metalurgjik e hidrocentralin e Fierzës, janë gati të barabarta me investimet e kryera në gjithë pesëvjeçarin e parë ose rreth 50 për qind të gjithë investimeve të pesëvjeçarit të dytë. Gjithsej do të ndërtohen rreth 270 vepra ekonomike e socialkulturore.

Revolucionarizimi i shkollës do të shoqërohet me zgjerimin e mëtejshëm të arsimit të mesëm e të lartë. Në çdo tre veta të popullsisë në të gjitha kategoritë e arsimit një do të mësojë në bankat e shkollës. Në pesë vjetët e ardhshëm do të përgatiten rreth 20 000 specialistë me arsim të lartë, ose 33 për qind më shumë sesa u përgatitën gjatë 26 vjetëve të fundit, që nga vendosja e pushtetit popullor e gjer në vitin 1970. Gjithë ndërtimi ynë socialist në çdo fushë të jetës do të intensifikohet nën shenjën e një përdorimi më të gjerë të dijeve dhe të kërkimeve shkencore.

Zhvillimi kompleks e dinamik që do të kryhet në ekonominë tonë, do të sjellë si gjithnjë ngritjen e mirëqenies materiale e kulturore të punonjësve të qytetit dhe të fshatit. Jeta e popullit tonë trim e punëtor do të zbukurohet edhe më shumë, do të bëhet më e lumtur dhe më e gëzuar. Mjafton të përmendim se në apartamentet e shtëpitë që do të ndërtohen gjatë pesëvjeçarit të pestë do të strehohet një popullsi e barabartë me atë që kanë sot qytetet Korçë, Elbasan, Shkodër, Durrës, Vlorë, Berat, Fier e Lushnjë të marra së bashku.

I tillë është në vija të përgjithshme programi i zhvillimit ekonomiko-shoqëror të vendit gjatë pesëvjeçarit të pestë dhe që shtrohet për aprovim para Kongresit. Me qenë se shoku Mehmet Shehu do t'i paraqesë Kongresit një raport të veçantë e më të hollësishëm mbi projektdirektivat e këtij plani, këtu do të ndalemi në disa nga çështjet më kryesore të politikës ekonomike të Partisë për pesë vjetët e ardhshëm.

Të përmirësohet struktura e prodhimit industrial dhe të fuqizohet baza materialo-teknike e tij

Gjatë periudhës së ndërtimit socialist vendi ynë ka përshkuar një rrugë industrializimi më shumë se 20-vjeçare. Sukseset e arritura i kanë dhënë fund prapambetjes ekonomike shekullore të trashëguar nga e kaluara. Perspektiva të reja të ndritura janë çelur për zhvillimin e kësaj dege jetike për ekonominë tonë. Shqipëria e dikurshme thellësisht agrare sot ecën e sigurt përpara në rrugën e kthimit në një vend industrialo-bujqësor. Potenciali prodhues ekzistues i industrisë dhe bashkë me të klasa punëtore e kuadrot teknikë përbëjnë atë bazë, e cila lejon tani që industrializimi i vendit të ngrihet në një stad të ri.

Duke ndjekur me vazhdimësi politikën e drejtë të krijimit të një industrie të fuqishme kombëtare, pikësynimi kryesor i industrializimit në këtë periudhë do të jetë shfrytëzimi më i gjerë dhe me efekt ekonomik më të madh i pasurive natyrore të vendit, me qëllim që të arrihet plotësimi i nevojave më të mëdha e më të ngutshme të riprodhimit të zgjeruar. Në përputhje me këtë

orientim, do të vazhdojnë të zhvillohen njëkohësisht, në përpjesëtimet e duhura sipas nevojave e mundësive, industria e rëndë dhe e lehtë, nxjerrëse e përpunuese, të harmonizuara kurdoherë me zhvillimin sidomos të bujqësisë dhe të degëve të tjera të ekonomisë.

Për zbatimin në jetë me etapa të këtij orientimi të përgjithshëm si detyrë kryesore e industrializimit tonë mbetet zgjerimi dhe përmirësimi i strukturës së prodhimit industrial. Është pikërisht për këtë arsye që gjatë pesëvjeçarit të pestë industrializimi do të vazhdojë në rrugën e zhvillimit të degëve ekzistuese dhe të krijimit të degëve të reja të industrisë së rëndë përpunuese.

Me rëndësi të jashtëzakonshme për tërë ekonominë tonë është ndërtimi për të parën herë i metalurgjisë së zezë. Kombinati metalurgjik që do të ngrihet në Elbasan është një vepër gjigande, e cila do të fuqizojë pavarësinë e vetëveprimin e ekonomisë sonë, do të sigurojë në vend lëndën e parë të domosdoshme për zhvillimin e industrisë mekanike dhe për kalimin në të ardhmen në atë të prodhimit të makinave, do të forcojë shumë bazën materiale të ndërtimeve.

Në zhvillimin kompleks të industrisë edhe në këtë pesëvjeçar prioriteti do t'u jepet degëve të industrisë nxjerrëse të mineraleve dhe të lëndëve djegëse. Kjo bëhet me qëllim që të zgjerohet baza e lëndës së parë për metalurgjinë dhe për industrinë kimike, që të shtohet eksportimi i mineraleve dhe të forcohet baza energjetike aq shumë e nevojshme për vetë industrinë dhe gjithë ekonominë popullore. Prandaj është e nevojshme që organet e Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë, punëtorët, teknikët dhe specialistët e këtij fronti jetik për çështjen e industrializimit të vënë tërë forcat e aftësitë për realizimin dhe tejkalimin e tyre.

Për të realizuar me sukses planin në degët e industrisë nxjerrëse, duhet që mjetet dhe forcat kryesore të përqendrohen në radhë të parë në minierat ekzistuese, duke siguruar prej tyre shumicën dërrmuese të shtesës së prodhimit. Arritja e këtij objektivi kërkon që në këto miniera të rriten rezervat e njohura dhe të intensifikohet shfrytëzimi i tyre racional.

Garantimi i realizimit të detyrave për nxjerrjen e mineraleve dhe të lëndëve djegëse varet shumë edhe nga roli i posaçëm që ka luajtur dhe luan gjeologjia për zhvillimin e industrisë nxjerrëse. Ajo duhet të sigurojë nevojat gjithnjë më të mëdha për lëndë të parë të industrisë përpunuese për sot dhe për një perspektivë të gjatë e të qëndrueshme. Për këtë arsye zgjerimi i njohjes së pasurive të nëntokës që sot shfrytëzohen, zbulimi e përvetësimi i pasurive të reja të çmueshme, ngritja e rezervave të zbuluara në kategori industriale, si edhe shfrytëzimi racional i teknikës ekzistuese të konsiderohen ndër detyrat më të rëndësishme të punonjësve të gjeologjisë. Realizimi i planit të shpim-

-kërkimeve të mos shihet kurrë si një qëllim në vetvete, por të vlerësohet kurdoherë me sasinë e rezervave të gjendura për mineralet që nxirren ose që zbulohen për herë të parë.

Si edhe në të kaluarën, një kujdes i madh do t'i kushtohet shtimit të prodhimit të energjisë elektrike. Industria elektrike duhet t'i paraprijë industrisë dhe gjithë degëve të tjera të ekonomisë. Prandaj ritmet e zhvillimit të saj duhet të jenë më të larta se ritmet e shtimit të prodhimit të përgjithshëm industrial. Ecja në këtë rrugë diktohet nga nevoja për të ngritur shkallën e pajimit energjetik të punës, si kusht i domosdoshëm për të zbatuar teknikën e re, për të lehtësuar punën dhe për të rritur rendimentin e saj në të gjitha degët e ekonomisë. Për këtë qëllim është parashikuar që në vitin 1975 prodhimi i energjisë elektrike të arrijë në mbi 2 miliard kilovatorë, domethënë të jetë mbi 2 herë më i madh se në vitin 1970. Me këtë sasi përballohen nevojat korente të ekonomisë dhe të popullsisë.

Për fuqizimin e bazës teknike të vetë industrisë dhe të degëve të tjera të ekonomisë një rol të posaçëm duhet të luajë industria mekanike. Detyra e saj e parë ka qenë dhe mbetet sigurimi i gatishmërisë teknike, i shfrytëzimit pa ndërprerje dhe me rendiment të lartë të makinave dhe pajisjeve që ka ekonomia. Si anë tjetër, po aq e rëndësishme dhe shumë e ngutshme e detyrës kryesore të industrisë mekanike, mbetet që ajo të përmirësojë shumë dhe pa pushim cilësinë e prodhimit të pjesëve të ndërrimit. Pa e ngritur në një shkallë më të lartë cilësinë, sado që të shtohet prodhimi i kësaj dege, ekonomia jonë nuk do të lehtësohet nga importimi i pjesëve të ndërrimit.

Në kushtet kur do të prodhohen në vend çeliqe, prokate dhe gizë, kur shtrohet çështja që përparimit tekniko-shkencor t'i jepet një hov i mëtejshëm, për këtë degë të industrisë çelet një perspektivë e re e madhe. Ajo nuk mund të kufizohet më vetëm me prodhimin e pjesëve të ndërrimit, por ka ardhur koha që t'i futet më me guxim edhe prodhimit të makinave. Kjo është bërë një nevojë e ngutshme për ekonominë tonë, që duhet zgjidhur hap pas hapi, por me vendosmëri, sipas mundësive të reja që do të krijohen. Në këtë çështje kaq të rëndësishme, por edhe të ndërlikuar të fillohet në radhë të parë nga ato makina, mekanizma e pajisje, që i nevojiten më shumë ekonomisë sonë, që mund të prodhohen në seri dhe që lehtësojnë barrën e importit.

Që industria mekanike t'u përgjigjet më mirë detyrave të sotme e në perspektivë është e nevojshme të thellohet më tej specializimi dhe kooperimi i prodhimit. Për këtë problem është hartuar në Plenumin e 3-të të KQ një program i hollësishëm dhe me afat të gjatë veprimi. Mirëpo gjer më sot vihet re se në zbatimin e këtij programi ka javashllëk, se shumë detyra që rrjedhin prej tij kanë mbetur ende të pazgjidhura. Në të ardhmen është e

nevojshme që për t'i dhënë rrugë këtij problemi kaq të rëndësishëm të bëhet një punë e bashkërenduar më mirë në shkallë rrethi e kombëtare, duke kapërcyer çdo interes të ngushtë lokal ose dikasterial, çdo pengesë burokratike.

Zhvillimi dhe struktura e industrisë janë lidhur kurdoherë ngushtë me nevojat e degëve të tjera të ekonomisë. Kjo ka bërë të mundur që të ruhet ekuilibri midis zhvillimit të industrisë dhe të bujqësisë, që industria t'i shërbejë drejtpërdrejt edhe zhvillimit të bujqësisë. Duke ecur në këtë rrugë të drejtë e të sprovuar, në pesëvjeçarin e pestë zhvillimi i industrisë do të lidhet më shumë me nevojat që ka bujqësia për intensifikimin dhe modernizimin e mëtejshëm të saj. Për këtë qëllim është parashikuar që prodhimi i plehrave kimike të rritet, gjithashtu të zgjerohet shumë prodhimi i lëndëve kimike për të luftuar dëmtuesit dhe sëmundjet e bimëve. Krahas me këtë do të dyfishohet prodhimi i pjesëve të ndërrimit për traktorë, do të përvetësohet prodhimi i makinerive e i pajisjeve të reja bujqësore, do të merren masa për të përgatitur më shumë ushqime të përpunuara për blegtorinë, për të shtuar mjetet e transportit dhe materiale të tjera të riprodhimit që i duhen bujqësisë. Të tëra këto do të jenë një kontribut i madh që do të japë industria jonë socialiste për zhvillimin e bujqësisë.

Megjithëse forcat njerëzore, burimet financiare dhe mjetet materiale kryesore do të përdoren edhe gjatë këtij pesëvjeçari për zhvillimin e industrisë së rëndë, nuk do të lejohet asnjë teprim që të rëndojë ose të ngadalësojë zhvillimin e industrisë së lehtë. Në vendosjen e përpjesëtimeve midis industrisë së rëndë e të lehtë prioriteti do t'i jepet industrisë së rëndë. Ky ka qenë dhe mbetet një parim i drejtë e i patundur për zhvillimin e industrisë sonë.

Sot te ne nuk përputhet kurdoherë dhe sa duhet prodhimi i mallrave të përdorimit të gjerë me fuqinë blerëse të popullsisë. Për zgjidhjen e kësaj kontradikte në pesëvjeçarin e pestë prodhimi i mallrave të përdorimit të gjerë do të shtohet me ritme më të shpejta sesa do të shtohen të ardhurat në para të popullsisë. Rritja e parashikuar për mallrat e përdorimit të gjerë lipset të konsiderohet si një cak i domosdoshëm për t'u realizuar, por jo si një detyrë maksimale. Prandaj organet e Partisë, të pushtetit dhe të ekonomisë të nxitin e të përkrahin me të gjitha mënyrat çdo iniciativë të punonjësve për të shtuar prodhimin e mallrave të përdorimit të gjerë, sidomos duke krijuar reparte e linja të reja për ato mallra, për të cilat ka kërkesa më shumë. Në këtë drejtim duhet të japin një ndihmë më të madhe se gjer më sot edhe kolektivat e ndërmarrjeve të industrisë së rëndë.

Prodhuesit e mallrave të përdorimit të gjerë të marrin të gjitha masat e nevojshme që plani të realizohet medoemos sipas

asortimenteve dhe cilësisë dhe t'u afrohen sa më shumë kërkesave reale të tregut. Tani është arritur një gjendje e tillë, kur, pa dobësuar për asnjë çast luftën për sasi, duhen bërë përpjekje të pareshtura që mallrat e prodhuara për popullin të jenë më të larmishme, më të forta, më të bukura e të lira.

Këto detyra të industrisë së lehtë kanë një kuptim dhe rëndësi të madhe, sa ekonomike, aq edhe politike. Ato kanë të bëjnë me plotësimin e nevojave të përditshme të popullit. Nga sasia, struktura dhe cilësia e mallrave varet përballimi i kërkesave të punonjësve, qarkullimi i shpejtë i parasë dhe rritja e fuqisë blerëse të saj.

Komiteti Qendror i Partisë ka besim të plotë se punonjësit e kësaj dege do të vënë tërë forcat dhe dijet e tyre për të bërë një kthesë rrënjësore në këtë drejtim, për të realizuar me sukses dhe për të tejkaluar detyrat që u shtron plani i pestë pesëvjeçar.

Drejtimet kryesore të politikës së Partisë për zhvillimin e bujqësisë

Megjithëse Shqipëria socialiste synon të kthehet në një vend industrial, bujqësia mbetet përsëri dega bazë e ekonomisë sonë. Mbështetja fort e ekonomisë kombëtare si në industrinë ashtu edhe në bujqësinë është një parim i përhershëm, një kusht i domosdoshëm për zhvillimin e saj të shpejtë e të harmonizuar, për të rritur shkallën e vetëveprimit të saj. Për këtë arsye politika e Partisë për zhvillimin e bujqësisë ka synuar kurdoherë që thellimi i revolucionit socialist në fshat të çojë medoemos edhe në zhvillimin e forcave prodhuese në bujqësi.

Dhe në të vërtetë çdo vit që kalon dëshmon gjithnjë e më shumë për drejtësinë e politikës marksiste-leniniste të Partisë edhe në këtë fushë. Rendi socialist në fshatin tonë tashmë ka fituar plotësisht dhe e gjithë jeta e fshatarësisë, marrëdhëniet ekonomiko-shoqërore, mentaliteti e psikologjia e saj transformohen pa pushim mbi baza revolucionare. Bujqësia ka bërë përparime të mëdha e të gjithanshme.

Suksese të mëtejshme shënoi bujqësia jonë edhe gjatë pesëvjeçarit të katërt. Në vitin 1970 prodhimi i përgjithshëm bujqësor ishte 33 për qind më i madh se më 1965. Megjithëkëtë, për shkak të një vargu faktorësh subjektivë e objektivë, bujqësia nuk i plotësoi sipas parashikimeve të gjitha detyrat e caktuara në pesëvjeçarin e katërt. Kjo krijoi edhe vështirësi e shpërpjesëtime të përkohshme për ekonominë popullore, që duhet të kapërcehen patjetër për të mos penguar zhvillimin e përgjithshëm e të shpejtë të vendit.

Gjatë pesëvjeçarit të pestë kërkesat e popullsisë dhe të ekonomisë për prodhime bujqësore e blegtorale shtohen në përpjesëtime më të mëdha se në të kaluarën. Kjo shtron përpara bujqësisë nevojën e ngutshme të zhvillimit të vrullshëm të saj. Për këtë arsye bujqësia duhet parë si hallkë vendimtare për plotësimin me sukses të planit të pestë pesëvjeçar.

Objektivi kryesor, detyra themelore e bujqësisë edhe në pesëvjeçarin e pestë mbetet shtimi i prodhimit të drithërave të bukës. Për këtë qëllim është e domosdoshme të arrihet që prodhimi i drithit të bëhet sa më i qëndrueshëm dhe të shtohet me ritme të larta nga njëri vit në tjetrin. Në vitin 1975, në krahasim me vitin 1970, është parashikuar që prodhimi i drithërave të rritet 50-55 për qind. Me këtë shtim sigurohen kërkesat e popullsisë e të ekonomisë për drithë, përballohen në një shkallë më të madhe nevojat e blegtorisë për ushqime të koncentruara dhe shtohen më tej rezervat e sigurimit. Realizimi i kësaj detyre do të jetë një fitore e madhe.

Duke i përqendruar forcat dhe mjetet për shtimin e drithërave të bukës, jo më pak duhet të luftohet për të zhvilluar edhe degët e tjera të bujqësisë, bimët industriale e blegtorinë, perimet e frutikulturën. Në vitin 1975, në krahasim me vitin 1970, është parashikuar që prodhimi i bimëve industriale në tërësi të shtohet 80-85 për qind, nga i cili ai i luledielli rreth 145 për qind. Përpjekje të mëdha do të bëhen edhe për zhvillimin e blegtorisë, sidomos për të shtuar prodhimin e qumshtit 68-72 për qind.

Ne flasim gjithnjë për të ndryshuar strukturën e ushqimit të popullit, për ta bërë atë më të shumanshëm e të pasur në përputhje me nevojat fiziologjike të njeriut. Për këtë duhet të shtohen prodhimi e rendimentet e të gjitha llojeve të perimeve dhe të frutave, duke synuar që punonjësit të sigurohen me to gjatë tërë vitit dhe në sasi të bollshme. Kështu jo vetëm do t'i jepen popullit më shumë prodhime me vlerë të madhe ushqyese, por do të shtohet edhe mundësia për të përdorur më shumë drithë në dobi të blegtorisë.

Për të plotësuar me sukses detyrat e mëdha që i shtrohen përpara bujqësisë është e domosdoshme të vazhdojë kursi i drejtë për intensifikimin e mëtejshëm të saj. Për këtë qëllim gjatë pesëvjeçarit të pestë do të bëhen investime të mëdha e të gjithanshme jo vetëm në fushë, por edhe në zonat malore. Qëllimi i tyre është që në bimët e arave dhe në blegtori të arrihen rendimente të tilla, të cilat të sigurojnë pjesën dërrmuese të shtesës që do të shënojë prodhimi i përgjithshëm bujqësor gjatë pesëvjeçarit.

Zhvillimi dhe intensifikimi i bujqësisë, natyrisht, do të jetë më i madh në fushat. Në të njëjtën kohë do të shtohen kujdesi dhe përpjekjet për ta çuar përpara zhvillimin e bujqësisë edhe në zonat malore. Krahas intensifikimit të bujqësisë, hapja e to-

kave të reja është për ne një detyrë e përhershme, gjersa të ketë sipërfaqe që mund të punohet dhe të prodhojë.

Përvetësimi i tokave të reja dhe intensifikimi i bujqësisë kërkojnë në radhë të parë që të rritet shkalla e mekanizimit të punimeve. Pa mekanizim kompleks të punës kudo, në fushë dhe në malësi, bujqësia jonë nuk mund të arrijë ato rezultate që kërkohen prej saj dhe kooperativistët nuk mund të revolucionarizojnë plotësisht konceptet e tyre për punën dhe bujqësinë moderne. Për këtë qëllim ne duhet të përpiqemi për një mekanizim sa më të madh të punimeve në bujqësi.

Bujqësia jonë do të ketë gjithçka i duhet për të plotësuar detyrat e mëdha që shtrohen para saj në këtë pesëvjeçar. Baza materialo-teknike e prodhimit bujqësor po zgjerohet dita-ditës. Rendi kooperativist është forcuar, duke kaluar nga prona e vogël dhe e kufizuar e grupit në kooperativat e zmadhuara. Fshatarësia jonë është patriote dhe revolucionare, e gatshme kurdoherë të luftojë e të punojë për socializmin, për të vënë në jetë mësimet e Partisë. Punonjësit dhe kuadrot e bujqësisë kanë fituar një përvojë të madhe shumëvjeçare.

Por diskutimi i gjerë popullor i Letrës së Komitetit Qendror të Partisë «Mbi nevojën e një kthese rrënjësore në përsosjen e organizimit dhe forcimin e disiplinës së punës në bujqësi»[1] nxori në shesh se, me gjithë fitoret e arritura, në veprimtarinë e kooperativave dhe të ndërmarrjeve bujqësore ekzistojnë të meta të rëndësishme. Këto të meta e kanë burimin në pikëpamjet e vjetra konservatore për bujqësinë, në konceptet, format dhe praktikat e vjetra të drejtimit, të organizimit të punës dhe të planifikimit. Diskutimi tregoi gjithashtu në mënyrë bindëse se ekzistojnë të gjitha mundësitë dhe kushtet e favorshme shoqërore-ekonomike që ndërmarrjet bujqësore shtetërore dhe kooperativat të kthehen brenda një kohe të shkurtër në ekonomi të zhvilluara dhe me rendimente të larta.

Që të zgjidhen detyrat e ngritjes së kooperativave në nivelin e ekonomive moderne është e domosdoshme të thellohet më tej specializimi i tyre. Bujqësia jonë nuk mund të zhvillohet me sukses me ekonomi «mozaike» që të mbjellin të gjitha llojet e bimëve ose të rritin të gjitha llojet e bagëtisë. Asaj nuk i duhet as një specializim i ngushtë e i njëanshëm. Ajo ka nevojë për një specializim të tillë, i cili të lejojë një përqendrim e shpërndarje më të drejtë e më racionale të bimëve bujqësore e të blegtorisë, si midis rretheve të ndryshme, ashtu edhe midis kooperativave të të njëjtit rreth. Qëllimi i fundit i specializimit në bujqësinë tonë është rritja e prodhimit bujqësor e blegtoral në përpjesëtime gjithnjë më të mëdha, duke ulur vazhdimisht shpenzimet shoqë-

1 Shih në këtë vëllim, f. 9.

rore për njësi prodhimi. Specializimi për çdo kooperativë bujqësore ose rreth duhet të argumentohet ekonomikisht, të përgatitet nga të gjitha anët dhe të mos bëhet i shpejtuar.

Në kuadrin e specializimit një vëmendje të posaçme kërkon zgjidhja e problemeve që lidhen me modernizimin e blegtorisë. Prandaj shtrohet detyra që, brenda një kohe relativisht të shkurtër, në strukturën e blegtorisë sonë të shënohet një kthesë rrënjësore. Nga ana tjetër, përpjekjet për të intensifikuar blegtorinë lipset të shoqërohen medoemos me sigurimin e një baze reale ushqimore, si për lopët e sektorit socialist, ashtu edhe për ato të oborrit kooperativist. Që të ecet me ritme më të shpejta në këtë drejtim është e nevojshme të luftohen pikëpamjet konservatore, të cilat janë rrënjosur te fshatarësia jonë në kushtet e mbisundimit për një kohë shumë të gjatë të blegtorisë ekstensive.

Detyrat komplekse që shtrohen për t'i kthyer kooperativat në ekonomi të rendimenteve të larta nuk mund të realizohen me sukses pa e vënë tërë bujqësinë tonë mbi baza të gjera e më të thella shkencore. Ka ardhur koha që puna e kooperativistëve të bashkohet më mirë e më ngushtë me dijet shkencore, që në të gjitha degët e bujqësisë të futet më shumë shkenca dhe të forcohet disiplina agroteknike për zbatimin e përpiktë e në kohën e duhur të kërkesave të saj në çdo proces të prodhimit. Prandaj Partia u bën thirrje punëtorëve, kooperativistëve, specialistëve dhe gjithë drejtuesve të ekonomive bujqësore që të studiojnë me ngulm dhe të zbatojnë me zell rezultatet e shkencës dhe të teknikës bujqësore.

Zgjidhja e detyrave të shumta e të mëdha në bujqësi kërkon medoemos që tërë forcat e afta në fshat, burra e gra, të rinj e të reja, të hidhen në punë gjatë gjithë vitit, dimër e verë, në kohë të keqe e të mirë. Është e domosdoshme gjithashtu që në çdo punë të bujqësisë të punohet me disiplinë të fortë socialiste dhe të mos lejohet të humbasë asnjë orë pune. Kudo dhe kurdoherë të punohet me norma pune të përcaktuara mirë, të mbështetura në kritere shkencore dhe në përvojën e përparuar, të cilat të shërbejnë për matjen e punës po me aq saktësi, sa edhe në industri.

Në stadin e sotëm të zhvillimit bujqësia jonë ka shumë nevojë për kuadro e specialistë, për mjeshtër të kualifikuar, që ta duan bujqësinë me gjithë shpirt dhe të jenë të lidhur ngushtë me fshatin. Për plotësimin sa më shpejt të këtyre nevojave do të merren masa që në të gjithë vendin të ngrihet një rrjet i gjerë shkollash tekniko-profesionale, ku të mësojnë të rinjtë dhe të rejat e fshatit, kooperativistët, të gjithë ata që duan t'i vënë forcat dhe mendjen e tyre në shërbim të bujqësisë. Krahas me këtë është e nevojshme që për punonjësit e bujqësisë të gjenden forma më të përshtatshme shpërblimi, të cilat të nxitin shtimin e prodhimit dhe punën me cilësi të mirë, të marrin parasysh përvojën në punë, shkallën e kualifikimit, vështirësitë e punës etj.

Në etapën e sotme të ndërtimit të plotë të socializmit ne duhet të forcojmë edhe më shumë punën për ngushtimin e dallimeve esenciale midis fshatit dhe qytetit. Rezultatet e arritura në këtë drejtim janë të mëdha, por ato duhet të çohen përpara duke u mbështetur fort në gjendjen reale të fshatit tonë, në karakteristikat e veçanta kombëtare dhe mundësitë e ekonomisë.

Komiteti Qendror i Partisë ka arritur në përfundimin që kooperativat e sotme të forta ekonomikisht të zonës fushore të kthehen në kooperativa të një tipi më të lartë, duke marrë pjesë në to drejtpërdrejt shteti me mjete shoqërore të pakthyeshme. Këto kooperativa do të vazhdojnë të jenë pronë kolektive e grupit, ndërsa shteti do t'i ndihmojë për të bërë investime kapitale në përpjesëtime më të mëdha nga sa u lejon fondi i tyre i pandashëm dhe do t'u sigurojë më shumë mjete teknike, kafshë të racës, farëra të zgjedhura etj. Ndonëse në këto kooperativa do të ruhen marrëdhëniet e shpërndarjes që rrjedhin nga prona e grupit dhe do të mbetet oborri kooperativist, format e drejtimit, të organizimit të punës e të shpërblimit do të jenë të përafërta ose të njëllojta me ato të ndërmarrjeve bujqësore shtetërore. Kooperativistët do të shpërblehen sipas punës me pagë të garantuar në bazë të të ardhurave të kooperativës.

Krijimi i kooperativave të tipit më të lartë ka një rëndësi të madhe teorike dhe praktike, për të tashmen dhe të ardhmen e bujqësisë sonë socialiste, të ndërtimit të plotë të socializmit në fshat. Qëllimi më i afërt i kësaj mase është që në fushat më pjellore të vendit tonë bujqësia të zhvillohet me ritme më të shpejta dhe të sigurohet në mënyrë të stabilizuar shtimi i prodhimit të atyre prodhimeve bujqësore e blegtorale, për të cilat ka nevojë më shumë ekonomia popullore. Nga ana tjetër, këto kooperativa do të përfaqësojnë një shkallë më të lartë shoqërizimi të pronës së grupit në rrugën e afrimit të saj me pronën e të gjithë popullit. Jeta, praktika revolucionare e ndërtimit tonë socialist do të tregojnë pastaj fazat e tjera, nëpër të cilat duhet kaluar në këtë proces, do të tregojnë masat që duhen marrë për të shuar dalngadalë ato dallime që ekzistojnë sot midis dy formave të pronës socialiste.

Përmirësimin e jetesës në fshat Partia e ka vlerësuar gjithnjë si një çështje parimore të dorës së parë për forcimin e aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë, për ngushtimin e dallimeve midis fshatit e qytetit, për ngritjen e mirëqenies së përgjithshme të popullit. Çdo qëndrim që nuk mban parasysh nevojat dhe interesat e fshatarësisë ajo e ka parë dhe e shikon si mbeturinë të heshtur në ndërgjegje të nënvlerësimit të fshatit, si një shfaqje të ideologjisë borgjeze.

Duke vazhduar me vendosmëri rrugën e drejtë marksiste-leniniste të lidhjeve ekonomike midis shtetit dhe kooperativave bujqësore, u hoq sistemi i grumbullimit të detyrueshëm të drithit dhe u kalua në grumbullimin e lirë me çmime të diferencuara për zonat malore dhe fushore. Është vendosur, gjithashtu, që mallrat industriale, të cilat përdoren për riprodhim në bujqësi, t'u shiten kooperativave me të njëjtin çmim që u shiten edhe ndërmarrjeve shtetërore. Për të afruar kushtet e jetesës në fshat me ato të qytetit do të përmirësohet furnizimi i fshatit me artikuj industrialë e ushqimorë. Nevojat e fshatit në fushën e arsimit, të kulturës e të shëndetësisë do të përballohen më shumë se gjer më sot me fondet shoqërore. Një fitore e madhe e rendit tonë socialist është vendosja e sistemit të pensioneve për të gjithë kooperativistët me mjetet e shtetit dhe të vetë kooperativave. Kjo masë ka një rëndësi të madhe politike, ekonomike e shoqërore për fshatarësinë tonë punonjëse. Ajo përbën një hap tjetër përpara për përmirësimin e mirëqenies së punonjësve kooperativistë, për afrimin e kushteve të jetesës së fshatit me ato të qytetit dhe do të shërbejë si një nxitje e fuqishme për përparimin e bujqësisë e të fshatit tonë socialist.

Detyrat që i shtrohen bujqësisë në planin e pestë pesëvjeçar janë të mëdha e të vështira, por reale dhe frymëzuese. Ato synojnë që fushat, arat, livadhet, malet tona të kthehen në kopshte të lulëzuara, nga të cilat të marrim prodhime të bollshme, për ta bërë jetën e popullit më të pasur e më të begatshme. Ne duhet të shfrytëzojmë me dije e nikoqirllëk çdo gjë. Syrit, mendjes së mprehtë dhe dorës së palodhur të kooperativistit tonë nuk duhet t'i shpëtojë asgjë, që nga toka e deri te prodhimi, që nga kafshët e deri te bari, që nga bletët e deri te lulet.

Komiteti Qendror i Partisë ka bindje të plotë se detyrat që na vihen përpara do të kthehen në një program luftarak pune për fshatarësinë kooperativiste dhe për gjithë punonjësit e bujqësisë. Çështja e bujqësisë, e zhvillimit dhe e modernizimit të shpejtë të saj duhet të bëhet çdo ditë e më shumë çështje e të gjithë popullit, e të gjithë ekonomisë sonë kombëtare.

Të rritim efektivitetin e investimeve dhe të ndërtimeve kapitale

Vënia në jetë e programit madhështor për zhvillimin ekonomiko-shoqëror të vendit gjatë pesëvjeçarit të pestë kërkon që të sigurohen mjetet përkatëse financiare e materiale për investimet dhe ndërtimet kapitale. Edhe në këtë pesëvjeçar shumica dërrmuese e këtyre mjeteve do të përballohen nga burimet e brendshme, duke ndjekur si kurdoherë kursin e drejtë revolucionar të

mbështetjes në forcat e veta. Në këto rrethana një rëndësi e kuptim të veçantë merr rritja e efektivitetit ekonomik të këtyre investimeve, si edhe forcimi i regjimit të kursimit.

Në pesëvjeçarin e pestë, kundrejt pesëvjeçarit të katërt, është parashikuar që investimet kapitale të rriten 70-75 për qind. Vëllimi i investimeve në këtë pesëvjeçar do të jetë më i madh se investimet e kryera gjatë 21 vjetëve 1946-1966. Vetëm investimet për zhvillimin e industrisë janë afro 2,5 herë më të mëdha se në pesëvjeçarin e katërt dhe përfaqësojnë afër 66 për qind të investimeve të përgjithshme që do të përdoren për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës.

Këto janë investime të pashembullta për ekonominë tonë dhe dëshmojnë për fuqinë gjithnjë në rritje të saj. Përballimi i tyre nga ekonomia jonë është një sukses i madh. Në të njëjtën kohë ne jemi të vetëdijshëm se ato përbëjnë një barrë jo të vogël për nivelin e sotëm të të ardhurave kombëtare dhe kërkojnë një shtim të ndjeshëm të fondit të akumulimit, duke e rritur normën e tij 34-37 për qind. Mbajtja e normës së akumulimit në një nivel të tillë të lartë diktohet nga një varg faktorësh ekonomikë e politikë, të brendshëm dhe të jashtëm, të cilët bëjnë të domosdoshëm realizimin brenda këtij pesëvjeçari të atij programi madhështor që është menduar për zhvillimin e ekonomisë dhe sidomos të industrisë, për të krijuar një ekonomi të fortë e të qëndrueshme, të aftë për vetëveprim, pavarësisht nga të papriturat që mund të ndodhin.

Me qëllim që me investimet e parashikuara të plotësohen sa më shumë nevojat e ekonomisë, na shtrohet detyra që për çdo vepër, fabrikë, repart, linjë të re ose rikonstruksion ato të planifikohen e të shpenzohen me shumë kursim, të luftohet çdo kërkesë mbi planin dhe të zbatohet një regjim i rreptë kursimi për lëndët e para, energjinë elektrike dhe materialet e tjera. Me këtë sy të shikohen të gjitha projektet që hartohen për ndërtime kapitale. Një kujdes shumë më i madh se gjer më sot për të kursyer mjete financiare e materiale u duhet kushtuar sidomos investimeve nën limit. Të merren të gjitha masat organizative, teknike dhe projektuese që veprat të ndërtohen në kohë dhe të vihen në shfrytëzim me faza, pa pritur përfundimin e tyre të plotë. Çdo zvarritje ose zgjatje e afatit të përfundimit bllokon mjetet dhe krijon pasoja të tjera të padëshirueshme.

Punonjësit e ndërtimit kanë në këtë pesëvjeçar një detyrë të madhe. Për realizimin e saj ata duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të futur në ndërtim më gjerësisht metodat industriale dhe për të shtuar mekanizimin e punimeve, nga më të thjeshtat e gjer te më të komplikuarat, sidomos të punimeve voluminoze, për të kursyer sa më shumë fuqinë punëtore. Organizimi i punës dhe disiplina teknike të ngrihen në një shkallë të

tillë që kantieret dhe sheshet e ndërtimit të kthehen në sheshe montimi për të vënë në jetë parullën luftarake të Partisë «të ndërtojmë më shpejt, më mirë dhe më lirë».

Përvoja ka treguar se efektiviteti i ndërtimeve kapitale nuk mund të rritet pa përmirësuar punën e projektimit. Me gjithë përmirësimet e bëra, duhen marrë masa që projektet të thjeshtohen, duke luftuar çdo prirje për ndërtime të rënda dhe duke përhapur struktura sa më të lehta ndërtimi. Një kujdes më i madh duhet t'u kushtohet edhe problemeve të arkitekturës, me qëllim që ajo të bëhet më tërheqëse dhe më e larmishme, që qytetet dhe fshatrat tona të ndërtohen më të bukura dhe sa më të përshtatshme për një jetesë të kulturuar të punonjësve.

Që të realizohet me sukses programi i madh i ndërtimeve kapitale një rol të veçantë duhet të luajë industria e materialeve të ndërtimit, zhvillimi dhe modernizimi i së cilës janë bazë e domosdoshme për të përballuar të gjithë frontin e ndërtimeve në qytet dhe në fshat. Ka ardhur koha që kjo degë e industrisë të zgjerojë shumë prodhimin e parafabrikateve në përgjithësi dhe atyre më të lehta në veçanti, të fillojë prodhimin e atyre materialeve që mund të zëvendësojnë ato deficitare.

Për të përballuar vëllimin e madh të lëvizjes së produktit shoqëror dhe të ndërtimeve kapitale të pesëvjeçarit të pestë një zhvillim të mëtejshëm do të marrin llojet e ndryshme të transportit. Në mënyrë të veçantë do të intensifikohet transporti hekurudhor, i cili për kushtet tona paraqet leverdinë më të madhe ekonomike. Për këtë qëllim do të zgjerohet rrjeti hekurudhor dhe do të lidhen me linja hekurudhore objektet industriale më të rëndësishme. Si përfundim, transporti hekurudhor do të shtohet rreth 3 herë më shumë dhe do të përfaqësojë rreth 41 për qind të vëllimit të përgjithshëm të transportit të planifikuar për sistemin e Ministrisë së Komunikacionit. Në përputhje me kushtet territoriale të vendit do të zgjerohen më tej edhe transporti automobilistik e detar.

Të rritet pa ndërprerje e me ritme më të larta rendimenti i punës

Me përpjesëtimet e sotme që ka marrë prodhimi shoqëror te ne, ruajtja e ritmeve të larta të zhvillimit të tij nuk mund të mendohet pa rritur në të njëjtën kohë edhe rendimentin e punës. Prandaj për zhvillimin e ekonomisë, si deri më sot, do të ndiqet kursi që harmonizon shtimin e numrit të punëtorëve të rinj me rritjen e rendimentit të punës shoqërore. Kjo mbetet një çështje parimore për riprodhimin e zgjeruar socialist. Në analizë të fundit kjo ka të bëjë me zgjidhjen e drejtë të problemeve të tilla

ekonomiko-shoqërore, siç janë rritja e pagës nominale të punonjësve, ulja e kostos dhe shtimi i akumulimit, mënjanimi i tërheqjes me shumicë të fuqisë punëtore nga fshati në qytet etj. Për këtë arsye rritja e pandërprerë e rendimentit të punës duhet të bëhet gjithnjë më shumë rruga kryesore, nëpër të cilën të ecë zhvillimi i industrisë dhe i gjithë ekonomisë. Mendja e punëtorëve dhe e kooperativistëve, e specialistëve dhe e kuadrove të punojë kurdoherë e pa pushim për të rritur rendimentin, për të kursyer dhe lehtësuar sa më shumë punën e njeriut.

Sukseset e arritura gjer më sot për rritjen e rendimentit të punës në ekonominë tonë s'janë të pakta. Por gjatë pesëvjeçarit të katërt pati edhe boshllëqe, detyra e caktuar në plan për rritjen e rendimentit nuk u plotësua. Si pasojë e ritmeve të ngadalta të rritjes së rendimentit të punës, shtimi i prodhimit industrial gjatë pesëvjeçarit të katërt u arrit pothuajse tërësisht nga shtimi i numrit të punëtorëve edhe mbi kufirin e parashikuar. Kjo shkaktoi shpërpjesëtime midis rritjes së prodhimit dhe të fondit të pagave. Natyrisht ky duhet parë si një fenomen i përkohshëm në ekonominë tonë, por që duhet kapërcyer medoemos dhe sa më parë.

Mundësitë dhe rezervat për rritjen me ritme më të shpejta të rendimentit në ekonominë tonë janë të mëdha, të shumanshme e të pashtershme. Duke u nisur nga gjendja reale e tyre, shtrohet detyra që në pesëvjeçarin e pestë nga rritja e rendimentit të punës të sigurohen rreth 70 për qind të shtesës së prodhimit shoqëror, 56 për qind të shtesës së prodhimit industrial, 90 për qind të shtesës së vëllimit të ndërtimeve dhe rreth 80 për qind e rritjes së prodhimit bujqësor do të sigurohet nga rritja e rendimenteve të prodhimeve bujqësore e blegtorale. Kjo është një nga detyrat më të rëndësishme të planit, e cila duhet të vlerësohet shumë seriozisht nga organet e Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë, nga klasa punëtore, fshatarësia kooperativiste dhe nga të gjithë kuadrot e specialistët.

Për të plotësuar detyrën lidhur me rritjen e pandërprerë e me ritme më të larta të rendimentit të punës, përpjekjet kryesore duhet të përqendrohen në thellimin e revolucionit teknikо-shkencor. Përparimi teknik tashmë është vënë te ne në rendin e ditës dhe është shndërruar në një lëvizje të gjerë të masave punonjëse, në qytet dhe në fshat. Detyra jonë është që këtë lëvizje ta zgjerojmë e ta çojmë vazhdimisht përpara, duke luftuar me vendosmëri konceptet konservatore, praktikat burokratike dhe çdo gjë tjetër që pengon përparimin e saj. Fjala është që përparimi tekniko-shkencor të përfshijë të gjithë ata faktorë materialë, nga të cilët varet rritja e rendimentit të punës shoqërore dhe në radhë të parë mjetet e punës, makineritë, pajisjet dhe instrumentet, me qëllim që të kalohet kudo e sa më parë në

një mekanizim më të lartë e kompleks të punës dhe në një teknologji e organizim më të përsosur të prodhimit.

Që nga Plenumi i 3-të i KQ të Partisë[1] dhe në luftën për të vënë në jetë vendimet e tij janë arritur rezultate të mira për mekanizimin e proceseve të punës. Megjithatë për zgjidhjen e këtij problemi është ecur shumë ngadalë dhe jemi akoma larg atyre objektivave që caktoi edhe Plenumi i 9-të i KQ të Partisë[2]. Prandaj është e domosdoshme që organet e Partisë, të pushtetit dhe të ekonomisë ta marrin mirë në dorë këtë punë dhe në çdo ministri, ndërmarrje, uzinë, fabrikë, minierë, kooperativë dhe fermë bujqësore të hartohen plane të veçanta për mekanizim, sepse puna e thjeshtë e krahut zë akoma një vend të madh në të gjithë sektorët e ekonomisë.

Sjellja nga jashtë e makinave dhe e mekanizmave me rendiment të lartë do të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm për mekanizimin, por kjo do të bëhet kurdoherë brenda mundësive të ekonomisë. Çështja shtrohet që mekanizimi në front të gjerë të bëhet me rezervat dhe mundësitë e mëdha të brendshme, me fondet që disponohen dhe me njerëzit tanë të mrekullueshëm, duke filluar nga mekanizmat e vegjël e të thjeshtë masivë dhe gjer te modernizimi i fabrikave e i reparteve të tëra, siç po veprohet në mjaft raste.

Një rezervë e brendshme e madhe për rritjen e rendimentit të punës ekziston edhe në përsosjen e vazhdueshme të proceseve teknologjike. Për të përmirësuar ose ndryshuar në mënyrë rrënjësore teknologjinë ekzistuese një barrë e madhe u bie byrove teknike, teknologjike, të konstruksionit dhe laboratorëve, të cilat duhet të bëjnë një punë të programuar e me perspektivë. Në këtë drejtim është e nevojshme të zgjerohet më shumë ndihma dhe pjesëmarrja e gjithanshme edhe e institucioneve kërkimore-shkencore, projektuese e mësimore.

Por që çdo ndryshim në faktorët materialë të rendimentit të japë një efekt sa më të madh, është e domosdoshme që ai të shoqërohet edhe me rritjen e rolit të njeriut punonjës si faktori vendimtar i prodhimit. Mundësitë e rezervat tona më imediate për rritjen e rendimentit të punës duhen kërkuar e gjetur në përmirësimin e shfrytëzimit të kohës së punës, në vendosjen e një disipline të shëndoshë proletare në punë, duke rritur e forcuar si kontrollin shtetëror ashtu edhe kontrollin e drejtpërdrejtë të klasës punëtore.

Për ta vënë në rrugë të mbarë këtë problem organet e Partisë, të pushtetit dhe të ekonomisë të marrin të gjitha masat konkrete organizative që nevojiten për të forcuar organizimin e madh

1 Shih: «Dokumente kryesore të PPSH», vëll. V, f. 349.

2 Po aty, f. 647.

e të vogël socialist të punës. Një shembull të madh organizimi të përsosur pune dhe disipline të ndërgjegjshme revolucionare na dhanë aksionet me goditje të përqendruar. Përvojën e tyre të mirë ta shtrijmë në çdo ndërmarrje e kooperativë, në repart e brigadë, në çdo vend pune.

Zhvillimi i vrullshëm i ekonomisë, futja me shpejtësi e teknikës dhe e teknologjisë së përparuar, zbatimi i metodave të reja dhe më efektive në punë e në prodhim, shtrojnë gjithnjë e më shumë kërkesa të reja ndaj normimit dhe shpërblimit të punës. Duke i ballafaquar këto kërkesa me gjendjen e sotme në këtë fushë shtrohen disa çështje të ngutshme për t'i zgjidhur. Në radhë të parë, shtrohet çështja që normat e punës të shtrihen kudo dhe të pakësohet në minimum numri i punonjësve që punojnë pa norma. Të merren, gjithashtu, të gjitha masat e nevojshme për t'i dhënë rrugë dhe për të zgjidhur sa më parë normimin teknik të punës mbi baza shkencore. Për sa i përket shpërblimit të punës, është e nevojshme të përsosen më tej format e tij, duke mbajtur parasysh kurdoherë parimin socialist «sipas punës», diferencimin sipas kualifikimit dhe nxitjen për të rritur rendimentin e prodhimit pa dëmtuar cilësinë.

Detyrat e mëdha që shtrohen për rritjen me ritme më të shpejta të rendimentit të punës nuk mund të zgjidhen me sukses pa ngritur kualifikimin, nivelin tekniko-profesional të klasës punëtore, të fshatarësisë dhe të të gjitha masave punonjëse. Këtë e kërkon, nga ana tjetër, edhe vetë rritja e nivelit të bazës materialo-teknike të prodhimit, vënia në shfrytëzim e makinave dhe e uzinave moderne, të cilat pa fuqi punëtore të kualifikuar nuk mund të japin rezultatet e dëshiruara në sasi dhe cilësi.

Të ngrihet në mënyrë të vazhdueshme mirëqenia e popullit

I gjithë zhvillimi ynë ekonomik, politik dhe shoqëror ka pasur kurdoherë si pikësynim që t'u shërbejë interesave të popullit, t'i sigurojë atij një jetë të lumtur e të begatshme, të lirë, demokratike e të pavarur. Prandaj edhe gjatë pesëvjeçarit të pestë do të bëhen të gjitha përpjekjet që kërkesat gjithnjë më të mëdha materiale e kulturore të popullit të plotësohen sa më shumë e sa më mirë.

Partia do të ndjekë edhe në të ardhmen politikën e saj të drejtë për ngritjen e mirëqenies: të arrihet një mirëqenie e përgjithshme për tërë popullin; të plotësohen nevojat më të ngutshme e më masive ekonomike, kulturore e shoqërore të punonjësve; të ngushtohen me vazhdimësi dallimet në nivelin e të ardhurave e të jetesës midis qytetit dhe fshatit, midis grupeve të ndryshme të popullsisë.

Zbatimi në jetë i kësaj politike gjatë pesëvjeçarit të pestë mishërohet në shtimin e të ardhurave kombëtare dhe përdorimin përfundimtar të tyre. Në vitin 1975, në krahasim me vitin 1970, të ardhurat kombëtare do të shtohen 55-60 për qind, fondi i konsumit 50-55 për qind, të ardhurat reale për frymë të popullsisë do të rriten 14-17 për qind, ndërsa vëllimi i qarkullimit të mallrave të tregtisë me pakicë do të shtohet 36-39 për qind.

Fondi i konsumit shoqëror është parashikuar në një nivel të tillë, i cili lejon të përballohen nevojat e punonjësve për arsim, kulturë, shëndetësi, sigurime shoqërore dhe disa kërkesa të tjera sociale të tyre. Në vitin 1975, shpenzimet e shtetit për këto nevoja për frymë të popullsisë do të rriten rreth 60 për qind kundrejt vitit 1970, dhe do të përfaqësojnë 22-27 për qind të fondit të përgjithshëm të konsumit. Këto janë shpenzime shumë të mëdha, që shprehin jo vetëm fuqinë tonë ekonomike gjithnjë në rritje, por edhe epërsinë e rendit tonë shoqëror socialist mbi atë kapitalist e revizionist. Vetëm rendi socialist i çliron plotësisht punonjësit nga ai shqetësim i vazhdueshëm dhe nga ato vështirësi që ata hasin për plotësimin e nevojave të arsimit, të kulturës e të shëndetësisë në vendet kapitaliste.

Në luftën për të plotësuar sa më mirë detyrat në fushën e ngritjes së mirëqenies një rol i madh i takon tregtisë sonë socialiste. E gjithë veprimtaria e tregtisë duhet t'i nënshtrohet drejtpërdrejt furnizimit të rregullt e pa ndërprerje të popullit me mallrat që atij i nevojiten dhe që i kërkon më shumë, shpërndarjes dhe çuarjes në kohën e duhur te konsumatori të çdo gjëje që prodhon industria e bujqësia dhe që plotëson nevojat e popullit, shërbimit të punonjësve në mënyrë sa më të kulturuar. Tregtia ka si mision ekonomiko-shoqëror të luajë një rol më të madh dhe të ushtrojë një ndikim më aktiv se gjer më sot për të nxitur prodhimin e mallrave me cilësi të mirë, për të zgjeruar asortimentet e tyre dhe për të parandaluar prodhimin e atyre mallrave që janë me cilësi të dobët ose që nuk tërhiqen nga populli. Prandaj organet e tregtisë dhe gjithë punonjësit e saj duhet të studiojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe të njohin me hollësi kërkesat e konsumatorëve, ndryshimet që këto pësojnë në kohë, sipas grupeve të punonjësve dhe krahinave.

Ka një rëndësi të madhe parimore e praktike që të krijohet një kuptim i drejtë e i gjithanshëm për jetesën e punonjësve, për lehtësimin e saj, për shërbimet që duhet t'u kryhen punonjësve në mënyrë kolektive dhe individuale. Në këtë kuadër duhet të bëhen përpjekje më shumë se gjer më sot për të zgjeruar dhe përmirësuar ushqimin social e shërbimet komunale, si në qytet ashtu edhe në fshat, për të krijuar kushte më të mira për kalimin e kulturuar të kohës së lirë etj. Mbi të gjitha, të merren masa për të ngritur më lart kulturën e shërbimeve, për të përmirësuar cilësinë dhe për të shkurtuar sa më shumë kohën e kryerjes së tyre.

Përpjekje të veçanta duhet të bëhen për të përmirësuar furnizimin e fshatrave me ujë të pijshëm dhe lidhjen e tyre me rrugë automobilistike. Për këto dy probleme të ngrihet në këmbë e gjithë fshatarësia jonë kooperativiste, shteti të ndihmojë shumë më tepër se gjer më sot me mjete financiare e materiale, me kuadro specialistësh e teknikësh, ndërsa qyteti të japë tërë ndihmën e tij të mundshme. Përvoja e madhe revolucionare, që u grumbullua gjatë aksionit popullor për elektrifikimin e gjithë fshatrave të përdoret e të pasurohet më tej edhe për zgjidhjen e problemeve të lartpërmendura.

Kthesa që ka filluar në ndërtimin e shtëpive të banimit do të bëhet edhe më e dukshme në këtë pesëvjeçar. Me investimet shoqërore dhe me kontributin e drejtpërdrejtë e vullnetar të punonjësve gjatë pesëvjeçarit të pestë vetëm në qytete e qendra pune do të ndërtohen rreth 40 mijë apartamente të reja, nga rreth 29 mijë që u ndërtuan në pesëvjeçarin e katërt. Kjo sasi do të ndihmojë shumë për të normalizuar në përgjithësi problemin e strehimit për punonjësit e qytetit. Kjo është një ndërmarrje e guximshme që dëshmon për epërsinë e rendit socialist mbi atë kapitalist, për kujdesin e Partisë sonë për të zgjidhur këtë problem të mprehtë për jetesën e punonjësve.

Jeta e lumtur, gëzimi i njeriut tonë nuk mund të kuptohen dhe të arrihen pa ruajtjen e shëndetit të tij. Prandaj kujdesi për shëndetin e popullit, për zgjatjen e jetës së tij ka qenë dhe mbetet pjesë e pandarë e politikës së Partisë për ngritjen e mirëqenies. Objekt i një vëmendjeje të veçantë për tërë shoqërinë tonë, për Partinë dhe për shtetin do të jetë kujdesi i gjithanshëm për të mbrojtur shëndetin e nënës dhe të fëmijës, duke përmirësuar rrënjësisht, sidomos në fshat, trajtimin ushqimor dhe shëndetësor të tyre.

Të përmirësojmë më tej drejtimin e ekonomisë

Stadi i arritur në ndërtimin socialist dhe detyrat e reja që kemi përpara kërkojnë që të përmirësohet më tej organizimi dhe drejtimi i ekonomisë, duke e vënë në baza më të shëndosha shkencore. Ndonëse ky problem nuk është as i ri, as edhe i panjohur, ai përbën sot një ndër hallkat themelore nga duhet të kapemi për t'i dhënë një shtytje të re të fuqishme gjithë zhvillimit të ekonomisë.

Përpjekjet tona për të përmirësuar drejtimin e ekonomisë nisen nga parimet e shëndosha marksiste-leniniste, ato janë krejt në kundërshtim me konceptet dhe praktikat revizioniste. Përvoja

e derisotme tregon se i ashtuquajturi vetadministrim punëtor apo reformat ekonomike të revizionistëve hrushovianë çojnë në degjenerimin kapitalist të ekonomisë socialiste, në rivendosjen e kapitalizmit. Pasojat negative të koncepteve revizioniste mbi organizimin dhe drejtimin e ekonomisë sot i njeh mirë e gjithë bota. Ato janë një demaskim i pakontestueshëm publik për teorinë dhe praktikën revizioniste të zhvillimit ekonomiko-shoqëror.

Shumë çështje që kanë të bëjnë me përmirësimin e drejtimit të ekonomisë u shtruan drejt në Plenumin e 10-të të Komitetit Qendror[1] dhe tani mjaft prej tyre po vihen me sukses në jetë. Për të mënjanuar shfaqjet e theksuara të një centralizmi të tepruar e të tutelës burokratike u zgjeruan kompetencat e bazës. Komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë dhe ndërmarrjeve ekonomike u janë dhënë më shumë kompetenca financiare dhe materiale, si për hartimin, ashtu edhe për zbatimin e planit. Drejtimi i ekonomisë është bërë më i zhdërvjellët dhe më vetëveprues, është rritur përgjegjësia e bazës, e ndërmarrjes. Megjithatë, për forcimin e mëtejshëm të tij është e domosdoshme që jo vetëm të zbatohen në frymë krijuese masat e marra, por edhe të gjenden rrugë e forma të reja, më të mira, më efikase.

Cilat janë problemet kryesore që duhet të tërheqin më shumë vëmendjen tonë për një drejtim më të mirë të ekonomisë në stadin e ri të zhvillimit të saj? Të tilla janë: ngritja e nivelit të punës drejtuese të organeve ekonomike, duke e vënë mbi baza më të shëndosha shkencore; përsosja e metodave të drejtimit të prodhimit në bazë të njohjes më të thellë të ligjeve ekonomike; zgjerimi i mëtejshëm i pjesëmarrjes së masave punonjëse në administrimin e ekonomisë.

Përmirësimi i mëtejshëm i drejtimit të ekonomisë kërkon, në radhë të parë, të forcohet në nivelin e detyrave të reja roli organizues i shtetit. Detyrat e organeve shtetërore të drejtimit të ekonomisë sot janë shtuar, janë bërë më të ndërlikuara e më komplekse. Çdo reduktim i tyre, siç ndodh nganjëherë, në drejtimin vetëm të çështjeve operative është i njëanshëm dhe me pasoja të dëmshme.

Organet e shtetit dhe kuadrot e tyre nuk mund ta drejtojnë ekonominë me efikasitet pa u marrë më shumë dhe më mirë me zbërthimin e politikës ekonomike të Partisë, të direktivave e të orientimeve të saj, pa kërkuar e gjetur rrugët më të drejta dhe më të efektshme për t'i vënë ato në jetë. Është e domosdoshme që në punën e tyre ato të kujdesen më shumë se gjer më sot për studimin e problemeve themelore, të ngutshme e të perspektivës, që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomiko-shoqëror të vendit.

1 Shih: «Dokumente kryesore të PPSH», vëll. V, f. 663.

Përmirësimi i drejtimit të ekonomisë ka shtruar si një çështje të mprehtë aktuale forcimin e karakterit shkencor të planifikimit. Zgjidhja e mjaft detyrave ekonomiko-shoqërore në etapën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste kërkon më shumë se një plan pesëvjeçar. Prandaj, krahas planifikimit pesëvjeçar, të kalohet edhe në hartimin e planeve prognozë me afat më të gjatë. Pikësynimi kryesor i këtyre planeve lipset të jetë parashikimi i drejtimeve kryesore të zhvillimit të ekonomisë në tërësi, i degëve të veçanta të saj, i llojeve më të rëndësishme të prodhimeve industriale e bujqësore, i drejtimeve të zhvillimit të arsimit, të kulturës, të shkencës etj.

Që planet e zhvillimit të ekonomisë, qofshin këto pesëvjeçare ose me afat më të gjatë, të jenë sa më reale, duhet që nevojat shoqërore të llogariten sa më mirë, duke u mbështetur në vrojtime, studime, analiza dhe përgjithësime sistematike, të hollësishme e të gjithanshme, në variante të ndryshme dhe në përllogaritje teknike, ekonomike dhe financiare. E gjithë kjo të ketë si qëllim që t'u japë mundësi organeve të Partisë dhe të shtetit të zgjedhin variantin më optimal.

Forcimi i karakterit shkencor të planifikimit dikton nevojën që të përdoren më gjerësisht se deri më sot metodat e njohura analitike të krahasimit, normimit dhe balancimit. Krahas këtyre të bëhen përpjekje që në praktikën e planifikimit dhe të përllogaritjeve ekonomike të futet edhe përdorimi i metodave të reja që mbështeten në matematikën, programimin dhe teknikën moderne llogaritëse.

Niveli i sotëm i zhvillimit të ndërmarrjeve ekonomike shtron detyrën që metodat e drejtimit administrativ të prodhimit të kombinohen më mirë edhe me metodat e drejtimit ekonomik. Kjo kërkon medoemos që të njihen dhe të zbatohen në mënyrë të vetëdijshme ligjet ekonomike objektive të socializmit. Rritja e përpjesëtimeve të prodhimit në çdo degë të ekonomisë, nevojat për t'i kthyer më shumë sytë nga cilësia, për të zbatuar teknikën e re e teknologjinë moderne, po nxjerrin kohë pas kohe në shesh të meta e boshllëqe në drejtimin e prodhimit. Për të kapërcyer këto të meta rëndësi ka që të rritet iniciativa dhe vetëveprimi i bazës, të forcohet hozrashoti, përdorimi i levave ekonomike dhe disiplina e planit e financiare. Llogaritja e shpenzimeve dhe e leverdisë, krahasimi i punës së harxhuar me rezultatet e arritura të bëhen kriter i domosdoshëm për të vlerësuar caktimin e detyrave me plan dhe realizimin e tyre. Nevoja për të kombinuar më shumë drejtimin administrativ të prodhimit me metodat ekonomike, ka shtruar problemin që të përputhet më mirë me këtë kombinim edhe vetë struktura e organizimit dhe e drejtimit të ndërmarrjes.

Përmirësimi i drejtimit të ekonomisë sonë nuk mund as të kuptohet, as edhe të arrihet pa pjesëmarrjen e masave, të klasës punëtore, të kooperativistëve dhe të gjithë punonjësve, pa kontrollin e tyre mbi veprimtarinë e organeve ekonomike. Kjo nuk është një çështje dëshire, por rrjedhim logjik i asaj vije të masave që zbatohet me besnikëri te ne, është garanci që të shtohet prodhimi dhe baza shoqërore e socializmit të mos ndryshojë kurrë natyrën. Në të ardhmen duhet të nxitet më shumë, t'i lihet fushë më e lirë pjesëmarrjes, kontrollit, iniciativës e mendimit krijues të masave për të hartuar e zbatuar planet ekonomike, për të caktuar e vendosur treguesit tekniko-ekonomikë të planit, rendimentin, normat e punës e të harxhimit të materialeve, për të forcuar disiplinën dhe rregullin në punë, për të rritur prodhimin e përmirësuar cilësinë që nga gjërat më të vogla dhe deri te më të mëdhatë.

Rritja e pjesëmarrjes dhe e kontrollit të masave, sidomos të klasës punëtore, duhet të shkojnë kurdoherë paralel me shtimin e përgjegjësisë morale e financiare të secilit për fatet e prodhimit, të ndërmarrjes dhe të kooperativës, me zbatimin e përpiktë dhe në kohë të vendimeve e direktivave të organeve shtetërore, të disiplinës dhe të rregullit në punë.

Shokë,

Detyrat e planit të pestë pesëvjeçar janë një hap tjetër i madh e i rëndësishëm në rrugën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Ato janë të guximshme, por të menduara thellë, të peshuara mirë e drejt. Ne jemi optimistë dhe të sigurt se ato do të realizohen me sukses.

Kur shikon realizimet e tejkalimet e shifrave të planit të katërt pesëvjeçar, që edhe ato ishin shumë të ngjeshura e të guximshme, nuk mund të mos mahnitesh me forcën kolosale që kanë Partia dhe populli ynë.

Ne po i hyjmë realizimit të planit të ri pesëvjeçar me një entuziazëm të madh, i cili e ka bazën e tij në sigurinë që na japin rezultatet madhështore të së kaluarës dhe në frymëzimin që na ngjall perspektiva jonë e ndritur.

Heroizmi, pjekuria dhe dituria e njerëzve tanë, të pleksura me optimizmin dhe entuziazmin realist të tyre, do t'i shndërrojnë edhe shifrat e këtij pesëvjeçari në të mira materiale për popullin, atdheun e socializmin, do të bëjnë çudira të reja e më të mëdha që do ta ngrenë edhe më lart emrin e Partisë sonë heroike dhe lavdinë e Shqipërisë socialiste.

III

FORCIMI I DIKTATURËS SË PROLETARIATIT DHE ZHVILLIMI I MËTEJSHËM I DEMOKRACISË SOCIALISTE

Shokë dhe shoqe,

Problem kyç i revolucionit ka qenë dhe do të mbetet gjer në arritjen e fitores së komunizmit problemi i pushtetit shtetëror, i diktaturës së proletariatit. Në çfarëdo fushe që të zhvillohet lufta klasore midis dy rrugëve, socialiste e kapitaliste, në fushën politike ose ekonomike, ideologjike, kulturore ose ushtarake, ajo është, në fund të fundit, luftë për çështjen nëse do të ruhet e do të forcohet diktatura e proletariatit, apo kjo do të degjenerojë e do të përmbyset, siç ndodhi në Bashkimin Sovjetik e në disa vende të tjera. Këtë mësim jetik të marksizëm-leninizmit, të vërtetuar plotësisht nga jeta, Partia jonë e ka kurdoherë parasysh.

Vitet që kanë kaluar nga Kongresi i 5-të i Partisë janë vite të një lufte të gjithanshme të Partisë, të klasës punëtore e të mbarë popullit për zhvillimin e mëtejshëm të revolucionit socialist edhe në fushën politike. Kjo ka qenë luftë për ruajtjen, forcimin dhe përsosjen e diktaturës së proletariatit, për spastrimin e saj nga gjurmët e ndikimet e shoqërisë së vjetër, për shmangien e rrezikut të degjenerimit revizionist-borgjez të saj, për rritjen e rolit aktiv të shtetit në të gjitha sferat e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste.

Tehu i gjithë kësaj lufte është drejtuar kundër burokratizmit, për zhvillimin e mëtejshëm të demokracisë socialiste. Rezultatet e saj shihen e ndihen në të gjitha fushat e jetës së vendit. Janë forcuar e zgjeruar më tej lidhjet e pushtetit me masat. Aparati shtetëror është çliruar nga mjaft barrë burokratike dhe është bërë më i zhdërvjellët e më operativ, i është afruar më tepër bazës dhe problemeve të saj. Si kurrë ndonjëherë është rritur iniciativa e vetëveprimi i masave, interesimi dhe pjesëmarrja aktive e tyre në çështjet shtetërore. Kontrolli i punonjësve, në radhë të parë i klasës punëtore, mbi aparatet e drejtuesit, mbi tërë jetën e vendit, është bërë një mjet i fuqishëm dhe efektiv për përmirësimin e punëve në të gjitha drejtimet. Në një raport më të drejtë janë vendosur marrëdhëniet midis kuadrove dhe masave, gjë që ka forcuar më tej besimin reciprok dhe bashkëpunimin e ngushtë

Përmirësimi i drejtimit të ekonomisë sonë nuk mund as të kuptohet, as edhe të arrihet pa pjesëmarrjen e masave, të klasës punëtore, të kooperativistëve dhe të gjithë punonjësve, pa kontrollin e tyre mbi veprimtarinë e organeve ekonomike. Kjo nuk është një çështje dëshire, por rrjedhim logjik i asaj vije të masave që zbatohet me besnikëri te ne, është garanci që të shtohet prodhimi dhe baza shoqërore e socializmit të mos ndryshojë kurrë natyrën. Në të ardhmen duhet të nxitet më shumë, t'i lihet fushë më e lirë pjesëmarrjes, kontrollit, iniciativës e mendimit krijues të masave për të hartuar e zbatuar planet ekonomike, për të caktuar e vendosur treguesit tekniko-ekonomikë të planit, rendimentin, normat e punës e të harxhimit të materialeve, për të forcuar disiplinën dhe rregullin në punë, për të rritur prodhimin e përmirësuar cilësinë që nga gjërat më të vogla dhe deri te më të mëdhatë.

Rritja e pjesëmarrjes dhe e kontrollit të masave, sidomos të klasës punëtore, duhet të shkojnë kurdoherë paralel me shtimin e përgjegjësisë morale e financiare të secilit për fatet e prodhimit, të ndërmarrjes dhe të kooperativës, me zbatimin e përpiktë dhe në kohë të vendimeve e direktivave të organeve shtetërore, të disiplinës dhe të rregullit në punë.

Shokë,

Detyrat e planit të pestë pesëvjeçar janë një hap tjetër i madh e i rëndësishëm në rrugën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Ato janë të guximshme, por të menduara thellë, të peshuara mirë e drejt. Ne jemi optimistë dhe të sigurt se ato do të realizohen me sukses.

Kur shikon realizimet e tejkalimet e shifrave të planit të katërt pesëvjeçar, që edhe ato ishin shumë të ngjeshura e të guximshme, nuk mund të mos mahnitesh me forcën kolosale që kanë Partia dhe populli ynë.

Ne po i hyjmë realizimit të planit të ri pesëvjeçar me një entuziazëm të madh, i cili e ka bazën e tij në sigurinë që na japin rezultatet madhështore të së kaluarës dhe në frymëzimin që na ngjall perspektiva jonë e ndritur.

Heroizmi, pjekuria dhe diturija e njerëzve tanë, të pleksura me optimizmin dhe entuziazmin realist të tyre, do t'i shndërrojnë edhe shifrat e këtij pesëvjeçari në të mira materiale për popullin, atdheun e socializmin, do të bëjnë çudira të reja e më të mëdha që do ta ngrenë edhe më lart emrin e Partisë sonë heroike dhe lavdinë e Shqipërisë socialiste.

III

FORCIMI I DIKTATURËS SË PROLETARIATIT DHE ZHVILLIMI I MËTEJSHËM I DEMOKRACISË SOCIALISTE

Shokë dhe shoqe,

Problem kyç i revolucionit ka qenë dhe do të mbetet gjer në arritjen e fitores së komunizmit problemi i pushtetit shtetëror, i diktaturës së proletariatit. Në çfarëdo fushe që të zhvillohet lufta klasore midis dy rrugëve, socialiste e kapitaliste, në fushën politike ose ekonomike, ideologjike, kulturore ose ushtarake, ajo është, në fund të fundit, luftë për çështjen nëse do të ruhet e do të forcohet diktatura e proletariatit, apo kjo do të degjenerojë e do të përmbyset, siç ndodhi në Bashkimin Sovjetik e në disa vende të tjera. Këtë mësim jetik të marksizëm-leninizmit, të vërtetuar plotësisht nga jeta, Partia jonë e ka kurdoherë parasysh.

Vitet që kanë kaluar nga Kongresi i 5-të i Partisë janë vite të një lufte të gjithanshme të Partisë, të klasës punëtore e të mbarë popullit për zhvillimin e mëtejshëm të revolucionit socialist edhe në fushën politike. Kjo ka qenë luftë për ruajtjen, forcimin dhe përsosjen e diktaturës së proletariatit, për spastrimin e saj nga gjurmët e ndikimet e shoqërisë së vjetër, për shmangien e rrezikut të degjenerimit revizionist-borgjez të saj, për rritjen e rolit aktiv të shtetit në të gjitha sferat e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste.

Tehu i gjithë kësaj lufte është drejtuar kundër burokratizmit, për zhvillimin e mëtejshëm të demokracisë socialiste. Rezultatet e saj shihen e ndihen në të gjitha fushat e jetës së vendit. Janë forcuar e zgjeruar më tej lidhjet e pushtetit me masat. Aparati shtetëror është çliruar nga mjaft barrë burokratike dhe është bërë më i zhdërvjellët e më operativ, i është afruar më tepër bazës dhe problemeve të saj. Si kurrë ndonjëherë është rritur iniciativa e vetëveprimi i masave, interesimi dhe pjesëmarrja aktive e tyre në çështjet shtetërore. Kontrolli i punonjësve, në radhë të parë i klasës punëtore, mbi aparatet e drejtuesit, mbi tërë jetën e vendit, është bërë një mjet i fuqishëm dhe efektiv për përmirësimin e punëve në të gjitha drejtimet. Në një raport më të drejtë janë vendosur marrëdhëniet midis kuadrove dhe masave, gjë që ka forcuar më tej besimin reciprok dhe bashkëpunimin e ngushtë

midis tyre. Në të gjitha nivelet është gjallëruar mjaft puna e organeve të zgjedhura të pushtetit, të cilat gjithnjë më mirë i ushtrojnë kompetencat dhe kontrollin e tyre mbi organet ekzekutive e administratat. Është krijuar kështu një kuptim më i drejtë për këto çështje dhe u është dhënë një goditje e fortë koncepteve e praktikave burokratike, intelektualiste e teknokratike.

Përvoja jonë dhe veçanërisht ajo e grumbulluar në këto vitet e fundit të një jete politike të gjallë e plot origjinalitet, tregoi se në kushtet e një udhëheqjeje të drejtë nga ana e Partisë, diktatura e proletariatit mund t'u qëndrojë të gjitha provave dhe të kryejë me sukses misionin e saj historik.

Por ne jemi të ndërgjegjshëm se rezultatet e arritura në zbatimin e orientimeve dhe të masave që ka marrë Partia nuk i kanë zhdukur të gjitha rreziqet një herë e përgjithmonë. Lufta kundër burokratizmit dhe të gjitha shfaqjeve të tij, si një ndër shprehjet më të rëndësishme të luftës së klasave në kushtet e socializmit, mbetet një detyrë e përhershme e partisë, e shtetit socialist dhe e gjithë punonjësve. Duhet thënë se në praktikë, në mjaft raste, nuk kuptohet me të gjithë seriozitetin kjo çështje. Këtu e ka burimin fakti që në luftën për zbatimin e orientimeve të Partisë jemi ndeshur e ndeshemi me koncepte frenuese, me konservatorizëm e rezistencë burokratike, jemi ndeshur e ndeshemi në formalizëm, gjë që tregon se nuk është kuptuar në tërë thellësinë e vet thelbi i shtrembërimeve burokratike dhe shpesh lufta kundër tyre thjeshtësohet e reduktohet në goditjen e disa shfaqjeve të pjesshme e anësore.

Prandaj organizatat e Partisë dhe organet e pushtetit duhet ta kenë në qendër të vëmendjes luftën kundër burokratizmit, të forcojnë punën edukuese dhe të jenë në kërkim të vazhdueshëm të masave dhe të rrugëve që duhen zbatuar për ta çuar këtë luftë deri në fund, duke thyer me vendosmëri pengesat e prirjet frenuese në çdo kohë e formë që të paraqiten.

Kjo luftë është me rëndësi jetike për të ardhmen e diktaturës së proletariatit, sepse burokratizmi është një e keqe e madhe dhe me rrënjë të thella. Ai, siç e tregoi edhe eksperienca negative e Bashkimit Sovjetik dhe e disa vendeve të tjera, çon në shkëputjen e pushtetit nga masat e popullit, në vënien e organeve drejtuese e të kuadrove mbi masat e jashtë kontrollit të tyre, në venitjen e demokracisë socialiste, në krijimin e centralizmit burokratik, në degjenerimin e diktaturës së proletariatit.

Bruga e përgjithshme për forcimin e diktaturës së proletariatit, të tërë rendit socialist, është zhvillimi i demokracisë së ma-

save. Pa demokraci socialiste nuk ka diktaturë të proletariatit, ashtu siç nuk mund të ketë demokraci të vërtetë për punonjësit pa diktaturë të proletariatit. Revizionistët hrushovianë, nën maskën e zgjerimit të demokracisë, likuiduan diktaturën e proletariatit dhe në vend të saj kanë vendosur diktaturën e tyre burokratike, si armë të sundimit të klasës së re borgjeze mbi masat punonjëse. E ashtuquajtura demokraci në vendet e sunduara nga revizionistët është, po ashtu si në vendet borgjeze klasike, një privilegj i pakicës shfrytëzuese dhe një mashtrim i paturpshëm për masat e popullit.

Tërheqja sa më e gjerë e masave në qeverisjen e vendit ka qenë dhe mbetet vija e patundur në tërë veprimtarinë e Partisë sonë të Punës e të shtetit tonë proletar për ndërtimin e socializmit. Këtë pjesëmarrje ne e konsiderojmë si drejtimin kryesor të thellimit të demokracisë socialiste në veprim, si kusht të domosdoshëm për të siguruar eksperiencën e masave të gjera punonjëse në ndërtimin e socializmit, për të shumëfishuar forcën e aparatit shtetëror të diktaturës së proletariatit, për t'i bërë punonjësit gjithnjë më të ndërgjegjshëm se ata vetë janë zotërit e plotfuqishëm të vendit, që duhet të thonë për çdo gjë fjalën e tyre vendimtare.

Armatosja e gjithë qytetarëve me një kuptim të tillë të rolit e të vendit të tyre në jetën politiko-shoqërore, përgatitja për ta luajtur si duhet këtë rol, ka kërkuar e kërkon, veç një pune të madhe edukuese e sqaruese nga ana e Partisë, shumë masa praktike për t'u krijuar kushtet e nevojshme punonjësve që të marrin pjesë sa më gjerë në ushtrimin e pushtetit, që marrja dhe zbatimi i vendimeve të vihet gjithnjë e më mirë nën gjykimin dhe kontrollin e drejtpërdrejtë të tyre.

Nga kjo pikëpamje zbatimi i metodës së konsultimit me masat, dëgjimi i zërit të tyre, mbështetja në to, që tashmë është bërë pjesë e pandarë e praktikës sonë, duhen zhvilluar e thelluar pa ndërprerje. Do të ishte gabim të binim në vetëkënaqësi dhe të mbeteshim në atë që është arritur. Është e domosdoshme të vazhdojmë akoma më me këmbëngulje përpjekjet tona për të thyer çdo pengesë që kufizon pjesëmarrjen efektive të masave në drejtimin e punëve të shoqërisë, që frenon iniciativën e tyre krijuese, të gjallërojmë e të pasurojmë më tej format e demokracisë, të rritim sidomos rolin e organizatave të masave si qendra të rëndësishme të organizimit të punonjësve, si tribuna të zërit dhe të vetëveprimit revolucionar të tyre.

Rëndësi të veçantë ka mbështetja e fuqishme te masat për verifikimin e drejtësisë së vendimeve në praktikën e gjallë të je-

tës. Verifikimi i vazhdueshëm, rishikimi i pandërprerë kritik e autokritik i tërë punës dhe përvojës së mëparshme në të gjitha sferat e veprimtarisë, me qëllim që të ruhet e të zhvillohet ajo që qëndron mbi një bazë të shëndoshë, të ndryshohet ajo që nuk justifikohet nga praktika ose që është kapërcyer nga jeta, të gjenden rrugë e mënyra të reja për zgjidhjen e problemeve, kjo përbën një ligj të revolucionit socialist, që, siç thoshte Karl Marksi, është i pamposhtur, sepse kritikon vazhdimisht vetveten.

Kjo metodë është e papajtueshme me prirjet burokratike e konservatore për të fetishizuar çdo gjë që del nga aparatet, me skemat dhe praktikat e ngurosura, që nuk u përgjigjen më detyrave e kushteve të reja, që nuk përputhen me idetë e mëdha revolucionarizuese të partisë dhe bëhen pengesë për vënien e tyre në jetë. Kjo çështje duhet të na tërheqë seriozisht vëmendjen, sepse, siç na mëson Lenini, në këtë fushë shfaqen me një forcë të veçantë dhe ruhen për një kohë të gjatë kontradiktat midis së resë e së vjetrës në zhvillimin e revolucionit.

> «Në të gjithë fushën e marrëdhënieve shoqërore, ekonomike dhe politike — shkruante ai — ne jemi «tmerrësisht» revolucionarë. Por në fushën e hierarkisë, të respektimit të formave e të procedurës administrative «revolucionizmi ynë» zëvendësohet pothuaj gjithnjë nga rutina më e mykur. Këtu mund të vihet re shpeshherë një fenomen shumë interesant: se si në jetën shoqërore kërcimi më i madh përpara shoqërohet me frikën më të përbindshme nga ndryshimet më të vogla»[1].

Organizatat e Partisë, kuadrot e gjithë punonjësit duhet të jenë kurdoherë revolucionarë dialektikë, ta shohin në sy realitetin në zhvillimin e tij të pandërprerë, të mos kanunizojnë asgjë, të mos kenë frikë nga ndryshimet, por me guxim të kapërcejnë çdo gjë të vjetruar në konceptet, metodat, ligjet, format e organizimit e të drejtimit.

Kontrolli i masave nga poshtë, si çështje me rëndësi parimore dhe një ndër aspektet kryesore të zhvillimit të demokracisë socialiste, ka qenë vazhdimisht në qendër të vëmendjes së Partisë. Por thellimi dhe përsosja e tij në forma sa më të përshtatshme mbetet një detyrë gjithnjë aktuale e dorës së parë.

Vendimtar këtu është kontrolli i drejtpërdrejtë i klasës punëtore. Kontrolli punëtor nga poshtë është një domosdoshmëri e një parim bazë i jetës shoqërore gjatë tërë periudhës historike të socializmit. Ky kontroll, që kryhet nën udhëheqjen e partisë, është një ndër shprehjet konkrete të rolit udhëheqës të klasës punëtore dhe të demokracisë proletare në veprim. Ai përbën një armë të mprehtë në luftën kundër burokratizmit dhe ndikimeve të huaja në jetën shoqërore e në ndërgjegjen e punonjësve, një formë shumë të efektshme të edukimit proletar të vetë klasës punëtore, është një nxitje e fuqishme për të çuar përpara ndërtimin socialist. Në kontrollin punëtor shohim një ndër garancitë themelore për të shmangur rrezikun e revizionizmit e të kthimit prapa në kapitalizëm.

Praktika jonë mbi kontrollin e drejtpërdrejtë të klasës punëtore po vërtetohet në jetë. Në periudhën pas Kongresit të 5-të të Partisë zbatimi i kontrollit punëtor ka çuar në një rritje e gjallërim të mëtejshëm të veprimtarisë revolucionare të klasës punëtore në të gjitha fushat. Është rritur në mënyrë të dukshme roli i masave punëtore në zgjidhjen e problemeve të ndryshme, është shtuar shumë interesimi dhe ndjenja e tyre e përgjegjësisë për punët e ndërmarrjes dhe përgjithësisht për jetën e vendit, është forcuar fryma kritike e autokritike ndaj shfaqjeve të huaja.

Kontrolli punëtor është një proces i gjatë lufte kundër prirjeve të ndryshme burokratike, që përpiqen ta kufizojnë, ta frenojnë e ta vënë nën tutelë, kundër frikës, dyshimeve, ekuivokeve në zbatimin e tij. Përsosja e mëtejshme e tij kërkon që ai të kuptohet nga kushdo si një e drejtë e pamohueshme e klasës punëtore për të ruajtur e forcuar diktaturën e proletariatit dhe rendin socialist. Ai është kontroll i klasës punëtore mbi tërë veprimtarinë e organeve dhe të organizatave të partisë, të atyre shtetërore dhe ekonomike, të aparateve e të kuadrove, që shtrihen mbi çdo gjë e mbi këdo, si në qytet ashtu edhe në fshat. Kontrolli punëtor nuk është një kontroll administrativ për çështje të vogla, korente e të sipërfaqshme. Ai është shprehje e opinionit dhe e qëndrimit të klasës punëtore për problemet kyç, politike, ekonomike e shoqërore.

Organizatat e Partisë, bashkimet profesionale, vetë punëtorët duhet të jenë në kërkim të vazhdueshëm për të gjallëruar format ekzistuese dhe për të gjetur forma të reja, të zhdërvjellta dhe efikase në ushtrimin e kontrollit punëtor. Kornizat dhe format e ngurosura e gjymtojnë dhe e paralizojnë atë.

Qëllimi i kontrollit punëtor është jo vetëm të vrojtojë e të konstatojë, por t'i zgjidhë e t'i çojë gjer në fund çështjet që ngre. Është detyrë e të gjithëve, e organizatave të Partisë, e organeve

1 V. I. Lenin. Vepra të zgjedhura, vëll. II, f. 925. Tiranë, 1958.

të pushtetit dhe e organizatave të masave të luftojnë me këmbëngulje që të zbatohen vërejtjet dhe propozimet që bëjnë punëtorët, të zgjidhen me shpejtësi e me seriozitetin më të madh problemet që dalin nga kontrolli punëtor. Kjo është e domosdoshme për vetë zhvillimin e mendimit, të veprimit revolucionar e të pjesëmarrjes aktive të punëtorëve në punët e shtetit, për inkurajimin e iniciativës së tyre dhe për vetë zhvillimin e mëtejshëm të kontrollit punëtor.

Për klasën punëtore ka rëndësi të veçantë që ajo të kuptojë vetë në radhë të parë jo vetëm rolin e saj si forca prodhuese vendimtare, por edhe rolin e saj politik si klasa pararojë në shoqërinë tonë. Me luftën, qëndrimet dhe shembullin e saj ajo tërheq pas vetes gjithë masën tjetër të popullsisë, fut te të gjithë frymën, disiplinën dhe kulturën proletare në punë e në jetë. Për të qëndruar në lartësinë e këtij misioni është e domosdoshme që kontrolli punëtor të zhvillohet edhe si vetëkontroll i klasës punëtore, si kritikë e autokritikë në radhët e saj, si një luftë këmbëngulëse kundër shfaqjeve të vetëkënaqësisë, indiferentizmit e të tërheqjes pas interesit të ngushtë personal, kundër çdo fryme të pajtimit me fenomenet që pengojnë ecjen tonë përpara.

Kontrolli punëtor është pjesë përbërëse dhe e pandarë e kontrollit të masave mbi veprimtarinë e organeve të pushtetit, organizatave ekonomike e kulturoro-arsimore të qytetit e të fshatit. Ushtrimi i këtij kontrolli është një e drejtë dhe detyrë për të gjithë: për fshatarin në kooperativë, për studentin në shkollë, për intelektualin në sferën e veprimtarisë së tij, për çdo qytetar në tërë jetën shoqërore.

Me qëllim që kontrollit të masave t'i hapet horizont i gjerë e t'i krijohen kushte sa më të përshtatshme, është e nevojshme që punonjësit të informohen vazhdimisht për veprimtarinë e organizmave dhe të institucioneve shtetërore e shoqërore. Kontrolli i masave bëhet i mundshëm e lehtësohet sa më shumë luftohet kundër prirjeve për forma të mbyllura të punës së aparateve e organeve shtetërore e shoqërore, sa më shumë i jepet publicitet veprimtarisë së tyre, e cila duhet të jetë sa më e hapët dhe lehtësisht e kontrollueshme nga punonjësit. Njohja gjithnjë më e mirë e masave të gjera të punonjësve me mekanizmat e jetës shoqërore socialiste, me ligjet e shtetit, ballafaqimi dhe dhënia llogari para masave, si metodë e përhershme e funksionimit të gjithë sistemit tonë të diktaturës së proletariatit, përbëjnë gjithashtu kushte të domosdoshme për ushtrimin e kontrollit të masave. Një rol më aktiv në këtë drejtim duhet të luajë edhe shtypi, i cili ka për detyrë t'u bëjë të njohura më mirë masave gjendjen

e problemet, të forcojë kritikën, të bëhet në një shkallë më të theksuar tribunë e rrahjes së gjallë të mendimeve, e pasqyrimit dhe e përgjithësimit të thellë të përvojës së masave në ndërtimin socialist.

Në luftën kundër burokratizmit dhe për forcimin e diktaturës së proletariatit rëndësi të dorës së parë kanë raportet midis kuadrove dhe masave. Eksperienca negative e vendeve revizioniste tregon se kur midis kuadrove e masave vendosen marrëdhënie jo të drejta, kur kuadrot shkëputen nga masat, nga jeta dhe lufta e tyre, kur ata nuk i nënshtrohen kontrollit të masave, kur kuadrove u jepen privilegje e favorizime të jashtëligjshme, ata burokratizohen e degjenerohen, marrëdhëniet e tyre me masat shndërrohen në marrëdhënie sundimi e nënshtrimi.

Partia dhe pushteti ynë popullor, të ndriçuar nga mësimet e marksizëm-leninizmit, sidomos në periudhën pas Kongresit të 5-të, kanë marrë një varg masash rrënjësore politike, ideologjike dhe ekonomike për përmirësimin e marrëdhënieve midis kuadrove dhe masave, me qëllim që kuadrot të mbeten kurdoherë revolucionarë konsekuentë e shërbëtorë të devotshëm të popullit. U vu në zbatim qarkullimi sistematik i kuadrove nga postet drejtuese në bazë e nga administratat në prodhim dhe anasjelltas. Tani rreth 56 për qind e kuadrove kryesorë të aparateve qendrore e lokale dhe 50 për qind e të gjithë kuadrove të aparateve e të administratave në funksionet aktuale kanë një stazh më pak se 5 vjet. U zbatua me kritere më të shëndosha pjesëmarrja e kuadrove dhe e gjithë njerëzve të punës mendore në punën fizike. Në të njëjtën kohë, u bënë rregullime në pagat e kuadrove, për të mos lejuar shpërpjesëtime në nivelin e tyre të jetesës në krahasim me masat punonjëse. Përpjekjet tona kanë synuar, gjithashtu, që përgatitja ideopolitike, arsimore-kulturore e tekniko-profesionale e kuadrove të bëhet jo e shkëputur nga ngritja e pandërprerë e nivelit të gjithanshëm të shtresave të gjera punonjëse. Këto masa, krahas punës së gjerë edukuese që zhvillon Partia, shërbejnë për të luftuar në kuadrot shfaqjet e burokratizmit e të karrierizmit, për të forcuar e thelluar lidhjet e tyre me punëtorët e fshatarët, për të luftuar e çrrënjosur ndikimet e koncepteve intelektualiste të nënvlerësimit e të mospërfilljes së masave, për t'i mbyllur shtigjet gjallërimit të ndjenjës së rrezikshme të mendjemadhësisë, subjektivizmit etj.

Për Partinë tonë ka qenë dhe mbetet një preokupacion i vazhdueshëm problemi që të gjithë kuadrot të rriten e të kaliten si revolucionarë, të mendojnë e të punojnë si të tillë deri në fund

të jetës së tyre. Socializmi nuk ka nevojë për burokratë e teknokratë që t'i besojnë vetëm «gjenisë» së tyre, teknikës, fuqisë së dekretit, por për kuadro që të shkrihen e të jetojnë me masat, të mendojnë e të ndiejnë njëlloj si klasa punëtore dhe fshatarësia kooperativiste. Në vijën e Partisë, në veprën madhështore dhe në botën shpirtërore të klasës punëtore e të kooperativistëve, kuadrot do të gjejnë kurdoherë forcë e frymëzim të vazhdueshëm.

Që ta çojmë më tej përvojën e fituar në marrëdhëniet midis kuadrove dhe masave, është e nevojshme të luftohet kundër çdo pozite subjektiviste, dikasteriale e lokaliste, si dhe kundër qëndrimeve mikroborgjeze nga vetë disa kuadro, në mënyrë që qarkullimi dhe puna drejtpërdrejt në prodhim të kuptohen si një masë me rëndësi edukuese e ideologjike dhe jo si një qëllim në vetvete, të kuptohen si një masë për revolucionarizimin e vazhdueshëm të vetë kuadrove dhe të organeve e të aparateve të ndryshme.

Partia i kushton një vëmendje të veçantë parimit që kuadrot, të çdo hallke e niveli qofshin, të jenë në vartësi të dyfishtë: si prej organeve të Partisë e të shtetit proletar nga lart, ashtu edhe nga poshtë drejtpërdrejt prej masave punonjëse. Duke iu përmbajtur këtij parimi, është e nevojshme që në të ardhmen të luftojmë çdo prirje për fetishizimin e nomenklaturave dhe punën e mbyllur, në mënyrë që zëri, mendimi dhe vlerësimi i masave për kuadrot e veprimtarinë e tyre të dëgjohet gjithnjë e më shumë.

Për thellimin e mëtejshëm të demokracisë dhe rritjen e rolit të masave në periudhën midis dy kongreseve një kujdes i veçantë i është kushtuar forcimit e përmirësimit të punës së organeve të zgjedhura të pushtetit popullor. Në këtë drejtim një rol të rëndësishëm luajtën zgjedhjet e fundit për Kuvendin Popullor dhe për këshillat popullorë, që në një shkallë të konsiderueshme u përtëritën me njerëz të rinj, revolucionarë e të aftë, të lidhur ngushtë me masat.

Me gjithë rezultatet e arritura, na mbetet akoma shumë për të bërë që këshillat popullorë të çdo shkalle, si përfaqësues të drejtpërdrejtë të popullit punonjës në pushtet, të kryejnë funksionet që u janë besuar, të mënjanojnë çdo shfaqje të formalizmit në punën e vet, të mos lejojnë kurrfarë spostimi të rolit të tyre nga organet ekzekutive, administratat ose organizatat ekonomike. Të mos lejojmë asnjë qëndrim mospërfillës nga kushdo qoftë ndaj përfaqësuesve të zgjedhur të popullit dhe problemeve që ngrenë ata. Fjala e deputetit ose e këshilltarit duhet të dëgjohet me vëmendje e respekt.

Përsosja e mëtejshme e punës së organeve ekzekutive është e

lidhur me luftën e ashpër kundër shfaqjeve të burokratizmit, të teknokratizmit e të prakticizmit të cekët në stilin dhe metodën e veprimtarisë së tyre, me forcimin e vazhdueshëm të lidhjeve me masat. Të mos harrojmë për asnjë çast se e keqja e burokratizmit zë vend në radhë të parë e mbi të gjitha në organet ekzekutive e në aparatet administrative. Vigjilenca e organizatave të Partisë, e vetë kuadrove që punojnë këtu dhe e masave punonjëse është një armë e mprehtë për të luftuar me sukses çdo e që në embrion çdo prirje e shtrembërim burokratik.

Masat që janë marrë kohët e fundit për një shpërndarje më të drejtë të kompetencave kanë çliruar organet e qendrës nga ngarkesa të tepërta dhe nga një përqendrim i panevojshëm i shumë punëve në duart e tyre. Në mënyrë të veçantë kjo ka rritur përgjegjësinë dhe iniciativën e pushtetit në bazë.

Duke marrë parasysh zhvillimin e hovshëm në gjerësi e thellësi të ekonomisë e të kulturës, shtimin dhe ngritjen e vazhdueshme të nivelit të kuadrove, rritjen e pjesëmarrjes së masave në tërë jetën shoqërore dhe ekonomike, do të ishin anakronike dhe të dëmshme tendencat për të kodifikuar çdo gjë nga lart, për tutelë mbi organet më të ulëta. Centralizmi proletar në vendin tonë qëndron mbi baza të patundura, sepse mbështetet në vijën e vetme marksiste-leniniste të Partisë, në ligjet unike që rregullojnë të gjitha marrëdhëniet shoqërore e shtetërore, në planin unik të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës socialiste, në përdorimin e centralizuar të mjeteve financiare nëpërmjet buxhetit të shtetit, në politikën unike të çmimeve, në sistemin unik të centralizuar të pagave, në monopolin e shtetit mbi tregtinë e jashtme etj. Prandaj nuk ka vend për asnjë druajtje se mos me zhvillimin e iniciativës e të vetëveprimit të bazës, me zgjerimin e kompetencave të saj, cenohet centralizmi.

Shokë,

Ndërtimi i socializmit në vendin tonë bëhet në kushtet e rrethimit imperialisto-revizionist. Prandaj mbrojtjen e atdheut, të lirisë e të pavarësisë kombëtare, pa të cilën nuk ka as pushtet popullor e as socializëm, Partia jonë gjithnjë e ka konsideruar dhe e konsideron si detyrë të saj të lartë e të përhershme. Në qoftë se Shqipëria e vogël ka qëndruar dhe qëndron e fortë dhe e patundur si shkëmb graniti, kjo para së gjithash ka ndodhur sepse armiqtë e njohin mirë unitetin, forcën dhe vendosmërinë e popullit tonë për të mbrojtur gjer në fund fitoret e revolucionit, për t'i bërë ballë me sukses çdo rreziku.

Përgatitja për mbrojtjen e atdheut është një detyrë e përhershme dhe e vazhdueshme që bëhet si në kohë të mira, ashtu edhe të këqija, pavarësisht nga ngjarjet që ndodhin në botë. Mbrojtjen e vendit ne e mbështesim jo në koniunkturat politike ndërkombëtare, por kryesisht në faktorin e brendshëm, që e konsiderojmë si vendimtarin, e mbështetim në forcën, heroizmin dhe qëndresën e hekurt të popullit, të udhëhequr me guxim nga Partia e Punës, në gatishmërinë luftarake të vendit për të përballuar çdo situatë e agresor.

Për të kryer me sukses këtë detyrë të lartë historike, i tërë populli, i madh e i vogël, i bashkuar si një trup i vetëm rreth Partisë, duhet të ngrihet në një nivel të lartë ideopolitik dhe të kuptojë qartë vijën e Partisë, taktikat dhe strategjinë e saj, t'i zbatojë ato në jetë me ndërgjegje e disiplinë të çeliktë, me një patriotizëm të zjarrtë në çdo moment e në çdo rrethanë, pa marrë parasysh asnjë sakrificë.

Atdheu dhe socializmi, jeta dhe puna e popullit mbrohen me armë në dorë, duke e pajisur ushtrinë e popullin me mjete moderne, duke i stërvitur ata vazhdimisht që të dinë t'i përdorin ato në mënyrë të përsosur e me efikacitetin më të madh. Atdheu është i të gjithë popullit, prandaj dhe mbrohet jo vetëm nga ushtria e rregullt, e veshur me uniformë, por nga i tërë populli i armatosur, i organizuar dhe i përgatitur ushtarakisht.

Duke u udhëhequr nga porosia e Leninit për ta bërë «çdo qytetar ushtar dhe çdo ushtar qytetar», ne përpiqemi që çdo njeri njëkohësisht të punojë, të mësojë dhe të përgatitet për mbrojtje. Tërë vendi është një kantier i madh pune ndërtimtare, një shkollë e madhe e edukimit komunist dhe një fortesë ushtarake e pathyeshme.

Partia dhe Qeveria i kanë kushtuar kurdoherë kujdesin më të madh rritjes, edukimit dhe kalitjes së forcave të armatosura. Ushtria jonë Popullore është e gatshme që në çdo kohë e situatë, sado e vështirë qoftë, të kryejë me nder detyrën e lartë të mbrojtjes së atdheut socialist.

Ushtria jonë është ushtri e tipit të ri, ushtri e popullit, ushtri e revolucionit. Duke ruajtur fort traditat e lavdishme të ushtrisë partizane, ajo ndryshon rrënjësisht nga ushtritë e vendeve borgjeze e revizioniste. Ajo nuk është një ushtri kazerme, një kastë e mbyllur që qëndron e shkëputur nga populli e mbi popullin, por një ushtri e shkrirë në një të vetme me tërë popullin e armatosur. Për kuadrot e saj që janë bij të popullit, janë të huaja pikëpamjet reaksionare borgjeze e revizioniste mbi ushtrinë, shfaqjet e arrogancës, fodullëkut, prepotencës, qëndrimi larg ushtarëve etj.

Në rrugën e revolucionarizimit të mëtejshëm të ushtrisë, si rezultat i masave të marra nga Partia për spastrimin e saj nga shumë forma e struktura organizative, nga shumë rregullore të huaja, të papërshtatshme për një ushtri si jona, e kanë bërë atë një ushtri të vërtetë të diktaturës së proletariatit, të aftë të përmbushë me nder misionin e saj në përshtatje me kushtet dhe detyrat e mbrojtjes së vendit.

Në të gjithë jetën e ushtrisë ne i jemi përmbajtur me konsekuencë parimit të prioritetit të punës ideopolitike mbi atë ushtarake, të prioritetit të njeriut, si faktori vendimtar në krahasim me armën. Është puna politike ajo që, duke ngritur ndërgjegjen e njerëzve, i jep jetë gjithë punës tjetër që bëhet në ushtri dhe e aftëson atë. Puna politike e bën ushtrinë të qëndrojë kurdoherë armë besnike e diktaturës së proletariatit, roje vigjilente e fitoreve të popullit.

Partia i ka kushtuar e do t'i kushtojë edhe në të ardhmen tërë kujdesin, pa lejuar kurrfarë qëndrimesh sempliste, përgatitjes së shëndoshë ushtarake, përvetësimit të thellë të artit ushtarak të luftës popullore, zotërimit të përsosur të armëve dhe të teknikës moderne nga luftëtarët, forcimit të rregullit e të disiplinës ushtarake proletare.

Partia ka qenë dhe mbetet shpirti i ushtrisë, truri që e drejton atë në rrugë të drejtë, forca jetëdhënëse që e bën atë të pathyeshme. Në ushtrinë tonë, në krye të mbrojtjes sonë, në komandë është Partia.

Komitetet dhe organizatat e Partisë në terren në çdo veprim që bëjnë, në çdo problem që zgjidhin të mos harrojnë kurrë detyrat lidhur me forcimin e mbrojtjes së atdheut. Ato duhet të zhvillojnë një punë të dendur ideopolitike për edukimin e gjithë punonjësve në frymën e vigjilencës, të gatishmërisë së lartë e të seriozitetit më të madh në përgatitjen ushtarake, duke mbajtur parasysh sa më realisht kushtet dhe kërkesat e luftës së sotme.

Organet e Partisë në ushtri dhe komandat ushtarake, nga ana e tyre, duhet të përmirësojnë stilin e punës për rritjen e përgatitjes politike dhe të gatishmërisë luftarake të forcave të armatosura, të forcojnë e të përsosin sidomos format e metodat e edukimit dhe të përgatitjes ushtarake të të gjithë popullit në përshtatje me strukturat e sotme organizative të ushtrisë.

Duke qenë se problemet e mbrojtjes, të ushtrisë dhe të stërvitjes ushtarake janë probleme të të gjithëve, është e nevojshme të forcohet e të përmirësohet më tej bashkëpunimi e bashkërendimi i punës midis organizatave të Partisë e komandave në ushtri dhe organizatave të Partisë e organeve të pushtetit e të ekonomisë në terren.

Nën kujdesin e vazhdueshëm të Partisë janë zhvilluar e forcuar organet e sigurimit të shtetit, të policisë popullore e të kufirit. Në tërë veprimtarinë e tyre ato janë mbështetur gjithmonë e më shumë në ndihmën dhe përkrahjen aktive të masave punonjëse, kanë zbatuar me përpikëri mësimet e Partisë, kanë luftuar me guxim për të mbrojtur ligjshmërinë socialiste, interesat e shtetit e të popullit.

Forcimi i mëtejshëm i organeve të sigurimit të shtetit, të policisë popullore e të kufirit kërkon ngritjen në një shkallë më të lartë të punës ideopolitike e profesionale, rritjen e vigjilencës revolucionare e të disiplinës së ndërgjegjshme për zbatimin me rreptësi të normave të përcaktuara, zgjerimin e mëtejshëm të lidhjeve me masat. Sigurimi i vazhdueshëm i rolit udhëheqës e kontrollues të Partisë në të gjithë veprimtarinë e tyre është kusht i domosdoshëm dhe një garanci e shëndoshë që këto organe të dashura të Partisë e të popullit të kryejnë me nder misionin e tyre.

Në forcimin dhe përsosjen e diktaturës së proletariatit një rol shumë të rëndësishëm luan legjislacioni ynë revolucionar. Sipas orientimeve të Kongresit të 5-të, me pjesëmarrjen aktive të masave, u bë një punë e madhe për rishikimin e gjithë legjislacionit të shtetit, për thjeshtimin e tij, për t'ua përshtatur atë kushteve të sotme. Kjo, krahas riorganizimit të organeve të drejtësisë, duke i afruar ato me masat e duke i vënë më mirë nën kontrollin e masave, ka ndikuar në mënyrë të dukshme në revolucionarizimin e punës së tyre. Përsosja e vazhdueshme e legjislacionit, njohja e ligjeve nga ana e masave të popullit, për t'i bërë ato sa më të ndërgjegjshme për zbatimin e tyre, forcimi i mëtejshëm i lidhjeve të organeve të drejtësisë me punonjësit dhe mbështetja në ta për mbrojtjen e ligjeve është një detyrë e madhe partie.

Shokë dhe shoqe,

Kanë kaluar 27 vjet nga koha kur populli ynë, nën udhëheqjen e patundur marksiste-leniniste të Partisë së Punës, përmbysi me luftë të armatosur pushtetin e urryer të imperialistëve të huaj e të klasave shfrytëzuese reaksionare vendëse dhe, për herë të parë në historinë e vet shumëshekullore, vendosi në Shqipëri pushtetin popullor. Pas zgjedhjeve të para të lira, të përgjithshme e demokratike të dhjetorit 1945, nga të cilat doli Asambleja Kushtetuese, përfaqësuese e vërtetë e aspiratave dhe e interesave të popullit, u aprovua ligji themeltar i shtetit të ri, Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë.

Atëherë vendi ynë sapo kishte dalë nga Lufta e madhe Nacionalçlirimtare dhe po bënte hapat e parë në rrugën e ndërtimit socialist. Në ato rrethana aprovimi i Kushtetutës ishte një ngjarje e shënuar historike dhe një fitore tjetër e madhe politike e popullit. Rëndësia e saj qëndronte në faktin se ajo ligjëroi atë përmbysje të thellë e rrënjësore që u bë në jetën e shoqërisë sonë si rezultat i triumfit të revolucionit popullor, sanksionoi nga pikëpamja juridike të gjitha ato fitore të mëdha politike, ekonomike e shoqërore që populli kishte arritur me luftën e vet heroike dhe hapi perspektiva të qarta për transformime të tjera revolucionare në të gjitha fushat e jetës mbi baza socialiste.

Kushtetuta u bë mbështetja dhe burimi i gjithë legjislacionit të shtetit tonë të ri demokratik popullor, që shprehte vullnetin e popullit dhe mbronte interesat e tij. Ajo luajti një rol të madh, jo vetëm për mbrojtjen e konsolidimin e pushtetit dhe të të gjitha fitoreve të tjera të revolucionit, por edhe për zhvillimin e gjithanshëm të rendit shoqëror-ekonomik në rrugën e socializmit.

Që nga ajo kohë ka kaluar një çerek shekulli. Kjo është periudha e transformimeve të mëdha revolucionare për të hedhur dhe konsoliduar themelet e rendit të ri në të gjitha fushat. Idetë e mëdha të marksizëm-leninizmit mbi shoqërinë e re, të lirë nga çdo shtypje e shfrytëzim dhe programi i Partisë sonë për ndërtimin e bazave të socializmit u bënë realitet. Pushteti popullor, i lindur nga pushka partizane, u konsolidua si pushtet i diktaturës së proletariatit, nën udhëheqjen e pandarë të Partisë së Punës. Mjetet e prodhimit, që më parë ndodheshin në duart e kapitalistëve vendës e të imperialistëve të huaj, u bënë pronë e përbashkët e popullit. U likuidua plotësisht sektori kapitalist i ekonomisë. Një revolucion rrënjësor u krye në fshat, kolektivizimi i bujqësisë e transformoi nga themelet prodhimin e vogël fshatar dhe e vuri atë mbi baza socialiste. Vendin e ekonomisë shumëformëshe e zuri sistemi i vetëm i ekonomisë socialiste. Bashkë me pronën private u zhdukën edhe klasat shfrytëzuese dhe të gjithë antagonizmat e tjerë midis qytetit e fshatit, punës mendore e fizike, që ngrihen mbi bazën e shfrytëzimit kapitalist. Marrëdhënie krejt të reja, të aleancës mbi bazën e socializmit, të përkrahjes e të ndihmës reciproke, janë vendosur midis klasës punëtore, fshatarësisë punonjëse dhe inteligjencies popullore. Dallimet midis tyre shkojnë duke u ngushtuar. Mbi këto baza është çelikosur çdo ditë e më tepër uniteti social, ekonomik e ideopolitik i popullit.

Me ndërtimin e bazës ekonomike të socializmit, që është fitorja e dytë më e madhe pas vendosjes së pushtetit popullor, ve-

ndi ynë hyri në një etapë të re historike, në atë të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Në luftë për zbatimin e detyrave të kësaj etape janë arritur fitore të reja të mëdha. Kjo luftë u ngrit në një shkallë më të lartë pas Kongresit të 5-të të Partisë. Procesi i madh i revolucionarizimit të të gjitnë jetës së vendit, që ngriti peshë mbarë popullin, ka çuar në konsolidimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të transformimeve të thella ekonomike, shoqërore, politike e ideologjike, në forcimin dhe përsosjen e bazës ekonomike e të gjithë superstrukturës së shoqërisë. Është grumbulluar një eksperiencë e re me vlerë të madhe se si t'i pritet rruga revizionizmit e restaurimit të kapitalizmit, si të sigurohet marshimi gjithnjë përpara i revolucionit deri në fitoren e tij të plotë e përfundimtare.

E parë në prizmin e këtyre ndryshimeve të thella revolucionare, Kushtetuta në fuqi, me gjithë korrigjimet e shtesat e mëvonshme që i janë bërë, në shumë aspekte themelore është kapërcyer dhe nuk pasqyron më realitetin socialist të sotëm në Shqipëri. Prandaj Komiteti Qendror i Partisë propozon hartimin e një Kushtetute të re, e cila t'i përshtatet etapës së sotme të zhvillimit të vendit, realitetit të ri, në mënyrë që, si pjesë përbërëse e superstrukturës politike, ajo t'i shërbejë më mirë bazës ekonomike, gjithë zhvillimit socialist të shoqërisë.

Ripunimi i Kushtetutës do të jetë një hap me rëndësi të madhe teorike e praktike për forcimin dhe përsosjen e mëtejshme të shtetit të diktaturës së proletariatit në vendin tonë. Kushtetuta e re do të shërbejë si bazë juridike për organizimin dhe legjislacionin shtetëror që kërkon faza e sotme e ndërtimit tonë socialist. Ajo duhet të jetë një dokument juridik, politik e ideologjik që të pasqyrojë plotësisht vijën e Partisë, të mishëruar në praktikën tonë revolucionare dhe t'i frymëzojë punonjësit në luftën për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste.

Hartimi i Kushtetutës së re është një punë me përgjegjësi të madhe. Ajo do të jetë Kushtetuta e Shqipërisë socialiste, e një vendi që u qëndron besnik parimeve të socializmit shkencor dhe që i zbaton e i zhvillon ato në mënyrë krijuese. Në hartimin e saj duhet të mbajmë parasysh si përvojën tonë të pasur revolucionare, ashtu edhe eksperiencën e socializmit botëror. Kjo kushtetutë duhet të paraqesë tiparet e vërteta të socializmit që e dallojnë atë nga të gjitha shtrembërimet e deformimet që i kanë bërë atij revizionistët modernë. Ajo do të jetë pasqyrimi i një rruge dhe eksperience të tërë të lavdishme, nën udhëheqjen e urtë të Partisë së Punës, që do të na frymëzojë, do të na mbushë me optimizëm e do të na nxitë për beteja e fitore të reja.

Zhvillimi i revolucionit në fushën e ideologjisë e të kulturës vitet e fundit është karakterizuar nga një luftë frontale klasore kundër të gjitha formave të ideologjisë së huaj, duke filluar që nga mbeturinat e vjetra, që vijnë nga thellësitë e shekujve, e deri te ndikimet e sotme të ideologjisë borgjeze e revizioniste. Qëllimi themelor i kësaj lufte është revolucionarizimi i mendjes dhe i ndërgjegjes së njerëzve, i gjithë botës shpirtërore të tyre për të afirmuar ideologjinë marksiste-leniniste, moralin proletar, kulturën socialiste. Kjo është një luftë e gjerë masive, që zhvillohet me pjesëmarrjen aktive të të gjitha shtresave të popullsisë, që realizohet në praktikë nëpërmjet lëvizjeve dhe aksioneve revolucionare, diskutimeve të gjera popullore, debatit dhe kritikës së hapur publike, ku ballafaqohen mendimet dhe zakonet e vjetra reaksionare me idetë dhe moralin e ri revolucionar.

Lufta për thellimin e revolucionit ideologjik e kulturor, si pjesë përbërëse e procesit të revolucionarizimit të gjithanshëm të jetës së vendit, u përgatit nga tërë puna 30-vjeçare e Partisë. Duke u mbështetur në rezultatet e arritura, Partia jonë lufton për ta çuar përpara pa ndërprerje punën për formimin e njeriut të ri të shoqërisë së re socialiste, të pajisur me bindje të thella marksiste-leniniste, me veti morale të larta revolucionare komuniste, me horizont të gjerë kulturor e botë të pasur shpirtërore.

Të forcojmë më tej ndërgjegjen socialiste të masave punonjëse në luftë me të gjitha mbeturinat dhe ndikimet e ideologjive të huaja

Megjithëse revolucioni ynë përmbysi marrëdhëniet e vjetra në prodhim, pra likuidoi atë bazë materiale, e cila lind, mban gjallë e ushqen format e ndryshme të ideologjisë së klasave shfrytëzuese, përsëri vazhdojmë të ndeshemi me ndikime e gjurmë të shumta të tyre. Shoqëria e re socialiste dhe zhvillimi i mëtejshëm i saj nuk mund të pajtohen më me këto mbeturina të huaja. Ato jo vetëm pengojnë marshimin përpara të revolucionit, por përmbajnë në vetvete rrezikun e kthimit prapa. Përvoja e hidhur e shfaqjes së revizionizmit në Bashkimin Sovjetik e vende të

tjera vërtetoi se, po të mos i hysh me të gjitha forcat thellimit të revolucionit ideologjik e kulturor, do të thotë ta lësh revolucionin socialist në mes të rrugës, të vësh në rrezik realizimet e tij në lëmin politik e ekonomik, t'i hapësh rrugën degjenerimit borgjez në të gjitha fushat.

Intensifikimi i luftës klasore ideologjike diktohet edhe nga nevoja për emancipimin e gjithanshëm të energjive fizike, mendore e shpirtërore të të gjithë punonjësve dhe veçanërisht të grave e të rinjve, për t'i çliruar ata nga barra e rëndë e paragjykimeve të vjetra, për t'i dhënë mundësi vrullit revolucionar të tyre që të shpërthejë furishëm e i papërmbajtur në të gjitha fushat e jetës. Ideali i socializmit është t'i çlirojë punonjësit jo vetëm nga zgjedha sociale dhe ekonomike, por edhe nga skllavëria shpirtërore e ideologjive të huaja. Socializmi është rendi i vetëm që krijon të gjitha kushtet dhe që është në gjendje të realizojë këtë emancipim të gjithanshëm të njerëzve.

Lufta që zhvillon Partia për edukimin e njeriut të ri është e gjerë dhe komplekse. Ky edukim nuk bëhet vetëm me anë të propagandës e të agjitacionit, nuk mbetet në luftën kundër ideve e koncepteve të vjetra në plan akademik. Ai arrihet edhe nëpërmjet krijimit të kushteve të atilla ekonomike, sociale e politike, që kultivojnë në njerëzit konceptet e normat socialiste. Ai realizohet në procesin e veprimtarisë praktike të njerëzve, në luftën e punën e tyre për ndërtimin e socializmit. Gjatë viteve të fundit me një guxim të rrallë Partia po lufton për të përpunuar orientimet marksiste-leniniste në të gjitha këto fusha dhe për të hedhur masat në aksione revolucionare. Në procesin e thellimit të revolucionit socialist Partia ka grumbulluar tani një përvojë të vlefshme teorike e praktike.

Një sulm i paparë ndonjëherë po zhvillohet sidomos kundër formave më të vjetra të ideologjisë së klasave shfrytëzuese, patriarkalizmit e konservatorizmit, fesë e zakoneve prapanike, të cilat, për arsyet e njohura të prapambetjes së rëndë që trashëguam nga e kaluara, kanë akoma rrënjë dhe nuk janë shkallmuar përfundimisht.

Një aksion me rezultate të mëdha është lufta për shpartallimin e ndikimit të fesë. Brenda një kohe shumë të shkurtër, u arrit që t'u hiqeshin përfundimisht funksionet e tyre gjithë institucioneve dhe predikuesve të fesë, të cilët përhapnin e mbanin gjallë idealizmin e misticizmin më obskurantist dhe më anakronik. Shqipëria u bë një vend pa kisha e xhami, pa priftërinj e hoxhallarë.

Natyrisht kjo nuk do të thotë se u arrit çlirimi i plotë i punonjësve nga ndikimi i opiumit fetar, përkundrazi për këtë do

të duhet një proces i gjatë riedukimi dhe edukimi. Por kjo ishte një goditje dhe fitore vendimtare, e cila krijon një premisë të re e të fuqishme për emancipimin e mëtejshëm të ndërgjegjes së njerëzve, për çlirimin e plotë të tyre nga besimet e paragjykimet fetare.

Kjo fitore nuk erdhi vetvetiu dhe as u arrit me masa administrative. Për këto u poqën të gjitha kushtet dhe punonjësit me vullnetin e tyre të lirë vendosën për fatin e institucioneve fetare që kanë qenë kurdoherë në pozita antikombëtare, u kanë shërbyer feudalëve, borgjezisë e pushtuesve të huaj, pavarësisht se ka pasur edhe klerikë patriotë nga të gjitha besimet që kanë luftuar për lirinë dhe pavarësinë e Shqipërisë. Ky qëndrim antikombëtar e antipopullor i fesë dhe i institucioneve të saj kishte rënë prej kohësh në kundërshtim me ndjenjat patriotike e liridashëse të popullit shqiptar. Këtë kontradiktë Lufta Nacionalçlirimtare e thelloi akoma më shumë. Transformimet e mëdha socialiste në tërë jetën e vendit dhe puna e gjithanshme dhe e pandërprerë propagandistike e Partisë i bënë edhe më të ndërgjegjshme masat për kotësinë e besimeve fetare dhe për papajtueshmërinë e realitetit të ri socialist me institucionet dhe predikuesit e fesë.

Partia jonë nuk ka lejuar kurrë të luhet me ndjenjat e popullit. Por, si parti marksiste-leniniste, ajo e ka të qartë se revolucioni socialist, gjatë marshimit të tij fitimtar, nuk mund të mos presë e të mos shkulë nga rrënjët, kur piqen të gjitha kushtet objektive e subjektive, të gjitha ato fije që i mbajnë masat të lidhura me botën e vjetër dhe që i pengojnë ato të ecin përpara.

Shikoni se ç'ngjet në vendet ku janë në fuqi revizionistët! Në truallin e përgjithshëm të degjenerimit borgjez, për hir të koniunkturave politike të brendshme e të jashtme, bile duke e përdorur kishën edhe për qëllime socialimperialiste, atje po zgjerohet propaganda fetare, po shtohen kishat e kleri, po gjallërohen vjetërsirat reaksionare dhe obskurantiste të mesjetës.

Në etapën e sotme të revolucionit jeta shtroi me forcë në rendin e ditës si një problem shumë të mprehtë emancipimin e plotë të gruas. Gratë dhe të rejat kanë qenë ato forca të shoqërisë sonë që mbaheshin më shumë se kushdo tjetër të shtypura e të ndrydhura, si nga ligjet e fesë, ashtu edhe nga normat, kanunet e zakonet e patriarkalizmit.

Me vendosjen e pushtetit popullor dhe me krijimin e bazës ekonomike të socializmit gruaja shqiptare, krahas gjithë punonjësve, shpëtoi nga shfrytëzimi kapitalist, fitoi liritë dhe të drejtat politike të barabarta me burrin, asaj iu krijuan mundësitë që të hidhej me të gjitha forcat në frontin e madh të ndër-

timit socialist të vendit. Sot nuk ka aktivitet në vendin tonë ku të mos militojnë dhe gratë, nuk ka vepër të re ku të mos mishërohet dhe puna fizike e mendore e tyre. Ato përbëjnë rreth 45 për qind të të gjithë njerëzve të zënë me punë në qytet e fshat.

Në vendin ku gratë dhe vajzat ishin masat më të prapambetura, që përçmoheshin nga shoqëria e nga burrat, sot me qindra e mijëra prej tyre drejtojnë punët e pushtetit në të gjitha instancat deri në Kuvendin Popullor, kryejnë funksione të rëndësishme në organizatat e masave dhe të Partisë, drejtojnë prodhimin e sektorë të tjerë të jetës së vendit. Partia dhe gjithë populli ndiejnë gëzim dhe krenari të vërtetë për gratë dhe vajzat tona heroike, të cilat, megjithëse akoma në kushte më të rënda se burrat, me zgjuarsi, me guxim dhe trimëri, punojnë e luftojnë jo më keq se shokët e tyre.

Me gjithë rezultatet e arritura në luftën për emancipimin e gruas, mbetej problem shqetësues sigurimi i barazisë së plotë e të vërtetë të gruas me burrin në jetën shoqërore e familjare. Pengesë kryesore këtu ishin dhe mbeten konceptet prapanike, feudale e patriarkale të vlerësimit të gruas si një qenie inferiore. Pa thyer këto koncepte që shtypnin e ndrydhnin personalitetin dhe energjitë e gruas, pa kapërcyer këtë mur nuk mund të sigurohej përparimi i saj dhe i gjithë shoqërisë sonë në rrugën e socializmit.

Ja përse Partia jonë tehun e luftës së saj për emancipimin e plotë të gruas e drejtoi kryesisht në frontin ideologjik, në luftën kundër konservatorizmit, normave e zakoneve skllavëruese, koncepteve denigruese e ofenduese për gratë.

Sukseset janë të mëdha. Por emancipimi i plotë i gruas mbetet edhe për të ardhmen një nga detyrat më të rëndësishme për Partinë. Dhe emancipimi i gruas do të thotë jo vetëm një grua e çliruar, por dhe një shoqëri e tërë e çliruar përfundimisht nga paragjykimet e konceptet e huaja mbi gruan. Ky emancipim nënkupton gjithashtu edhe krijimin e të gjitha kushteve materiale e shpirtërore për vendosjen e barazisë efektive e të plotë të burrit e të gruas në të gjitha fushat e jetës. Prandaj aq sa duhet punuar me ngulm për ngritjen ideologjike dhe të nivelit kulturor, arsimor e tekniko-profesional të vetë grave, që të kenë të njëjtin zhvillim si shokët e tyre e ta thonë kudo e me kompetencë mendimin për të gjitha problemet, po me aq ngulm duhet punuar për t'u krijuar atyre nga shoqëria në përgjithësi e nga pjesëtarët e tjerë të familjes, në veçanti nga burrat, kushte të barabarta zhvillimi, për t'u dhënë mundësi të mësojnë e të krijojnë. Puna e veprimtaria shoqërore të mos u ndërpritet nga punët e përditshme, të lodhshme e drobitëse të shtëpisë, të cilat

zakonisht përballohen vetëm prej tyre. Ne kemi sot mundësi, dhe përherë e më tepër do të kemi, që shumë nga punët e shtëpisë shkallë-shkallë t'i shoqërizojmë.

Këtu del përpara një çështje tjetër shumë e rëndësishme: krijimi i një jete të vërtetë demokratike në familje. Lufta për zgjerimin dhe thellimin e demokracisë socialiste në jetën tonë shoqërore depërtoi edhe në familje, ku shfaqjet e pabarazisë janë më të forta. Para syve tanë po tronditen e po rrëzohen themelet e jetës patriarkale dhe në familje po futen gjithnjë e më gjerë parimet e moralit komunist, fryma e ideologjisë socialiste. Motive të reja demokratike dhe socialiste kanë filluar të veprojnë tani më shumë në lidhjet martesore dhe në marrëdhëniet familjare. Por këto motive të reja nuk janë bërë akoma dominuese. Është i njohur fakti se familja mbetet relativisht më prapa zhvillimit të përgjithshëm të shoqërisë. Prandaj duhet të luftojmë që edhe kjo prapambetje të zvogëlohet nga dita në ditë, duke bërë që edhe jeta në familje të ecë me ritmin e kohës e krahas ndryshimeve të mëdha që bëhen në jetën e vendit. Familja shqiptare si vatër edukimi ka kultivuar veti të çmueshme patriotike dhe morale. Por mjaft tradita të punës edukuese të saj nuk mund të plotësojnë kërkesat tona, bile në disa drejtime ato i kundërvihen realitetit të sotëm. Për revolucionarizimin e jetës në familje duhet punuar më aktivisht, që ajo të zhvishet gradualisht nga mbeturinat konservatore e nga mentaliteti patriarkal dhe të bëhet vatër e edukimit të njerëzve në frymën e ideologjisë së Partisë.

Shoqëria jonë nuk mund të qëndrojë indiferente ndaj problemeve të familjes, duke i quajtur ato vetjake e të mbyllura. Përkundrazi, ajo do të kërkojë kurdoherë format e përshtatshme për të ndikuar mbi të, duke dënuar në të njëjtën kohë, si të huaja, ndërhyrjet vulgare e pa takt, me vend e pa vend në çështjet intime familjare.

Një luftë të vazhdueshme ka bërë Partia edhe kundër mentalitetit e psikologjisë mikroborgjeze. Por tani ka ardhur koha ta mprehim më shumë tehun e goditjes sonë kundër tyre. Ideologjia mikroborgjeze ka rrënjë të thella në ndërgjegjen e njerëzve. Kjo lidhet me faktin se në vendin tonë në të kaluarën kanë mbizotëruar prona e vogël e fshatarit dhe puna private e zanatçiut, mbi bazën e të cilave ndërtoheshin të gjitha llojet e marrëdhënieve midis njerëzve dhe kryhej formimi i pikëpamjeve të tyre. S'ka dyshim se transformimet e mëdha ekonomiko-shoqërore dhe puna e gjithanshme për edukimin e masave i kanë dhënë goditje të forta edhe ideologjisë mikroborgjeze, kanë ngushtuar sferën e veprimit të saj në punë dhe në jetën e njerëzve tanë.

Por e vërteta duhet parë në sy. Konceptet e prirjet mikro-

borgjeze ruhen dhe mbahen akoma gjallë. Ato shfaqen jo vetëm në fshat, por edhe në qytet, në këtë ose atë masë në të gjitha shtresat e popullsisë. Mbeturinat mikroborgjeze mpleksen me të gjitha format e ideologjisë së klasave shfrytëzuese, si me zakonet prapanike e patriarkale, ashtu edhe me ndikimet borgjeze e revizioniste.

Ideologjia mikroborgjeze ka karakter konservator, influenca e saj shërben si një nga burimet kryesore të oportunizmit dhe aventurizmit në lëvizjen punëtore. Është fakt se vala mikroborgjeze, e pleksur me burokratizmin dhe me presionin e gjithanshëm të ideologjisë borgjeze e revizioniste, qe një nga faktorët kryesorë që bëri të mundur procesin e degjenerimit kapitalist në Bashkimin Sovjetik.

Këtej del akoma më qartë se lufta kundër ideologjisë mikroborgjeze dhe shfaqjeve të saj është një nga detyrat më të rëndësishme të punës së gjithanshme të Partisë e veçanërisht të punës së saj ideologjike.

Në radhë të parë duhet të luftojmë për forcimin e disiplinës proletare në punë, kundër të kënaqurit me pak dhe mentalitetit fshatar e artizan, për rritjen e kërkesave ndaj rendimentit të çdo pune shoqërore. Por ky nuk është një problem thjesht edukimi. Ai është një problem kompleks social dhe ekonomik. Vetëm mbi bazën e përcaktimit të kritereve të drejta socialiste në fushën e organizimit, normimit, shpërblimit dhe kontrollit të punës, të sasisë dhe cilësisë së saj mund të zhvillohet me sukses puna edukuese për rrënjosjen e vetive socialiste të domosdoshme për kryerjen me ndërgjegje, në kohën e duhur dhe me rendiment të lartë të çdo pune shoqërore.

Një luftë e vendosur duhet bërë kundër individualizmit mikroborgjez që shprehet në shikimin e ngushtë e tepër të ngushtë të çështjeve, në kapjen fort pas interesave vetjake që u kundërvihen interesave të përbashkëta të shoqërisë, në mbylljen brenda guaskës së një bote të vogël e meskine, që të largon nga idealet e mëdha të kohës, që zhvillon indiferentizmin dhe apatinë ndaj çdo gjëje që nuk ka të bëjë me interesin e ngushtë personal dhe familjar, që e bën njeriun të rendë pas interesit material e rehatisë personale.

Tërheqja pas interesit të ngushtë personal është shprehje jo vetëm e ideologjisë mikroborgjeze, por e të gjitha ideologjive të klasave shfrytëzuese që buron nga vetë prona private, mbi të cilën mbështeten këto ideologji. Kjo prirje, që shfaqet në format më të ndryshme, është një nga plagët më të rënda që kemi trashëguar nga e kaluara dhe një nga rreziqet më të mëdha për fatet e socializmit. Prandaj luftën kundër çdo shfaqjeje të vë-

nies së interesit personal mbi interesin e përgjithshëm duhet ta shohim si një çështje themelore në gjithë punën ideologjike të Partisë.

Në luftën kundër ideologjisë mikroborgjeze duhet të kemi parasysh se shfaqjet e saj mpleksen me qëndrime të ndryshme konservatore e liberale dhe ushqejnë mungesën e principialitetit dhe kalimin nga njëri ekstrem në tjetrin. Ato kanë një rreze të gjerë veprimi në qëndrimin ndaj punës e pronës shoqërore, dhe sidomos në mënyrën e jetesës, në shprehitë e zakonet e ndryshme, veçanërisht në familje.

Forcimi dhe kalitja e pareshtur e ndërgjegjes socialiste të njerëzve tanë bëhet jo vetëm duke luftuar kundër mbeturinave të ideologjive të vjetra patriarkale, konservatore e mikroborgjeze, por edhe në luftë të vazhdueshme e të papajtueshme kundër ndikimeve të rrymave të sotme ideologjike borgjeze e revizioniste. Vendi ynë nuk jeton i izoluar nga bota kapitaliste e revizioniste që na rrethon, e cila, siç na mëson Lenini, duke u dekompozuar, lëshon në ajër gjithfarë mikrobesh vdekjeprurëse.

Si revolucionarë dhe marksistë, ne e kuptojmë rrezikun e zëvendësimit të një ideologjie të vjetër skllavëruese me një ideologji të re skllavëruese, të një helmi të vjetër me një helm të ri, i cili, sado i sheqerosur që mund të jepet, nën çdo maskë «modernizimi» e «liberalizmi», është gjithmonë vdekjeprurës. Në kushtet e tanishme ai përfaqëson një rrezik të madh. Duke shkallmuar ndikimet e ideologjisë së huaj që vijnë nga thellësitë e shekujve, duke zhdukur plagët e vjetra sociale dhe ideologjike të trashëguara nga shoqëria e vjetër feudalo-borgjeze, Partia jonë lufton për të mos lejuar krijimin e plagëve të reja sociale dhe ideologjike, që janë karakteristike për botën e sotme kapitaliste e revizioniste.

Gjithë lufta jonë e viteve të fundit, i tërë procesi i revolucionarizimit të jetës së vendit janë në të njëjtën kohë goditje të forta kundër ideologjisë borgjeze dhe revizioniste. Ato synojnë t'i bëhen barrierë aktive depërtimit të kësaj ideologjie. Por do të ishte e pafalshme po të mendohej se në të ardhmen ne jemi të garantuar nga çdo ndikim i ideologjisë borgjeze e revizioniste, se njerëzit tanë tashmë janë të imunizuar. Një nga drejtimet kryesore të strategjisë armiqësore imperialiste dhe revizioniste kundër vendit tonë është pikërisht presioni ideologjik, të cilin ata kanë mundësi ta ushtrojnë duke shfrytëzuar kanalet e shumta të informacionit të sotëm dhe veçanërisht të ndikimit kulturor, i cili merr forma të shumëllojta. Prandaj është detyrë e dorës së parë që edhe në të ardhmen të organizojmë një luftë të vazhdueshme kundër ideologjisë borgjeze e revizioniste, duke

mbajtur gjithmonë lart vigjilencën tonë ideologjike dhe frymën luftarake revolucionare.

Lufta në frontin ideologjik, siç ka theksuar vazhdimisht Partia, është pjesë përbërëse dhe shumë e rëndësishme e luftës së klasave, e cila vazhdon e pandërprerë në të gjitha fushat, politike, ekonomike, ideologjike e kulturore. Nga kjo luftë varet zhvillimi me sukses i revolucionit, mbrojtja dhe konsolidimi i fitoreve të tij. Jeta tashmë ka vërtetuar katërcipërisht se çdo largim nga lufta e klasave, çdo dobësim i kësaj lufte, çdo keqkuptim dhe shtrembërim i saj është i mbarsur me pasoja tepër serioze. Këtu duhet të shohim e të kërkojmë një nga shkaqet më të rëndësishme të asaj që ndodhi në Bashkimin Sovjetik e në disa vende të tjera, vetë thelbin e tradhtisë revizioniste.

E rëndësishme është që jo vetëm të pranojmë luftën e klasave, por edhe të kemi për të një kuptim të drejtë e të gjerë, si një luftë që vazhdon gjatë gjithë periudhës historike të kalimit nga kapitalizmi në komunizëm, si një luftë që zhvillohet jo vetëm kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm, por edhe në gjirin e popullit e të Partisë, si një luftë që duhet bërë vazhdimisht, kudo e nga të gjithë.

Përderisa vazhdon lufta e klasave, e cila nuk nxitet artificialisht, por ekziston objektivisht si luftë midis dy rrugëve të zhvillimit, socialiste e kapitaliste, nuk ka vend për asnjë frymë qetësie, vetëkënaqësie e liberalizmi, se gjoja ne i kemi zhdukur të gjitha të këqijat dhe kemi shpëtuar nga çdo rrezik. Përkundrazi, tehu i luftës së klasave duhet mbajtur kurdoherë i mprehtë, sepse ajo është arma jonë e fuqishme që na mbron nga armiqtë, që na spastron nga të këqijat, që na farkëton si revolucionarë proletarë. Këtë luftë ne duhet ta zhvillojmë me konsekuencë, duke bërë gjithnjë të qartë karakterin e kontradiktave antagoniste e joantagoniste dhe duke u mbështetur fort në masat.

Te ne në fuqi është klasa punëtore, e cila nëpërmjet Partisë dhe shtetit proletar udhëheq tërë jetën e vendit. Roli i saj drejtues e kontrollues është vendimtar. Pa këtë rol nuk ka diktaturë të proletariatit, nuk ka socializëm. Për këtë arsye Partia i ka kushtuar dhe i kushton tërë kujdesin e saj edukimit të gjithanshëm të klasës punëtore, rritjes së ndërgjegjes politike dhe aftësimit të saj për ta bërë atë plotësisht në gjendje jo vetëm të kuptojë misionin e vet si klasë udhëheqëse në fuqi, por dhe që ta realizojë atë në praktikë.

Vitet që kanë kaluar kanë shënuar suksese të rëndësishme në këtë drejtim, të cilat duken qartë në rritjen e frymës luftarake të klasës punëtore, në rezultatet e mrekullueshme në punë, në shpërthimin e iniciativave dhe krijimtarisë revolucionare, në forcimin e zgjerimin e kontrollit punëtor të drejtpërdrejtë,

në ngritjen e nivelit ideologjik, kulturor e tekniko-profesional, në faktin se klasa punëtore me shembullin dhe veprën e saj po i jep gjithnjë e më shumë tonin tërë jetës së vendit.

Këto rezultate janë një bazë e shëndoshë për ta çuar vazhdimisht përpara edukimin e klasës punëtore. Në këtë punë vendin e parë e kryesor, si kurdoherë, duhet ta zërë edukimi ideopolitik, armatosja e klasës punëtore me teorinë marksiste-leniniste dhe me mësimet e Partisë, të lidhura ngushtë me jetën dhe luftën e përditshme. Jo më pak e rëndësishme është edhe puna për edukimin e saj profesional, arsimor e kulturor.

Këto dy anë të edukimit komunist të klasës punëtore dhe të të gjithë punonjësve janë të lidhura ngushtë. Por Partia i ka dhënë e do t'i japë prioritet edukimit ideologjik, politik e moral, sepse klasën punëtore ne nuk e shohim siç e shohin atë borgjezët e revizionistët, si një forcë thjesht prodhuese, që duhet vetëm të punojë e të prodhojë, kurse burokratët e teknokratët të sundojnë, të bëjnë ligjin, të shtypin e të shfrytëzojnë klasën punëtore në interes të borgjezisë kapitaliste e revizioniste.

Për ne janë krejt të huaja teoritë borgjeze teknokratike që përpiqen të mohojnë nevojën e domosdoshme të revolucionit social të proletariatit dhe ta zëvendësojnë atë me revolucionin tekniko-shkencor, që synojnë të hedhin poshtë karakterin konsekuent revolucionar dhe misionin historik të klasës punëtore. Revolucioni tekniko-shkencor nuk mund të ndryshojë kurrë natyrën as të kapitalizmit, as të socializmit, nuk mund të ndryshojë ligjet objektive të zhvillimit të shoqërisë. Te ne revolucioni tekniko-shkencor zhvillohet nën udhëheqjen e diktaturës së proletariatit. Burokratët e teknokratët nuk mund të jenë dhe nuk do të jenë kurrë në fuqi, por do të sundojë klasa punëtore dhe ligjet e diktaturës së proletariatit deri në shuarjen e shtetit, deri në fitoren e plotë të komunizmit.

Në vendin tonë specialistët, teknikët, intelektualët përgjithësisht, të dalë nga gjiri i klasës punëtore e i masave punonjëse, të edukuar në frymën e socializmit nga Partia, kanë një vend të merituar dhe luajnë një rol të madh në të gjitha fushat e veprimtarisë si ndihmës të klasës punëtore, si shërbëtorë të popullit. Duke luftuar konceptet burokratike, teknokratike e intelektualiste, Partia lufton në të njëjtën kohë edhe kundër koncepteve vulgare që mohojnë e përçmojnë punën e rolin e inteligjencies. Qëllimi i Partisë është ta ruajë inteligjencien të pastër e revolucionare, ta lidhë atë ngushtë me punëtorët e fshatarët, ta bëjë atë të aftë të përballojë vetë ndikimet e huaja borgjeze e revizioniste, që të luftojë, ashtu si deri më sot, me vendosmëri për çështjen e madhe të klasës punëtore e të popullit.

Në luftë për edukimin e njeriut të ri Partia ka bërë një punë

të frytshme sidomos për edukimin komunist të rinisë. Rinia jonë është e lidhur ngushtë me Partinë, e qartë politikisht dhe e pastër moralisht, e orientuar drejt dhe e sigurt në jetë, luftëtare e guximshme dhe sypatrembur, që i derdh energjitë e saj të vlefshme në dobi të revolucionit socialist dhe të përparimit të gjithanshëm të popullit.

Një pamje krejt të kundërt shohim në botën kapitaliste e revizioniste. Atje problemi i rinisë sot është nga më shqetësuesit. Rinia e ndien krizën e kësaj shoqërie të kalbur dhe kërkon rrugëdalje. Në këtë luftë ajo herë pas here hidhet në aksione të ndryshme revolucionare. Por atë e trullosin, e ushqejnë me ndjenjën e boshllëkut e të kotësisë shpirtërore, e fusin në rrugën e shthurjes e të degjenerimit, asaj ia konsumojnë energjitë në një jetë pa ideale e pa perspektivë. Borgjezia përdor të gjitha mjetet, që nga lojnat e fëmijëve e gjer te shtypi e literatura, që nga shkolla e gjer te kisha, për t'i korruptuar masat e rinisë dhe të popullit, për t'i dhënë këtij korruptimi pamjen e një jete gjoja të lirë e moderne, për t'i larguar të rinjtë nga politika, nga lufta për të ardhmen, nga revolucioni.

Ndershmëria, jeta në thjeshtësi dhe me dinjitet, morali i lartë dhe i pastër, besnikëria ndaj popullit punonjës dhe atdheut, të gjitha virtytet e larta dhe revolucionare të popujve, nga borgjezia dhe makina e saj propagandistike konsiderohen anakronike dhe arkaike. Ato luftohen haptazi dhe tërthorazi, shtrembërohen e përshtaten në mënyrë demagogjike për interesat e borgjezisë dhe në dëm të interesave të punonjësve, për të shuar revoltën revolucionare, për të përballuar ndikimin e marksizëm-leninizmit që është mbrojtësi i këtij thesari të madh shpirtëror të popullit.

Ideologët borgjezë e revizionistë përpiqen t'u mbushin mendjen rinisë dhe masave se është e kotë të luftosh për të kërkuar rrugëdalje nga kontradiktat e thella që brejnë shoqërinë e tyre. E vetmja alternativë që propozojnë ata është zhytja në pesimizëm dhe korrupsion. Këtu e ka burimin nxitja e paskrupull dhe me pasoja katastrofale shoqërore e alkoolizmit, narkotizmit, seksualizmit dhe shumë instinkteve të ulëta e shtazarake që janë bërë modë në botën kapitaliste e revizioniste.

Te ne, në kundërshtim të plotë me këtë gjendje, brezi i ri, i grumbulluar në organizatën e vet luftarake të Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë, nën drejtimin e Partisë ka dalë në arenën e luftës klasore ideologjike si një iniciator i guximshëm dhe luftëtar i paepur, si një forcë revolucionarizuese, shtytëse dhe goditëse në lëmin e transformimeve sociale, ideologjike e kulturore. Rinia jonë heroike, duke u ruajtur nga ndikimet e ideologjisë borgjeze e revizioniste, në të njëjtën kohë

ka çarë e çan me guxim në radhët e para në luftë kundër të gjitha atyre traditave të botës së vjetër, të cilave u ka shkuar koha, kundër çdo gjëje të huaj që pengon ecjen tonë përpara. Në këtë luftë është rritur dhe rritet çdo ditë personaliteti i rinisë, shtohen guximi dhe iniciativa e saj revolucionare, pasurohet përvoja e saj.

Por rininë tonë duhet ta shikojmë e ta kuptojmë gjithmonë në zhvillimin e saj të vrullshëm. Ky zhvillim shoqërohet me vështirësi të rritjes e me kontradikta. Një pengesë e madhe që rinia e ndesh gjithnjë në punë e kudo janë shfaqjet e konservatorizmit, të cilat frenojnë hovin revolucionar të rinisë, nënvlerësojnë energjitë dhe aftësitë e saj krijuese, e mbajnë atë të ndrydhur, sidomos në fushën e marrëdhënieve shoqërore, etike, veçanërisht në familje e në një masë të ndjeshme edhe në shkollë. Krahas kësaj, rinia ndeshet edhe me ndikime të liberalizmit e të njëfarë indiferentizmi të opinionit shoqëror e, në disa raste, edhe të familjes. Nuk duhet të harrojmë se tehu i ideologjisë revizioniste e borgjeze drejtohet në radhë të parë te rinia, e cila për mungesë përvoje mund të bëhet më e prekshme. Prandaj Partia do të luftojë që edhe në të ardhmen ta hedhë rininë në luftë kundër çdo lloj ndikimi të ideologjisë së huaj, ta ushqejë atë në mënyrë konsekuente me idealet revolucionare marksiste-leniniste, t'u hapë terren dhe horizont në çdo fushë energjive të pashtershme të saj, të nxisë gjerësisht iniciativën e vetëveprimin e saj.

Kjo kërkon të gjallërohet në mënyrë të gjithanshme jeta e rinisë, të zgjerohet rrethi i interesave dhe i veprimtarisë së saj, të njihen kërkesat dhe dëshirat e saj, të vlerësohen mundësitë dhe forcat që ajo ka. Në këtë drejtim duhet të bëhet një punë më e kualifikuar, duke luftuar kundër çdo shfaqjeje të formalizmit e burokratizmit, të diktatit e të tutelës, që nuk merr parasysh interesat dhe nevojat e rinisë, që nuk përfill veçoritë psikologjike të moshës etj. Të tilla shfaqje në mjaft raste vihen re jo vetëm në prindët e mësuesit, por edhe në organizata partie, bile edhe në kuadro që punojnë me rininë. Traditat e vjetra konservatore e burokratike bëhen pengesë sidomos për demokratizimin e mëtejshëm të jetës shkollore dhe krijimin e mundësive që rinia të marrë pjesë efektivisht në revolucionarizimin e gjithanshëm të kësaj jete.

Detyra jonë është t'i japim mundësi rinisë që vetë ta organizojë në mënyrë të gjallë dhe dinamike jetën e saj, ta ndihmojmë në këtë rrugë me mjeshtëri. Për këtë një rol të veçantë duhet të luajë organizata e Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë. Ajo duhet ta gjallërojë jetën e saj duke marrë parasysh ndryshimet e vrullshme që sjell zhvillimi i jetës së vendit dhe

i vetë rinisë, duke ua përshtatur edhe format e punës këtyre ndryshimeve, si edhe nevojave e kërkesave të reja që ato sjellin te rinia.

Shoqëria jonë është në një periudhë ngjitjeje të vrullshme. Po përmbysen tradita, norma e zakone shekullore, sulmohen ideologjitë e të tëra klasave që u ka perënduar ylli, lindin norma e zakone të reja që çlirojnë mendjen e ndërgjegjen e punonjësve, po triumfon ideologjia e proletariatit ngadhënjimtar. Revolucionarizimi i gjithanshëm i jetës së vendit dhe lufta e mprehtë ideologjike e zhvilluar gjatë viteve të fundit kanë krijuar një raport të ri, më të përshtatshëm midis kërkesave të socializmit dhe ndërgjegjes së njerëzve. Por, natyrisht, do të ishte gabim të mendohej se tashmë janë shkallmuar krejtësisht të gjitha format dhe shfaqjet e ideologjive të vjetra, se janë zgjidhur të gjitha kontradiktat në këtë fushë. Sado e fortë që të jetë goditja jonë, ajo nuk mund të jetë, dhe në fakt nuk është, përfundimtare. Pozitat e fituara nga ideologjia socialiste kanë nevojë të përforcohen e të thellohen më tej, gjersa të sundojnë kudo, në tërë shoqërinë tonë.

Duke luftuar me ngulm për revolucionarizimin e gjithanshëm të superstrukturës sonë shoqërore, duke e vënë theksin me forcë te nevoja e intensifikimit të luftës ideologjike, ne kemi gjithmonë parasysh se faktori vendimtar që përcakton ecjen tonë përpara është rritja e pandërprerë e prodhimit socialist dhe transformimi i vrullshëm i gjithanshëm i shoqërisë sonë. Vetëm mbi këtë bazë mund të bëhet revolucionarizimi i mendjes dhe i ndërgjegjes së njerëzve. Prandaj lufta jonë ideologjike mund të zhvillohet me sukses, duke çuar përpara prodhimin socialist dhe duke kombinuar revolucionarizimin e mekanizmave të jetës shoqërore, ekonomike e politike me edukimin komunist të masave punonjëse, me hedhjen e tyre në aksione dhe lëvizje revolucionare të vazhdueshme.

Lufta ideologjike, si një nga format më të ndërlikuara e më të mprehta të luftës së klasave, është një luftë për jetë a vdekje midis ideologjisë sonë dhe ideologjisë së huaj armike, midis së resë dhe së vjetrës, midis revolucionares e reaksionares.

Në këtë luftë së vjetrës që e mohojmë dhe duam ta shpartallojmë ne i kundërvëmë gjithmonë të renë që lind e afirmohet. Koncepteve dhe ideve borgjeze e revizioniste u kundërvëmë pikëpamjet tona marksiste-leniniste. Psikologjisë së vjetër mikroborgjeze i kundërvëmë psikologjinë e re socialiste. Shfaqjeve të individualizmit dhe të indiferentizmit borgjez e mikroborgjez u kundërvëmë kolektivizmin dhe solidaritetin socialist. Liberalizmit borgjez dhe konservatorizmit patriarkal u kundërvëmë frymën tonë të shëndoshë përparimtare. Tendencave të rehatisë e të mendjemadhësisë u kundërvëmë frymën

e sakrificës e të aksionit, shpirtin praktik, modestinë dhe ekzigjencën ndaj vetvetes.

Në thellimin e luftës klasore ideologjike një rëndësi të dorës së parë merr formimi i botëkuptimit marksist-leninist. Tani janë krijuar kushte të reja objektive e subjektive që na japin mundësi për ta ngritur në një nivel më të lartë gjithë punën për përvetësimin krijues të marksizëm-leninizmit nga komunistët dhe masat punonjëse, për ta mbështetur në baza akoma më shkencore luftën kundër koncepteve idealiste e metafizike, për ta realizuar përvetësimin e teorisë marksiste-leniniste në lidhje akoma më të ngushtë me praktikën revolucionare. Një punë e madhe është bërë vitet e fundit për studimin e historisë së Partisë sonë dhe të dokumenteve themelore të saj. Në këtë studim vëmendja është përqendruar në gjënë themelore, në parimet nga të cilat është nisur dhe në metodën e rrugët që ka përdorur Partia për zgjidhjen e problemeve të ndryshme në rrethanat konkrete të vendit tonë; bëhen përpjekje që nga kjo të mësojmë të zgjidhim problemet e sotme në kushte të reja historike. Edhe zhvillimi i aksioneve e i lëvizjeve të shumta revolucionare, sidomos i atyre ideologjike po shoqërohet me studimin e marksizëm-leninizmit dhe me përpunimin teorik të problemeve përkatëse. Në këtë fushë është gjallëruar edhe puna e shtypit dhe e mjeteve të tjera të propagandës e të kulturës masive.

Këto rezultate janë një bazë e shëndoshë për të punuar më me ngulm e në mënyrë më të kualifikuar për zotërimin e teorisë marksiste-leniniste nga gjithë komunistët e punonjësit. Për këtë kërkohet që të studiohen thellë e vazhdimisht veprat gjithnjë aktuale të klasikëve tanë të mëdhenj, Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit, dokumentet e Partisë sonë dhe materialet, në të cilat përgjithësohet eksperienca e lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Ky studim nuk është e nuk mund të jetë qëllim në vetvete, por i lidhur ngushtë me praktikën e sotme revolucionare dhe duhet t'i shërbejë kësaj praktike. Të studiojmë jo çdo gjë që na bie në dorë, por me një pikësynim të caktuar, duke zgjedhur për këtë qëllim edhe literaturën përkatëse. Studimi i teorisë marksiste-leniniste duhet të na shërbejë për të njohur thellë e për të zbatuar drejt politikën e Partisë në çdo fushë të veprimtarisë, për të kuptuar e për të zhvilluar me sukses luftën kundër imperializmit e revizionizmit modern, për të njohur ligjet e luftës së klasave, të marrëdhënieve midis kushteve të jetës materiale dhe ndërgjegjes së njerëzve, të ekonomisë e të politikës, për të kuptuar e zgjidhur drejt kontradiktat e problemet që shtron zhvillimi i jetës së vendit.

Kjo arrihet vetëm atëherë kur nuk mësohen përmendësh disa formula e teza, por kur zotërohen parimet themelore, metodo-

logjia marksiste-leniniste, kur përvetësohet mënyra materialiste-dialektike e interpretimit të fenomeneve dhe e zgjidhjes së çështjeve, kur luftohet si kundër qëndrimeve dogmatike, ashtu edhe kundër pikëpamjeve subjektiviste.

Marksizëm-leninizmi është një teori gjer në fund revolucionare. Duke ndriçuar problemet e reja që nxjerr jeta, ai zhvillohet në luftë me pikëpamjet e kundërshtarëve të tij ideologjikë. Vetëm në procesin e kësaj lufte ai mund të përvetësohet thellë, mund të rrënjosen ide të gjalla marksiste-leniniste dhe mund të shndërrohen ato në bindje të ndërgjegjshme dhe luftarake. Ballafaqimi i pikëpamjeve dhe debati duhet të përdoren gjerësisht edhe në gjirin e Partisë e të gjithë shoqërisë, në luftë me çdo shfaqje të konformizmit dhe me prirjet për mbulimin e kontradiktave. Vetëm në këtë rrugë mund të hidhen bazat e një imuniteti aktiv ndaj ideologjisë së huaj, mund të realizohet një edukim i vërtetë revolucionar.

Por në metodat tona të edukimit ka rutinë e struktura të vjetra pune që e pengojnë realizimin e këtyre qëllimeve. Në shtypin dhe botimet tona, në radio, në leksionet e konferencat e ndryshme që zhvillohen ka akoma shumë formalizëm e zyrtarizëm. Në to nuk ndihet siç duhet fryma e ballafaqimit të mendimeve dhe nuk përdoret gjerësisht metoda e debatit, përdoren metoda standarde e të konsumuara, ka pak krijimtari. Metoda të tilla pengojnë propagandimin e frytshëm dhe përvetësimin krijues të marksizëm-leninizmit dhe të politikës së Partisë. Prandaj lufta jonë kundër tyre duhet të jetë shumë më e vendosur. Të mos ngurrojmë që të heqim dorë me guxim nga të gjitha ato forma të vjetruara pune që nuk u përgjigjen më nivelit të sotëm të zhvillimit politik, ideologjik e kulturor të njerëzve tanë, kërkesave që kanë lindur mbi bazën e këtij niveli, nevojës për ta ngritur atë gjithnjë e më lart.

T'i vëmë gjithnjë më mirë arsimin, kulturën dhe artin në shërbim të socializmit e të popullit

Gjatë periudhës së fundit është zhvilluar një punë kolosale për të revolucionarizuar më tej arsimin e kulturën, letërsinë e artet, për t'i vënë ato gjithnjë e më mirë në shërbim të çështjes së socializmit e të popullit.

Revolucionarizimi i mëtejshëm i shkollës është një ndër aksionet më të mëdha që ka ndërmarrë Partia. Diskutimi i gjerë popullor që u zhvillua për këtë çështje kontribuoi shumë në luftimin e koncepteve e të ndikimeve borgjeze e revizioniste dhe në përpunimin e koncepteve marksiste-leniniste për shkollën.

Tani po luftohet frontalisht për t'i zbatuar orientimet e Partisë në këtë fushë dhe jeta po vërteton çdo ditë drejtësinë e tyre. Programet e reja mësimore po zbatohen me sukses. Një punë e madhe, në të cilën janë aktivizuar mijëra arsimtarë e pedagogë, po bëhet për hartimin e teksteve të reja shkollore. Po punohet gjithashtu për revolucionarizimin e strukturave, të metodave e formave mësimore dhe edukative. Këto masa synojnë realizimin e boshtit ideologjik marksist-leninist në të gjithë punën mësimore-edukative të shkollës, zbatimin në unitet të komponentëve themelorë të saj, mësimit, punës prodhuese dhe edukimit fizik e ushtarak, lidhjen e saj të ngushtë e të gjithanshme me praktikën revolucionare.

Masat për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës prekin në themel të gjithë jetën e saj. Krahas zhvillimit të mëtejshëm në gjerësi të arsimit, vëmendjen e Partisë e tërhoqi në mënyrë të veçantë zhvillimi në thellësi i tij, forcimi i gjithanshëm i përmbajtjes socialiste të shkollës. Sigurisht, edhe në të ardhmen do të kemi zgjerim dhe masivizim të mëtejshëm të shkollës në rrugë të shumëllojta, sidomos në arsimin e mesëm e të lartë. Por çështjet e përmbajtjes mbeten gjithnjë më themeloret. Prandaj zbatimi i plotë e me ritme sa më të shpejta i detyrave që kemi shtruar, përpunimi i mëtejshëm teorik, mbi bazën e përvojës praktike, i çështjeve ideologjike, shkencore e pedagogjike, të brendisë së punës mësimore-edukative, sidomos të programeve dhe teksteve shkollore, përbën preokupacionin tonë kryesor.

Tani që përfundoi shtrirja dhe zgjerimi i shkollës tetëvjeçare në të gjithë vendin del akoma më e mprehtë nevoja e konsolidimit dhe e forcimit të gjithanshëm cilësor të saj. Kjo është një premisë themelore për një nivel e cilësi më të lartë pune në të gjitha kategoritë e shkollave. Para shkollës sonë qëndron sot detyra e rëndësishme e modernizimit shkencor-pedagogjik të të gjithë procesit të mësimit, të brendisë dhe të metodës së tij. Ajo nuk mund të realizohet pa pasqyruar në mësim në mënyrë të përshtatshme proceset aktuale dhe prirjet e zhvillimit të revolucionit tekniko-shkencor, pa u thelluar në studimin e shkencës dhe të teknikës moderne, pa përdorur metoda pedagogjike moderne. Për këtë kërkohet të bëhen ndryshime të rëndësishme dhe më të shpejta jo vetëm në programe e tekste, por sidomos në bazën mësimore-didaktike, në futjen graduale të teknikës moderne në mësim, në kualifikimin e mësuesve, në sigurimin e literaturës për nxënës e pedagogë, në rritjen e kërkesave ndaj tyre. Një problem i dorës së parë është përdorimi i metodave aktive që stimulojnë punën e pavarur të nxënësve e të studentëve, si edhe zhvillimin e aftësive, të prirjeve e të talenteve të tyre.

Në shkollën tonë socialiste ngritja e nivelit shkencor dhe me-

todik të dhënies së mësimit po realizohet edhe si lidhje e ngushtë e teorisë me praktikën e me punën prodhuese. Me gjithë problemet e ndërlikuara organizative e pedagogjike, pjesëmarrja e rinisë shkollore dhe e studentëve në punë prodhuese në fabrika e kooperativa, në aksione lokale e kombëtare po realizohet me sukses. Por akoma ka mjaft vështirësi që rrjedhin nga moskuptimet dhe pengesat që dalin në organizimin e zbatimin praktik të saj, si nga drejtuesit e shkollave, ashtu dhe nga ata të ndërmarrjeve ekonomike.

Një kujdes i veçantë duhet treguar edhe për zbatimin e programeve të përgatitjes ushtarake të rinisë si një komponent tjetër tepër i rëndësishëm i shkollës sonë të re. Kjo përgatitje duhet bërë me tërë seriozitetin e saj, në përshtatje me moshën, duke luftuar çdo shfaqje të nënvlerësimit të kësaj detyre që ka të bëjë me forcimin e mbrojtjes së lirisë e të pavarësisë së atdheut.

Është e kuptueshme se lufta për revolucionarizimin e shkollës kërkon ngritjen e gjithë punës në një nivel më shkencor. Pa iu futur seriozisht studimeve, pa zhvilluar shkencat pedagogjike nuk mund të plotësohen me sukses gjithë detyrat që qëndrojnë përpara shkollës sonë.

Programet e reja të edukimit fizik e ushtarak në shkolla, të cilat po vihen në jetë me sukses, dhanë shkas për një gjallërim të mëtejshëm të kulturës fizike e të sportit. Megjithëkëtë ky është një sektor akoma i prapambetur i punës sonë. Parimet e përcaktuara, sipas të cilave themelore është lëvizja masive fizkulturale, kultura e përgjithshme fizike dhe sportet bazë që e sigurojnë atë, nuk po zbatohen në mënyrë konsekuente dhe në praktikë ka shumë njëanshmëri. Lëvizja fizkulturale e rinisë dhe e masave është e kufizuar dhe nuk është në qendër të vëmendjes të organeve të Partisë e të pushtetit, të arsimit e të fizkulturës, të rinisë e të bashkimeve profesionale. Kryesore këtu nuk janë pengesat e mungesat materiale, megjithëse edhe të tilla ka dhe ato mund të zgjidhen. Themelore është të luftohen konceptet e shtrembra që shprehen në nënvlerësimin e lëvizjes masive fizkulturale dhe të sporteve bazë. Për ne që duam një rini e popull të fortë, të shëndetshëm e të kalitur, është e domosdoshme të bëjmë kthesë edhe në këtë fushë dhe ta shtrojmë këtë si një detyrë të rëndësishme partie.

Më shumë duhet të kujdesemi edhe për jetën e rinisë e të punonjësve, për kulturën e tyre të gjithanshme, për çlodhjen e dëfrimin e tyre, për lojnat, për bazat sportive, për botimin e librave, lëvizjen artistike etj. Harmonizimi më i mirë i punës së shkollës me gjithë sistemin e edukatës jashtëshkollore dhe të kulturës masive, si edhe formimi i një koncepti të drejtë për gjerësinë e brendisë dhe të mjeteve të punës kulturore, janë një problem shumë i rëndësishëm e aktual. Botimi dhe përhapja më e gjerë e librit, zgjerimi dhe shtrirja e qendrave kulturore e artistike në të gjithë vendin, rritja e madhe e lëvizjes artistike amatore, tani së fundi ngritja e televizionit, si edhe revolucionarizimi i brendisë së gjithë kësaj pune janë tregues të rëndësishëm të hopit sasior e cilësor të saj. Në këtë lëmë ne jemi angazhuar në një luftë intensive për theksimin e tipareve socialiste të kulturës sonë dhe për shkallmimin e ndikimeve të huaja e të vjetruara. Por kërkesat gjithnjë në rritje të masave për kulturë janë shumë të mëdha dhe plotësimi i tyre nuk ecën me ritmin e duhur. Mjetet e shumëllojshme të kulturës masive nuk kanë depërtuar akoma siç duhet brenda në familje dhe nuk janë vënë akoma në shkallë të gjerë në përdorim të përditshëm të individit në punë dhe në kohën e lirë. Prandaj, në shumë raste, njohuritë e fituara në shkollë nuk plotësohen, nuk zhvillohen e nuk përforcohen. Detyra jonë është të marrim masa për të mos lejuar thellimin e mëtejshëm të kësaj kontradikte.

Jeta jonë socialiste është e duhet të jetë kulturë. Kjo do të thotë se, krahas shkollës, librit, veprimtarisë artistike etj., e tërë jeta dhe prodhimi, edhe mënyra e jetesës dhe e sjelljes, edhe krijimi i ambienteve në uzinë, në shkollë ose në fshat, edhe mënyra se si ne i ndërtojmë e i rregullojmë qytetet e fshatrat tona, arkitektura dhe urbanistika jonë, mirëmbajtja e rrugëve, edhe mënyra se si i shërbehet popullit, të gjitha, çdo gjë te ne, duhet t'i shërbejnë formimit kulturor të njeriut të ri. Qëllon që ka kuptime të ngushta ose nënvlerësime për njërën dhe tjetrën fushë të kulturës. Sidomos më pak tregohet vëmendje për kulturën e jetës. Tërë kujdesi përqendrohet në çështjet e prodhimit dhe kjo është e kuptueshme, por duhet më shumë vëmendje edhe për kushtet e punës, për çlodhjen dhe kohën e lirë të punonjësve, për shfrytëzimin racional të të gjitha mjeteve të informacionit e të komunikimit social nga ana e tyre, për zhvillimin e gjithanshëm kulturor të tyre.

Në luftë për kapërcimin e këtyre dobësive është e domosdoshme të rritet interesimi i gjithanshëm shtetëror e shoqëror për punën edukuese kulturore, për përsosjen e metodës së kësaj pune, për shfrytëzimin e plotë racional të mjeteve ekzistuese, si edhe për krijimin e mundësive e sigurimin e mjeteve të nevojshme materiale.

Të ndjeshme dhe me një vlerë të çmuar edukuese janë rezultatet e viteve të fundit edhe në zhvillimin e letërsisë e të arteve. Lufta heroike e Partisë dhe e popullit kundër bllokadës imperialiste e revizioniste, revolucionarizimi i gjithanshëm

i jetës së vendit, kërkesat e Partisë për një kulturë militante me frymë revolucionare aktuale dhe kombëtare, si edhe kuptimi e qëndrimi më i drejtë ndaj botimeve e repertorëve nga letërsia dhe arti i huaj, i dhanë nxitje të fuqishme zhvillimit të letërsisë dhe artit tonë. Ata fituan pjekuri më të madhe ideopolitike dhe nivel më të lartë artistik. Si kurrë ndonjëherë është rritur krijimtaria artistike dhe janë zhvilluar me sukses të gjitha gjinitë e artit e të letërsisë, si proza ashtu edhe poezia, si muzika ashtu edhe artet figurative, teatri, kinematografia etj. Talenteve të njohura iu shtuan e po u shtohen çdo ditë talente të reja. Krahas ngritjes cilësore të krijimtarisë profesioniste, shpërtheu një hov i paparë i krijimtarisë popullore dhe i lëvizjes artistike amatore. Arti ynë socialist po ecën kështu i fuqishëm me të dyja këmbët. Duke ndjekur në mënyrë konsekuente parimet e realizmit socialist, në të ardhmen, letërsia dhe arti ynë revolucionar do të njohin me siguri zhvillime të reja, edhe më të mëdha.

Partia, në krye të masave, lufton me këmbëngulje për afirmimin e asaj që është socialiste dhe për heqjen e çdo pengese që frenon ecjen tonë përpara, ajo zbulon me guxim kontradiktat dhe lufton për kapërcimin e tyre, kritikon të metat dhe nuk e humbet kurrë perspektivën, kryen përditë atë proces të njohur të ndërtimit të së resë dhe të shkatërrimit të së vjetrës, transformon jetën e njerëzve, formon njeriun e ri. Këto qëllime duhet të kenë kurdoherë parasysh edhe letërsia e arti ynë, këtë vulë të mbajnë edhe ato. Pasqyrimi i realitetit të ri socialist në zhvillimin e tij revolucionar dhe me kontradiktat e kohës, që i japin letërsisë dhe artit dramaticitetin dhe konfliktet e nevojshme — këtu qëndron përmbajtja e re që i jep forcën letërsisë e artit tonë të realizmit socialist. Dhe një përmbajtje e tillë patjetër çon edhe në kërkime e në gjetje formash të reja. Të gjitha këto, si edhe mbështetja fort në truallin kombëtar, në krijimtarinë e trashëgiminë kulturore përparimtare të popullit tonë, i japin letërsisë dhe artit socialist atë origjinalitet dhe atë novatorizëm që e dallojnë nga të tjerët, jo vetëm si krijimtari e një populli dhe e një kombi të caktuar, por edhe për tiparet që fiton kjo krijimtari përmes kushteve të luftës kundër imperializmit e revizionizmit modern dhe për revolucionarizimin e gjithë jetës së vendit.

Pikërisht karakterin militant revolucionar të letërsisë dhe të artit mohojnë revizionistët. Pasi i shpallën «të ngushtë» ose i hodhën poshtë realizmin socialist si metodë krijuese dhe parimin e partishmërisë proletare, ata u hapën portën rrymave më të ndryshme reaksionare dhe dekadente, të cilat çuan në degjenerimin e letërsisë dhe të artit, duke i kthyer ato në mjete avanguardiste për restaurimin kapitalist. Kur arti mbart idetë dhe synimet e kundërrevolucionit, kur ai bëhet zëdhënës i elementëve ose i shtresave të burokratizuara e të borgjezuara, kur u kundërvihet aspiratave dhe luftës së masave, ai nuk mund të jetë kurrë art i vërtetë.

Lulëzimi i mëtejshëm i artit të realizmit socialist do të arrihet duke përforcuar pozitat e fituara në luftë me çdo ndikim të huaj, që nuk pajtohet me ideologjinë tonë socialiste, në luftë si me modernizmin, ashtu edhe me konservatorizmin, duke i pasqyruar akoma më thellë nga ana ideoartistike jetën dhe luftën e gjithanshme të popullit për ndërtimin e socializmit, duke vënë në qendër të krijimtarisë heronjtë e kohës sonë, duke forcuar partishmërinë proletare dhe karakterin popullor të artit tonë, në luftë me çdo ndikim të objektivizmit borgjez dhe të humanizmit abstrakt, duke e rritur pa ndërprerje rolin edukues të letërsisë dhe të arteve.

Të zgjerojmë punën shkencore, të ngremë nivelin e organizimit e të drejtimit të saj

Ka ardhur koha që t'u kushtojmë një kujdes shumë më të madh se gjer tani zgjerimit dhe zhvillimit të kërkimeve e të veprimtarisë shkencore, organizimit e drejtimit të tyre. Kjo nevojë diktohet si nga rëndësia e madhe e shkencës në epokën e tanishme, ashtu edhe nga kushtet objektive e detyrat e zhvillimit të vendit tonë në etapën që kalojmë. Shkenca është bërë sot një faktor shumë i rëndësishëm për zhvillimin e prodhimit dhe të gjithë sektorëve të tjerë të veprimtarisë shoqërore. Ajo është shndërruar në një forcë të drejtpërdrejtë prodhuese, nga rezultatet e së cilës varet në një masë shumë të madhe rritja e fuqisë ekonomike të vendit. Përparimet e shkencës së sotme janë kolosale dhe çdo neglizhencë në këtë fushë do të pasqyrohej negativisht në ritmin e përgjithshëm të ndërtimit të vendit. Zhvillimi gjithnjë e më intensiv i ekonomisë e i kulturës mund të thellohet më tej vetëm duke u mbështetur në shkencën e teknikën moderne, duke nxitur revolucionin tekniko-shkencor. Në stadin që ka arritur tani vendi ynë në asnjë fushë nuk mund të ecet përpara me shpejtësi pa studime të thella shkencore aktuale e perspektive, të cilat sqarojnë objektivat që duam të arrijmë dhe rrugët për realizimin e tyre. Kjo kërkesë për ngritjen e drejtimit të të gjitha punëve në një nivel gjithnjë e më të lartë shken-

cor mund të realizohet me sukses në qoftë se do të mbështetemi fuqimisht në shkencën dhe do të shfrytëzojmë intensivisht rezultatet e saj.

Detyrat e reja në fushën e shkencës ne i shtrojmë duke u mbështetur edhe në mundësitë e rezultatet tona. Baza materialo-teknike e ekonomisë po përsoset e modernizohet gjithnjë. Niveli arsimor e kulturor i masave po ngrihet pareshtur. Është krijuar tashmë sistemi i shkollave të larta, si dhe i disa instituteve të posaçme ku kryhet një punë e organizuar shkencore. Vitet e fundit është zhvilluar një lëvizje e gjerë për eksperimentimin shkencor masiv. Si rezultat i saj janë bashkuar përpjekjet e punonjësve shkencorë e të gjithë inteligjencies krijuese me ato të masave. Mbi këto baza janë zgjidhur mjaft probleme të rëndësishme dhe jetike për vendin, për ekonominë dhe kulturën. Detyra jonë është që këto suksese t'i përforcojmë dhe ta çojmë këtë punë përpara pa ndërprerje.

Për t'ia arritur këtij qëllimi është e domosdoshme të hidhen poshtë të gjitha ato koncepte vulgare e primitive që e nënvlerësojnë rolin e shkencës, të institucioneve e të punonjësve shkencorë, të cilat e kanë burimin në mungesën e përvojës së mjaftueshme në këtë fushë dhe në moskuptimin e thellë të rolit të madh që përgjithësisht luan sot shkenca. Në të njëjtën kohë ne duhet të thellojmë luftën që po zhvillohet kundër të gjitha koncepteve intelektualiste, të cilat synojnë ta mbyllin hermetikisht punën shkencore, t'i japin asaj një karakter akademik të shkëputur nga praktika prodhuese revolucionare e masave punonjëse, të nënvlerësojnë rolin e masave në zhvillimin e eksperimentimit shkencor dhe të shkencës në përgjithësi.

Duke u nisur nga koncepte të drejta, ne do të mund të kapërcejmë atë prapambetje relative që vihet re sot në fushën e studimeve e të kërkimeve shkencore në krahasim me synimet e objektivat e caktuar për zhvillimin e shpejtë dhe intensiv të ekonomisë e të kulturës socialiste. Në këtë mënyrë do të mund të njohim, të zotërojmë dhe të zbatojmë më mirë rezultatet e përparuara të shkencës e të teknikës botërore në prodhim e në kërkimet shkencore. Kështu do të shpejtohet ritmi i luftës për të kaluar nga konceptet dhe metodat e ngushta artizanale të organizimit e të drejtimit të prodhimit në koncepte e metoda moderne industriale.

Në periudhën e ardhshme është e domosdoshme t'u japim prioritet dhe t'u kushtojmë më shumë kujdes, mjete e forca atyre degëve të shkencës që janë më vendimtare për përparimin e gjithanshëm të vendit si sot ashtu edhe në perspektivë, që i paraprijnë këtij përparimi. Në këtë vështrim, në organizimin e përgjithshëm të punës shkencore vendin e parë duhet ta kenë shkencat e ndryshme teknike dhe bujqësore, që lidhen drejtpërsëdrejti

me zhvillimin intensiv të degëve kryesore të ekonomisë. Sidomos ngritja e një bujqësie moderne kërkon studime të organizuara e komplekse, jo vetëm nga specialistët e bujqësisë, por edhe nga punonjësit e shkencave biologjike, kimike, fizike, mekanike etj.

Në të njëjtën kohë do të ecin përpara edhe kërkimet në lëmin e shkencave ekonomike e shoqërore. Një vëmendje të posaçme kërkojnë studimet mbi përsosjen e marrëdhënieve socialiste në prodhim, si edhe mbi problemet e tjera të zhvillimit të ekonomisë. Vitet e fundit janë masivizuar mjaft studimet për rrugët e zhvillimit të revolucionit tonë e përvojën e tij në fusha të ndryshme, si edhe për probleme të shumta sociologjike, të cilat e kanë gjallëruar e pasuruar mendimin tonë teorik marksist-leninist dhe kanë krijuar premisa për një organizim më të shëndoshë të të gjithë kësaj veprimtarie. Krahas kësaj, në shkencat që merren me studimin e historisë së popullit tonë, të kulturës së tij materiale e shpirtërore, traditat tashmë të krijuara janë konsoliduar dhe janë hapur horizonte të reja për intensifikimin e këtyre studimeve dhe thellimin e tyre në problemet më themelore të së kaluarës dhe në problemet më të mprehta të aktualitetit.

Këto detyra që na shtrohen në lëmin e shkencës kërkojnë një përmirësim rrënjësor të organizimit e të drejtimit të tërë punës shkencore në të gjitha nivelet e në të gjitha fushat, që nga planifikimi i zhvillimit e gjer te zbatimi i organizuar i rezultateve dhe i rekomandimeve të saj në praktikë. Duke punuar për forcimin e qendrave studimore të bazës, të byrove teknike, teknologjike e projektuese, të parcelave eksperimentale, të laboratorëve të ndryshëm, të rretheve e të komisioneve shkencore, si mjete të rëndësishme të masivizimit të mëtejshëm të punës shkencore, në të njëjtën kohë, shkallë-shkallë duhet të ecim më shpejt në rritjen dhe fuqizimin e institucioneve të posaçme shkencore ekzistuese, si dhe në krijimin e institucioneve të reja të nevojshme, duke marrë njëkohësisht masa për një organizim dhe drejtim më të koordinuar e të përqendruar të gjithë punës e të jetës shkencore në shkallë republike, në përshtatje me mundësitë e sotme dhe detyrat perspektive.

Një zhvillim i tillë i shkencës kuptohet se kërkon edhe zgjerimin gradual të bazës së nevojshme materiale për këtë punë. Akoma më i ngutshëm është problemi i përgatitjes dhe i specializimit të kuadrit. Ky specializim duhet të jetë i gjithanshëm dhe i shumëllojshëm. Ai pjesërisht duhet të fillojë që në shkollën e lartë, të thellohet në punë, të realizohet nëpërmjet studimeve pasuniversitare, nëpërmjet zgjidhjes së detyrave të ndryshme shkencore dhe, kur është e domosdoshme, të bëhet edhe jashtë vendit. Zvarritjet dhe neglizhencat në zgjidhjen e këtij problemi sjellin pasoja negative në të ardhmen.

Organet e Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë duhet të për-

krahin e të mbështetin më aktivisht mendimin shkencor të specialistëve e të punonjësve tanë, të vlerësojnë çdo përvojë pozitive dhe të inkurajojnë çdo propozim të vlefshëm, duke i hapur rrugë me guxim së resë, duke hequr dorë nga rutina dhe mënyra e vjetër e punës, duke u çelur shtigje energjive të vrullshme krijuese dhe shpirtit novator të njerëzve tanë.

V

TË FORCOJMË E TË REVOLUCIONARIZOJMË PA RESHTUR PARTINË

E ndërgjegjshme për misionin e vet historik si udhëheqëse e luftës së gjithë popullit për socializëm, në Kongresin e 5-të Partia shtroi detyra të rëndësishme për revolucionarizimin e mëtejshëm të jetës e të veprimtarisë së saj. Për këtë qëllim Komiteti Qendror ka marrë një sërë masash konkrete për edukimin dhe kalitjen politike e ideologjike të komunistëve e të kuadrove, për kuptimin e drejtë dhe zbatimin revolucionar të parimeve e të normave të Partisë, për forcimin e karakterit proletar të radhëve të saj e të organeve udhëheqëse, për thellimin e mëtejshëm të vijës së masave në veprimtarinë e Partisë.

Partia vjen në këtë Kongres më e fortë se kurrë, me një unitet të çeliktë marksist-leninist të radhëve të saj, e lidhur ngushtë si mishi me kockën me klasën punëtore dhe me masat punonjëse, e gatshme për të marrë përsipër detyra edhe më të mëdha dhe e vendosur për t'i realizuar ato me nder si gjithnjë.

Pa një parti revolucionare të klasës punëtore, besnike të marksizëm-leninizmit, të organizuar dhe në gjendje të udhëheqë e të mobilizojë masat punonjëse, nuk mund të mendohet as për fitoren e proletariatit mbi borgjezinë, as për ndërtimin me sukses të socializmit. Pikërisht sepse e kemi mbajtur gjithnjë parasysh këtë parim dhe i kemi qëndruar kurdoherë besnikë, te ne nuk ndodhi ai proces regresiv që ndodhi në Bashkimin Sovjetik e në disa vende të tjera, ku lindja e revizionizmit dhe rivendosja e kapitalizmit filloi me degjenerimin e partisë, me ndryshimin e karakterit klasor, me humbjen e cilësive dhe të frymës së saj revolucionare. Pikërisht sepse ndoqëm me konsekuencë mësimet leniniste mbi partinë dhe luftuam vazhdimisht për kalitjen dhe revolucionarizimin e saj të pandërprerë, te ne diktatura e proletariatit qëndron e çeliktë dhe e pamposhtur, socializmi marshon përpara gjithnjë fitimtar.

Partia e Punës e Shqipërisë është një parti e fortë dhe e organizuar, e sprovuar në beteja, një parti e pastër ideologjikisht e politikisht, e vendosur dhe e aftë për të çuar përpara me sukses kauzën e klasës punëtore. Ne jemi krenarë për Partinë tonë heroike, për luftën e fitoret e saj, për guximin, qartësinë e vitalitetin e saj. Por nuk duhet të harrojmë kurrë se lufta e klasave vazhdon si brenda ashtu edhe jashtë vendit, se ekziston presioni i ideologjisë borgjeze e revizioniste. Ne duhet t'i kushtojmë gjithë kujdesin, përpjekjet dhe aftësitë tona punës për forcimin e vazhdueshëm të Partisë, për edukimin e saj revolucionar, për rritjen e rolit të saj udhëheqës në të gjithë jetën e vendit.

Kjo bëhet akoma më e domosdoshme po të kemi parasysh detyrat madhështore, shumë të rëndësishme që shtron ky Kongres përpara Partisë e gjithë popullit. Realizimi me sukses i këtyre detyrave, zhvillimi i hovshëm i gjithë ekonomisë, transformimet në gjithë jetën e vendit, kërkojnë angazhimin total të energjive mendore e fizike të të gjithë komunistëve e kuadrove, kërkojnë ngritjen e gjithë punës së Partisë në një nivel më të lartë.

Roli udhëheqës i Partisë sigurohet nëpërmjet veprimtarisë së gjithë komunistëve dhe shembullit të tyre pararojë

Partia jonë i përmbahet parimit marksist-leninist se me zhvillimin e konsolidimin e socializmit roli udhëheqës i Partisë jo vetëm nuk vjen duke u dobësuar, por përkundrazi forcohet e përsoset gjithnjë e më shumë. Kjo diktohet nga fakti se procesi i ndërtimit socialist zgjerohet e bëhet gjithnjë e më kompleks. Në këtë proces roli udhëheqës i klasës punëtore rritet vazhdimisht. Nga ana tjetër, pjesëmarrja e masave në ndërtimin socialist të vendit, në gjithë jetën shoqërore, ekonomike e shtetërore bëhet gjithnjë e më aktive. Të gjitha këto bëjnë të domosdoshme ngritjen në një shkallë më të lartë të rolit drejtues, edukues, organizues e mobilizues të Partisë, e cila me ideologjinë e vet qartëson objektivat dhe ndriçon rrugën për arritjen e tyre.

Në vendin tonë roli udhëheqës i Partisë në të gjithë jetën e vendit ka qenë dhe është i padiskutueshëm. Të gjitha fitoret historike që ka arritur populli ynë në këta 30 vjet, çlirimi i atdheut, vendosja e pushtetit popullor, ndërtimi i shoqërisë së re socialiste janë të lidhura në mënyrë të pandarë me Partinë dhe udhëheqjen e saj të urtë e largpamëse.

Forcimi dhe përsosja e rolit udhëheqës të Partisë është një detyrë e përhershme dhe jetike. Kuptimi i thellë dhe sidomos zbatimi i tij i drejtë në praktikë kanë rëndësi të veçantë.

Roli udhëheqës i Partisë, si forca drejtuese e gjithë jetës së vendit, shtrihet në të gjitha fushat — ideologjike, politike, organizative, ekonomike, arsimore, ushtarake etj. Këta sektorë të jetës së vendit, që përbëjnë të gjithë së bashku një të tërë, Partia i drejton nëpërmjet gjithë anëtarëve të saj, kudo ku punojnë, qoftë në aparatet e Partisë ose të pushtetit, në organizatat e masave, në prodhim ose në institucionet shkencore-kulturore.

Puna e komunistëve të çdo sektori ka specifikën e vet, por ajo ka edhe një gjë të përbashkët, çdo komunist atje ku punon duhet të luftojë për zbatimin e vijës së Partisë dhe sigurimin e rolit udhëheqës të saj. Mjaft nga të metat e dobësitë që vihen re në punën tonë i kanë rrënjët në ngatërrimin e asaj çka është specifike dhe çka është e përbashkët.

Komunistët që punojnë në organet e Partisë duhet t'i njohin problemet ekonomike, të bujqësisë e të industrisë, problemet e arsimit, të kulturës e të ushtrisë pavarësisht se me ato merren drejtpërdrejt shokët që punojnë në aparatet përkatëse shtetërore. Të gjitha problemet, natyrisht jo në hollësi, duhet t'i dinë shokët e organeve drejtuese të Partisë, sepse pa këtë ata nuk mund të orientojnë drejt organet shtetërore dhe ekonomike për kryerjen e detyrave dhe organizatat e Partisë për mobilizimin e masave.

Kur themi që organet dhe aparatet e Partisë duhet t'i njohin të gjitha problemet e jetës së vendit e të merren me to, këtë duhet ta bëjnë, duke i parë këto në specifikën e punës së Partisë, pa u futur në vogëlima teknike e materiale të çështjeve të ditës dhe pa dubluar punën e organeve shtetërore dhe ekonomike. Themelore në punën e tyre është edukimi e mobilizimi i komunistëve dhe i masave që punojnë në sektorë të ndryshëm për të realizuar gjer në fund detyrat e ngarkuara, është vënia në pozita luftarake e organizatave të Partisë dhe nëpërmjet tyre e të gjithë organizmave të tjerë shtetërorë, ekonomikë e shoqërorë për zbatimin kudo e me konsekuencë të politikës së Partisë.

Komunistët e kuadrot e ngarkuar nga Partia të punojnë në organet shtetërore dhe ekonomike, edhe pse mund të jenë teknikë e specialistë, në radhë të parë janë njerëz politikë. Duke u marrë me drejtimin shtetëror të çështjeve, me organizimin e prodhimit, me sigurimin e masave tekniko-ekonomike për realizimin e planit, që përbën për ta detyrën kryesore, nuk i shohin dhe nuk duhet t'i shohin këto me syrin e teknokratit. Si komunistë, që përgjigjen përpara Partisë për zbatimin e vijës së saj në sektorin e tyre, ata duhet të punojnë pa u lodhur për kuptimin politik e ideologjik të detyrave nga punonjësit, për organizimin e mobilizimin e plotë të tyre.

Kështu realizohet në praktikë roli udhëheqës i Partisë në

të gjithë jetën e vendit, kështu Partia drejton në bllok, në mënyrë të organizuar e të centralizuar.

Roli udhëheqës i Partisë nuk arrihet as me dekrete, as imponohet me masa administrative. Ai fitohet me vijën e saj të drejtë që shpreh e mbron interesat jetike të klasës punëtore e të gjithë punonjësve dhe me luftën e saj të vendosur për zbatimin e kësaj vije në jetë. Ky rol sigurohet nëpërmjet veprimtarisë revolucionare të çdo komunisti, i cili me shembullin e aksionin e tij i frymëzon, i edukon dhe i mobilizon masat në luftën për socializëm. Partia përbëhet nga anëtarët e saj dhe roli pararojë i Partisë nuk mund të kuptohet e të realizohet pa rolin pararojë të çdo komunisti.

Por a janë të gjithë komunistët në pozitat pararojë të Partisë? Këtë pyetje duhet t'ia bëjë gjithnjë vetes çdo anëtar i Partisë, kjo çështje duhet të shqetësojë çdo organizatë partie. Është fakt se në radhët tona gjenden edhe të tillë anëtarë partie — megjithëse të paktë — që janë të mefshtë e pa iniciativë, që kanë koncepte të prapambetura në punë e në jetë, që jo vetëm nuk janë shembull e në pararojë, por shpesh qëndrojnë në bisht të masave, ashtu siç ka edhe të tillë që zhvillimi i vrullshëm i jetës sonë i ka lënë prapa.

Njerëz të tillë stonojnë midis masës dërrmuese të anëtarëve të Partisë sonë të lavdishme, të cilët kanë mbajtur e mbajnë mbi supe barrë të rënda, kanë kryer e kryejnë vepra të mëdha, kanë luftuar e luftojnë me heroizëm e vetëmohim për përparimin e gjithanshëm të atdheut socialist, kanë qëndruar e qëndrojnë me meritë në ballë të masave dhe kanë pasur e kanë respektin e besimin e pakufishëm të tyre.

Partia duhet të punojë, që edhe komunistët që kanë mbetur prapa t'i edukojë, t'i vërë në pozita luftarake, që të ecin me hapin e kohës e të revolucionit, që të mund ta meritojnë e ta mbajnë titullin e anëtarit të Partisë sonë heroike.

Në vendin tonë tërë atmosfera është e tillë që i shtyn njerëzit përpara. Te ne çdo gjë është në lëvizje, në zhvillim. Jeta jonë është e gjallë, dinamike, që nuk duron qetësinë e rutinën, të cilat i bëjnë njerëzit të ngecin në vend. Një nga detyrat më të rëndësishme të organizatave të Partisë është të gjejnë rrugët, metodat dhe atë stil revolucionar pune, që tërë komunistët t'i vënë në pozita pararojë, t'i hedhin në luftë, në aksione, që me shembullin e tyre të tërheqin pas vetes të gjitha masat punonjëse.

Hallka themelore e vendimtare, që siguron rolin udhëheqës të Partisë në çdo qelizë të jetës sonë, është organizata-bazë. Nëpërmjet saj zbërthehen e zbatohen në jetë të gjitha udhëzimet e direktivat e Partisë, sigurohen lidhjet e drejtpërdrejta të Partisë me masat dhe kryhet mobilizimi tyre për arritjen e objekti-

vave të caktuar, ushtrohet kontrolli mbi veprimtarinë e çdo komunisti, pavarësisht nga vendi ku punon e posti që mban.

Që të luajnë rolin e tyre udhëheqës, frymëzues e organizues në sektorët ku veprojnë, organizatat-bazë të Partisë duhet të thellohen në problemet kryesore e të mos mbyten në gjërat e vogla të ditës, të nxitin e të vënë në lëvizje të gjitha organizatat e të mos shndërrohen në leva të organeve ekonomike e shtetërore, të mos interesohen vetëm për shifrat e planit, por në radhë të parë për zbatimin e politikës së Partisë në çdo fushë. Ato duhet të luftojnë burokratizmin, indiferentizmin e çdo shfaqje të huaj dhe të forcojnë sidomos punën e tyre me njerëzit, sepse janë këta që vënë në jetë direktivat e Partisë dhe planet e shtetit.

Përbërja proletare dhe cilësia e komunistëve — kusht themelor që Partia të mbetet gjithnjë revolucionare

Partia, si një organizëm i gjallë politik, rritet e forcohet në luftë e revolucion, pasqyron në gjirin e saj ndryshimet që bëhen në sferën ekonomiko-shoqërore, në strukturën klasore dhe në jetën shpirtërore të shoqërisë.

Ky është një proces i pandërprerë, por jo spontan. Ai organizohet e drejtohet në mënyrë të ndërgjegjshme nga vetë partia në përshtatje me etapat e revolucionit dhe me detyrat që ka për të zgjidhur, duke u mbështetur kurdoherë në mësimet e marksizëm-leninizmit.

Gjatë këtyre pesë vjetëve të fundit, në saje të punës së madhe e të gjithanshme politike, ideologjike e organizative për revolucionarizimin e mëtejshëm të të gjithë jetës së vendit dhe të vetes së saj, në Parti janë bërë ndryshime të rëndësishme sasiore e cilësore.

Për këtë flet qartë rritja e ndieshme e efektivit të Partisë dhe sidomos përmirësimi i përbërjes klasore të radhëve të saj. Më 1 tetor 1971 në Parti militonin 86 985 komunistë, prej të cilëve 18 127 kandidatë, nga 66 327 komunistë që ishin në kohën e Kongresit të 5-të të Partisë. Kështu gjatë kësaj periudhe Partia është rritur me 20 658 komunistë.

Është një gëzim e fitore e madhe për Partinë dhe gjithë popullin që tani, për herë të parë në historinë e Partisë sonë, komunistët punëtorë zënë vendin e parë në efektivin e Partisë. Ata përbëjnë sot 36,41 për qind të të gjithë komunistëve.

Ky fakt dëshmon për dashurinë e madhe të klasës punëtore për Partinë e saj marksiste-leniniste dhe për besimin e pakufishëm ndaj saj. Ai dëshmon për vijën e drejtë organizative, të

ndjekur me këmbëngulje e konsekuencë nga Partia, e cila i është përmbajtur me vendosmëri parimit se Partia e klasës punëtore duhet të jetë proletare jo vetëm nga ideologjia, por edhe nga përbërja klasore e radhëve të saj.

Klasa punëtore ka dërguar në Partinë e saj bijtë e vet më të mirë, ata që janë dalluar e kalitur në aksionet e betejat revolucionare. Ky gjak i ri ka sjellë në Parti vendosmërinë, vullnetin e hekurt, urtësinë, disiplinën dhe hovin revolucionar të klasës punëtore.

Me qëllim që të ruhet e të forcohet vazhdimisht karakteri i saj klasor e proletar, Partia i ka kushtuar kujdes të posaçëm sidomos përmirësimit të përbërjes së organeve udhëheqëse me punëtorë. Sot 55 për qind e anëtarëve të plenumeve të komiteteve të Partisë në rrethe, 85,2 për qind e anëtarëve të byrove të organizatave-bazë në ndërmarrjet ekonomike dhe 86,3 për qind e sekretarëve të tyre janë me gjendje, origjinë ose që vetë kanë qenë më parë punëtorë. Shumë pozitiv e kuptimplotë është fakti që sot në organet udhëheqëse të Partisë bëjnë pjesë shumë punëtorë, të cilët edhe pasi janë zgjedhur në këto organe, vazhdojnë të punojnë si punëtorë në prodhim. Kjo ka një rëndësi të madhe parimore. E keqja që ndodhi në shumë parti komuniste që degjeneruan në revizioniste erdhi edhe nga fakti se, ndërsa në radhët e anëtarëve të tyre kishte mjaft punëtorë, organet udhëheqëse u deproletarizuan, u mbushën me specialistë teknokratë, intelektualë e nëpunës burokratë.

Duke u hapur rrugën punëtorëve për të hyrë në Parti, për të marrë pjesë aktive në organet udhëheqëse të saj, Partia jonë ka hedhur rrënjë të thella në gjirin e klasës më revolucionare dhe më të përparuar të shoqërisë, së cilës i takon misioni historik për të qenë në pararojë të luftës për socializëm e komunizëm.

Edhe në të ardhmen ne duhet të luftojmë për rritjen e radhëve të Partisë me punëtorë, të cilët duhet të kenë prioritet mbi gjithë ata që vijnë nga klasat dhe shtresat e tjera. Për këtë tani ekzistojnë mundësitë reale, pasi klasa punëtore rritet e zhvillohet me shpejtësi krahas me zhvillimin e ekonomisë e veçanërisht të industrisë. Kujdes të veçantë duhet të tregojnë disa rrethe, ku, megjithëse ka një klasë punëtore relativisht të zhvilluar, numri i punëtorëve në Parti është nën mesataren si republikë. Një e metë tjetër është se nuk ka një raport të drejtë midis numrit të komunistëve që punojnë në repartet kryesore e në makineri dhe atyre që punojnë në repartet ndihmëse.

Pranimet e punëtorëve të rinj në Parti duhet të bëhen sidomos në degët më të rëndësishme të ekonomisë, në industrinë minerale, nxjerrëse e përpunuese, në atë metalurgjike, mekanike e kimike, në objektet e mëdha dhe në degët e reja të industrisë,

kudo ku ndihet më tepër nevoja, si për gjendjen e sotme, ashtu edhe për perspektivën.

Krahas pranimit të më shumë punëtorëve në Parti, Komiteti Qendror u ka kushtuar një vëmendje të veçantë pranimit dhe shtrirjes së Partisë në gjithë sektorët e ekonomisë e të kulturës. Pranimet e reja dhe shtrirja e Partisë është bërë në bazë të nevojave, lidhur ngushtë me madhësinë e territorit, rëndësinë e problemeve ideopolitike e ekonomike që duhen zgjidhur, me çështjet që kërkojnë të drejtohen e të organizohen nga Partia.

Rritja e Partisë në kooperativat bujqësore, nga Kongresi i 5-të e këtej, ka shkuar normalisht në përputhje me detyrat që shtron ndërtimi i socializmit në fshat. Komunistët kooperativistë zënë 29,70 për qind të efektivit të Partisë. Sot nuk kemi asnjë fshat pa komunistë dhe në gjithë sektorët e kooperativave bujqësore kemi organizata-bazë partie. Por akoma kemi brigada pa grupe partie, bile ka edhe të tilla ku nuk kemi asnjë komunist.

Detyrat e mëdha që shtrohen para bujqësisë për shtimin e prodhimit dhe modernizimin e saj, roli i madh që ajo luan në gjithë ekonominë tonë, si edhe fakti që në fshat jeton pjesa më e madhe e popullsisë, kërkojnë që të pranohen në Parti më shumë kooperativistë, me qëllim që të forcohet më tej Partia në fshat dhe të përmirësohet drejtimi i saj në kooperativat bujqësore, duke iu afruar sa më shumë njësisë bazë të prodhimit, brigadës.

Në mënyrë të suksesshme është pasqyruar në përbërjen e Partisë lufta e madhe revolucionare që është zhvilluar, sidomos këto vitet e fundit, për emancipimin e plotë të gruas, për çlirimin e energjive të saj të pashtershme krijuese. Të entuziazmon shumë fakti që gratë zënë sot 22,05 për qind të të gjithë efektivit të Partisë nga 12,47 për qind që zinin në Kongresin e mëparshëm.

Gratë përbëjnë një forcë kolosale dhe luajnë një rol me shumë rëndësi në zhvillimin e gjithanshëm të vendit. Ato kanë kryer tani me shumicë shkollat 8-vjeçare, janë edukuar në frymën e Partisë e janë kalitur në kudhrën e aksioneve dhe lëvizjeve të ndryshme revolucionare. Sot në vendin tonë po krijohet një opinion i drejtë e i shëndoshë për pozitën dhe rolin e gruas në shoqëri. Të gjitha këto krijojnë mundësitë dhe diktojnë nevojën që edhe në të ardhmen të ecim me guxim përpara për pranimin me ritëm të shpejtë të grave në Parti.

Për Partinë tonë, siç e vërteton gjithë historia e saj, rëndësi vendimtare ka pasur e ka cilësia e anëtarëve, vetitë e tyre politike e morale, formimi ideologjik dhe kalitja revolucionare, vendosmëria për ta mbrojtur e për ta zbatuar vijën e Partisë kurdoherë e në çdo rrethanë. Numri i madh nuk flet gjithnjë

për forcën e Partisë. Por kur ky numër shoqërohet dhe me cilësi të lartë, kur në Parti hyjnë gjithnjë e më shumë elementë të ndërgjegjshëm, të gatshëm për zbatimin e të gjitha detyrave që shtron Partia, që vënë kurdoherë e mbi çdo gjë interesin e përgjithshëm, atëherë ai kthehet në një forcë kolosale. Njerëz të tillë e bëjnë Partinë të pamposhtur, e mbajnë atë gjithnjë revolucionare, pararojë e forcë udhëheqëse të të gjithë shoqërisë.

Kërkesat që shtron Partia ndaj komunistëve vijnë gjithnjë duke u rritur krahas zhvillimit të socializmit dhe daljes në rendin e ditës të problemeve e detyrave të reja, më të vështira e më të ndërlikuara. Çdo etapë e revolucionit kërkon cilësi e virtyte të reja nga të gjithë punonjësit, të cilat duhet të mishërohen në radhë të parë te komunistët. Krahas besnikërisë politike dhe devotshmërisë për çështjen e Partisë, krahas punës së palodhur për të mirën e popullit, krahas bindjeve internacionaliste dhe urrejtjes për armiqtë, nga komunistët sot kërkohet më tepër se kurrë të jenë njerëz të përparuar, me koncepte të reja për punën, jetën, familjen, shoqërinë, njerëz që dashurojnë dijen e kulturën, që thellohen në profesionin e tyre dhe përkrahin me të gjitha forcat progresin tekniko-shkencor, që nuk durojnë rutinën e injorancën, që luftojnë me guxim çdo gjë që bëhet pengesë e frenon marshimin e vrullshëm të shoqërisë socialiste.

Përbërja e shëndoshë dhe cilësitë e mira të atyre që pranohen në Parti nuk janë gjithçka. Që Partia të jetë e fortë, revolucionare, e aftë të luajë rolin e saj pararojë është e domosdoshme që gjithë anëtarët e saj të edukohen vazhdimisht me ideologjinë marksiste-leniniste dhe politikën e mësimet e Partisë, të kaliten pandërprerë në zjarrin e luftës e të punës revolucionare. Kjo është një domosdoshmëri jetike që komunistët kurrë të mos sklerozohen, të mos burokratizohen dhe të mos degjenerojnë, ashtu siç ndodhi në Bashkimin Sovjetik e gjetkë, por të mbeten kurdoherë luftëtarë të vendosur e konsekuentë për çështjen e komunizmit.

Për këtë edukim e kalitje kanë nevojë të gjithë, jo vetëm komunistët e rinj, por edhe ata me stazh të vjetër në Parti, jo vetëm njerëzit e prodhimit, por edhe të punës mendore, jo vetëm ata që kanë një nivel relativisht të ulët ideopolitik e arsimor, por edhe ata që kanë mbaruar shkolla. Komunistët, ndonëse janë pjesa më e zgjedhur, më revolucionare dhe më përparimtare e shoqërisë, nuk janë të zhveshur nga mbeturinat e ideologjive të huaja, ashtu siç nuk janë të garantuar nga rreziku i infektimit borgjez e revizionist.

Puna edukuese e Partisë duhet të synojë jo vetëm t'i armatosë komunistët me ligjet e zhvillimit të shoqërisë, t'i pajisë me botëkuptimin marksist-leninist, por dhe t'u kalitë atyre ndër-

gjegjen, të mbajë kurdoherë lart frymën revolucionare, figurën morale të anëtarit të Partisë, me qëllim që mendimi e veprimi të përbëjnë një unitet të pandarë, që komunistët të mendojnë, të jetojnë e të veprojnë kudo e kurdoherë si revolucionarë. Ajo duhet t'i bëjë ata të zotë që të orientohen shpejt dhe drejt në çdo situatë, të kuptojnë mirë realitetin, në të cilin veprojnë, të njohin thellë problemet që lindin nga zhvillimi i brendshëm i vendit tonë ose nga situatat ndërkombëtare dhe t'u përgjigjen si duhet detyrave që qëndrojnë para tyre dhe masave të popullit.

Nga Kongresi i 5-të e këtej puna për edukimin e komunistëve është gjallëruar, është lidhur më ngushtë me problemet e detyrat që ka pasur vendi e Partia. Janë përdorur forma më të larmishme e më të zhdërvjellta, është zhvilluar më tej iniciativa e komiteteve dhe e organizatave-bazë, të cilat e kanë marrë më mirë në dorë këtë punë. Edukimi teorik është shoqëruar në mënyrë më organike me hedhjen e komunistëve në aksione e lëvizje revolucionare.

Edukimi i komunistëve nuk ka qenë dhe nuk është një qëllim dhe një çështje në vetvete. Këtë edukim Partia nuk e ka parë dhe nuk e sheh të shkëputur nga ai i masave, si edukim të një elite, por si edukim të pararojës, për ta bërë këtë të aftë që të edukojë masat. Çdo shkëputje e edukimit të Partisë nga ai i masave, siç e tregon eksperienca e hidhur e Bashkimit Sovjetik, çon në kultivimin e koncepteve intelektualiste në Parti dhe në indiferentizëm ndaj çështjeve politike e ideologjike në punonjësit, çon në fund të fundit në dobësimin dhe minimin e lidhjeve të Partisë me popullin.

Në Parti bëhet një punë e madhe për studimin e teorisë marksiste-leniniste dhe të dokumenteve të Partisë sonë. Kjo punë duhet të vazhdojë e të përsoset, me qëllim që ajo t'i ndihmojë komunistët jo vetëm t'i kuptojnë drejt, por edhe t'i zbatojnë si duhet në jetë direktivat e Partisë e ligjet e shtetit, normat e shoqërisë sonë socialiste. Dijet marksiste nuk duhet të mbeten si një zbukurim intelektual, por nga to të udhëhiqen komunistët në çdo hap të jetës së tyre. Këtë punë ne mund ta bëjmë edhe më mirë, sepse tani mundësitë janë më të mëdha, Partia ka fituar një përvojë të pasur dhe ka përgatitur një armatë të madhe kuadrosh që janë në gjendje të zhvillojnë një punë të kualifikuar për edukimin e komunistëve e të punonjësve.

Një kujdes të veçantë Partia duhet të tregojë për edukimin e kandidatëve, të cilët tani përbëjnë një të pestën e efektivit të Partisë. Këta janë komunistë të rinj, energjikë e të vullnetshëm, njerëz të dalluar që kanë dalë nga valët e luftës për revolucionarizimin e jetës së vendit, sidomos të reja e gra, që kanë nevojë të edukohen e të formohen si militantë, të fitojnë dije marksiste dhe cilësitë e anëtarit të Partisë sonë heroike.

Ndryshime të ndjeshme janë bërë edhe në rritjen e nivelit arsimor e kulturor të Partisë. Tani rreth 70 për qind e komunistëve janë me shkollë 8-vjeçare, të mesme e të lartë. Ky është një tregues shumë i mirë, që dëshmon për përpjekjet këmbëngulëse të komunistëve për të fituar kulturë dhe për t'u aftësuar gjithnjë e më shumë. Por këto përpjekje duhet të jenë të vazhdueshme, sepse dijet nuk kanë fund. Me gjithë sukseset, të tërheq vëmendjen fakti që rreth 30 për qind e komunistëve kanë vetëm arsimin fillor ose 8-vjeçar të pambaruar. Këtu përfshihet një numër i madh komunistësh me moshë të kaluar dhe të zonave të thella malore, ku shkollat 8-vjeçare janë shtrirë vetëm vitet e fundit. Duke nxitur këta komunistë që të ngrenë nivelin e tyre kulturor, tani që arsimi 8-vjeçar është bërë kudo i detyrueshëm, është e mundshme që në të ardhmen, si rregull, të pranohen në Parti njerëz që të paktën të kenë arsimin 8-vjeçar.

Të gjallërojmë jetën e brendshme dhe të rritim iniciativën e vetëveprimin e organizatave të Partisë

Rritja e rolit udhëheqës dhe revolucionarizimi i pandërprerë i Partisë nuk mund të kuptohen e të arrihen pa gjallërimin e jetës së brendshme të organizatave të Partisë, pa iniciativën e pjesëmarrjen aktive të të gjithë komunistëve në luftën për përpunimin dhe zbatimin e vijës së saj.

Partia e Punës e Shqipërisë lindi, u rrit dhe u zhvillua në valën e veprimit revolucionar të klasës punëtore dhe të masave. Në luftën e ashpër klasore me armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm, në aksionet e guximshme dhe në lëvizjet e thella revolucionare që transformojnë botën materiale e shpirtërore të njerëzve, është revolucionarizuar vazhdimisht çdo komunist e organizatë-bazë, çdo organ udhëheqës partie.

Gjatë periudhës për të cilën raportojmë iniciativa dhe vetëveprimi, shpirti novator dhe vrulli revolucionar për të çarë përpara morën një zhvillim të gjerë dhe përmbajtje të re në të gjithë sektorët, në ekonomi e kulturë, në shkencë e teknikë. Këto sollën një stil të ri më të zhdërvjellët, forma pune më origjinale në përshtatje me detyrat e kohës. Sot jetën e organizatave të Partisë dhe të komunistëve e përshkon një frymë e lartë luftarake, mobilizimi e përgjegjësie.

Këtë frymë revolucionare duhet ta mbajmë gjallë e ta forcojmë vazhdimisht, me qëllim që organizatat e Partisë t'i bëjmë gjithnjë e më mirë organizma vetëveprues, që me iniciativë e përgjegjësi të plotë të zbërthejnë, të zbatojnë e të kontrollojnë

direktivat e vendimet e Partisë, të kapin me shkathtësi problemet e reja që nxjerr jeta dhe t'u japin rrugë atyre.

Iniciativa dhe vetëveprimi janë koncepte revolucionare të të menduarit e të të vepruarit. Ato nuk lindin vetiu dhe as jepen të gatshme nga të tjerët, por vijnë si rezultat i njohjes së thellë dhe i depërtimit në thelbin ideopolitik të direktivave të Partisë, i studimit e i vlerësimit të drejtë të realitetit, të opinionit dhe të përvojës së masave, i guximit për të marrë përgjegjësi të plotë për veprimin që kryen.

Për zhvillimin e iniciativës e të vetëveprimit të organizatave të Partisë është e nevojshme të luftojmë me vendosmëri kundër rutinës dhe formave të vjetruara të punës, kundër metodave administrative dhe tutelës burokratike, që, me gjithë përmirësimet e bëra, vihen re akoma në punën e Partisë. Këtu ka kuadro dhe organe drejtuese të Partisë që në mjaft raste janë të prirur të ndërhyjnë e të vendosin për gjithçka ose që, nën pretekstin për të mbajtur lidhje ose për të «mbuluar» të gjitha organizatat-bazë, vendosin një tutelë të palejueshme me anë të instruktorëve, duke harruar se kështu u kufizojnë iniciativën organizatave e komunistëve dhe i bëjnë që të presin çdo gjë nga lart. Kjo është një nga shfaqjet e burokratizmit në Parti. Iniciativa e vetëveprimi kufizohen edhe atëherë kur organet drejtuese i ngarkojnë organizatat-bazë me orientime, udhëzime e vendime të shumta, të cilat shpesh janë të gjata, të ndërlikuara e të përgjithshme. Kjo bën që organizatat-bazë të mos jenë në gjendje t'i kuptojnë, t'i zbërthejnë e t'i zbatojnë ato, por të kërkojnë vazhdimisht sqarime e interpretime nga instancat eprore. Këtu kemi të bëjmë me një shfaqje tjetër të burokratizmit e të intelektualizmit.

Të gjitha format e punës e të organizimit duhet t'i shërbejnë vënies në lëvizje të organizatave-bazë e të komunistëve, nxitjes së iniciativës së tyre, forcimit të përgjegjësisë individuale e kolektive. Këtë duhet ta kuptojnë mirë sidomos kuadrot e organet udhëheqëse të Partisë. Por për këtë është e domosdoshme të luftojnë vetë organizatat-bazë. Këto duhet të jenë më të shkathëta e më të guximshme, të mos presin zgjidhje të gatshme nga lart për problemet që i preokupojnë, të mos veprojnë në mënyrë mekanike pa pasur parasysh karakterin e direktivës dhe kushtet e ndërmarrjes, të kooperativës ose të institucionit ku veprojnë. Mendimi dhe iniciativa krijuese nuk janë për zhurmë, ato duhet të shpërthejnë lidhur ngushtë me detyrat aktuale e konkrete dhe t'i shërbejnë zgjidhjes së tyre.

Iniciativa dhe vetëveprimi nuk kanë të bëjnë vetëm me organizatën si forum, por në shembullin e saj, në këtë frymë, duhet të veprojë përditë dhe për çdo gjë, secili anëtar ose kandidat i saj. Pa komunistë revolucionarë nuk mund të ketë organizata partie

revolucionare. Në këtë kuptim për çdo komunist shfaqja e iniciativës nuk kufizohet me pjesëmarrjen aktive gjatë shqyrtimit të problemeve brenda në organizatë. Organizata-bazë s'është vetëm mbledhja e saj, por tërësia e veprimtarisë së komunistëve veç e veç e së toku, para, gjatë dhe mbas mbledhjes, për të përpunuar e zbatuar vijën dhe vendimet e Partisë kudo ku ata jetojnë e punojnë.

Detyrat për ndërtimin e socializmit dhe problemet që shtron jeta janë kaq të shumta saqë nuk ka mundësi praktike të bëhen të gjitha objekt shqyrtimi në organizatën e Partisë. Prandaj kërkohet që çdo komunist t'i njohë thellë e në hollësi direktivat e vendimet e Partisë dhe, sipas kushteve e vendit të punës ku militon, t'i vërë në jetë me iniciativë, duke punuar si agjitator, propagandist e organizator, por kurdoherë të luajë rolin e pararojës. Ata nuk duhet të jenë zbatues mekanikë dhe as konformistë, por të mbajnë përgjegjësi të plotë për zbërthimin dhe realizimin krijues të direktivave dhe të orientimeve, të tregojnë me guxim kur vendimet, urdhrat e udhëzimet e ndryshme bien në kundërshtim me politikën e drejtë të Partisë ose nuk u përgjigjen kushteve të veçanta reale.

Iniciativa e vetëveprimi si tipare dalluese të komunistëve formohen dhe kaliten në luftë e në punë, në veprimtarinë e përditshme praktike shoqërore. Në aksione e lëvizje shkrihet në një të vetme vrulli revolucionar i komunistëve me krijimtarinë e masave dhe u jepet kështu një goditje e fortë metodave burokratike e teknokratizmit, dembellëkut e formalizmit. Është detyrë e gjithë komunistëve, e organizatave-bazë dhe e komiteteve të Partisë që ta shtrijnë metodën e aksionit në të gjitha fushat e jetës, sepse kështu puna e Partisë do të gjallërohet dhe do t'u përgjigjet më mirë hovit dhe entuziazmit të klasës punëtore e të gjithë punonjësve.

Për forcimin e Partisë rëndësi të veçantë ka kuptimi i thellë ideologjik dhe zbatimi këmbëngulës i normave që rregullojnë jetën e brendshme të saj. Këto norma janë ato që e çelikosin Partinë, forcojnë unitetin e mendimit dhe të veprimit të saj, që sigurojnë vitalitetin dhe suksesin e veprimtarisë së Partisë.

Çdo kuptim i shtrembër, çdo zbatim formal i tyre çon në pasoja të rënda, ndrydh jetën e brendshme të Partisë, mbyt frymën e hovin revolucionar të komunistëve, i hap rrugën burokratizmit dhe degjenerimit të Partisë. Këtu qëndron edhe një nga burimet kryesore të asaj tragjedie të madhe që ndodhi në Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Atje tani normat e partisë, megjithëse paraqiten si komuniste, përdoren si leva për nënshtrimin e partisë dhe zbatimin e vullnetit të klikës revizioniste në fuqi. Centralizmi demokratik është shndërruar në centralizëm burokratik, me

anën e të cilit i imponohet partisë diktati i grupit sundues të borgjezisë së re sovjetike. Kritika dhe autokritika është shndërruar në një mjet për të goditur e diskriminuar kundërshtarët e vijës revizioniste, disiplina e ndërgjegjshme është zëvendësuar me nënshtrimin e verbër ndaj autoriteteve burokratike. Etika komuniste e anëtarit të partisë i ka lënë vendin moralit borgjez të karrieristëve, servilëve e hipokritëve.

Partia jonë gjatë gjithë jetës së saj ka luftuar pandërprerë që normat e Partisë të ruhen të pastra dhe të bëhen pjesë e pandarë e jetës së përditshme të organizatave e të komunistëve. Kjo e ka bërë Partinë tonë të pathyeshme, të aftë për t'u bërë ballë armiqve të ndryshëm dhe për ta udhëhequr popullin shqiptar me sukses në rrugën e ndritur të socializmit.

Duke pasur parasysh si eksperiencën pozitive të Partisë sonë, ashtu edhe atë negative të partive revizioniste, ne duhet t'i kushtojmë tërë vëmendjen kësaj çështjeje të madhe jetike, të luftojmë me vendosmëri çdo shfaqje të formalizmit në kuptimin dhe zbatimin e normave leniniste të jetës së Partisë.

Këto norma nuk janë një qëllim në vetvete, as rregulla administrimi. Kështu, demokracia e brendshme, si një normë shumë e rëndësishme në jetën e Partisë, nuk reduktohet vetëm në procedurën demokratike të zhvillimit të mbledhjeve, për të marrë vendime me shumicë votash etj. Demokracia në Parti ka një kuptim e përmbajtje të thellë ideologjike e praktike. Thelbi i saj është që çdo komunist të marrë pjesë aktive në përpunimin dhe zbatimin e vijës së Partisë, të shfaqë lirisht mendimet e tij për punën dhe njerëzit, të kritikojë hapur të metat dhe të bëjë autokritikë për dobësitë e veta. E kuptuar dhe e zbatuar në këtë mënyrë, demokracia u shërben forcimit të Partisë, edukimit dhe kalitjes së komunistëve, gjallërimit të organizatave dhe kompaktësisë së radhëve të Partisë, mbi bazën e parimit themelor të ndërtimit e funksionimit të saj, centralizmit demokratik.

Demokracia forcohet nëpërmjet debatit, ndeshjes së mendimeve dhe pikëpamjeve, parashtrimit dhe kapërcimit të kontradiktave. Lufta në rrugë të drejtë e mendimeve nuk është shprehja e mungesës së unitetit, por mjet efektiv për forcimin e tij. Atje ku mungojnë debatet, ku ka «qetësi» dhe «harmoni», atje ka amulli, demokracia dhe uniteti kanë karakter formal. Frika nga debati nuk është karakteristikë e komunistëve, por e mikroborgjezëve dhe e burokratëve, që nuk duan telashe e kokëçarje.

Por demokracia do të mbetej prapë formale, në qoftë se ajo do të kufizohej vetëm në diskutime e debate. Ajo bëhet efektive dhe i shërben forcimit të Partisë, kur komunistët i zbatojnë me konsekuencë e deri në fund vendimet që merren, kur veprojnë si një trup i vetëm e karakterizohen nga një vullnet i përbashkët. Kështu realizohet në praktikë uniteti i mendimit e i veprimit.

Dihet rëndësia e madhe parimore që ka kushti leninist se për të qenë anëtar partie duhet të pranosh statutin e programin e partisë, të bësh pjesë në një organizatë të saj dhe të paguash rregullisht kuotizacionin. Por kjo normë mbetet formale, në qoftë se komunisti nuk është luftëtar aktiv për zbatimin e vijës së partisë, nuk mishëron në jetë e në punë cilësitë e komunistit që përcaktohen në statut, nuk është njeri i pararojës dhe nuk qëndron në ballë të masave në luftën për socializëm. Komunistët shqiptarë nuk janë komunistë për vota, siç i kërkojnë partitë revizioniste, por luftëtarë të frontit të parë, njerëz që s'i zë gjumi as natën as ditën për punët e Partisë dhe fatet e popullit.

Partia nuk mund të jetë në ballë të luftës dhe të ecë përpara pa mobilizuar masat, pa u mbështetur në to, sepse puna e Partisë është e gjerë, pa kufi dhe atë nuk mund ta bëjnë kurrë një numër i kufizuar komunistësh. Lidhja me masat është një parim dhe normë tjetër e rëndësishme e Partisë.

Problemet e Partisë janë probleme që preokupojnë masat, prandaj ato t'i kërkojmë e t'i gjejmë te masat, t'i diskutojmë e t'i zgjidhim bashkë me to, sepse janë pikërisht masat e gjera ato që krijojnë, që ndërtojnë dhe transformojnë botën, shoqërinë. Vënia në jetë e këtij parimi të madh marksist-leninist përbën atë hallkë të zinxhirit, nga e cila duhet kapur për të çuar përpara tërë punën tonë. Vija e masave qindfishon forcat e Partisë, thellon më tej demokracinë në jetën e brendshme të saj, forcon lidhjet e Partisë me popullin.

Sukseset në këtë drejtim janë të dukshme, por ndeshemi akoma me koncepte formaliste e sektare. Vihen re raste kur konsultimi me masat bëhet sa për të kaluar radhën, kur, edhe pasi për një çështje merret mendimi i tyre, në vendimet nuk pasqyrohen si duhet vërejtjet dhe propozimet e drejta të masave. Formalizëm është edhe ai kur pyeten vetëm disa njerëz dhe kjo quhet si dëgjim i zërit të masave. Nuk janë, gjithashtu, të rralla rastet kur nën parullën e vijës së masave mblidhen njerëzit vend e pa vend e për çështje fare të parëndësishme.

Nga ana tjetër, disa organizata-bazë me vështirësi po dalin nga kuadratet e ngushta të një pune të mbyllur e pa perspektivë. Ç'të keqe ka nëse për çdo problem të rëndësishëm që shtrohet për diskutim në organizatën-bazë ose në forumet e Partisë jo vetëm të merret mendimi i masës, por pas çdo mbledhjeje partie punonjësit të vihen në dijeni për çështje që atyre u interesojnë dhe bashkë me ta të gjenden format e mjetet më të përshtatshme për zbatimin e tyre? Ç'normë organizative shkelet që organizata-bazë të dalë herë pas here para kolektivit dhe të njoftojë se si janë zbatuar vendimet, si kanë punuar komunistët, anëtarët e byrove deri tek anëtarët e plenumeve të rretheve ose të bëhen

mbledhje të hapura të organizatës-bazë, bile edhe kur diskutohen gabime të komunistëve? Këtu nuk shkelet asnjë normë, asnjë parim organizativ, por vetëm thyhen konceptet burokratike që nënvlerësojnë mendimin dhe kontrollin e masave, thellohet më tej demokracia në jetën e brendshme të Partisë, zbatohen parimet e normat e Partisë në mënyrë revolucionare.

Vënia e gjithë veprimtarisë së organizatave të Partisë e të komunistëve nën kontrollin e klasës punëtore dhe të masave punonjëse është një çështje me rëndësi të madhe parimore që Partia të mos shkëputet nga klasa e masat, të mbetet deri në fund revolucionare dhe t'u shërbejë me besnikëri interesave të popullit. Mungesa e këtyre raporteve, largimi nga vija e masave, kthimi i punës së Partisë në diçka të mbyllur, jashtë kontrollit të klasës e të punonjësve, bëri që revizionistët t'i kapin në befasi masat dhe t'i vënë ato para faktit të kryer.

Këtë mësim të hidhur ta kemi kurdoherë parasysh dhe të thellojmë më tej përvojën e pasur të Partisë sonë në rrugën e madhe drejt demokratizimit të mëtejshëm të jetës së Partisë, zbatimit në frymë revolucionare të normave të saj, forcimit të lidhjeve të Partisë me masat. Kështu Partia do të jetë gjithnjë e fortë si çeliku, e pamposhtur, e zonja të orientohet drejt në çdo situatë dhe të zgjidhë me sukses çdo detyrë.

Thellimi i vijës së masave nuk mund të kuptohet pa përmirësuar më tej punën e Partisë me organizatat e masave dhe udhëheqjen e saj në këto organizata. Roli i organizatës së bashkimeve profesionale, të rinisë, të gruas dhe të Frontit Demokratik është i madh për forcimin e lidhjeve të Partisë me masat, për edukimin revolucionar dhe mobilizimin e punonjësve në luftë për kryerjen e detyrave të ndërtimit socialist. Ato çojnë në masa vijën e Partisë dhe shtrojnë para Partisë e shtetit problemet që preokupojnë masat, jo vetëm i edukojnë punonjësit, por edhe i organizojnë ata për të marrë pjesë aktive në drejtimin e punëve shtetërore e shoqërore dhe për të ushtruar kontrollin e tyre të drejtpërdrejtë mbi këdo si zotër të plotfuqishëm të vendit.

Partia e ka vlerësuar kurdoherë lart këtë rol të madh që luajnë organizatat e masave në sistemin e diktaturës së proletariatit, prandaj ajo u ka kushtuar e u kushton atyre tërë vëmendjen e saj. Ky kujdes nuk duhet të pakësohet në asnjë mënyrë edhe në të ardhmen. Përkundrazi, ai duhet të rritet duke luftuar çdo shfaqje të nënvlerësimit të organizatave të masave, që vihet re aty-këtu në ndonjë organizatë partie, kuadër e komunist.

Udhëheqja e Partisë në organizatat e masave është ai kusht që siguron një orientim të drejtë politik, ideologjik e organizativ për bashkimin e forcave popullore në luftë për idealet e larta të socializmit. Partia jonë shprehet si kundër pikëpamjeve të revizionistëve modernë që predikojnë pavarësinë e organizatave të masave nga partia revolucionare e klasës punëtore, për t'i vënë kështu ato në vartësinë e partive borgjeze, ashtu edhe kundër koncepteve burokratike, sipas të cilave organizatat e masave duhet të jenë shtojca të aparateve shtetërore, duke u mohuar kështu atyre çdo iniciativë e vetëveprim me qëllim që t'u diktohet çdo gjë nga lart.

Udhëheqja e Partisë është udhëheqje politike e ideologjike, që do të thotë se në themel të veprimtarisë së organizatave të masave qëndron ideologjia dhe vija e përgjithshme politike e Partisë, se direktivat e vendimet e saj përbëjnë burimin e vetëm që i frymëzon e i udhëheq ato në të tërë punën e tyre. Këtej del edhe detyra që këtë vijë e këto direktiva komitetet dhe organizatat e Partisë t'ua bëjnë të qarta organizatave të masave në përshtatje me specifikën dhe funksionet e tyre, duke u lënë në të njëjtën kohë iniciativë të plotë që ato të mendojnë e të punojnë edhe vetë për zbërthimin dhe zbatimin e tyre.

Në këtë kuptim është krejt e huaj dhe e dëmshme ajo praktikë që vihet re jorrallë, kur çdo gjë duhet ta shohin më parë organizatat e Partisë dhe pastaj të veprojnë organizatat e masave.

Praktikat burokratike, të cilat shpesh mbulohen me «nevojën e ndihmës konkrete» për organizatat e masave me «mungesën e përvojës» së tyre, në fakt dëshmojnë se disa organizata partie nuk janë zhveshur akoma nga disa forma e metoda pune të vjetruara.

Në kushtet kur niveli ideopolitik dhe kulturoro-arsimor i masave është rritur dhe kur organizatat e tyre kanë fituar një eksperiencë të pasur, është e nevojshme të përsosen edhe format e metodat e udhëheqjes së Partisë, të cilat duhet të synojnë jo në ndrydhjen, por në zhvillimin e gjerë të iniciativës e të vetëveprimit të organizatave të masave, ashtu si vetë këto të fundit duhet të përsosin më tej stilin e metodën e tyre, të gjejnë forma pune më të lira, më të shkathta e më të larmishme.

Me një kujdes të veçantë është punuar për edukimin e aktivit të organizatave të masave, i cili përbën një forcë të madhe dhe një burim të pashtershëm për rritjen e radhëve të Partisë dhe për kuadro për të gjithë sektorët. Ky aktiv nuk përbëhet vetëm nga funksionarët, as vetëm nga ata që janë zgjedhur në forumet e organizatave të masave, por edhe nga dhjetëra mijëra aktivistë shoqërorë, që punojnë me një ndërgjegje të lartë si propagandistë, agjitatorë dhe organizatorë të masave. Punës për rritjen, aftësimin e kalitjen e këtij aktivi Partia si dhe vetë organizatat e masave duhet t'i kushtojnë tërë kujdesin e tyre.

Disa çështje të politikës së kuadrit dhe të metodës e stilit në punë

Partia me punën e saj të kujdesshme për vite me radhë ka krijuar një armatë kuadrosh të aftë e besnikë, të cilët të kalitur në luftë me vështirësitë e pengesat, të ndriçuar nga vija marksiste-leniniste e Partisë, punojnë si revolucionarë në të gjithë sektorët.

Masat e rëndësishme që ka marrë Partia për revolucionarizimin e mëtejshëm të tyre, duke filluar që nga qarkullimi e puna në prodhim dhe deri te përmirësimi i përbërjes sociale të forumeve të Partisë, të organizatave të masave dhe të gjithë aparateve, kanë bërë që, pavarësisht nga mosha ose stazhi në punë, kuadrot të kaliten më tej si militantë të Partisë dhe bij të devotshëm të popullit.

Sot rreth 44 për qind e të gjitha kategorive të kuadrove janë të moshës deri në 30 vjeç, ndërsa mbi 50 për qind janë në moshën nga 30 deri 50 vjeç. Këta tregues janë shumë pozitivë. Ata dëshmojnë se Partia ka ndjekur një politikë të drejtë në ngritjen e kuadrit, duke kombinuar në harmoni të plotë kuadrot e vjetër me të rinjtë, duke përgatitur dhe edukuar një brez të ri kuadrosh për të përtërirë në mënyrë graduale e të vazhdueshme organet udhëheqëse të Partisë, të shtetit, të ekonomisë e të kulturës.

Këtë politikë të drejtë Partia do ta ndjekë edhe në të ardhmen. Përtëritja dhe zëvendësimi i kuadrove është një domosdoshmëri jetike, prandaj ai duhet të jetë një preokupacion i vazhdueshëm, për atë duhet menduar seriozisht dhe me kohë.

Kuadrot, veçanërisht ata drejtues, nuk përgatiten lehtë, për një ditë ose për një vit, duhet mjaft kohë për t'i rritur e formuar si të tillë. Emërimet bëhen shpejt, por transmetimi i përvojës nuk mund të bëhet me një të rënë të shkopit. Ky është një proces i vazhdueshëm që e udhëheq me kujdes Partia. Në punën e përbashkët të kuadrove të vjetër dhe të rinj trashëgohet e pasurohet përvoja e mirë, rriten të rinjtë e freskohen të moshuarit, realizohet ai harmonizim i plotë i kuadrove dhe i eksperiencave të ndryshme.

Partia duhet të luftojë me guxim kundër pengesave që dalin në rrugën e ngritjes së kuadrove të rinj, sidomos kundër koncepteve konservatore e sektare, që janë shprehje të mosbesimit tek aftësitë krijuese të masave, të egoizmit profesional dhe intelektualizmit. Këto shfaqen në forma, doza e në njerëz të ndryshëm dhe për kategori të ndryshme punonjësish.

Tani kemi një bazë të shëndoshë dhe janë krijuar të gjitha kushtet për të avancuar më me guxim kuadro të rinj në të gjitha

fushat. Të tillë ka me mijëra e mijëra në radhët e klasës sonë punëtore, të fshatarësisë kooperativiste, të rinisë sonë të mrekullueshme. Njerëzit tanë të rinj kanë një nivel arsimor e kulturor të ngritur, janë pajisur qysh në fëmijëri e vazhdimisht me edukatën e Partisë, janë kalitur e kaliten përditë në jetën tonë revolucionare. Ata janë plotësisht të denjë dhe të aftë për t'u besuar çdo detyrë. Të mos e shohësh këtë realitet do të thotë të mbetesh prapa jetës, të dëmtosh punën e Partisë, të pengosh zhvillimin e vendit.

Kuadrot e rinj kanë nevojë të ndihmohen e të udhëhiqen me kujdes, por pa i mbajtur nën tutelë, në rolin e ndihmësit ose të çirakut. Kuadrot me stazh të gjatë pune, me ndjenjën e përgjegjësisë së lartë për të tashmen dhe të ardhmen e vendit, ta shohin këtë si detyrë partie, t'i ndihmojnë ata me pasion, t'i inkurajojnë, t'i mësojnë, por dhe të mësojnë prej tyre dhe të besojnë sinqerisht se kanë çfarë të mësojnë. Ata të mos harrojnë se edhe ata vetë dikur kanë qenë të rinj dhe megjithatë Partia u ngarkoi përgjegjësira të mëdha, i rriti, i edukoi, i mësoi të luftojnë e të fitojnë, ajo u ka qëndruar gjithnjë pranë dhe i ka ndihmuar të ecin përpara.

Respekti në baza revolucionare e josentimentale për kuadrot e vjetër, që kanë dhënë një kontribut të madh në luftën e çlirimit dhe për ndërtimin e socializmit, që kanë mbajtur mbi supet e tyre detyra të vështira, është një gjë e domosdoshme, sepse ky është respekti për veprën dhe eksperiencën e tyre, për të cilën ata janë e duhet të jenë kurdoherë modestë. Detyra e Partisë është të punojë që të gjithë kuadrot, pavarësisht nga mosha dhe stazhi në punë, të kuptojnë drejt vendin e rolin e tyre, dialektikën e zhvillimit të jetës, të ecin me kohën dhe të japin tërë kontributin e tyre të vlefshëm për të mirën e Partisë e të popullit.

Kuadrot duhet të jenë gjithnjë revolucionarë të devotshëm dhe në shërbim të popullit punonjës. Prandaj është e domosdoshme ta thellojmë punën për kalitjen e revolucionarizimin e vazhdueshëm të tyre, të inkurajojmë dhe të forcojmë lidhjet e kuadrit me masat, të kërkojmë e të gjejmë gjithnjë forma e mjete të reja që i shërbejnë edukimit të kuadrove të partisë, të pushtetit dhe të gjithë sektorëve të tjerë.

Përmirësimi i metodës dhe i stilit të punës së kuadrove, është një problem tjetër me rëndësi të dorës së parë, që ata të kryejnë me sukses detyrat e mëdha e me përgjegjësi.

Me planin e ri pesëvjeçar para nesh shtrohen detyra të mëdha në fushën e industrisë, bujqësisë, ndërtimeve, kulturës dhe të gjithë sektorëve të tjerë. Këto detyra janë mjaft komplekse, kanë anën e tyre politike, ekonomike, teknike e organizative. Prandaj edhe masat për realizimin e tyre duhet të jenë të gjithanshme,

kuadrot duhet të thellohen në tërë këtë kompleks, t'i trajtojnë dhe t'i zgjidhin problemet, duke i parë në unitet dhe në lidhjen e vartësinë e tyre reciproke. Ata duhet të kombinojnë dhe të harmonizojnë me zgjuarsi punën sqaruese e edukuese me atë ekonomike, punën teknike me atë organizuese.

Vetëm mbi këtë bazë mund të zhvillohet me sukses veprimtaria praktike revolucionare e masave, të ngrihet në një shkallë më të lartë mobilizimi i tyre dhe të arrihen rezultate më të mëdha si në prodhimin e të mirave materiale, ashtu edhe në kalitjen e ndërgjegjes së njerëzve.

Si në gjithë sektorët e tjerë, edhe në punën e Partisë sot kërkohet që drejtimi të ngrihet në një nivel më të lartë, në baza shkencore. Nga kuadrot tanë kërkohet që tani të reflektojnë më shumë mbi përmbajtjen politike e ideologjike të direktivave, të përgjithësojnë më mirë teorikisht përvojën e masave dhe të Partisë, të kapen pas çështjeve themelore dhe të dinë t'i hapin perspektivë punës në të gjithë sektorët. Për këtë është e domosdoshme që kuadrot tanë të të gjitha niveleve të studiojnë shkencën revolucionare të Partisë, të përvetësojnë botëkuptimin materialist dialektik, në lidhje të ngushtë me praktikën, me problemet që kanë për të zgjidhur. Ata duhet të bëjnë një luftë të vendosur kundër çdo shfaqjeje të subjektivizmit, empirizmit e praktikizmit, kundër çdo gjëje që kultivon rutinën, që të gozhdon pas gjërave të vogla të ditës, të ushqen frymën e komandimit dhe të largon nga njohja e realitetit.

Stili dhe metoda e punës nuk janë të dhëna një herë e përgjithmonë. Ato ndryshojnë, zhvillohen e pasurohen në përputhje me kushtet dhe detyrat e reja. Çdo gjë duhet t'i nënshtrohet verifikimit në jetë. Për këtë ka rëndësi që kuadrot të shohin dhe të kuptojnë mirë realitetin në transformimin e tij revolucionar, të renë që lind e zhvillohet, të njohin thellë kërkesat e kohës. Kështu ata do të jenë në gjendje të luftojnë më me efikasitet kundër çdo shfaqjeje të konservatorizmit, çdo tendence që kërkon të kapet pas formave e metodave të vjetruara, të cilat vetë jeta i ka kapërcyer.

Partia jonë është Parti e progresit, Parti e së ardhmes. Ajo është e papajtueshme me çdo gjë të vjetër, konservatore e regresive. Ajo lufton për të zhdukur të gjitha pengesat, për t'i hapur rrugën e gjerë së resë, emancipimit dhe zhvillimit të energjive krijuese të masave, përparimit të gjithanshëm të shoqërisë sonë socialiste.

VI

MARKSIZËM-LENINIZMI — DOKTRINË GJITHMONË E RE DHE SHKENCORE

Lufta kundër rrymës më të rrezikshme antimarksiste, revizionizmit modern me atë sovjetik në krye, ka qenë vazhdimisht në qendër të vëmendjes së Partisë. E ndërgjegjshme për nevojën historike të kësaj lufte, Partia jonë ka demaskuar pikëpamjet e tezat antimarksiste dhe veprimtarinë kundërrevolucionare, demagogjinë dhe taktikat mashtruese të revizionistëve hrushovianë. Ajo ka luftuar me vendosmëri për t'u grisur atyre njërën maskë pas tjetrës, për të zbuluar fytyrën e tyre tradhtare e socialimperialiste.

Partia e Punës e Shqipërisë dhe marksistë-leninistët e vërtetë, patën paralajmëruar që në fillim të polemikës së madhe me revizionistët modernë se largimi nga pozitat parimore të marksizëm-leninizmit do t'i çonte ata në prehrin e borgjezisë e të kapitalizmit, në barrikadën e kundërrevolucionit. Jeta e vërtetoi plotësisht këtë parashikim.

Revizionizmi, që lindi si një rrymë oportuniste e antimarksiste në gjirin e lëvizjes komuniste, si rezultat i vetë zhvillimit logjik të tradhtisë, është shndërruar tani në një rrymë borgjeze në lëvizjen punëtore, rrymë që është e njëllojtë me socialdemokracinë. Vendet, ku në fuqi erdhën revizionistët, u kthyen në shtete borgjeze që shtypin e shfrytëzojnë punonjësit njëlloj si edhe borgjezia në vendet kapitaliste. Kreu i revizionizmit, Bashkimi Sovjetik, u shndërrua në një fuqi imperialiste, që ndjek një politikë ekspansioniste e agresive, që lufton për hegjemoni e sundim botëror.

Të vënë me shpatulla për muri nga demaskimi i forcave marksiste-lenineiste, të tronditur nga dështimet e disfatat që pësojnë vazhdimisht, të mbërthyer nga kontradiktat dhe kriza e thellë, në të cilën janë futur, revizionistët modernë përpiqen të manovrojnë, të përdorin taktika të ndryshme për të mashtruar komunistët e popujt, për të zgjatur sundimin e tyre.

Megjithëse këto përpjekje dhe këto manovra që u përsëritën edhe një herë me ngulm në Kongresin e 24-t të PK të BS, tashmë janë bërë bajate, ato nuk duhen nënvlerësuar. Revizionistët vazhdojnë të mbajnë nën influencën e tyre dhe të mashtrojnë shtresa të gjera të punonjësve, sidomos në vendet ku janë në fuqi. Ata vazhdojnë t'i sjellin dëme të mëdha çështjes së komunizmit. Për

marksistë-leninistët, për revolucionarët konsekuentë revizionizmi mbetet një armik i madh jo më pak i rrezikshëm se borgjezia imperialiste. Asnjë iluzion nuk duhet ushqyer në këtë çështje për asnjë arsye. Lufta kundër revizionizmit modern, me udhëheqësit sovjetikë në krye, duhet vazhduar e forcuar, duhet çuar deri në fund. Ata nuk mund t'i ndreqë asgjë, përveç revolucionit që do t'i fshijë nga faqja e dheut.

Partia e Punës e Shqipërisë, ashtu si deri më sot, do të luftojë me të gjitha forcat e saj kundër tradhtisë revizioniste, e bindur se kështu kryen detyrën e saj para popullit të vet dhe para komunizmit ndërkombëtar. Luftën ideologjike kundër revizionizmit modern ne e shohim si pjesë përbërëse e të pandarë të luftës për mbrojtjen e ndërtimin e socializmit në Shqipëri, për fitoren e lirisë së popujve dhe të revolucionit kudo në botë.

Situata e sotme e bën edhe më imperative nevojën e forcimit të kësaj lufte me rëndësi historike. Jetojmë në një periudhë të ngritjes së hovit revolucionar. Lufta kundër imperializmit e reaksionit po merr përpjesëtime gjithnjë e më të mëdha. Të gjitha kontinentet ziejnë nga lëvizjet revolucionare, të cilat po tronditin nga themelet botën e vjetër të shtypjes e të shfrytëzimit. Kjo është shprehja më e qartë e acarimit të të gjitha kontradiktave klasore e nacionale, të brendshme e të jashtme, të sistemit kapitalist botëror, e thellimit të mëtejshëm të krizës së tij të përgjithshme.

Zhvillimi i procesit revolucionar botëror është bërë sot shumë i larmishëm. Repartet e ndryshme të lëvizjes revolucionare botërore luftojnë e veprojnë jo në të njëjtat kushte, ndodhen në etapa të ndryshme të zhvillimit shoqëror, shtrojnë para tyre detyra të ndryshme, kanë specifikën e praktikës së tyre historike. Po zgjerohet edhe baza sociale klasore e revolucionit botëror. Përveç klasës punëtore, në lëvizjet e ndryshme revolucionare po marrin pjesë gjithnjë e më aktivisht shtresa të gjera shoqërore si fshatarësia e borgjezia e vogël e qytetit, inteligjencia e studentët, rinia e gratë, të cilët sjellin në lëvizje gjithë bagazhin ideologjik të shtresave që përfaqësojnë me të mirat e të këqijat e tyre.

Por, ndërsa ka një ngritje të fuqishme të masave e të popujve në luftë e revolucion, dobësia e lëvizjes revolucionare në shumë vende e zona qëndron pikërisht në mungesën e një strategjie e taktike shkencore që t'u hapë masave perspektivën revolucionare dhe t'i orientojë drejt në rrugën për arritjen e qëllimeve të tyre. Situata është e tillë që lëvizja praktike e masave ka ecur e po ecën përpara, kurse faktori subjektiv, ndërgjegjja, organizimi dhe

drejtimi i tyre në mjaft vende kanë mbetur prapa, nuk u përgjigjen detyrave të kohës. Këtu një rol të drejtpërdrejtë minues e sabotues luajnë revizionistët modernë, të cilët, pasi braktisën idealet revolucionare, janë shndërruar në grevëthyes e zjarrfikës të revolucionit dhe me pikëpamjet e veprimtarinë e tyre oportuniste e antimarksiste përpiqen të çarmatosin klasën punëtore dhe të çoroditin ideologjikisht e politikisht radhët e revolucionit. Ky është shërbimi më i madh që ata i bëjnë borgjezisë dhe reaksionit, është dëmi më i madh që ata i sjellin çështjes së çlirimit të popujve e të socializmit.

Me tezat e tij të shuarjes së luftës së klasave dhe të bashkëpunimit klasor nën maskën e bashkekzistencës paqësore, me iluzionet mbi ndryshimin e natyrës së imperializmit dhe mbi botën pa armë e pa luftëra, me frikën nga armët atomike dhe nga lufta termobërthamore, me predikimet për kalimin në socializëm në rrugë paqësore etj., etj., revizionizmi hrushovian u puq me socialdemokracinë dhe u shndërrua në një rrymë të vetme kundërrevolucionare në shërbim të borgjezisë.

Kjo platformë oportuniste e reformiste që u shtrua në Kongresin e 20-të të PK të BS dhe që u zhvillua e u plotësua më vonë në kongreset e tjera që pasuan, u paraqit nga revizionistët si një platformë që gjoja mbronte leninizmin nga të ashtuquajturat deformime staliniste. Në fakt u provua shumë shpejt se rryma që doli me parullat e antistalinizmit ishte një rrymë e huaj, e papajtueshme dhe në luftë me marksizëm-leninizmin.

Revizionistët hrushovianë trumbetuan e vazhdojnë të trumbetojnë me të madhe se me pikëpamjet e tezat e tyre teorike hodhën «bazat» e luftës dhe të rrugës së «drejtë» për socializëm. Në të vërtetë kjo ishte një rrugë e luftë për të shuar luftën për socializëm, për t'i larguar masat nga rruga e revolucionit, për të përjetësuar rendin kapitalist dhe për të minuar kudo fitoret e socializmit.

Teoritë e praktikat kundërrevolucionare të revizionistëve shërbejnë si ushqim për rrymat më të ndryshme ideologjike armiqësore, që nga ato më reaksionaret borgjeze, deri tek ato trockiste e mikroborgjeze. Ideologët borgjezë përpiqen qëllimisht ta paraqesin tradhtinë revizioniste si dështim të socializmit e të marksizëm-leninizmit, sikur komunizmi nuk është i aftë të japë një alternativë pozitive për zgjidhjen e problemeve të botës së sotme. Duke bërë apologjinë e rendit kapitalist, ata pretendojnë se ky është bërë sot i aftë për të kapërcyer kontradiktat dhe konfliktet sociale, të krijojë një shoqëri të «mirëqenies së përgjithshme», se gjoja revolucioni i sotëm tekniko-shkencor po zëvendëson revolucionin social, po e afron kapitalizmin me socializ-

min dhe po i shkrin gjoja në një shoqëri të re e të vetme «industriale» ose «pasindustriale». Ky është krahu më reaksionar, krahu i hapët antikomunist në luftën e sotme ideologjike.

Janë gjalleruar si kurrë ndonjëherë më parë rrymat e ndryshme antimarksiste të trockistëve e të anarkistëve, të cilët, duke depërtuar në lëvizjet e ndryshme masive, sidomos të rinisë e të intelektualëve, përpiqen të peshkojnë në ujë të turbullt, me qëllim që t'i largojnë masat nga rruga e drejtë dhe t'i hedhin ato në aventura të rrezikshme që çojnë në disfata e deziluzione të rënda. Megjithëse këta shpesh dalin me parulla ultrarevolucionare dhe antirevizioniste, në fakt bëjnë lojën e revizionistëve dhe së bashku minojnë çështjen e revolucionit.

Ka edhe disa ideologë mikroborgjezë e njerëz me prirje të sinqerta revolucionare, që, të deziluzionuar nga tradhtia revizioniste, vënë në dyshim parimet themelore të marksizëm-leninizmit dhe përpiqen të krijojnë teori të reja ose të ringjallin të vjetrat. Ata predikojnë se marksizëm-leninizmi nuk është i plotë e i saktë, se ai gjoja nuk u përgjigjet më kushteve të reja historike të vendeve ose kontinenteve të ndryshme.

Në këtë situatë, kur është thelluar çoroditja ideologjike, që shkaktuan dhe që përpiqen ta mbajnë të gjallë revizionistët modernë, del qartë se ç'rëndësi të madhe merr lufta e të gjithë marksistë-leninistëve për çlirimin e klasës punëtore e të masave punonjëse nga të gjitha ndikimet e ideologjisë borgjeze, revizioniste dhe të rrymave të ndryshme mikroborgjeze, armatosja e tyre me ideologjinë e vetme shkencore, marksizëm-leninizmin.

> «Një nga kushtet e domosdoshme të përgatitjes së proletariatit për fitoren e tij, ka thënë Lenini, është lufta e gjatë, e vendosur dhe e pamëshirshme kundër oportunizmit, reformizmit, socialshovinizmit dhe ndikimeve të rrymave borgjeze të këtij lloji, të cilat janë të pashmangshme, përderisa proletariati vepron në kushtet e kapitalizmit. Pa këtë luftë, pa fitoren e plotë paraprake mbi oportunizmin në lëvizjen punëtore, as që mund të bëhet fjalë për diktaturë të proletariatit»[1].

Lufta ideologjike që zhvillohet sot në botë është mjaft e gjerë e shumë komplekse. Por problemet më themelore, për të cilat diskutohet janë ato mbi hegjemoninë në lëvizjen revolucionare, mbi thelbin dhe rrugët e zhvillimit të revolucionit dhe mbi kuptimin e ndërtimin e shoqërisë socialiste.

1. V. I. Lenin. Vepra të plota, bot. rus. vëll. 40, f. 24.

Udhëheqja e klasës punëtore dhe e Partisë së saj marksiste-leniniste — kusht themelor për mposhtjen e borgjezisë dhe të imperializmit

Kundërshtarët ideologjikë të marksizëm-leninizmit, që nga ata borgjezë e revizionistë, radikalë e mikroborgjezë, me fjalë dhe me vepra orvaten të mohojnë misionin historik botëror të klasës punëtore, rolin dhe hegjemoninë e saj në revolucion. Të gjithë së bashku, në këtë ose atë mënyrë, përpiqen të vërtetojnë se idetë e marksizëm-leninizmit për këtë çështje janë vjetruar.

Duke spekuluar me fenomenet e reja të kapitalizmit të sotëm, sidomos me pasojat e zhvillimit të kapitalizmit monopolist shtetëror dhe të revolucionit tekniko-shkencor, ideologët borgjezë si Markuze me shokë, me teoritë e tyre teknokratike kërkojnë të vërtetojnë se gjoja shoqëria kapitaliste po deproletarizohet, klasa punëtore po shndërrohet në «bashkëpronare e bashkëdrejtuese» e ndërmarrjeve kapitaliste, se ajo nuk është më e interesuar për transformimin revolucionar të shoqërisë, pasi është «integruar» në sistemin kapitalist. Edhe kur ndonjëri nga këta shikon ndonjë forcë revolucionare, atë e gjen në shtresat që ndodhen në «kufi të klasave», në lumpenproletarët, në getot e qyteteve të mëdha, në emigrantët ose në studentët e intelektualët.

Revizionistët, nga ana tjetër, duke mbivlerësuar shtytjen objektive drejt socializmit që vjen nga zhvillimi i forcave të reja prodhuese dhe që forcohet nga ndikimi i raportit të ri të forcave në arenën ndërkombëtare në dobi të socializmit, përhapin pikëpamjet se luftën për socializëm mund ta udhëheqin edhe klasa e forca të tjera shoqërore joproletare që nga borgjezia kombëtare e mikroborgjezia e deri tek inteligjencia përparimtare e patriotike.

Këto pikëpamje i sjellin një dëm të madh lëvizjes revolucionare, krijojnë konfuzion në disa militantë të pakalitur dhe në shtresa të ndryshme të popullsisë, sidomos në rininë studenteske dhe intelektualët e rinj, të cilët përpiqen ta paraqesin veten si forca të pavarura dhe kryesore të revolucionit, që nuk ndiejnë nevojën e hegjemonisë së klasës punëtore dhe të udhëheqjes politike të Partisë së saj marksiste-leniniste.

Çështja e hegjemonisë në revolucion ka rëndësi të madhe parimore, sepse nga fakti se kush është në krye të tij, se kush e udhëheq atë varen drejtimi, zhvillimi konsekuent dhe vetë fati i tij. Qëndrimi ndaj klasës punëtore dhe rolit të saj udhëheqës është një gur prove për gjithë revolucionarët. Heqja dorë nga ideja e hegjemonisë së proletariatit në lëvizjen e sotme revolucionare, siç theksonte Lenini, është pamja më vulgare e reformizmit.

Kushtet që e bëjnë klasën punëtore forcën vendimtare të zhvi-

llimit të sotëm shoqëror, forcën drejtuese të luftës për transformimin revolucionar të botës kapitaliste nuk kanë ndryshuar aspak.

Klasa punëtore, me gjithë ndryshimet që ka pësuar bota e sotme kapitaliste, është e zhveshur nga çdo lloj prone mbi mjetet e prodhimit, nga drejtimi, organizimi e qëllimi i tij. E ashtuquajtura «shoqëri e konsumit» nuk është krijuar për të plotësuar nevojat e punonjësve, por për të intensifikuar shfrytëzimin e tyre dhe për të rritur fitimet e kapitalistëve. Është fakt se fitimet e monopoleve, trusteve e koncerneve kanë arritur shifra astronomike, ashtu siç është fakt që vitet e fundit dhe pikërisht në vendet më të zhvilluara kapitaliste kanë shpërthyer me një forcë të paparë beteja të ashpra midis klasës punëtore dhe borgjezisë. Punëtorët e Francës, Italisë, Anglisë e Amerikës janë ngritur në greva, kanë dalë në rrugë dhe pushtojnë fabrikat jo nga e mira por sepse jeta e tyre është e rëndë, sepse makina kapitaliste i shtyp, i kthen në instrumente të thjeshta, i çnjerëzon.

Në kundërshtim me predikimet e ideologëve borgjezë e revizionistë, shoqëria kapitaliste nuk deproletarizohet, por proletarizohet vazhdimisht, pesha dhe roli i klasës punëtore në prodhim po bëhen gjithnjë e më vendimtarë, ajo mbetet forca kryesore prodhuese e shoqërisë. Jeta tregon se vetëm kur lëviz klasa punëtore, kur ajo ndërpret punën qoftë edhe për një ditë, trondit et e tërë borgjezia dhe vihen në gjendje alarmi të gjitha institucionet e saj. Klasa punëtore është klasa me tradita të pasura lufte e organizimi, ajo ka Partinë dhe teorinë e saj shkencore që e udhëheqin në luftën klasore.

Të gjitha forcat revolucionare që luftojnë për përmbysjen e rendit borgjez mund të arrijnë në fitore, vetëm në qoftë se shkrihen me luftën e klasës punëtore, nëse njohin e pranojnë rolin udhëheqës të saj dhe të Partisë proletare marksiste-leniniste. Kjo është një domosdoshmëri objektive. Çdo alternativë tjetër çon në aventurizëm e disfatë. Këtij bashkimi të madh të të gjitha forcave të majta revolucionare me klasën punëtore borgjezia dhe revizionistët i tremben më shumë se çdo gjëje tjetër.

Veçanërisht i dëmshëm është në këtë çështje roli i socialdemokracisë dhe i revizionistëve modernë, të cilët, duke e inkuadruar klasën punëtore në sindikatat e tyre reformiste, orvaten të frenojnë hovin e saj revolucionar, të paralizojnë frymën luftarake, ta shndërrojnë atë në një klasë rajá, të bindur e të nënshtruar ndaj padronëve kapitalistë. Në këto kushte zgjimi i klasës punëtore dhe dalja e saj në krye të luftës revolucionare nuk mund të arrihet pa bërë një luftë të vendosur edhe në gjirin e vetë sindikatave reformiste kundër vijës e qëndrimeve të krerëve të tyre borgjezë, për demaskimin dhe izolimin e tyre nga masa e punëtorëve.

Në lëvizjen e sotme revolucionare një vend të rëndësishëm zënë rinia, studentët dhe shtresa të ndryshme të inteligjencies. Në shumë vende si në Francë e Itali, SHBA e Japoni, në Spanjë e në Amerikën Latine ata janë treguar mjaft aktivë dhe kanë dhënë prova guximi, vetëmohimi e fryme revolucionare. Por duhet pranuar se në lëvizjet e majta të intelektualëve e të studentëve vihet re një konfuzion i madh ideologjik e politik. Karakteri shpeshherë utopik i programeve dhe i parullave të tyre, mungesa e durimit dhe shpërthimet spontane e kanë burimin në ndikimin e ideologjive të huaja dhe në vetë natyrën klasore heterogjene të përbërjes së këtyre lëvizjeve.

Marksistë-leninistët u kushtojnë tërë vëmendjen lëvizjeve të majta të rinisë e të inteligjencies dhe pa i fshehur dobësitë që kanë këto lëvizje, luftojnë për t'i tërhequr ato në pozita të drejta revolucionare, për t'i çliruar nga ndikimet e ideologjisë borgjeze, mikroborgjeze e revizioniste.

Me gjithë rritjen e peshës së inteligjencies në shoqërinë e sotme, me gjithë ndryshimet që pëson pozita, karakteri dhe roli i punës së saj, si dhe përbërja klasore e kësaj shtrese, ajo nuk është një klasë më vete. Inteligjencia është një shtresë që qëndron në mes të klasave të ndryshme të shoqërisë dhe që vjen nga klasa të ndryshme. Për vetë këtë natyrë të saj ajo karakterizohet nga lëkundje të ndryshme politike e ideologjike. Këto lëkundje shtohen edhe më tepër, për shkak se borgjezia përpiqet me të gjitha mënyrat ta korruptojë inteligjencien e ta vërë në shërbim të saj.

Inteligjencia, siç ka treguar Lenini dhe siç e vërteton jeta, asnjëherë nuk ka qenë dhe nuk mund të jetë një forcë sociale e politike e pavarur. Roli dhe vendi i saj në shoqëri janë në vartësi me prejardhjen klasore e gjendjen ekonomiko-shoqërore, me aleancën e reparteve të ndryshme të saj me këto ose ato klasa. Prandaj inteligjencia nuk mund të zëvendësojë kurrë rolin udhëheqës të klasës punëtore në revolucion.

Rinia, studentët, pjesa përparimtare e inteligjencies janë aleatë të afërt të klasës punëtore, por jo të vetmit. Hegjemonia e klasës punëtore shtrihet edhe mbi shtresa të tjera të popullsisë, të interesuara për revolucion, sidomos mbi fshatarësinë, e cila në shumicën dërrmuese të vendeve dhe të rajoneve të botës përfaqëson aleaten kryesore, më të fuqishme e më të vendosur të saj.

Revizionistët e sotëm përpiqen të mohojnë rëndësinë e madhe të aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë nën pretekstin se fshatarësia nuk luan ndonjë rol të veçantë, sidomos në vendet e zhvilluara kapitaliste dhe në vend të saj nxjerrin në plan të parë aleancën e klasës punëtore me inteligjencien. Në disa vende të tjera revizionistët e zëvendësojnë aleancën midis klasës punëtore dhe fshatarësisë me aleancën e klasës punëtore me shtresat mikroborgjeze të qytetit e të periferisë së tij. Me këto teori e prak-

tika ata synojnë t'i shkëputin klasës punëtore aleaten më të afërt dhe më të vendosur në luftë. Teza leniniste se aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë është forca sociale e aftë të përmbysë borgjezinë dhe të ndërtojë socializmin është plotësisht e vlefshme edhe në kohën tonë.

Ashtu si fati i revolucionit në çdo vend të veçantë varet nga aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë, edhe në arenën ndërkombëtare fati i revolucionit botëror varet po nga i njëjti kusht, i cili në këtë rast shprehet si aleancë e vendeve socialiste dhe e lëvizjes punëtore në vendet e zhvilluara kapitaliste me lëvizjen antikolonialiste, çlirimtare e demokratike të popujve të Azisë, të Afrikës dhe të Amerikës Latine. Çdo qëndrim mospërfillës e denigrues ndaj luftës së popujve të këtyre kontinenteve, që përbëjnë shumicën dërrmuese të popullsisë së botës dhe ku imperializmit i jepen sot goditjet më të forta e më të drejtpërdrejta, është në thelb një aspekt tjetër i mohimit të rolit të fshatarësisë, që i sjell një dëm shumë të madh çështjes së revolucionit.

Baza e aleancave zgjerohet edhe më tepër, kur është fjala për revolucione demokratike antiimperialiste, në të cilat mund të marrë pjesë, përveç fshatarësisë e mikroborgjezisë së qytetit, edhe borgjezia kombëtare. Por, cilado që të jetë pesha e tyre në çdo revolucion, ato nuk mund të luajnë dot atë rol hegjemon e udhëheqës që luan klasa punëtore. Borgjezia kombëtare, e lidhur me shfrytëzimin kapitalist, karakterizohet nga lëkundje e prirje për kompromis me imperializmin e jashtëm e reaksionin e brendshëm. Si e tillë, ajo nuk është e aftë ta çojë me konsekuencë e deri në fund luftën çlirimtare e revolucionin demokratik. Edhe përfaqësuesit e fshatarësisë e të shtresave të tjera mikroborgjeze kanë kërkesa të kufizuara, janë nën ndikimin e ideologjisë borgjeze dhe shpeshherë lëkunden, sa nga e majta aq nga e djathta, duke shkarë herë në oportunizëm e herë në aventurizëm.

Prandaj klasa punëtore, si klasa më revolucionare e shoqërisë, mund dhe duhet të dalë në krye e të udhëheqë jo vetëm luftën për socializëm, por edhe luftën për demokraci e pavarësi kombëtare. Lenini e ka argumentuar këtë më se gjysmëshekulli më parë. Kjo është aq shumë e vërtetë sot kur klasa punëtore është rritur, kalitur, edukuar e organizuar në një shkallë më të lartë dhe kur detyrat demokratike e socialiste janë afruar e pleksur akoma më tepër. Në kushtet e sotme klasa punëtore është klasa më e interesuar se kushdo tjetër për të çuar deri në fund revolucionin demokratik e antiimperialist.

Numri i vogël i klasës punëtore në ndonjë vend nuk është argument për të mohuar rolin e saj udhëheqës, sepse forca dhe roli i klasës nuk varen nga numri. Rolin udhëheqës klasa punëtore

e luan nëpërmjet partisë së saj, e cila, siç tregon edhe shembulli i vendit tonë, mund të krijohet e të dalë në krye të luftës revolucionare edhe kur klasa punëtore është e vogël në numër dhe e paorganizuar.

Sot janë gjallëruar teoritë e ndryshme që predikojnë spontaneitetin në lëvizjen revolucionare, që përçmojnë rolin e faktorit të ndërgjegjshëm, që mohojnë rolin e teorisë dhe të Partisë së proletariatit. Degjenerimi i partive revizioniste, shndërrimi i tyre në parti reformiste të padëmshme për borgjezinë dhe tezat antimarksiste të revizionistëve modernë sovjetikë, jugosllavë, italianë etj., se «kapitalizmi po integrohet në socializëm në mënyrë të ndërgjegjshme ose të pandërgjegjshme, graduale ose rrënjësore», se «bartës të idealeve të socializmit dhe udhëheqës të luftës për realizimin e tyre mund të bëhen edhe parti e organizata politike joproletare», se «drejt socializmit ecin edhe disa vende ku në fuqi është borgjezia e re nacionale» etj., janë bërë bazë për përhapjen e pikëpamjeve më ekstremiste që mohojnë krejtësisht rolin e teorisë dhe nevojën e Partisë së klasës punëtore. Ka edhe të tillë njerëz që hiqen si revolucionarë të kulluar, të cilët arrijnë deri atje sa të thonë se «në teorinë e Marksit mbi revolucionin nuk ekziston as vendi as nevoja mbi partinë» se «pararoja e revolucionit socialist nuk mund të barazohet me partinë marksiste-leniniste», se rolin e partisë mund ta luajë «pakica aktive» që del si «ferment» në lëvizjen spontane, se nga «vetë aksioni revolucionar lind edhe ndërgjegjja e organizimi revolucionar».

Të gjitha këto «teori» i sjellin një dëm të pallogaritshëm lëvizjes revolucionare, pasi e trullosin dhe e lënë klasën punëtore të çarmatosur përpara sulmit të borgjezisë, e cila nga ana e saj ka perfeksionuar në kulm metodat e mjetet e propagandës, organizimin e luftës kundër revolucionit e komunizmit.

Tashmë është provuar historikisht se pa partinë e saj klasa punëtore, në çfarëdo kushtesh që të jetojë e të veprojë, nuk bëhet vetvetiu e ndërgjegjshme. Ajo që e shndërron klasën punëtore nga një «klasë më vete» në një «klasë për vete» është Partia. Natyrisht lufta, aksioni i kalitin e i sprovojnë klasën, masat dhe revolucionarët, u mësojnë atyre shumë gjëra. Por, po mungoi partia politike me një program të qartë, me strategji e taktikë shkencore, lufta ose mbetet në mes të rrugës, ose dështon. Këtë na mëson edhe përvoja e lëvizjes së sotme revolucionare dhe e luftërave të shumta të popujve të kontinenteve të ndryshme.

Edhe kur disa nga revizionistët e oportunistët e ndryshëm e pranojnë nevojën e ekzistencës së partisë, shtrembërojnë keq rolin dhe parimet organizative të ndërtimit të saj. Ata i shpallin të vjetruara e të kapërcyera idetë e Leninit për këto çështje. Në mënyrë të veçantë ata sulmojnë parimin, sipas të cilit partia është

jo vetëm pararoja e ndërgjegjshme e klasës, por edhe forma më e lartë e organizimit të saj, që karakterizohet nga një unitet mendimi e veprimi dhe së cilës i përket roli udhëheqës në tërë veprimtarinë revolucionare në çdo fushë që ajo zhvillohet. Disa prej tyre e reduktojnë rolin e partisë në një organizatë orientimi e edukimi politik e ideologjik, ose në një qendër koordinuese e informacioni. Të tjerë e identifikojnë atë me gueriljen, ose shprehen për «partneritetin» e barabartë të partisë marksiste-leniniste me partitë dhe organizatat e tjera të klasës punëtore e të masave punonjëse.

Roli udhëheqës i partisë së klasës punëtore në luftën për socializëm, si në kushtet e ekzistencës së një partie, ashtu edhe në kushtet e ekzistencës së shumë partive, është një ligj objektiv. Transformimi revolucionar i shoqërisë kapitaliste mbi baza socialiste është një luftë e gjerë e shumë e ndërlikuar që zhvillohet në forma të shumta dhe në të gjitha fushat — ekonomike, politike, ideologjike e ushtarake. Në këtë luftë klasa punëtore hyn në aleanca me forca shoqërore e politike të ndryshme. Të gjitha format e luftës e të organizimit, të gjitha repartet e lëvizjes revolucionare duhet t'i shërbejnë një qëllimi. Këtej del nevoja e partisë si një qendër e vetme drejtuese, udhëheqëse e organizuese.

Lufta për socializëm ka si bazë teorike ideologjinë e klasës punëtore, marksizëm-leninizmin, i cili është doktrina shkencore që jep kuptimin e vetëm të drejtë të socializmit dhe të rrugëve për realizimin e tij. Bartëse e kësaj teorie, përpunuesja e zbatuesja e saj në jetë nuk mund të jetë asnjë parti e organizatë tjetër veç partisë komuniste të proletariatit, partisë së asaj klase që i përket e ardhmja socialiste e komuniste, që mbron interesat rrënjësore të punonjësve e të të gjitha forcave përparimtare të shoqërisë e që lufton për to, partia e klasës, që, siç ka thënë Marksi, nuk mund të çlirojë vetveten pa çliruar gjithë njerëzimin. Në qoftë se fati i revolucionit i lihet një qendre orientimi të përgjithshme, një organizate thjesht koordinuese ose gueriljes, ai do të futet në qorrsokak dhe do të pësojë disfatë.

Përmbajtja objektive e të gjitha «teorive», që mohojnë nevojën e rolit udhëheqës të klasës punëtore dhe të partisë së saj, është në fakt mohimi i revolucionit, i socializmit dhe i marksizëm-leninizmit. Këto koncepte çojnë ujë vetëm në mullirin e borgjezisë e të kundërrevolucionit. Prandaj demaskimi i tyre dhe mbrojtja e vendosur e mësimeve leniniste mbi hegjemoninë e klasës punëtore, mbi rolin udhëheqës të partisë së proletariatit dhe e parimeve të ndërtimit e të organizimit të saj — përbëjnë sot një detyrë shumë të rëndësishme e aktuale për të zhdukur konfuzionin dhe çoroditjen që kanë krijuar revizionistët në këtë fushë, për të çuar përpara revolucionin, luftën për socializëm e komunizëm.

Revolucioni — rruga e çlirimit të njerëzimit

Ideja se revolucioni është i vetmi mjet për transformimin e botës, e vetmja rrugë për shpëtimin nga zgjedha kombëtare e shoqërore ka pushtuar mendjet e miliona njerëzve në të gjitha kontinentet. Për revolucionin tani flasin të gjithë. Por konceptet mbi përmbajtjen, forcat lëvizëse, rrugët e format e zhvillimit të tij janë nga më të ndryshmet. Të gjitha këto janë objekt i një lufte dhe polemike të madhe ideologjike.

Edhe në këtë çështje me rëndësi jetike revizionistët modernë, me ata sovjetikë në krye, kanë dalë në mbrojtje të interesave të borgjezisë dhe u shërbejnë atyre. Ata përpiqen të mbjellin konfuzion në radhët e revolucionarëve dhe t'i vënë minat revolucionit. Megjithëse për demagogji hiqen sikur janë për revolucionin, me pikëpamjet e veprimet e tyre revizionistët përpiqen ta mbytin që në embrion ose ta sabotojnë kur ai shpërthen. Tërë teorinë e praktikën e revolucionit ata e kanë reduktuar në reformat brenda rendit kapitalist. Ata mundohen t'u mbushin mendjen punonjësve se gjoja në kohën tonë kufiri midis revolucionit e reformave është fshirë plotësisht. Me të madhe ata propagandojnë se klasa punëtore ka mundësi të realizojë transformime rrënjësore në bazën ekonomike të kapitalizmit, të zërë pozita të rëndësishme, të shtjerë në dorë të gjithë pushtetin dhe të realizojë socializmin pa revolucionin me dhunë, pa thyer makinën e shtetit borgjez dhe pa vendosur diktaturën e proletariatit.

Në praktikën e tyre revizionistët kapen vetëm pas kërkesave të ditës. Tërë përpjekjet ata i kanë përqendruar në zgjerimin e demokracisë borgjeze, në perfeksionimin e institucioneve të saj dhe për hir të tyre bëjnë fli qëllimin e fundit. Këtë e tregon sot më së miri gjithë veprimtaria e revizionistëve italianë, francezë e të tjerë, të cilët janë kthyer në bisht të borgjezisë, në mburojë të rendit të saj, kanë tradhtuar interesat jetike të klasës punëtore dhe kanë shkuar aq larg sa të dënojnë me egërsi çdo veprim revolucionar të masave që prek sundimin e borgjezisë. Revizionistët modernë, megjithëse shprehen kundër dhunës revolucionare të masave dhe justifikojnë dhunën e borgjezisë, atje ku janë vetë në fuqi zbatojnë dhunën kundërrevolucionare, siç ndodhi në Çekosllovaki e Poloni, ku me zjarr e hekur shtypën popullin çekosllovak dhe revoltën e klasës punëtore polake. Këtu duket edhe më qartë tradhtia e degjenerimi i plotë i tyre.

Dështimi i teorive evolucioniste e paqësore të revizionistëve modernë vërtetohet edhe nga zhvillimi i ngjarjeve të sotme në botë. Luftërat antiimperialiste e çlirimtare që kanë shpërthyer në Azi, në Afrikë e në Amerikën Latine, revoltat e punëtorëve e të masave punonjëse në vetë vendet e zhvilluara kapitaliste dëshmojnë se alternativa reformiste revizioniste nuk u përgjigjet rea-

litetit dhe aspiratave të masave. Në fakt veprimtaria e sotme revolucionare zhvillohet pa revizionistët dhe kundër vullnetit të tyre. Megjithëkëtë nuk duhet të nënvlerësohet rreziku dhe dëmi i teorive dhe i praktikave revizioniste. Shumë njerëz, ndër të cilët ka edhe revolucionarë të sinqertë, duke hedhur poshtë rrugën reformiste të revizionistëve dhe duke e kritikuar atë, kanë përqafuar disa koncepte të tjera të gabuara mbi revolucionin dhe mbi rrugët e zhvillimit të tij. Kjo lidhet me pozitën klasore mikroborgjeze, me mungesën e formimit të tyre ideologjik marksist-leninist dhe me ndikimet që ushtrojnë mbi ta pikëpamjet anarkiste, trockiste e puçiste. Disa prej tyre revolucionin e konceptojnë si një grusht ushtarak, si vepër të disa «heronjve». Ata mbivlerësojnë e absolutizojnë rolin e «aktivitetit subjektiv» dhe mendojnë se situata revolucionare, si kusht për shpërthimin e revolucionit, mund të krijohet artificialisht nga «veprimet aktive» të një grupi luftarak, i cili shërben si «motor i vogël», që vë në lëvizje «motorin e madh» të masave. Sipas tyre potenciali revolucionar i masave në shoqërinë kapitaliste është kurdoherë gati të shpërthejë, mjafton një shtytje nga jashtë, mjafton të krijohet një vatër guerilleje dhe masat do ta ndjekin atë automatikisht.

Lufta e armatosur e grupit të revolucionarëve profesionistë mund të ushtrojë ndikim në hovin e masave vetëm atëherë kur ajo bashkërendohet me faktorë të tjerë objektivë politikë, socialë e psikologjikë që përcaktojnë lindjen e situatës revolucionare, kur ajo mbështetet në masat e gjera të popullit dhe gëzon simpatinë e përkrahjen e tyre aktive. Ndryshe, siç tregon praktika tragjike e disa vendeve të Amerikës Latine, veprimi i pakicës së armatosur, sado heroik dhe vetëmohues të jetë, ndesh në moskuptimin e masave, izolohet nga masat dhe pëson disfatë.

Revolucionet piqen nga vetë situata, kurse fitorja ose disfata e tyre varen nga gjendja dhe roli i faktorit subjektiv. Këtë faktor nuk mund ta përfaqësojnë vetëm një grup njerëzish, sado të ndërgjegjshëm që të jenë ata për nevojën e revolucionit. Revolucioni është vepër e masave. Pa bindjen, përgatitjen, mobilizimin dhe organizimin e tyre asnjë revolucion nuk mund të fitojë. Faktori subjektiv nuk përgatitet vetëm nga aksionet e «vatrës» guerilje, as vetëm me agjitacion e propagandë. Për këtë, siç na mëson Lenini dhe vetë jeta, është e domosdoshme që masat të binden nëpërmjet eksperiencës së tyre praktike.

Koncepti mbi rolin vendimtar të pakicës së armatosur shoqërohet edhe me pikëpamjet e zhvillimit të luftës vetëm në fshat ose vetëm në qytet, se duhet kapur vetëm pas luftës së armatosur dhe vetëm pas veprimtarisë ilegale. Përhapje të gjerë ka marrë edhe teza trockiste që e sheh revolucionin si një akt të menjëhershëm dhe grevën e përgjithshme politike si të vetmen formë të kryerjes së tij. Të orientohesh nga lufta e armatosur, nuk do të

thotë aspak të heqësh dorë nga të gjitha format e tjera të luftës, nuk do të thotë të përqendrohesh në fshat e të braktisësh luftën në qytet ose anasjelltas, të kapesh vetëm pas objektivit final — marrjes së pushtetit e të lësh pas dore «luftën e vogël» për kërkesat e ngutshme ekonomike, politike e sociale të punonjësve, nuk do të thotë të merresh vetëm me organizimin e forcave të armatosura e të mos përfillësh punën me masat dhe në organizatat e tyre, të punosh e të luftosh vetëm në ilegalitet e të heqësh dorë nga shfrytëzimi i mundësive legale e gjysmë legale etj. Përgatitja e revolucionit nuk është çështje e një dite, por është një punë e gjithanshme e komplekse. Për të duhet punuar e luftuar në të gjitha drejtimet e me të gjitha format, duke i kombinuar ato drejt e duke i ndryshuar kur ndryshojnë situatat, por kurdoherë duke ia nënshtruar arritjes së qëllimit të fundit.

Revolucioni nuk bëhet vetëm nga klasa punëtore dhe aq më pak vetëm nga partia e saj pararojë. Për kryerjen e tij klasa punëtore, sipas karakterit dhe etapave të revolucionit, hyn në aleanca me forca të tjera shoqërore, me të cilat ka interesa themelore të përbashkëta, krijon fronte të gjera popullore me programe të caktuara politike, në të cilat partia e klasës punëtore nuk shkrihet, por ruan kurdoherë pavarësinë e saj organizative e politike. Elementët e ngushtë e sektarë i quajnë të gjitha këto taktika të gabuara që i hapin gjoja dyert rrugës paqësore e reformiste. Sipas tyre programet, frontet, aleancat janë vetëm makinacione artificiale që kanë për qëllim të tërheqin vëmendjen dhe të pengojnë luftën e armatosur. Këto pikëpamje janë jehonë e tezave të njohura të trockistëve, të cilët çdo aleancë e shohin si pajtim klasor, mohojnë etapat e revolucionit dhe janë për revolucionin proletar «të kulluar» e të drejtpërdrejtë.

Revolucioni ka ligjet e tij që janë të përgjithshme e të domosdoshme për çdo vend. Mohimi i këtyre ligjeve të çon në revizionizëm. Duke spekuluar me ndryshimet që bëhen në botë dhe me kushtet e veçanta kombëtare, revizionistët të vërtetat universale të marksizëm-leninizmit i kanë zëvendësuar me tezat e konkluzionet e tyre antimarksiste e kundërrevolucionare. Por jo më pak të dëmshme janë edhe konceptet dogmatike të atyre që nuk përfillin veçoritë kombëtare, largohen nga analiza e gjendjes reale, ndërtojnë skema, në të cilat përpiqen të futin realitetin e vendeve të ndryshme, absolutizojnë eksperiencën e një vendi dhe e japin atë si universale, flasin për një revolucion kontinental dhe mohojnë mundësinë e fitores së revolucionit në një ose disa vende të veçanta.

Në ditët tona, kur vala e revolucionit është në ngjitje, kur në mjaft vende e zona revolucioni qëndron në rend të ditës, kuptimi i drejtë i përmbajtjes, i rrugëve dhe i formave të zhvilli-

mit të tij është vendimtar. Lufta kundër koncepteve revizioniste e antimarksiste të djathta e të majta, lufta për zbatimin krijues të mësimeve themelore të marksizëm-leninizmit për këtë çështje është pjesë përbërëse e luftës klasore, kusht i domosdoshëm për fitoren e revolucionit.

Socializmi mund të ndërtohet vetëm mbi bazën e teorisë marksiste-leniniste

Triumfi i Revolucionit të Tetorit në Rusi shënoi fillimin e epokës së madhe në historinë e njerëzimit, atë të kalimit nga kapitalizmi në socializëm. Që nga ajo kohë socializmi u shndërrua nga një teori shkencore në një realitet të gjallë, i cili, me gjithë tradhtinë revizioniste, ka treguar plotësisht epërsitë e tij të padiskutueshme në të tëra fushat mbi rendin kapitalist. Të gjitha fitoret e socializmit janë arritur mbi bazën e teorisë shkencore të marksizëm-leninizmit.

Si një rend i ri shoqëror, që ndërtohet në kushtet e një lufte të ashpër klasore midis proletariatit dhe borgjezisë në shkallë kombëtare e ndërkombëtare, socializmi nuk mund të zhvillohet qetë, pa vështirësi e kontradikta. Lufta midis dy rrugëve të zhvillimit, rrugës socialiste e kapitaliste, është një luftë e gjatë dhe, përderisa vazhdon ajo, ekziston kurdoherë rreziku i restaurimit të kapitalizmit. Por ky rrezik nuk është fatal, siç përpiqen ta paraqesin ideologët borgjezë. Ai është plotësisht i shmangshëm, në qoftë se partia komuniste u qëndron besnike mësimeve të marksizëm-leninizmit, zhvillon me vendosmëri e konsekuencë luftën e klasave kundër ndikimeve e presioneve të botës së vjetër, di të zgjidhë me sukses vështirësitë e kontradiktat që lindin, në qoftë se i mbyll të gjitha shtigjet mundësisë së degjenerimit borgjez.

Kthimi prapa i Bashkimit Sovjetik dhe i disa vendeve të tjera lidhet pikërisht me faktin se atje u braktisën mësimet e marksizëm-leninizmit dhe u hoq dorë nga parimet themelore të ndërtimit socialist, iu vu kazma fitoreve të revolucionit dhe iu hap rruga rivendosjes së kapitalizmit. Por nuk është ky dëmi i vetëm i madh që revizionistët i sollën socializmit. Për t'i hapur rrugë tradhtisë së tyre ata sulmuan me tërbim vijën revolucionare të ndjekur nga Partia Komuniste Bolshevike, me Stalinin në krye, dhe tërë eksperiencën historike të diktaturës së proletariatit, vunë në dyshim vitalitetin e shkencës marksiste-leniniste për zgjidhjen e problemeve të kohës së sotme, aftësinë e klasës punëtore për transformimin revolucionar të shoqërisë dhe rolin udhëheqës të partisë komuniste. Me të gjitha këto revizionistët hrushovianë u dhanë armë të fuqishme ideologëve borgjezë për propa-

gandën e tyre antikomuniste. Ata u bënë burim i përhapjes së gjithfarë koncepteve antimarksiste mbi socializmin.

Konfuzioni shtohet edhe më shumë ngaqë revizionistët hrushovianë restaurimin e kapitalizmit në Bashkimin Sovjetik e gjetkë përpiqen ta shesin për socializëm. Nga kjo demagogji ngatërrohen edhe shumë njerëz të ndershëm, të cilët, duke kritikuar me të drejtë shumë fenomene negative në jetën e Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të tjera revizioniste, e identifikojnë rendin e tyre me socializmin dhe pasojat e rivendosjes së kapitalizmit ia veshin socializmit. Rrymat e tjera revizioniste, që kanë kontradikta me udhëheqjen sovjetike, kritikojnë «modelin sovjetik të socializmit» si burokratik e totalitar dhe propagandojnë modelin e tyre «demokratik e humanitar», që nuk është veçse një variant tjetër i kapitalizmit. Degjenerimin borgjez të socializmit në vendet ku në fuqi janë revizionistët përpiqen ta shfrytëzojnë edhe elementët e grupet trockiste për të përhapur shpifjet e tyre kundër socializmit, të cilat i kanë inkurajuar vetë revizionistët me teoritë e praktikat e tyre antimarksiste.

Në këto kushte mbrojtja e teorisë dhe e praktikës së socializmit shkencor nga sulmet e deformimet e revizionistëve modernë të ngjyrave e nuancave të ndryshme dhe të rrymave të tjera borgjeze e mikroborgjeze është një nga detyrat më të rëndësishme në luftën e sotme ideologjike. Para së gjithash duhet grisur deri në fund maska socialiste që i kanë vënë vetes revizionistët që janë në fuqi, sidomos krerët sovjetikë.

Në Bashkimin Sovjetik janë likuiduar diktatura e proletariatit dhe partia e proletariatit, në fuqi nuk është më klasa punëtore, por borgjezia e re revizioniste. Shteti dhe partia janë shndërruar në vegla në duart e revizionistëve për të mbrojtur e konsoliduar sundimin e tyre politik e ekonomik. Maskat socialiste dhe komuniste që ata u vënë shtetit dhe partisë së tyre janë vetëm për të mashtruar njerëzit, sepse karakteri i shtetit dhe i partisë nuk përcaktohet nga emrat dhe as vetëm nga përbërja e tyre shoqërore, por në radhë të parë e mbi të gjitha nga politika që ndjekin, kujt i shërben dhe në dobi të kujt është ajo.

Ndryshimi i karakterit të partisë e të shtetit, transformimi kundërrevolucionar në fushën e superstrukturës politike e ideologjike nuk mund të mos çonte në ndryshimin edhe të bazës ekonomike të socializmit. Reformat ekonomike që kanë ndërmarrë hrushovianët, në përputhje me konceptet e tyre ideologjike antimarksiste, çuan në ndryshimin rrënjësor të marrëdhënieve në prodhim. Ata futën në ekonominë sovjetike një sistem të tillë organizimi e drejtimi ku qëllimi i prodhimit u bë nxjerrja e fitimit kapitalist. Shteti i sotëm sovjetik si një kapitalist kolektiv administron mjetet e prodhimit në emër dhe në interes të bor-

gjezisë së re sovjetike. Prona e përbashkët socialiste u shndërrua në një kapitalizëm shtetëror të një tipi të ri.

Duke shtënë në dorë frenat e shtetit e të ekonomisë borgjezia e re sovjetike e përbërë nga burokratët dhe teknokratët, i përdor ato për të siguruar për vete privilegje dhe të ardhura të mëdha. Po thellohet gjithnjë më shumë hendeku midis saj dhe klasës punëtore e masave punonjëse. Ajo ka zëvendësuar shpërblimin sipas punës me një sistem të tërë të ndarjes së të ardhurave, që i jep mundësi të përvetësojë punën dhe djersën e masave punonjëse, të sigurojë në rrugë nga më të ndryshmet të ardhura me dhjetëra herë më të mëdha nga ato të punëtorëve e të fshatarëve.

Në Bashkimin Sovjetik po zhvillohet një proces i thellë shthurjeje, dekadence e degjenerimi në të gjitha fushat — të ideologjisë, moralit, arsimit e kulturës. Po shkallmohen të gjitha vlerat morale e shpirtërore të socializmit. Ideologjia borgjeze me të gjitha pasojat e saj po bëhet ideologjia sunduese. Vendin e normave të moralit komunist për t'i shërbyer me devocion çështjes së popullit po e zë rendja pas interesit personal, individualizmi e karrierizmi. Përpjesëtime të gjera ka marrë mënyra borgjeze e jetesës. Janë braktisur fryma revolucionare dhe partishmëria proletare në art e në kulturë. Shkolla sovjetike kultivon teknokratizmin e intelektualizmin, përgatit kontingjente të reja për revizionistët.

Rivendosja e kapitalizmit brenda në Bashkimin Sovjetik nuk mund të mos çonte në ndryshimin rrënjësor të politikës së tij të jashtme. Udhëheqësit e sotëm sovjetikë e kanë zëvendësuar internacionalizmin proletar me egoizmin nacional dhe shovinizmin e shtetit të madh. Bashkimi Sovjetik është bërë sot një fuqi imperialiste që ndjek një politikë agresive. Nga një bazë e revolucionit botëror, Bashkimi Sovjetik është shndërruar në një bazë të kundërrevolucionit.

Të gjitha këto tregojnë se Bashkimi i sotëm Sovjetik nuk mund të quhet më një vend socialist, por një shtet kapitalist e një fuqi imperialiste. Të këqijat e politikës së tij të brendshme dhe të jashtme nuk janë të këqija të socializmit, siç i paraqet ato propaganda borgjeze, dhe ata që kanë rënë viktima të saj ose i mbajnë ison asaj. Ato janë të këqija të vetë sistemit kapitalist që është rivendosur në Bashkimin Sovjetik. Ato nuk mund të ndreqen me riparime të pjesshme. Çdo iluzion do të ishte tepër i rrezikshëm. Ato do të zhduken vetëm atëherë kur të jenë përmbysur revizionistët dhe të jetë rivendosur diktatura e proletariatit.

Në situatën e krijuar nga tradhtia e revizionistëve sovjetikë dhe nga propaganda antikomuniste e borgjezisë një reklamë e ma-

dhe i bëhet sidomos «sistemit të vetadministrimit» jugosllav si rruga më e mirë e ndërtimit të socializmit. Partizanë të kësaj rruge janë veçanërisht shumë revizionistë në vendet kapitaliste perëndimore. Ajo ka simpatizantët e vet edhe në vendet revizioniste të Evropës Lindore. Teoricienët e «socializmit vetadministrues» pretendojnë se shprehin dhe zbatojnë idetë autentike të Marksit e të Leninit mbi socializmin, të shtrembëruara gjoja në praktikën e derisotme nga «stalinizmi». Në të vërtetë ata kanë ringjallur e marrin në mbrojtje teoritë e vjetra anarkosindikaliste e buhariniste të kritikuara në kohën e vet nga Marksi e Lenini. Argumentet e tyre teorike janë krejt pa baza, kurse realiteti i sotëm jugosllav është prova më e qartë e dështimit të «sistemit të vetadministrimit».

Baza e teorive të revizionistëve jugosllavë është ideja buhariniste e integrimit të kapitalizmit në socializëm. Në arenën ndërkombëtare, sipas tyre, kapitalizmi i pasluftës së Dytë Botërore, krahas me stabilizimin dhe evoluimin e tij në një kapitalizëm shtetëror, po shndërrohet gradualisht në një «socializëm të tipit etatist», duke fshirë kështu kufijtë midis dy sistemeve dhe duke hapur rrugën për një bashkëpunim të gjerë e të gjithanshëm midis tyre, për të minuar në fakt socializmin e vërtetë.

Brenda vendit, revizionistët jugosllavë, si edhe ata gomulkianë, braktisën kolektivizimin e fshatit, i lanë të lirë kulakët të shfrytëzonin e të akumulonin, duke pretenduar se kështu do të integronin ata në socializëm dhe me kapitalet e furnizuara prej tyre do të bënin industrializimin e vendit. Nga ana tjetër, revizionistët jugosllavë copëtuan pronën shtetërore të të gjithë popullit dhe duke e shndërruar atë gjoja në pronë grupi, i hapën rrugën lindjes së një borgjezie të re, e cila mori në dorë frenat e vendit dhe tani sundon mbi klasën punëtore dhe popujt e Jugosllavisë. Njëkohësisht revizionistët blofonin, duke e paraqitur këtë vijë si një proletarizim të regjimit, si luftë kundër formave «burokratike etatiste të socializmit» si një «rrugë të re» për ndërtimin e shoqërisë së vërtetë socialiste. Por gjithë kjo u demaskua dhe jeta vërtetoi kalbësirën.

Për të dalë nga situata e rëndë, nga vështirësitë e kontradiktat e mëdha ekonomike, politike e sociale, pjellë e restaurimit kapitalist, revizionistët jugosllavë, pasi nuk mundën «të ndërtojnë socializmin» me ndihmën e borgjezisë së brendshme e të kapitaleve të saj, u shtrinë dorën imperialistëve amerikanë dhe kapitalistëve të vendeve të tjera. Ata shpikën kështu një «socializëm» të ri, i cili mund të ndërtohet me ndihmën e kredive dhe të investimeve të borgjezisë ndërkombëtare, e në radhë të parë të imperializmit amerikan, armikut më të egër të komunizmit. Fakt është se në Jugosllavinë e sotme vërshimi i kapitaleve dhe investimeve direkte të shteteve e firmave të huaja kapitaliste po

pushton kyçet e ekonomisë kombëtare. Një proces i këtillë po zhvillohet edhe në vendet e tjera revizioniste.

Një shfaqje tjetër e këtij kursi në Jugosllavi është edhe fenomeni masiv i emigrimit të forcave të gjalla krijuese: me qindra mijëra punëtorë, teknikë e specialistë janë detyruar të braktisin familjet e atdheun e tyre dhe të shesin fuqinë e krahut e të mendjes te kapitalistët gjermanë, belgë, francezë etj. Kjo shitje e punonjësve, kjo tregti me njerëzit për të siguruar pak valutë është një nga pamjet më të shëmtuara të realitetit të sotëm jugosllav.

Në Jugosllavi për asnjë integrim të kapitalizmit në socializëm nuk mund të bëhet fjalë. Ajo që ka ndodhur atje dhe që po ndodh edhe në vendet e tjera ku në fuqi janë revizionistët është integrimi i socializmit në kapitalizëm, likuidimi i fitoreve socialiste dhe futja në rrugën kapitaliste.

Revizionistët jugosllavë pretendojnë se në sistemin e tyre afirmohet roli i vërtetë i punonjësit dhe i klasës punëtore në tërësi, e cila gjoja vetadministron mjetet e prodhimit, drejton ekonominë dhe bën shpërndarjen e produktit shoqëror. Në fakt ndodh krejt e kundërta. Copëtimi i pronës shtetërore dhe mohimi i rolit drejtues të shtetit socialist është copëtimi i klasës punëtore, mohim i rolit të saj udhëheqës në jetën e shoqërisë. Praktika jugosllave çon në kundërvënien e interesave të reparteve të ndryshme të klasës punëtore, në konkurrencën dhe luftën midis kolektivave punëtorë. Këtu në plan të parë dalin interesat e ngushta e të çastit të ndërmarrjes, të komunes ose të republikave të veçanta, të cilat u kundërvihen interesave të përgjithshme të shoqërisë.

Në këto kushte klasa punëtore nuk vepron dot si klasë, nuk shpreh e nuk mbron dot interesat e saj të përgjithshme si klasë në fuqi. Në Jugosllavi klasa punëtore e ka humbur prej kohësh rolin e saj hegjemon. Ajo është shndërruar nga një klasë udhëheqëse në fuqi në një klasë që udhëhiqet, shtypet e shfrytëzohet nga borgjezia e re që ka tërë fuqinë në dorë. Partia komuniste e klasës punëtore në Jugosllavi ka degjeneruar plotësisht, ajo është bërë një strehë për shtresat antiproletare që përfaqësojnë e mbrojnë kursin kapitalist.

Jugosllavia e sotme ka të gjitha tiparet e një vendi borgjez dhe vuan po nga ato plagë të rënda e kronike që janë tipike për kapitalizmin, siç janë krizat e thella ekonomike, papunësia, konkurrenca, anarkia e inflacioni, konfliktet e ashpra sociale e politike dhe grindjet nacionale. Kjo situatë ka çuar në krijimin e forcimin e grupimeve dhe tendencave nacionaliste borgjeze, në acarimin e luftës për hegjemoni midis tyre dhe midis republikave. Në skenën e sotme politike jugosllave zotërojnë klanet «serbomëdhenj» e «kroatomëdhenj». Të parëve u kanë vënë etiketën e informbyroistëve, por në fakt ata kanë qenë e janë armiq të betuar të Informbyrosë, aq sa janë edhe vetë udhëheqësit jugosllavë dhe ata hrushovianë sovjetikë.

Revizionistët jugosllavë i kanë vënë popujt e Jugosllavisë dhe klasën punëtore në një darë të fortë, në darën e borgjezisë së brendshme dhe të kapitalizmit të huaj, që po bëhet zot shtëpie. Nga kjo gjendje ata nuk mund t'i shpëtojnë as reformat ekonomike e politike të reklamuara nga revizionistët, as shpresat e iluzionet te këto ose tek ato grupime nacionaliste. E keqja i ka rrënjët të thella dhe ajo mund të shmanget vetëm kur popujt e Jugosllavisë, në rrugën marksiste-leniniste, do ta thyejnë darën që i ka mbërthyer.

Për socializmin sot flitet edhe në disa vende që janë çliruar nga sundimi i vjetër kolonial i imperializmit. Në nocionet «socializëm», «shoqëri socialiste» futet një përmbajtje e ndryshme në vendet e ndryshme. Në këto teori ka shumë gjëra të errëta, konfuze, eklektike, ka një përzierje të parimeve të socializmit me ato të kapitalizmit, të ideologjisë socialiste me ato të ideologjisë borgjeze, nacionaliste e fetare.

Këtyre teorive joshkencore u bëjnë jehonë edhe revizionistët sovjetikë e të tjerë. Ata kanë zbuluar bile edhe një rrugë të re, të ashtuquajturën «rrugë jokapitaliste të zhvillimit» që çon gjoja në socializëm pa rolin udhëheqës të klasës punëtore e të partisë komuniste, pa teorinë marksiste-leniniste, pa revolucionin socialist e diktaturën e proletariatit. Me këto predikime revizionistët hrushovianë e të tjerë çorientojnë tendencat e sinqerta socialiste në këto vende, shtojnë konfuzionin ideologjik dhe paralizojnë luftën e forcave progresive për socializëm. Duke pretenduar se edhe këto vende gjoja kanë hyrë në rrugën e socializmit, revizionistët sovjetikë u japin atyre disa thërrime për t'u marrë shpirtin, për të shtrirë ndikimin e tyre imperialist dhe për t'i tërhequr ata pas qerres së tyre.

Marksistë-leninistët përshëndetin e përkrahin çdo prirje dhe aspiratë të sinqertë drejt socializmit, por në të njëjtën kohë ata theksojnë se socializmi në çdo vend ka fituar dhe mund të fitojë vetëm mbi bazën e marksizëm-leninizmit dhe nën udhëheqjen e klasës punëtore e të partisë së saj të armatosur me botëkuptimin proletar.

Në kohën tonë nuk shtrohet çështja as të kopjohen pseudosocializmat revizionistë, as të shpiken socializma të rinj. Socializmi ekziston dhe zhvillohet si teori e si praktikë. Ai ka grumbulluar një përvojë të pasur historike, që është sintetizuar në teorinë marksiste-leniniste, e cila është vërtetuar në jetë për vitalitetin e saj. Duke u mbështetur në këtë teori shkencore dhe duke e zbatuar atë në kushtet e çdo vendi forcat revolucionare do të gjejnë rrugën e drejtë për në socializëm.

Kuptimi i drejtë i socializmit është një çështje e madhe parimore, sepse ai ndihmon që aspiratat dhe lufta e popujve për socializëm të orientohen drejt, të synojnë në një objektiv të qartë. Prandaj për revolucionarët ka rëndësi të veçantë vendosja e një kufiri dhe e një vije të qartë demarkacioni midis vendeve të vërteta socialiste dhe atyre që mbajnë vetëm emrin socialiste, ashtu siç ka rëndësi edhe dallimi midis partive e forcave të vërteta marksiste-leniniste që luftojnë për socializmin dhe atyre partive që mbajnë vetëm tabela komuniste. Kështu revolucionarët do të dinë më mirë se ku duhet të mbështeten dhe kë duhet të përkrahin. Në këtë mënyrë forcohet uniteti i vërtetë i forcave revolucionare dhe lufta për socializëm shkrihet në një rrymë të vetme, mbi bazën e marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar.

* * *

Në luftën për çështjen e madhe të çlirimit të klasës punëtore e të popujve rriten e forcohen radhët e forcave marksiste-leniniste. Sot, gati kudo ku partitë e vjetra komuniste degjeneruan në revizioniste, janë formuar lëvizje e parti të reja marksiste-leniniste, të cilat kanë marrë në dorë flamurin e revolucionit e të socializmit, të braktisur nga revizionistët modernë.

Pjesëmarrja në Kongresin tonë e një numri kaq të madh delegatësh që përfaqësojnë komunistët e vërtetë revolucionarë nga vendet e Evropës, të Azisë, të Afrikës, të Amerikës Latine dhe të Oqeanisë është dëshmi e gjallë e zhvillimit të hovshëm që ka marrë lëvizja marksiste-leniniste, është një shprehje elokuente e karakterit dhe e unitetit ndërkombëtar të saj.

Rritja e lëvizjes marksiste-leniniste ka ngjallur urrejtjen e tërbuar të reaksionit dhe sidomos të revizionistëve modernë, të cilët shohin në të një armik të tyre të rrezikshëm. Ata përpiqen ta denigrojnë atë dhe t'i vënë gjithfarë etiketash. Por gjithë kjo fushatë sulmesh e shpifjesh dëshmon se lëvizja marksiste-leniniste është në rrugë të drejtë.

Lëvizja marksiste-leniniste zhvillohet në kushtet e një lufte të ashpër klasore në shkallë kombëtare e ndërkombëtare. Partitë dhe grupet e reja kanë përballë armiq të shumtë, reaksionin borgjez, tradhtinë revizioniste, reformizmin socialdemokrat, aventurizmin mikroborgjez. Por presioneve, intrigave e provokacioneve të tyre ato u bëjnë ballë me vigjilencë, qartësi ideologjike e vendosmëri revolucionare.

Në këtë luftë ajo që ka rëndësi dhe që përbën tendencën e përgjithshme të zhvillimit është se forcat marksiste-leniniste rriten, kaliten, organizohen dhe afirmohen për ditë e më shumë si forca politike revolucionare në jetën e vendit të tyre.

Duke u hedhur në luftën e madhe politike, në aksionet konkrete e në lëvizjet revolucionare të punonjësve, ato po forcojnë lidhjet me masat dhe pasurojnë eksperiencën e tyre. Në zjarrin e betejave të reja klasore ato përsosin format e organizimit leninist të partisë dhe të gjithë veprimtarisë së saj, farkëtojnë unitetin e mendimit e të veprimit, forcojnë kompaktësinë e radhëve të tyre.

Në emër të delegatëve të kongresit dhe të të gjithë komunistëve shqiptarë ne u shprehim marksistë-leninistëve, gjithë revolucionarëve të vërtetë, kudo që ndodhen, përshëndetjet e zjarrta e urimet më të mira për fitore gjithnjë më të mëdha në dobi të çështjes sonë të madhe të përbashkët. Ne i sigurojmë ata se Partia e Punës e Shqipërisë do të përkrahë e do ta mbështesë me të gjitha forcat e mundësitë e saj lëvizjen marksiste-leniniste, të gjithë ata që luftojnë kundër imperializmit e revizionizmit, për fitoren e revolucionit e të socializmit. Këtë ne e konsiderojmë si një detyrë internacionaliste të dorës së parë, ashtu si çmojmë solidaritetin dhe përkrahjen që u japin Partisë dhe vendit tonë partitë dhe forcat revolucionare si një faktor shumë të rëndësishëm për çështjen e socializmit në Shqipëri.

Shokë e shoqe delegatë,

Në këtë raport Komiteti Qendror i Partisë ju paraqiti një tablo të përgjithshme të asaj veprimtarie të madhe të Partisë dhe të asaj pune heroike e vetëmohuese të popullit tonë të kryer në pesë vjetët e fundit në të gjitha frontet e ndërtimit socialist. Fitoret e arritura na i mbushin zemrat me gëzim dhe na frymëzojnë, na japin forca të reja për të ecur gjithnjë përpara ballëlart e të sigurt në rrugën e drejtë e të ndritur ku na udhëheq Partia.

Detyrat e problemet që kemi për të zgjidhur janë të shumta e të rënda, por ato janë sa fisnike. aq edhe të lavdishme. Ato synojnë të forcojnë edhe më tej çështjen e socializmit në Shqipëri, dhe t'i japin një hov të ri e të fuqishëm ekonomisë, ndërtimit, kulturës e të gjithë sektorëve të tjerë dhe t'i ngrenë në një shkallë më të lartë, të zbukurojnë edhe më tepër jetën e njerëzve tanë, të garantojnë punën paqësore të popullit, lirinë e pavarësinë e atdheut.

Ne jemi entuziastë e optimistë se objektivat e caktuar do t'i arrijmë e do t'i tejkalojmë. Këtë siguri e bindje e gjejmë në popullin tonë të mrekullueshëm, në mençurinë dhe urtësinë e tij të thellë, në frymën revolucionare dhe duart e arta të klasës punëtore, në patriotizmin e fshatarësisë kooperativiste, në devo-

cionin e inteligjencies popullore, në vrullin e papërmbajtur krijues të rinisë, në energjitë e pashtershme të grave të vendit tonë. Këtë siguri e bindje e gjejmë në Partinë tonë heroike, në vijën e saj të drejtë marksiste-leniniste, në vendosmërinë e komunistëve shqiptarë, që, për çështjen e popullit e të socializmit, ashtu si gjithnjë, janë të gatshëm të kapërcejnë çdo vështirësi e pengesë, të bëjnë çdo sakrificë.

Përpara, shokë, drejt fitoresh të reja për lumturinë e begatinë e popullit dhe të atdheut tonë socialist!

— Rroftë populli ynë heroik, trim e punëtor!

— Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë, udhëheqësja e sprovuar dhe farkëtuesja e të gjitha fitoreve të popullit tonë!

— Lavdi marksizëm-leninizmit!

Botohet, me ndonjë shkurtim, sipas librit: Enver Hoxha «Raport në Kongresin e 6-të të PPSH». Tiranë, 1971

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 262 (7239), 2 nëntor 1971

VENDIM
I KONGRESIT TË 6-TË TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË PËR APROVIMIN E RAPORTIT «MBI VEPRIMTARINË E KOMITETIT QENDROR TË PPSH»

4 nëntor 1971

Kongresi i 6-të i Partisë së Punës të Shqipërisë, pasi dëgjoi dhe diskutoi raportin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, «Mbi veprimtarinë e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë»,

Vendosi:

1. Të aprovojë plotësisht vijën politike dhe veprimtarinë praktike të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

2. Të aprovojë raportin e shokut Enver Hoxha dhe të porositë të gjitha organet dhe organizatat e Partisë që në punën e tyre të udhëhiqen nga tezat, konkluzionet dhe detyrat që shtrohen në të.

KONGRESI I 6-TË I PPSH

Botohet sipas librit: «Kongresi i 6-të i PPSH», (Përmbledhje materialesh). Tiranë, 1972

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 265 (7242), 5 nëntor 1971

VENDIM

I KONGRESIT TË 6-TË TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË PËR APROVIMIN E RAPORTIT TË KOMISIONIT QENDROR TË KONTROLLIT E TË REVIZIONIMIT TË PPSH

4 nëntor 1971

Kongresi i 6-të i Partisë së Punës të Shqipërisë

Vendosi:

Të aprovojë raportin e Komisionit Qendror të Kontrollit e të Revizionimit të PPSH.

KONGRESI I 6-TË I PPSH

Botohet sipas librit: «Kongresi i 6-të i PPSH» (Përmbledhje materialesh). Tiranë, 1972

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 265 (7242), 5 nëntor 1971

REZOLUTË

E KONGRESIT TË 6-TË TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË NË PËRKRAHJE TË LUFTËS ÇLIRIMTARE TË POPULLIT VIETNAMEZ

4 nëntor 1971

Kongresi i 6-të i Partisë së Punës të Shqipërisë, interpret i ndjenjave internacionaliste të të gjithë komunistëve dhe masave punonjëse të Republikës Popullore të Shqipërisë, u dërgon përshëndetjet më të zjarrta luftarake popullit vëlla vietnamez, të gjithë luftëtarëve heroikë të tokës së lavdishme të Vietnamit të Veriut e të Jugut, që janë ngritur të tërë në këmbë dhe po zhvillojnë një luftë legjendare për shpëtimin e atdheut kundër agresorëve imperialistë amerikanë dhe veglave e bashkëpunëtorëve të tyre.

Populli vietnamez, duke përballuar me guxim sakrifica të panumërta, ka shkruar faqe të ndritura heroizmi, u ka dhënë agresorëve barbarë amerikanë grushte dërrmuese ushtarake e politike dhe ka fituar respektin e simpatinë e zjarrtë të të gjithë popujve të botës. Me luftën e tij të armatosur konsekuente ai ka hedhur në erë planet kriminale të imperializmit amerikan për të skllavëruar gjithë Vietnamin dhe për ta kthyer atë në një bazë sundimi e agresioni kundër popujve të tjerë të Azisë, ka dërrmuar mitin e pathyeshmërisë së fuqisë ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe ka provuar se në kushtet e sotme edhe një vend i vogël mund të mposhtë një superfuqi kur ai është i vendosur të bëjë çdo sakrificë dhe të ecë me guxim në rrugën e lirisë e të revolucionit. Populli vietnamez së bashku me popujt trima të Laosit dhe të Kamboxhias po e shndërrojnë Indokinën fushë të disfatës më të rëndë e më të turpshme për imperializmin janki.

Lufta çlirimtare e popullit vietnamez ka marrë sot një rëndësi historike botërore dhe frymëzon të gjithë popujt e shtypur, të gjithë njerëzit liridashës e përparimtarë të botës. Si kurrë

ndonjëherë janë rritur përkrahja dhe solidariteti i popujve për Vietnamin heroik dhe çështjen e tij të drejtë.

Tanimë imperializmin amerikan në Indokinë nuk mund ta shpëtojnë nga disfata as forca ushtarake as fushatat propagandistike dhe as manovrat e ndryshme djallëzore. Doktrina e Niksonit e «vietnamizimit» të luftës ka falimentuar plotësisht, ashtu siç do të dështojnë edhe planet e tjera armiqësore të administratës së tij. Populli heroik vietnamez do t'u bëjë ballë me sukses të gjitha komploteve dhe intrigave të imperialistëve amerikanë dhe miqve të tyre.

Duke i qëndruar besnik porosisë së udhëheqësit të tij të madh Ho Shi Min, populli vëlla vietnamez e ka bërë të qartë se ai nuk do ta pushojë luftën e tij të vendosur derisa të jetë larguar edhe ushtari i fundit amerikan nga Vietnami, derisa të jetë hequr prej andej edhe baza e fundit e ushtrisë së Shteteve të Bashkuara.

Kongresi i 6-të i Partisë së Punës të Shqipërisë, duke rikonfirmuar përkrahjen e vendosur për qëndrimet e drejta të Qeverisë së Republikës Demokratike të Vietnamit dhe të Qeverisë së Përkohshme Revolucionare të Republikës së Vietnamit të Jugut për largimin e trupave amerikanë dhe zgjidhjen e konfliktit vietnamez, shpreh bindjen e patundur se populli vietnamez, me luftën e tij të armatosur, do të fitojë me siguri dhe imperializmi amerikan do të pësojë disfatë të plotë.

Partia e Punës dhe populli shqiptar, si deri tani, do të jenë me gjithë shpirt me popullin trim vietnamez dhe do të përkrahin deri në fund luftën e tij të drejtë për mbrojtjen e Veriut, çlirimin e Jugut dhe bashkimin e atdheut.

Lavdi e fitore popullit heroik vietnamez!

Rrofshin e u forcofshin në shekuj miqësia dhe uniteti luftarak midis popullit shqiptar dhe popullit vietnamez!

KONGRESI I 6-TË
I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Botohet sipas librit: «Kongresi i 6-të i PPSH» (Përmbledhje materialesh). Tiranë, 1972

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 265 (7242), 5 nëntor 1971

VENDIM
I KONGRESIT TË 6-TË TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË PËR APROVIMIN E RAPORTIT «MBI DIREKTIVAT E PLANIT TË PESTË PESËVJEÇAR TË ZHVILLIMIT EKONOMIK E KULTUROR TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË»

6 nëntor 1971

Kongresi i 6-të i PPSH, pasi dëgjoi dhe diskutoi raportin «Mbi direktivat e planit të pestë pesëvjeçar të zhvillimit ekonomik e kulturor të Republikës Popullore të Shqipërisë», mbajtur nga shoku Mehmet Shehu, anëtar i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH dhe Kryetar i Këshillit të Ministrave të RPSH,

Vendosi:

Të aprovojë raportin e mbajtur nga shoku Mehmet Shehu dhe të porositë të gjitha organet dhe organizatat e Partisë, organet shtetërore dhe të ekonomisë, si dhe organizatat e masave, që në veprimtarinë e tyre për zbatimin e planit të pestë pesëvjeçar të udhëhiqen nga tezat, konkluzionet dhe detyrat që shtrohen në këtë raport.

KONGRESI I 6-TË I PPSH

Botohet sipas librit: «Kongresi i 6-të i PPSH» (Përmbledhje materialesh). Tiranë, 1972

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 267 (7244), 7 nëntor 1971

DIREKTIVAT E KONGRESIT TË 6-TË TË PPSH MBI PLANIN E PESTË PESËVJEÇAR TË ZHVILLIMIT TË EKONOMISË DHE TË KULTURËS TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË PËR VITET 1971-1975

6 nëntor 1971

Pesëvjeçari i katërt 1966-1970 ka qenë një periudhë përpjekjesh të mëdha të të gjitha masave punonjëse të vendit, të organizatave të Partisë, të organeve shtetërore të ekonomisë dhe të organizatave të masave për të vënë në jetë vendimet dhe direktivat e Kongresit të 5-të të PPSH.

Vendimet historike të Kongresit të 5-të të PPSH, vendimet e rëndësishme të plenumeve të Komitetit Qendror të Partisë të kësaj periudhe dhe fjalimet programatike të shokut Enver zgjuan forca dhe energji të reja dhe ngritën lart hovin revolucionar të masave të gjera punonjëse.

Zhvillimi i vrullshëm i forcave prodhuese, përsosja e mëtejshme në rrugën revolucionare e marrëdhënieve socialiste në prodhim dhe e superstrukturës politike, revolucionarizimi i mëtejshëm i gjithë jetës së vendit, i ndërgjegjes dhe i koncepteve të njerëzve, janë karakteristikat dalluese kryesore të zhvillimit tonë gjatë pesëvjeçarit të katërt në rrugën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste.

Zbatimi me sukses i vendimeve dhe i direktivave të Kongresit të 5-të të PPSH shënoi një hap të rëndësishëm përpara në ndërtimin e bazës materialo-teknike të socializmit nëpërmjet industrializimit të mëtejshëm socialist të vendit, zhvillimit më të shpejtë të prodhimit bujqësor, sidomos të drithërave të bukës, dhe thellimit të revolucionit tekniko-shkencor. Mbi këtë bazë u ngritën më tej mirëqenia materiale dhe niveli kulturor i popullit dhe u rrit fuqia mbrojtëse e atdheut tonë socialist.

Gjatë periudhës që kaloi, në kushtet e zhvillimit të vrullshëm të luftës revolucionare të popujve për pavarësi kombëtare, demokraci e socializëm, në saje të qëndrimit internacionalist e të luftës së paepur të Partisë sonë të Punës kundër imperializmit, me atë amerikan në krye, dhe kundër revizionizmit modern, klikës socialimperialiste sovjetike në mënyrë të veçantë, është forcuar më tej pozita ndërkombëtare e Republikës Popullore të Shqipërisë, janë rritur autoriteti dhe prestigji ndërkombëtar i saj. Pësoi disfatë të plotë bllokada e egër imperialisto-revizioniste dhe atdheu ynë ka marshuar e marshon përpara në mënyrë të pandalshme në rrugën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste.

I

MBI PLOTËSIMIN E DETYRAVE KRYESORE TË PLANIT TË KATËRT PESËVJEÇAR 1966—1970

Detyrat e planit të katërt pesëvjeçar janë plotësuar me sukses dhe në shumë degë të ekonomisë popullore janë tejkaluar. Ekonomia popullore gjatë kësaj periudhe u zhvillua në mënyrë të gjithanshme dhe me ritme të shpejta në bazë të parimit revolucionar të mbështetjes në forcat e veta.

Industrializimi socialist i vendit u zhvillua më tej në gjerësi e në thellësi, duke shfrytëzuar në mënyrë më të plotë aftësitë prodhuese dhe duke ndërtuar vepra të reja. Prodhimi i përgjithshëm industrial në vitin 1970 ishte 83 për qind më i lartë se në vitin 1965, nga 50-54 për qind sipas direktivave të Kongresit të 5-të të PPSH. Ritmi mesatar vjetor i rritjes së prodhimit në industri ka qenë 12,9 për qind, nga 8,7 për qind që parashikonin direktivat.

Prodhimi i mjeteve të prodhimit (grupi A) në vitin 1970 u rrit 108 për qind kundrejt vitit 1965, nga 65-69 për qind që ishte detyra e pesëvjeçarit. Në fushën e gjeologjisë detyrat për shtimin e rezervave industriale u tejkaluan. Në vitin 1970 prodhimi i naftës bruto u rrit 81 për qind kundrejt vitit 1965, nga 46 për qind që ishte detyra. Detyrat u tejkaluan në nxjerrjen e mineraleve të dobishme, në përpunimin e naftës, në prodhimin e bakrit blister etj. Prodhimi i energjisë elektrike u rrit 2,8 herë kundrejt vitit 1965, nga 2,3 herë që ishte parashikuar. Pesëvjeçari i katërt hodhi bazat e industrisë kimike, e cila është bërë një mbështetje e rëndësishme për një rritje të madhe e të pandërprerë të prodhimit, sidomos të atij bujqësor. Zhvillim të mëtejshëm mori industria mekanike nëpërmjet ngritjes së aftësive të reja prodhuese dhe

përdorimit më të mirë të rezervave të brendshme të saj. Kjo degë e rëndësishme i kreu me sukses detyrat kryesore që i ishin caktuar. Në vitin 1970 vëllimi i prodhimit në industrinë mekanike ishte mbi 3 herë më i madh se në vitin 1965.

Zhvillimi i prodhimit të mjeteve të prodhimit është bërë në harmoni me nevojat për rritjen e prodhimit të mallrave të konsumit të gjerë (grupi B). Në vitin 1970, kundrejt vitit 1965, prodhimi i mallrave të konsumit të gjerë u rrit 58 për qind, nga 33-38 për qind që ishte detyra e pesëvjeçarit. Ritmi mesatar vjetor i rritjes ka qenë 9,5 për qind, nga 6,7 për qind që ishte parashikuar.

Në vitet e pesëvjeçarit të katërt plotësimi i detyrave në lëmin e prodhimit bujqësor ka qenë një ndër çështjet më të rëndësishme të Partisë, të shtetit, të punonjësve të bujqësisë dhe të mbarë punonjësve të vendit. Si pasojë e kuptimit revolucionar të detyrave, u rrit mobilizimi në punë i punonjësve të bujqësisë dhe u ngrit në një shkallë më të lartë drejtimi i bujqësisë nga organet e Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë.

Në vitin 1970 prodhimi i përgjithshëm bujqësor ishte 33 për qind më i madh se ai i vitit 1965, me një ritëm mesatar vjetor rritjeje prej 5,8 për qind. Prodhimi i bimëve të arave u rrit 55 për qind, nga kjo drithërat e bukës 65 për qind. Rritje të mëtejshme patën qumshti, mishi dhe prodhimet e tjera blegtorale.

Në pesëvjeçarin që kaloi plani i hapjes së tokave të reja nga fshatarësia kooperativiste u tejkalua. Aftësia ujitëse u rrit 38 për qind dhe përfshiu 54 për qind të sipërfaqes së tokës arë, nga 46 për qind që ishte në vitin 1965. Vëllimi i punimeve të mekanizuara u rrit 80 për qind, kundrejt 36 për qind që parashikonte plani i katërt pesëvjeçar. Bujqësia u furnizua me mbi 6 herë më shumë plehra kimike në krahasim me pesëvjeçarin e tretë. Gjatë pesëvjeçarit të katërt u kalua në shkallë të gjerë në përmirësimin e racës së lopëve.

Me gjithë këto suksese, plani i tretë pesëvjeçar i prodhimit bujqësor në disa zëra, sidomos dy vjetët e fundit, nuk u plotësua në shkallën e duhur, kryesisht për shkak të kushteve të këqija atmosferike, si dhe për shkak të disa dobësive e të metave në punën e kooperativave dhe të ndërmarrjeve bujqësore shtetërore.

Në pesëvjeçarin e katërt vëllimi i investimeve, në krahasim me pesëvjeçarin e tretë, u rrit 55 për qind dhe i ndërtimeve 46 për qind, nga 34 dhe 18 për qind përkatësisht që ishin parashikuar. Investimet dhe ndërtimet u përdorën për të siguruar zhvillimin me ritme të shpejta të riprodhimit të zgjeruar socialist, për zhvillimin e sektorëve shoqërorë dhe kulturorë, për vënien në jetë të iniciativave revolucionare të punonjësve, si dhe për kapërcimin

e dëmeve të mëdha të shkaktuara nga disa tërmete radhazi gjatë kësaj periudhe.

Përfundime të mira u arritën në zhvillimin e transportit. Në vitin 1970, kundrejt vitit 1965, vëllimi i transportit të mallrave u rrit 53 për qind, nga 41-46 për qind që parashikonte pesëvjeçari. Në transportin e udhëtarëve vëllimi i punës u rrit 108 për qind, nga 83 për qind që ishte detyra. U zgjerua rrjeti hekurudhor dhe u forcua më tej flota tregtare detare.

Mbi bazën e zhvillimit të pandërprerë të prodhimit shoqëror, në vitin 1970, kundrejt vitit 1965, të ardhurat kombëtare u rritën rreth 55 për qind, nga 45-50 për qind që parashikonin direktivat e Kongresit të 5-të të PPSH. Në shpërndarjen dhe në përdorimin e të ardhurave kombëtare karakteristikë themelore kanë qenë shpejtimi i ritmeve të zhvillimit ekonomik e kulturor të vendit, forcimi i aftësisë mbrojtëse të atdheut, shtimi i rezervave dhe rritja e mëtejshme e konsumit të popullit.

Gjatë pesëvjeçarit të katërt u realizua një normë akumulimi prej rreth 34 për qind. Kjo rritje u shoqërua me ngritjen e vazhdueshme e të përgjithshme të konsumit të popullit. Në vitin 1970, kundrejt vitit 1965, fondi i konsumit u rrit 30 për qind, ose 2,1 herë më shumë se rritja e përgjithshme e popullsisë. Të ardhurat reale për frymë të popullsisë në vitin 1970, kundrejt vitit 1965, u shtuan 17 për qind. Në pesëvjeçarin që kaloi janë zbatuar masa të rëndësishme për ngritjen e nivelit të jetesës së punonjësve. U hoqën tatimet dhe taksat mbi të ardhurat e punonjësve. Sot Shqipëria është një vend ku nuk zbatohet asnjë lloj tatimi e takse e drejtpërdrejtë mbi të ardhurat e popullsisë. U ulën çmimet për një sërë artikujsh të konsumit të gjerë dhe u zbatuan një varg masash favorizuese për kooperativat bujqësore. Qarkullimi i mallrave të tregtisë me pakicë në vitin 1970 u rrit 45 për qind kundrejt vitit 1965, nga 25-27 për qind që ishte detyra.

Janë zbatuar masa të rëndësishme për përmirësimin e kushteve të banimit, duke e bërë këtë çështje të drejtpërdrejtë të masave punonjëse. Gjatë viteve të pesëvjeçarit të katërt u ndërtuan rreth 73 mijë apartamente e ndërtesa të reja banimi, nga të cilat rreth 29 mijë në qytete (13 mijë apartamente më shumë se parashikimi) dhe rreth 44 mijë banesa në fshatra. Në vitin 1970 përfundoi elektrifikimi i të gjitha fshatrave dhe vendi ynë u bë një ndër vendet e pakta në botë me fshatra të elektrifikuara.

Duke punuar për të vënë në jetë direktivat e Kongresit të 5-të dhe vendimet e Plenumit të 8-të të KQ të PPSH, gjatë pesëvjeçarit të katërt u morën masa rrënjësore për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës dhe të sistemit arsimor në përgjithësi. Në vitin 1970 numri i nxënësve e i studentëve në të gjitha kategoritë

e shkollave arriti në 661 mijë nga 541 mijë që parashikohej në pesëvjeçarin e katërt. Arsimi i detyrueshëm 8-vjeçar u zbatua me sukses në të gjithë vendin. Në vitin 1970 numri i kuadrove të lartë arriti në 15 mijë e 200 dhe ai i kuadrove të mesëm në 37 mijë e 700, nga 9 mijë e 200 dhe 22 mijë e 500 që ishin përkatësisht në vitin 1965.

Shërbimi shëndetësor ka marrë dhe po merr gjithnjë e më shumë karakter parambrojtës. U zgjerua më tej rrjeti i institucioneve shëndetësore dhe numri i shtretërve u tejkalua 8 për qind në krahasim me detyrën. Shtesa natyrore e popullsisë së vendit tonë është nga më të lartat në Evropë. Mesatarja e jetës së popullit në vitin 1970 arriti në 68 vjet.

Të gjitha këto dëshmojnë se në pesëvjeçarin e katërt në të gjitha fushat e veprimtarisë ekonomike e shoqërore të vendit janë arritur rezultate të shkëlqyera. Megjithatë, në tërë këtë proces zhvillimi dinamik e përparimi ka pasur edhe vështirësi, të meta e mungesa të ndryshme, objektive e subjektive. Mënjanimi në kohë i tyre do të bënte të mundur arritjen e përfundimeve më të mëdha në shtimin e prodhimit shoqëror dhe në zhvillimin e të gjitha veprimtarive të tjera.

Zhvillimi i pareshtur i forcave prodhuese në pesëvjeçarin e katërt është shoqëruar e mbështetur në përsosjen e mëtejshme të marrëdhënieve socialiste në prodhim. Revolucionarizimi i marrëdhënieve në prodhim kurdoherë është lidhur ngushtë me thellimin e revolucionit ideologjik e kulturor, me ngushtimin e mëtejshëm të dallimeve esenciale ndërmjet fshatit e qytetit, punës fizike e punës mendore dhe është bërë në kushtet e fuqizimit të vazhdueshëm të bazës materialo-teknike të socializmit.

Në bazë të rezultateve të arritura në zhvillimin e gjithanshëm dhe me ritme të shpejta të forcave prodhuese, në ngritjen dhe përmirësimin e nivelit material e kulturor të popullit, në revolucionarizimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ekonomiko-shoqërore të njerëzve, në forcimin e pushtetit popullor dhe në rritjen e aftësisë mbrojtëse të atdheut, Kongresi i 6-të i PPSH nxjerr përfundimin se detyrat që caktoi Kongresi i 5-të i PPSH për planin e katërt pesëvjeçar në përgjithësi janë plotësuar me sukses.

Karakteristikë dalluese e pesëvjeçarit të katërt janë sukseset e arritura në të gjitha fushat e zhvillimit të jetës sonë materiale e shpirtërore. Ato janë rezultat i punës vetëmohuese të masave punonjëse të udhëhequra nga Partia, i zbatimit të parimit të mbështetjes në forcat e veta. Ato janë një dëshmi e gjallë e drejtësisë së vijës së përgjithshme dhe të politikës ekonomike të Partisë e të pushtetit popullor për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste. Këto fitore të shkëlqyera kanë krijuar një bazë më të fuqishme për të ecur përpara.

II

MBI DETYRAT KRYESORE TË ZHVILLIMIT TË EKONOMISË DHE TË KULTURËS NË PLANIN E PESTË PESËVJEÇAR 1971-1975

Zhvillimi ekonomik dhe shoqëror i arritur, fitoret e mëdha në frontin ideologjik dhe kulturor, përsosja në rrugë revolucionare e marrëdhënieve socialiste në prodhim dhe revolucionarizimi i gjithë jetës së vendit kanë krijuar kushte objektive dhe subjektive për të parashikuar në pesëvjeçarin e pestë detyra akoma më të mëdha në rrugën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Këto detyra të pesëvjeçarit të ri, në bazë të orientimeve paraprake të Komitetit Qendror të Partisë, janë shqyrtuar gjerësisht dhe janë hartuar drejtpërdrejt nga masat punonjëse, të cilat kanë shfaqur mendime e propozime shumë të vlefshme dhe kanë ndërmarrë një varg iniciativash e lëvizjesh revolucionare.

Kongresi i 6-të i PPSH, duke u udhëhequr nga vija e përgjithshme e Partisë për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste, mbështetur në kushtet e reja të krijuara, si dhe duke përpunuar e përgjithësuar përvojën e masave punonjëse, cakton këtë detyrë themelore për zhvillimin e ekonomisë popullore gjatë pesëvjeçarit të pestë 1971-1975:

Të sigurohet furnizimi i përgjithshëm i ekonomisë popullore në rrugën e kthimit të Shqipërisë nga një vend bujqësor-industrial në një vend industrialo-bujqësor, me qëllim që të rritet shkalla e vetëveprimit të ekonomisë, të forcohet më tej rendi socialist, të ngrihet mirëqenia materiale e kulturore e popullit, duke ngushtuar sidomos dallimet esenciale midis fshatit e qytetit dhe të rritet aftësia mbrojtëse e vendit.

Për këtë:

Të luftohet për një zhvillim të mëtejshëm të industrisë, duke përmirësuar strukturën e saj me degë e prodhime të reja, sidomos të industrisë së rëndë përpunuese, për të zgjeruar bazën energjetike dhe të lëndëve të para dhe për të shfrytëzuar më racionalisht burimet dhe pasuritë e vendit.

Të arrihet një rritje më e madhe e prodhimit bujqësor nëpërmjet intensifikimit të mëtejshëm të tij, duke u mbështetur në forcimin e organizimit e të drejtimit shkencor të prodhimit dhe në fuqizimin e bazës materialo-teknike të bujqësisë.

Të zhvillohet me vrull përparimi tekniko-shkencor në të gjitha degët e ekonomisë popullore, të përsosen pa ndërprerje marrëdhëniet socialiste në prodhim, të thellohet revolucioni socialist në fushën e ideologjisë e të kulturës, të zbatohet me vendosmëri parimi i mbështetjes në forcat e veta.

Treguesit më kryesorë të zhvillimit të ekonomisë popullore gjatë pesëvjeçarit të pestë të rriten si vijon (në përqindje):

	Viti 1975 kundrejt vitit 1970
— Prodhimi i përgjithshëm industrial	61—66
— Prodhimi i përgjithshëm bujqësor (në pesëvjeçarin e pestë kundrejt pesëvjeçarit të katërt) për të pesë vjetët të marrë së bashku	50—55
— Investimet gjithsej (në pesëvjeçarin e pestë kundrejt pesëvjeçarit të katërt) për të pesë vjetët të marrë së bashku	70—75
— Transporti i mallrave gjithsej	65—70
— Numri i punonjësve për të gjithë ekonominë popullore (duke përfshirë edhe kooperativistët)	15—17
— Rendimenti i punës:	
— Në industri	26—28
— Në ndërtim	34—36
— Të ardhurat kombëtare	55—60

Zhvillimi i industrisë

Gjatë pesëvjeçarit të pestë të çohet më përpara procesi i industrializimit socialist të vendit, duke e konsideruar industrinë si degën drejtuese të zhvillimit të ekonomisë popullore dhe duke i dhënë prioritet rritjes së prodhimit të mjeteve të prodhimit.

1. Prodhimi i mjeteve të prodhimit (grupi A) në vitin 1975, kundrejt vitit 1970, të rritet 78-83 për qind dhe prodhimi i mallrave të konsumit (grupi B) 40-44 për qind.

2. T'i jepet epërsi zhvillimit të industrisë së nxjerrjes e përpunimit të naftës dhe industrisë minerare. Në vitin 1975 nxjerrja e naftës bruto të rritet rreth 82 për qind më shumë se në vitin 1970; nxjerrja e gazit natyror të rritet rreth 2,8 herë. Të kalohet në përpunimin e thellë të naftës. Në vitin 1975 të përpunohet rreth 84 për qind më shumë naftë bruto se në vitin 1970. Nxjerrja e qymyrgurit në vitin 1975 të rritet rreth 105 për qind më shumë kundrejt vitit 1970, e mineralit të kromit rreth 93 për qind më shumë, e mineralit të bakrit rreth 77 për qind më shumë, e hekur-nikelit rreth 62 për qind më shumë etj.

3. Të intensifikohen e të zgjerohen punimet për kërkim- zbulimin e naftës, të gazit e të mineraleve të dobishme dhe të rriten shkalla e cilësia e punimeve dhe e studimeve gjeologjike.

Për zbulimin e rezervave të naftës e të gazit të ngrihet në një nivel më të lartë përgatitja e strukturës dhe e shesheve që i nënshtrohen shpim-kërkimit, duke shtuar vëllimin dhe duke përmirësuar cilësinë e punimeve gjeofizike.

Gjatë këtij pesëvjeçari të fillojnë nxjerrja e mineralit të fosforiteve dhe pasurimi i azbestit, duke fuqizuar bazën e lëndëve të para për shtimin e plehrave fosfatike dhe të prodhimeve prej eterniti.

4. Të hidhen bazat e metalurgjisë së zezë, duke prodhuar për herë të parë në vend gizë për derdhje dhe çeliqe. Të zgjerohet metalurgjia me ngjyra. Prodhimi i bakrit blister të rritet rreth 63 për qind, ndërsa prodhimi i bakrit të rafinuar rreth 1,8 herë. Zhvillimi i industrisë metalurgjike të synojë krijimin e kushteve për të zgjeruar më tej në të ardhmen industrinë e ndërtimit të makinave.

5. Të zhvillohet me ritme të shpejta industria kimike. Në vitin 1975, kundrejt vitit 1970, prodhimi i industrisë kimike të rritet 124-128 për qind më shumë. Të prodhohen për herë të parë në vendin tonë uréja, polivinilkloridi, acidi klorhidrik dhe karbonate me cilësi të lartë, vajra lubrifikante, gaz i lëngët etj. Të krijohen kushtet për të zhvilluar në të ardhmen petrokiminë, si një degë me perspektivë e industrisë kimike.

6. Industria elektrike t'u paraprijë zhvillimit të industrisë në tërësi dhe degëve të tjera të ekonomisë popullore. Në vitin 1975 prodhimi i energjisë elektrike të jetë mbi 2 herë më shumë se në vitin 1970.

7. Të zhvillohet më tej industria mekanike, prodhimi i së cilës në vitin 1975 të jetë 102-106 për qind më shumë se në vitin 1970. Detyrat kryesore të zhvillimit të industrisë mekanike të jenë: prodhimi me ritme të shpejta i pjesëve të ndërrimit dhe përmirësimi i cilësisë së tyre, mirëmbajtja e makinerive dhe e pajisjeve të ndryshme të ekonomisë popullore, si dhe prodhimi i makinerive dhe i pajisjeve të reja të nevojshme për ekonominë.

8. Prodhimi i materialeve të ndërtimit në vitin 1975 të jetë 100-103 për qind më shumë se në vitin 1970, prodhimi i çimentos në vitin 1975 të rritet rreth 2,9 herë më shumë se në vitin 1970 dhe prodhimi i tullave e i tjegullave të rritet rreth 45 për qind në krahasim me vitin 1970.

9. Prodhimi i industrisë së drurit dhe i asaj të letrës në vitin 1975 të rritet 35-39 për qind kundrejt vitit 1970. Të merren masa të mëtejshme për të përmirësuar teknologjinë e prodhimit dhe për ta përdorur me kursim të madh lëndën e drurit. Kooperativat bujqësore t'i shtojnë përpjekjet për t'i plotësuar më mirë me forcat e veta nevojat për lëndë druri.

10. Gjatë pesëvjeçarit të pestë të përdoren drejt të gjitha mundësitë për rritjen e mëtejshme të mallrave të përdorimit të gjerë, të merren masa për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe zgjerimin e asortimentit, duke rritur, ripërtëritur e mo-

dernizuar aftësitë prodhuese, duke krijuar linja e reparte të reja për ato mallra për të cilat ka kërkesa më shumë. Kolektivat e ndërmarrjeve të industrisë së rëndë të japin një ndihmë më të madhe për të shtuar mallrat e përdorimit të gjerë. Prodhimi i industrisë së lehtë dhe i asaj ushqimore në vitin 1975 të arrijë 40-43 për qind më shumë se në vitin 1970.

Zhvillimi i bujqësisë

Bujqësia ka qenë dhe mbetet një nga degët më të rëndësishme të ekonomisë popullore. Prodhimi bujqësor të karakterizohet nga rritja me prioritet e prodhimit të drithërave të bukës dhe e bimëve industriale, nga zhvillimi i shpejtë i blegtorisë, në radhë të parë i lopës, si dhe nga shtimi më i madh i pemëtarisë. Shtimi i prodhimit dhe plotësimi i nevojave gjithnjë në rritje për drithëra mbeten detyra themelore e gjithë bujqësisë.

1. Prodhimi i bimëve të arave gjatë pesëvjeçarit të pestë të rritet 60-65 për qind kundrejt pesëvjeçarit të katërt. Prodhimi i drithërave të bukës të rritet rreth 50 për qind për të pesë vjetët së bashku. Prodhimi i patates të konsiderohet burim i rëndësishëm për shtimin e fondit të drithërave dhe të rritet 80-85 për qind kundrejt pesëvjeçarit të katërt. Të sigurohet një rritje e konsiderueshme e prodhimit të orizit, duhanit, pambukut, luledielli, fasules dhe perimeve.

2. Rritja e rendimenteve të konsiderohet rruga kryesore për shtimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale. Nga rritja e rendimenteve të sigurohet rreth 80 për qind e rritjes së prodhimit të përgjithshëm bujqësor për të gjithë pesëvjeçarin e pestë.

Plehërimi i tokës, në radhë të parë me plehra organike, të jetë në rendin e ditës të punonjësve të bujqësisë. Në përdorimin e plehrave organike e kimike të gërshetohen të dhënat e shkencës me përvojën e përparuar të punonjësve të bujqësisë, për të rritur efektivitetin e përdorimit të tyre. Në vitin 1975 aftësia ujitëse të përfshijë rreth 58 për qind të sipërfaqes së tokës arë.

3. Gjatë këtij pesëvjeçari të hapen e të mbillen 92 mijë hektarë toka të reja, nga të cilat 60 mijë hektarë për ara. Për hapjen e tokave dhe sistemimin e tyre në tërësi të organizohen aksione masive në të gjitha rrethet e vendit. Të merren masa të rrepta për ruajtjen e fondit të tokës.

4. Zhvillimi i blegtorisë të bëhet duke mbajtur parasysh kërkesat gjithnjë në rritje të popullsisë dhe të ekonomisë për produkte blegtorale, sidomos për qumësht, mish e vezë. Prodhimet blegtorale të rriten 38-41 për qind më shumë se në pesëvjeçarin e katërt. Në vitin 1975, në krahasim me vitin 1970, prodhimi

i qumshtit të rritet 68-72 për qind, i mishit 42-46 për qind dhe i vezëve 100-105 për qind.

Krahas shtimit në numër, të luftohet për përmirësimin e ndjeshëm të racës së lopës, për një strukturë më të drejtë në tufën e gjedhit, për shtimin e mëtejshëm të derrit e të shpendëve, si dhe për harmonizimin më mirë të bagëtive të imëta me zhvillimin e përgjithshëm të blegtorisë. Të bëhet kthesë rrënjësore për sigurimin e bazës ushqimore, si kusht vendimtar për intensifikimin e prodhimit blegtoral. Të merren masa për përpunimin, kombinimin dhe shpërndarjen sa më të drejtë të ushqimeve të ndryshme, sipas llojeve dhe kategorive të bagëtive.

5. Të krijohen blloqe të reja të mëdha me pemë në të gjithë vendin, sidomos në zonat kodrinore e malore. Të tregohet kujdes i madh për të mirëmbajtur e përmirësuar pemët, ullishtet e vreshtat ekzistuese. Gjatë pesëvjeçarit të mbillen 32 mijë hektarë me pemë, ullinj e vreshta. Në krahasim me pesëvjeçarin e katërt, prodhimi i pemëve të rritet 49-53 për qind.

6. Ekonomia pyjore të plotësojë më mirë nevojat në rritje të vendit për lëndë druri. Të merren masa për shtimin e aftësisë prodhuese të pyjeve, duke përdorur metoda të përparuara shkencore për mirëmbajtjen, ripërtëritjen dhe shfrytëzimin e tyre, si dhe për krijimin e pyjeve të reja.

7. Në vitin 1975 numri i traktorëve (të kthyer në 15 kuaj-fuqi) të rritet rreth 40 për qind kundrejt vitit 1970, duke përmirësuar strukturën e tyre dhe duke shtuar më tej parkun e makinave të tjera bujqësore. Të merren masa për të rritur shkallën e gatishmërisë së mjeteve të mekanizuara, duke forcuar e specializuar bazat e riparimit dhe uzinat ekzistuese, për shtimin e prodhimit të pjesëve të ndërrimit, përgatitjen e agregatëve për riparim dhe për zgjerimin e prodhimit të pajisjeve bujqësore. Në zonat kodrinore e malore të merren masa që të zgjerohen punimet me mjete të tërhequra nga kafshët.

8. Të thellohet më tej procesi i përqendrimit dhe i specializimit të prodhimit bujqësor në përshtatje me kushtet ekonomike dhe natyrore, duke mbajtur parasysh kërkesat e përgjithshme të zhvillimit të vendit, leverdinë e prodhimeve bujqësore e blegtorale dhe harmonizimin e interesave të çdo ndërmarrjeje shtetërore e kooperative bujqësore me interesat e ekonomisë në tërësi.

9. Plotësimi më mirë i nevojave të bujqësisë me kuadro, kualifikimi i mëtejshëm profesional i punonjësve të bujqësisë, rritja e dashurisë për mjeshtërinë e bujkut, kërkesat për një pjesëmarrje më të gjerë dhe për një disiplinë të fortë në punë nga ana e kooperativistëve, të konsiderohen si faktorë të rëndësishëm për të forcuar organizimin dhe tejkalimin e prodhimit, si dhe për të rritur rendimentin e punës në bujqësi.

10. Të tregohet një vëmendje e veçantë për ngritjen e nivelit

të organizimit dhe të drejtimit të kooperativave bujqësore, për t'i kthyer ato në ekonomi moderne të prodhimit të madh socialist. Në rrethe të caktuara të vendit, në zonën fushore, të organizohen kooperativa të tipit të lartë me pjesëmarrjen e shtetit. Ndërmarrjet bujqësore shtetërore të bëhen shembull nga çdo pikëpamje për kooperativat bujqësore.

Investimet dhe ndërtimet kapitale

Në pesëvjeçarin e pestë investimet dhe ndërtimet kapitale të drejtohen për të zhvilluar në mënyrë harmonike si degët e prodhimit material ashtu edhe sektorët shoqërorë e kulturorë, si industrinë ashtu edhe bujqësinë, si qytetin ashtu edhe fshatin, duke krijuar kushte më të mira për rritjen sistematike të nivelit material dhe kulturor të popullit.

1. Vëllimi i investimeve që përballohet nga shteti, të jetë 70-75 për qind më i madh se në pesëvjeçarin e katërt, ndërsa vëllimi i ndërtimeve të rritet 42-45 për qind. Investimet për sektorët prodhues të rriten rreth 80 për qind në krahasim me pesëvjeçarin e katërt, ndërsa investimet për sektorët shoqërorë, kulturorë etj. të rriten rreth 55 për qind, duke siguruar përmirësimin e mëtejshëm të strukturës së investimeve kapitale. Pesëvjeçari i pestë karakterizohet nga investime dhe ndërtime në përpjesëtime të mëdha, nga ndërtimi i veprave të mëdha, me teknikë të ndërlikuar, siç janë Kombinati Metalurgjik, Hidrocentrali i madh i Fierzës, Uzina e Përpunimit të Thellë të Naftës, Uzina e Prodhimit të Urésë, Fabrika për Prodhimin e Parafabrikateve të Gatshme për Ndërtim Banesash, Kombinati Poligrafik e shumë vepra të tjera në të gjitha degët e ekonomisë popullore.

2. Vëmendja e punonjësve të projektimit e të ndërtimit të përqendrohet në thjeshtësimin e ndërtimeve, në përsosjen e organizimit të punës dhe në rritjen e shkallës së mekanizimit të punimeve. Të rritet cilësia e ndërtimeve, të shkurtohen afatet e ndërtimit dhe të vënies në shfrytëzim të veprave duke rritur efektivitetin e përdorimit të mjeteve dhe të fondeve të investimeve. Kujdes i veçantë t'u kushtohet studimit, projektimit dhe zbatimit të veprave të mëdha të pesëvjeçarit.

3. Të forcohet e të përmirësohet puna në studimet urbanistike, për zhvillimin e harmonizuar të qyteteve e të fshatrave dhe për shfrytëzimin më racional të tokës, duke bërë ndërtime në blloqe të mëdha dhe me shumë kate. Urbanistika të mbajë kurdoherë parasysh zgjidhjen sa më të mirë të problemeve shoqërore dhe ekonomike që lidhen me zhvillimin e qyteteve dhe të fshatrave.

4. Të luftohet prirja për të përhapur forcat dhe mjetet në

ndërtimin e shumë veprave në të njëjtën kohë, të ngrihet shkalla e përqendrimit të punimeve dhe të synohet që veprat të vihen në shfrytëzim faza-faza. Ndërtimi i veprave të thjeshta e shumë të thjeshta me përdorimin e materialeve rrethanore të konsiderohet si një rrugë e shpejtë që ndihmon për rritjen e prodhimit shoqëror.

5. Kooperativat bujqësore t'i rritin më tej fondet dhe mjetet për investime kapitale; duke kombinuar drejt interesat e tyre me ato të përbashkëtat dhe interesat e çastit me ato të perspektivës. Të zgjerohet e të forcohet aftësia ndërtuese e vetë kooperativave bujqësore dhe prodhimi i materialeve të ndërtimit të tyre, të forcohet puna studimore për një shpërndarje e përdorim sa më të drejtë të veprave që ndërtohen dhe të mjeteve që investohen.

Zhvillimi i transportit

Gjatë pesëvjeçarit të pestë të zhvillohen dhe të intensifikohen të gjitha llojet e transportit mbi bazën e përdorimit më të mirë të aftësive transportuese, shtimit të mëtejshëm të tyre, sidomos në transportin hekurudhor dhe të organizimit më të mirë të transportit.

1. Në vitin 1975, kundrejt vitit 1970, me transportin automobilistik të kryhet një vëllim pune rreth 39 për qind më i madh. Të merren masa për t'i përmirësuar më tej përpjesëtimet në parkun e mjeteve midis kamionëve dhe rimorkiove, duke rritur përdorimin e këtyre të fundit. Të thellohet puna për riorganizimin e transportit automobilistik, me qëllim që të përdoren më mirë mjetet dhe të përballohet një vëllim pune më i madh. Të rritet shkalla e mekanizimit të proceseve të punës të ngarkim-shkarkimeve.

2. Një zhvillim të veçantë të marrë transporti hekurudhor, duke përmirësuar shfrytëzimin e linjave dhe të mjeteve ekzistuese dhe duke ndërtuar linja të reja. Rrjeti hekurudhor të rritet rreth 42 për qind në krahasim me atë të vitit 1970. Në vitin 1975, kundrejt vitit 1970, me transportin hekurudhor të mallrave të kryhet një vëllim pune rreth 3 herë më i madh se në vitin 1970.

3. Transporti detar i jashtëm të luajë një rol më të madh në përballimin e nevojave të eksport-importit dhe vëllimi i punës së tij të rritet rreth 27 për qind. Në vitin 1975, kundrejt vitit 1970, transporti detar i brendshëm të kryejë një vëllim pune gati dy herë më të madh. Të merren masa për zhvillimin e mëtejshëm të porteve dhe të rritet aftësia e kantierit detar për mirëmbajtjen e mjeteve ekzistuese dhe ndërtimin e mjeteve të reja.

4. Me transportin automobilistik dhe atë hekurudhor të udhëtarëve të kryhet një vëllim pune rreth 27 për qind më i madh. Transporti hekurudhor t'u përgjigjet më mirë nevojave për lëviz-

jen e udhëtarëve midis qyteteve kryesore, ndërsa transporti automobilistik të përqendrohet më shumë në lëvizjet tranzit me stacionet hekurudhore, në shërbimin urban, në transportimin e punëtorëve në kantieret e mëdha të ndërtimit, si dhe në transportimin e udhëtarëve nga qendrat e rretheve në periferi.

Të forcohet baza materialo-teknike e ndërlidhjes. Të shtohet numri i centraleve automatike dhe brenda pesëvjeçarit të përfundojë telefonizimi i fshatrave.

5. Rendimenti i mjeteve të transportit në vitin 1975, kundrejt vitit 1970, për transportin automobilistik dhe atë hekurudhor të rritet rreth 17 për qind për secilin, ndërsa për transportin detar të brendshëm rreth 38 për qind.

Mbi rendimentin e punës, regjimin e kursimit dhe eksportin

1. Rritja e rendimentit të punës me ritme të larta të konsiderohet faktori kryesor për shtimin e prodhimit shoqëror, për zgjidhjen, në shkallën dhe në kohën e duhur, të kërkesave të riprodhimit të zgjeruar socialist, për mbajtjen e ritmeve të larta të akumulimit dhe për ngritjen e mëtejshme të nivelit material e kulturor të masave punonjëse. Nga rritja e rendimentit të punës të sigurohet rreth 70 për qind e rritjes së prodhimit shoqëror, rreth 56 për qind e rritjes së prodhimit industrial dhe 90 për qind e rritjes së vëllimit të ndërtimeve.

Të luftohet për një kuptim më të drejtë revolucionar të rendimentit të punës, për të harmonizuar sa më mirë rrugët e zhvillimit të prodhimit shoqëror dhe për të nxitur iniciativat krijuese të punonjësve. Vëmendja kryesore për rritjen e rendimentit të përqendrohet në ngritjen e shkallës së mekanizimit, në përmirësimin e vazhdueshëm të teknologjisë së prodhimit, në përsosjen e organizimit dhe në forcimin e disiplinës së punës, si dhe në kualifikimin e vazhdueshëm të punonjësve.

2. Të ngrihet në një shkallë më të lartë lufta për përdorimin racional të mjeteve që investohen, lufta për kursimin e fondit të drithit, për kursimin e lëndës së drurit, për zëvendësimin e druve të zjarrit me lëndë të tjera djegëse, për përdorimin racional të ambalazheve, për uljen e normativave të shpenzimit të karburanteve, të çeliqeve, të autogomave etj. Pikësynimi të jetë që me shpenzime sa më të pakta të punës së gjallë e të materializuar të arrihet një efekt ekonomiko-shoqëror sa më i lartë.

3. Të luftohet për një rritje të madhe e sistematike të eksportit dhe për përmirësimin e strukturës së tij, duke e zgjeruar eksportin e produkteve të përpunuara. Eksporti të rritet rreth 67 për qind më shumë se në pesëvjeçarin e katërt. Zbatimi i kësaj detyre

kërkon një mobilizim të madh, të përgjithshëm, të vazhdueshëm dhe gjithmonë në rritje të të gjitha ndërmarrjeve e organizatave prodhuese dhe të organizatave të tregtisë së jashtme.

Të merren masa për kursime sa më të mëdha në fushën e importit, duke zgjeruar prodhimin në vend të pjesëve të ndërrimit, të makinerive e pajisjeve të ndryshme, të mallrave metalike të përdorimit të gjerë, të pajisjeve elektrike, laboratorike, të kimikateve etj., si dhe duke ulur normativat e përdorimit të lëndëve të para e të materialeve. Plotësimi me sukses i detyrave të planit në prodhimin e pambukut dhe të bimëve vajore të përbëjë një nga fushat e rëndësishme të luftës për shkurtimin e importit.

Ngritja e mirëqenies materiale dhe e nivelit kulturor të punonjësve

Ngritja dhe përmirësimi i vazhdueshëm e i përgjithshëm i mirëqenies materiale dhe i nivelit kulturor të popullit të përbëjnë, si kurdoherë, qëllimin kryesor të prodhimit tonë socialist.

1. Të ardhurat kombëtare në vitin 1975, kundrejt vitit 1970, të rriten 55-60 për qind. Shpërndarja dhe përdorimi i të ardhurave kombëtare të bëhen në përputhje me nevojat për intensifikimin e mëtejshëm të ekonomisë popullore dhe të synojnë zhvillimin me ritme të shpejta të forcave prodhuese, në mënyrë të veçantë të industrisë së rëndë përpunuese, të bujqësisë dhe të transportit, rritjen e aftësisë vetëvepruese të ekonomisë popullore, forcimin e aftësisë mbrojtëse të vendit dhe ngritjen e mëtejshme të mirëqenies së popullit. Pjesa e të ardhurave kombëtare që drejtohet për rritjen e fondit të akumulimit të përbëjë 34-37 për qind. Fondi i konsumit të rritet 50-55 për qind kundrejt vitit 1970, duke qenë mbi 3 herë më lart se shtesa e popullsisë.

2. Në vitin 1975, kundrejt vitit 1970, të ardhurat reale për frymë të popullsisë të rriten 14-17 për qind. Gjatë pesëvjeçarit të pestë të vendoset sistemi i plotë i pensioneve dhe i sigurimeve shoqërore në kooperativat bujqësore. Qarkullimi i mallrave në tregtinë me pakicë në vitin 1975, kundrejt vitit 1970, të rritet 36-39 për qind. Të sigurohet rritja e mëtejshme e përdorimit për frymë të mallrave kryesore, sidomos e yndyrnave, mishit, qumshtit, vezëve, orizit, sheqerit, frutave, sapunit, pëlhurave të pambukta dhe stofave, këpucëve etj. Në mënyrë të veçantë të shtohet përdorimi për frymë i patateve dhe i perimeve. Përputhja e strukturës së mallrave në treg me kërkesat e popullit të jetë një nga detyrat më të rëndësishme në fushën e tregtisë. Të përmirësohet dhe të zgjerohet më tej rrjeti i tregtisë, sidomos ai i ushqimit social, duke përmirësuar shërbimin për punonjësit. Kujdes

i veçantë t'i kushtohet furnizimit më të mirë të fshatit me mallra industriale e ushqimore.

3. Gjatë pesëvjeçarit të ndërtohen nga shteti dhe me punë vullnetare rreth 40 mijë apartamente banimi. Në të njëjtën kohë, fshatarësia do të ndërtojë vetë rreth 40 mijë banesa.

4. Të zhvillohen në mënyrë të gjithanshme e të përmirësohen shërbimet komunale për popullin në qytet dhe në fshat. Sektorët e shërbimit të krijojnë kushte sa më të mira për përdorimin e dobishëm të kohës së lirë nga ana e punonjësve, për lehtësimin e punëve në familje, për rritjen e pjesëmarrjes së gruas në punë dhe për ngushtimin e mëtejshëm të dallimeve në mënyrën e jetesës midis popullsisë qytetare dhe asaj fshatare.

5. Zhvillimi i arsimit popullor të synojë, në radhë të parë, që shkolla jonë socialiste të ngrihet në një nivel më të lartë politik, ideologjik, organizativ, shkencor dhe pedagogjik, në përputhje me detyrat që ka shtruar Partia në këtë fushë. Në vitin 1975 numri i nxënësve dhe i studentëve në të gjitha kategoritë e shkollave të arrijë në rreth 780 mijë.

Të zgjerohet në mënyrë të ndjeshme arsimi parashkollor, sidomos në fshat, duke arritur që në vitin 1975 të tërhiqen në kopshtet rreth 50 për qind e fëmijëve të kësaj moshe. Të forcohet në të gjitha drejtimet arsimi 8-vjeçar dhe të sigurohet në vitet e ardhshme tërheqja në shkollë e të gjithë fëmijëve të moshës 6-vjeçare.

Të zgjerohet më tej arsimi i mesëm, veçanërisht në fshat, dhe në vitin 1975 të tërhiqen në shkollat e mesme, me shkëputje dhe pa shkëputje nga puna, mbi 60 për qind e nxënësve që mbarojnë shkollën 8-vjeçare. Të zhvillohet më tej arsimi i lartë me zgjerimin e fakulteteve të sotme, hapjen e degëve të reja dhe të shkollave të larta, ose të fakulteteve në rrethet kryesore. Gjatë pesëvjeçarit të mbarojnë shkollat e larta rreth 20 mijë veta dhe shkollat e mesme e profesionale rreth 42 mijë veta.

6. Kultura, letërsia dhe artet të zhvillohen më tej dhe të thellojnë përmbajtjen e tyre revolucionare, duke u mbështetur fort në metodën e realizmit socialist. Masivizimi i fizkulturës e i sporteve të jetë detyrë mbi bazën e së cilës të rritet cilësia sportive, të sigurohet një kalitje më e mirë fizike e ushtarake e rinisë dhe e masave punonjëse në qytet e në fshat.

7. Forcimi i gjithanshëm i karakterit parambrojtës të mjekësisë, shtimi i vëmendjes ndaj higjienës, sidomos në fshat, rritja e kujdesit ndaj nënës dhe fëmijës, fuqizimi i shërbimit sanitar antiepidemik, forcimi i vazhdueshëm i edukatës sanitare, zgjerimi dhe përmirësimi i punës në institucionet e ndryshme shëndetësore të përbëjnë detyrat kryesore në fushën e shëndetësisë. Çdo kooperativë bujqësore të ketë qendër shëndetësore. Në vitin 1975 numri i kuadrove të lartë mjekësorë të rritet 58 për qind.

8. Për të përballuar nevojat gjithnjë në rritje të zhvillimit të arsimit, kulturës, shëndetësisë e të shërbimeve komunale në fshat, shteti të ndihmojë me fonde shoqërore më shumë se deri sot.

Zhvillimi i revolucionit tekniko-shkencor dhe ngritja në një shkallë të re, më të lartë, e punës kërkimore-shkencore

Revolucioni tekniko-shkencor të synojë zhvillimin e bazës materialo-teknike të socializmit, përsosjen e mëtejshme të proceseve teknologjike dhe rritjen e efektivitetit të prodhimit shoqëror. Tipari themelor i zhvillimit të revolucionit tekniko-shkencor të jetë pjesëmarrja sa më e gjerë e masave punonjëse.

1. Kalimi gjithnjë e më shumë në prodhimin industrial e bujqësor modern, duke përdorur sa më mirë të gjitha mundësitë dhe mjetet për rritjen e prodhimit, zgjerimi i mekanizimit të proceseve të punës e të prodhimit dhe kalimi dora-dorës në automatizimin e proceseve të veçanta të tij, zgjerimi dhe thellimi i përqendrimit, i specializimit dhe i kooperimit të prodhimit të përbëjnë drejtimet kryesore të zhvillimit të revolucionit tekniko-shkencor.

2. Shkenca t'u përgjigjet më mirë kërkesave të sotme dhe të perspektivës së prodhimit. Puna shkencore t'i paraprijë zhvillimit të ekonomisë e kulturës dhe të gjejë zbatim sa më të gjerë. Tematika e punëve kërkimore-shkencore t'u përgjigjet më mirë detyrave themelore të zhvillimit socialist. Në punën shkencore të aktivizohen sa më shumë forca krijuese. Të organizohet më mirë puna për përhapjen e dijenive shkencore në masat e gjera punonjëse të qytetit dhe të fshatit. Të zgjerohen dhe të plotësohen bazat e domosdoshme studimore e laboratorike. Të merren masa për një kualifikim sistematik të kuadrit të lartë dhe të mesëm.

Për përsosjen e mëtejshme të drejtimit me plan të ekonomisë popullore

Përmirësimi i organizimit dhe i drejtimit shkencor të ekonomisë popullore të konsiderohet si një proces i pandërprerë revolucionar, që lidhet ngushtë me zhvillimin e forcave prodhuese, me përsosjen e marrëdhënieve socialiste në prodhim dhe me zhvillimin e anëve të tjera të revolucionit socialist.

1. Thellimi i mëtejshëm i vijës së masave në planifikim të synojë që punëtorët, kooperativistët dhe kuadrot, në mënyrë të vetëdijshme të marrin përsipër detyra sa më të mëdha. Të bëhet një punë më e organizuar për të thelluar njohjen e ligjeve eko-

nomike objektive të socializmit nga klasa punëtore dhe masat e tjera punonjëse, për të njohur e për të zbërthyer detyrat, parimet dhe kriteret e planifikimit të ekonomisë popullore. Të luftohet kurdoherë për një kuptim revolucionar të vijës së masave në drejtimin me plan të ekonomisë popullore, duke thelluar më tej luftën kundër shfaqjeve të burokratizmit e të teknokratizmit.

2. Të thellohet karakteri shkencor i planifikimit në të gjitha hallkat e shtetit dhe të ekonomisë. Të luftohet me këmbëngulje që caktimi i detyrave të zhvillimit ekonomik e kulturor dhe marrja e masave për zbatimin e tyre në ndërmarrjet, në kooperativat bujqësore, në institucionet dhe në degët e ndryshme të ekonomisë të mbështetet kurdoherë në kërkesat e ligjeve ekonomike objektive të socializmit, në përfundimet e arritura nga shkenca dhe teknika, në analizën e thellë dhe kritike të sukseseve e të metave, në mundësitë tona reale, në llogaritje të bazuara teknike-ekonomike dhe financiare. Hartimi dhe zbatimi i planeve të shtetit të përbëjnë kurdoherë një unitet të vetëm, një proces të pandërprerë.

3. Të forcohet vazhdimisht kontrolli mbi prodhimin dhe shpërndarjen, mbi sasinë e punës dhe shpërblimin e saj, si çështje thelbësore në të gjithë procesin e ndërtimit socialist të vendit.

4. Organet e Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë, organizatat e masave, drejtuesit, kuadrot të kuptojnë më thellë e të materializojnë kudo parimin revolucionar të mbështetjes në forcat e veta, t'u çelin masave horizonte të reja dhe t'i hedhin ato gjithmonë e më shumë në aksione konkrete, duke vënë kurdoherë politikën proletare në plan të parë.

*
* *

Fitoret e arritura në zhvillimin e përgjithshëm politik, ideologjik, ekonomik dhe shoqëror të vendit në rrugën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste janë të mëdha e të gjithanshme. Kudo zotërojnë fryma e aksionit, hovi dhe optimizmi revolucionar për të ardhmen. Me planin e pestë pesëvjeçar hapen perspektiva të reja, të mrekullueshme, për të ecur më përpara drejt ndërtimit të socializmit dhe të komunizmit. Në këtë rrugë të lavdishme populli ynë ka mbështetjen dhe ndihmën e popullit vëlla kinez.

Gjatë pesëvjeçarit do të rriten aftësia mbrojtëse e vendit, gatishmëria dhe përgatitja politike dhe ushtarake e mbarë popullit, do të modernizohen më tej forcat e armatosura, me qëllim që atdheu ynë të jetë kurdoherë kështjellë e pamposhtur e socializmit në brigjet e Adriatikut.

Kongresi i 6-të i PPSH shpreh bindjen e thellë se, nën udhëheqjen e Partisë dhe në unitet të plotë moralo-politik, masat punonjëse do të mobilizojnë të gjitha energjitë fizike e mendore dhe, me frymë të lartë revolucionare, me vrull të pandalshëm dhe me heroizëm masiv në punë, do t'i vënë në jetë këto direktiva. Duke ecur me vendosmëri në këtë rrugë, populli ynë, i udhëhequr me besnikëri nga Partia dhe Komiteti Qendror i saj me shokun Enver Hoxha në krye, do ta thellojë e do ta zhvillojë më tej revolucionin socialist drejt ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste.

Botohet sipas librit: «Kongresi i 6-të i PPSH» (Përmbledhje materialesh). Tiranë, 1972

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 270 (7247), 10 nëntor 1971

VENDIM
I KONGRESIT TË 6-TË TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË MBI APROVIMIN E DIREKTIVAVE TË PLANIT TË PESTË PESËVJEÇAR TË ZHVILLIMIT EKONOMIK E KULTUROR TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

6 nëntor 1971

Kongresi i 6-të i Partisë së Punës të Shqipërisë, pasi shqyrtoi projektdirektivat mbi planin e pestë pesëvjeçar,

Vendosi:

Të aprovojë direktivat mbi planin e pestë pesëvjeçar të zhvillimit ekonomik e kulturor të Republikës Popullore të Shqipërisë për vitet 1971-1975, të cilat të shërbejnë si bazë për hartimin e planit të pestë pesëvjeçar.

KONGRESI I 6-TË I PPSH

Botohet sipas librit: «Kongresi i 6-të i PPSH» (Përmbledhje materialesh). Tiranë, 1972

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 267 (7244), 7 nëntor 1971

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË PLENUMIT TË 1-RË TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 7 nëntor 1971

Rendi i ditës:

Zgjedhja e organeve të Komitetit Qendror — Byrosë Politike, Sekretariatit dhe Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror.

Mbledhja u bë menjëherë porsa u shpallën rezultatet e votimeve që u bënë në Kongresin e 6-të. Në mbledhje, të cilën e hapi shoku Enver Hoxha, ndodheshin të pranishëm të gjithë anëtarët e Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Të dashur shokë dhe shoqe,

Kongresi ynë i 6-të i Partisë, që sot është duke mbaruar punimet e tij, ishte një Kongres i mrekullueshëm. Aty u shpreh edhe një herë, me të gjithë forcën e pamposhtur revolucionare, uniteti i çeliktë i Partisë, që përfaqësohej nga delegatët e zgjedhur dhe u afirmua vija e drejtë e papërkulur e konsekuente marksiste-leniniste, vija politike, ideologjike, ekonomike, kulturore dhe ushtarake e Partisë sonë heroike. Ky Kongres, si gjithë kongreset e tjera, përbën një ngjarje nga më të rëndësishmet në historinë e lavdishme të Partisë dhe të popullit tonë. Vendimet që u morën aty do të jenë një frymëzim i ri për popullin tonë, për klasën punëtore, për fshatarësinë kooperativiste, për intelektualët, për gratë, për të rinjtë, me një fjalë për të gjitha masat punonjëse të popullit, të cilat do të shumëfishojnë forcat dhe energjitë e tyre për të zbatuar deri në fund politikën e drejtë jetëdhënëse të Partisë.

Kongresi i 6-të na zgjodhi ne në udhëheqje të Partisë. Ky është një nder jashtëzakonisht i madh që na bëhet, por njëkohësisht na ngarkon me përgjegjësi e detyra shumë të mëdha, të

rëndësishme e fisnike, të cilat ne, si kurdoherë, do t'i mbajmë mbi supet tona sa të kemi jetë, si ushtarë besnikë të Partisë. Ne do të vëmë të gjitha forcat për të kryer me nder detyrat që na janë ngarkuar si ushtarë të thjeshtë, duke u bërë shembull për të gjithë shokët komunistë, kuadrot dhe punonjësit tanë, duke qenë të parët në sakrifica dhe të fundit në pretendime. Titulli i anëtarit të plenumit kurrë dhe askujt të mos i shërbejë për t'u dukur e për të dalë mbi të tjerët, por vetëm për të kryer detyrat e funksionet me përgjegjësi që na ngarkoi Kongresi.

Të gjithë shokët e zgjedhur në Plenumin e KQ të Partisë nga Kongresi i 6-të janë të pranishëm, prandaj mbledhjen e Plenumit të 1-rë të Komitetit Qendror të Partisë e konsiderojmë të hapur. Në rendin e ditës, kemi, sipas rregullave, zgjedhjen e Byrosë Politike dhe të Sekretariatit të Komitetit Qendror të Partisë.

Në emër të një grupi shokësh më lejoni t'i bëj tani plenumit të porsazgjedhur propozimet për të cilat jam ngarkuar.

Siç e dini, Byroja Politike që kishim përbëhej nga 11 anëtarë dhe 5 kandidatë. Mirëpo, duke marrë parasysh zgjerimin e Partisë, dhe si rrjedhim edhe zgjerimin e vetë Plenumit të Komitetit Qendror, ne kemi menduar t'i propozojmë Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë që Byroja e re Politike të përbëhet prej 13 anëtarësh dhe 4 kandidatësh, ndërsa Sekretariati nga 4 sekretarë të Komitetit Qendror, njëri nga të cilët të jetë Sekretar i Parë. Jeni dakord me këtë përbërje?

Të gjithë anëtarët e Plenumit të ri të Komitetit Qendror të Partisë u shprehën njëzëri dakord me propozimin e shokut Enver Hoxha që Byroja Politike e re të jetë me 13 anëtarë dhe 4 kandidatë, ndërsa Sekretariati i Komitetit Qendror të Partisë të mbetet siç ka qenë me 4 sekretarë të KQ, njëri nga të cilët Sekretar i Parë i KQ.

Pastaj shoku Enver Hoxha, në emër të një grupi shokësh, propozoi anëtarët dhe kandidatët e Byrosë Politike si dhe Sekretariatin e Komitetit Qendror. Të gjithë shokët u shprehën njëzëri dakord.

SHOKU MEHMET SHEHU: Edhe unë në emër të po atij grupi shokësh propozoj që Sekretar të Parë të Komitetit Qendror të PPSH të zgjedhim shokun Enver Hoxha.

Të gjithë anëtarët e Plenumit të Komitetit Qendror ngrihen në këmbë dhe me duartrokitje të zjarrta aprovojnë njëzëri propozimin e shokut Mehmet Shehu që shoku Enver Hoxha të jetë Sekretar i Parë i Komitetit Qendror.

SHOKU ENVER HOXHA: Në emër të Byrosë Politike dhe të Sekretariatit të Komitetit Qendror siguroj Plenumin se ne do të jemi në radhët e para të luftës, të vendosur deri në vdekje, për t'i shërbyer Partisë dhe popullit me të gjitha forcat tona, me vetëmohim, me guxim e vendosmëri dhe në unitet të plotë.

Me kaq mbledhjen e parë të Plenumit të KQ të PPSH e deklaroj të mbyllur. Tani do të kthehemi përsëri në sallën e Kongresit për t'u komunikuar delegatëve rezultatet e zgjedhjeve që bëmë këtu.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Plenumit të KQ të PPSH, që gjendet në AQP